

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në Evropën Juglindore dhe perspektivat e Konventës së HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në Evropën Juglindore dhe perspektivat e Konventës së HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Botuar nga

Deutsche Gesellschaft für

Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Selitë e regjistruara

Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma ligjore
Str. Pirinska 52

1000 Shkup, Maqedoni e Veriut

Telefon +389 2 3103 588

www.giz.de

Data e botimit

Nëntor 2021

Dizajni

Dal Kompani - Shkupi

Shtypjen

Printers office

Tekstet e hartuara

Aida Gugu Bushati

Meliha Povlakić

Donikë Qerimi

Maja Kostić-Mandić

Ilija Rumenov

Slavko Đorđević

Në emër të

Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ)

Përmbajtja e këtij Libri pasqyron opinionin, përvojën dhe pikëpamjet personale të autorëve dhe nuk lidhet me qëndrimin dhe politikën e redaktimit të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose me asnjë mjet, elektronik ose mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose sistemet e ruajtjes dhe nxjerrjes së informacionit, pa lejen me shkrim nga Botuesi, me përjashtim të përfshirjes së citimeve të shkurtra në një rishikim.

Parathënie

Ekzekutimi në fushën e vendimeve gjyqësore ndërmjet shteteve ka marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe përgjatë viteve. Tregtia dhe shkëmbimet tregtare në nivel ndërkombëtar janë rritur gradualisht dhe numri i njerëzve që jetojnë jashtë vendeve të tyre të lindjes vijon të rritet. Njohja e vendimeve të huaja gjyqësore dhe ekzekutimi i tyre kursejnë kohë dhe kosto gjyqësore, si dhe nuk ekziston më nevoja për ta rigjykuar të njëjtën mosmarrëveshje ndërmjet të njëjtave palë në gjykatën e një shteti tjetër. Qysh prej nisjes së procesit të integritimit evropian, njohja e ndërsjellë e vendimeve gjyqësore ka qenë një komponent jetik i bashkëpunimit në fushën e së drejtës civile.

Ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore (EJL), si vende në prag të aderimit në BE, janë angazhuar në reforma progresive të sistemeve të tyre gjyqësore me synimin parësor të forcimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe të profesionalizmit të gjyqësorit në përmbushjen e standardeve evropiane për gjyqtarët. Bashkëpunimi më i ngushtë gjyqësor ndërmjet autoriteteve në EJL, i cili bazohet mbi parimin e njohjes së ndërsjellë dhe në besimin reciprok, mund të ndihmojë me kapërcimin e kompleksiteteve të sistemeve të ndryshme në rajon dhe të ndërtojë ura lidhjeje mes juridiksioneve të ndryshme.

Konventa e vitit 2019 “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare” (Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”) do të nxisë forcimin e bashkëpunimit gjyqësor në njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare, si dhe do të garantojë një siguri ligjore në marrëdhëniet tregtare ndërmjet shteteve. Harmonizimi dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve në çështjet civile dhe tregtare mes sistemeve gjyqësore në vendet e Evropës Juglindore, pa diskutim që do t’i bëjë procedurat më pak komplekse dhe më pak të gjata, por edhe do të reduktojë rrënjësisht kostot financiare.

Me synimin për të zbatuar kërkime të thelluara mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve, raportet kombëtare u hartuan për të analizuar sistemet aktuale juridike, strukturën institucionale, praktikat ligjore dhe pengesat ekzistuese në vendet e Evropës Juglindore.

Ky botim përmbledh gjashtë raportet kombëtare dhe jep një panoramë gjithëpërfshirëse të qëllimit të zbatimit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore; të kuadrit ligjor dhe institucional; të llojeve të vendimeve gjyqësore që kualifikohen për njohje dhe ekzekutim; të pajtueshmërisë së dispozitave kombëtare për juridiksionin ndërkombëtar me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”; të procedurës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore; të burimeve dhe aktorëve kryesorë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe miratimin e Konventës së HCCH-së së vitit 2019; si dhe të partnerëve kryesorë tregtarë për import dhe eksport në çdo vend të EJL-së.

Ne shpresojmë se ai do të rrisë nivelin e rëndësisë së ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve dhe do t’i nxisë autoritetet përgjegjëse, komunitetin ligjor dhe gjyqësorin në vendet e EJL-së që të vlerësojnë e marrin në konsideratë perspektivat dhe avantazhet që mund të sjellë Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” për rajonin në tërësi.

Dr. Veronika Efremova

Menaxhere e Lartë e Projektit të GIZ

Përmbajtja

Parathënie..... 6

Raport kombëtar: Shqipëria 16

Përmbledhje ekzekutive..... 17

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 17

1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore..... 17

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor..... 19

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 20

2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 20

2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 21

2.2.1 Gjykatat..... 21

2.2.2 Institucionet administrative 22

2.2.3 Përfaqësuesit ligjorë..... 22

2.2.4 Agjentët zbatues..... 22

2.2.5 Aktorë të tjerë të rëndësishëm..... 23

2.3 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve..... 23

3. Roli i gjykatave dhe i agjentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 23

3.1 Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore..... 24

3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore..... 24

3.3 Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve..... 25

3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor..... 25

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 26

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport..... 26

4.1.1 Importi..... 26

4.1.2 Eksporti..... 27

4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 27

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 28

4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 28

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 29

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar 29

5.2 Caktimi i juridiksionit me marrëveshje 29

5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kritereve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare..... 30

5.4 Juridiksioni ekskluziv..... 31

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”..... 32

6.1 Qëllimi material i zbatimit	32
6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	33
6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen	33
6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)	33
6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore	33
6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	34
6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	37
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore	38
7.1 Lloji i procedurës përbarimore	38
7.2 Procedura përbarimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj	39
8. Referenca	39
Raport kombëtar: Bosnjë-Hercegovina	42
Përmbledhje ekzekutive	43
1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	47
1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore	47
1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor	51
2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	52
2.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	52
2.2. Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	53
2.2.1. Gjykatat	53
2.2.2. Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore, etj.)	54
2.2.3. Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.)	54
2.2.4. Agjentët zbatues	54
2.2.5. Aktorë të tjerë të rëndësishëm	54
2.3. Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve	55
3. Roli i gjykatave dhe i agentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	55
3.1. Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	55
3.2. Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	56
3.3. Kapacitetet e agentëve zbatues lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	58
3.4. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor	58
4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	61
4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport	61
4.1.1 Importi	62
4.1.2 Eksporti	63
4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	63

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	64
4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklarata në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	65
5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	65
5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)	65
5.2 Kaktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur, i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës)	66
5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	67
5.4 Juridiksioni ekskluziv	69
6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	70
6.1 Qëllimi material i zbatimit	70
6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	70
6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përcohshme)	72
6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)	73
6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore	74
6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	75
6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	76
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore	77
7.1 Lloji i procedurës përbarimore	77
7.2 Procedura përbarimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj	77
8. Referenca	78
Raport kombëtar: Kosova	84
Përmbledhje ekzekutive	85
1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	85
2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	87
2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore që përcaktojnë palët e interesit në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	87
2.2 Palët e interesit që e zbatojnë në praktikë njohjen ndërmjet shteteve dhe vendimet e huaja gjyqësore	88
2.2.1. Gjykatat	88
2.2.2 Institucionet administrative	88
2.2.3 Juristët - avokatët dhe noterët	88
2.2.4 Përbaruesit privatë	89
3. Roli i gjykatave dhe përbaruesve privatë në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	89
4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	91
4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport	91
4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	92
5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH të vitit 2019 "për vendimet gjyqësore"	93

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi).....	93
5.1.1. Pluraliteti i palëve.....	97
5.2 Prorogimi i juridiksionit (drejtpërdrejtë/tërthorazi, para ose pas fillimit të procedurës).....	97
5.2.1. Prorogimi i juridiksionit përmes marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës kompetente.....	97
5.2.1.1 Prorogimi i juridiksionit të paraparë në Projektligjin e ri të DNP në Kosovë.....	99
5.2.2. Pëlqimi i shprehur dhe i nënkuptuar	100
5.3 Pajtueshmëria e kriterëve të tjera të juridiksionit në Konventë me Ligjin e DNP të Kosovës.....	102
5.3.1. Juridiksioni i bazuar në aktivitetet e degës, agjencisë ose një institucioni tjetër.....	102
5.3.2. Juridiksioni i bazuar në vendin e realizimit të një detyrimi kontraktor.....	103
5.3.3. Juridiksioni i bazuar në detyrimet jokontraktore.....	107
5.4 Juridiksioni ekskluziv.....	108
6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	109
6.1 Fushëveprimi material i zbatimit.....	109
6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme).....	109
6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake).....	110
6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.....	111
6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.....	111
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore.....	114
8. Referenca.....	114
Raport kombëtar: MALI I ZI.....	118
Përmbledhje ekzekutive.....	119
1. Kuadri ligjor për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	119
1.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore.....	120
1.2. Vlerësimi i kuadrit ligjor	121
2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	121
2.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	121
2.2. Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	122
2.2.1. Gjykatat.....	122
2.2.2. Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.).....	122
2.2.3. Juristët (avokatët, përfaqësuesit ligjorë etj.).....	122
2.2.4. Agjentët zbatues.....	123
2.2.5. Aktorë të tjerë të rëndësishëm.....	123
2.3. Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve.....	124
3. Roli i gjykatave dhe agjentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	124
3.1. Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore.....	124
3.2. Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore.....	124
3.3. Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	125

3.4. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor.....	125
4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	126
4.1. Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport.....	127
4.1.1. Importi.....	127
4.1.2. Eksporti.....	127
4.2. Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	128
4.2.1. Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	128
4.2.2. Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	128
5.1. Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm).....	130
5.2. Caktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur/i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës).....	130
5.3. Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare.....	132
5.4. Juridiksioni ekskluziv.....	134
6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".....	135
6.1. Qëllimi material i zbatimit.....	135
6.1.1. Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	135
6.2. Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh., vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme).....	137
6.3. Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake).....	137
6.4. Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.....	138
6.5. Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.....	138
6.6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.....	140
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore.....	141
7.1. Lloji i procedurës përbarimore.....	141
7.2. Procedura përbarimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me një vendim të gjykatës së huaj.....	141
8. Referenca.....	141
Raport kombëtar: Republika e Maqedonisë së Veriut.....	144
Përmbledhje ekzekutive.....	145
1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile.....	146
1.1 Përmbledhje e dispozitave kushtetuese dhe ligjore	146
1.1.1 Burimet ligjore kombëtare.....	146
1.1.1.1. Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	146
1.1.1.2 Dispozitat e LDNP 2020 në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja.....	147
1.1.2 Burimet ligjore ndërkombëtare.....	147
1.1.2.1 Marrëveshjet bilaterale.....	147
1.1.2.2 Marrëveshjet multilaterale.....	148

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor.....	149
2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile.....	152
2.1 Pasqyrë e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile	152
2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve civile ndërmjet shteteve	152
2.2.1 Gjykatat.....	152
2.2.2 Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.).....	153
2.2.3 Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.).....	153
2.2.4 Përmbauesit.....	153
2.3 Aktorët përgjegjës për zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019.....	154
2.3.1 Ministrinë dhe institucionet e tjera.....	154
2.3.2 OJQ-të	155
2.3.3 Akademia.....	156
2.3.4 Aktorë të tjerë të rëndësishëm.....	156
2.4 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve	156
2.4.1 Aktorët me rëndësi për procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore.....	156
2.4.2 Aktorët me rëndësi për procedurën e miratimit të Konventës së Hagës të vitit 2019.....	157
3. Roli i gjykatave dhe i përmbauesve në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile.....	157
3.1 Kapacitetet e gjykatave për njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore.....	157
3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore.....	157
3.3 Kapacitetet e përmbauesve lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	159
3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor	159
4. Aspektet ekonomike dhe politike në lidhje me zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019	159
4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport.....	159
4.1.1 Importi.....	160
4.1.2 Eksporti	160
4.2 Aspektet politike në lidhje me zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019.....	161
4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së Hagës të vitit 2019	161
4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së Hagës të vitit 2019.....	161
5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e Hagës të vitit 2019.....	162
5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm).....	162
5.2 Prorogimi i juridiksionit (drejtpërdrejtë/tërthorazi, para ose pas fillimit të procedurës).....	163
5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kritereve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	164
5.3.1 Vendi kryesor i biznesit (person fizik).....	164
5.3.2 Paraqitja e një padie në procesin kryesor - paditësi.....	164
5.3.3 Dega, agjencia ose institucionet e tjera.....	165
5.3.4 Detyrimet kontraktore	165
5.3.5 Detyrimet jokontraktore	166

5.3.6 Trustet.....	166
5.3.7 Kundërpaditë	166
5.3.8 Kontratat e konsumatorëve dhe kontratat e punës.....	166
5.4 Juridiksioni ekskluziv.....	167
5.4.1 Kriteri juridiksional për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar lidhur me të drejtat reale (in rem) në pronën e paluajtshme	168
6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e Hagës të vitit 2019.....	169
6.1 Fushëveprimi material i aplikimit	169
6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e fushëveprimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	169
6.2 Llojet e vendimeve gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme).....	171
6.3 Fillimi i procedurës (si çështje kryesore ose paraprake) – juridiksioni i gjykatave të Maqedonisë së Veriut lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.....	171
6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat formale) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.....	172
6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.....	172
6.5.1 Kushtet e përcaktuara ex officio.....	172
6.5.1.1 Certifikata e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë	172
6.5.1.2 Juridiksioni ekskluziv	173
6.5.1.3 Juridiksioni i tepruar i gjykatës së huaj.....	173
6.5.1.4 Vendimi i formës së prerë për të njëjtën çështje mes palëve të njëjta.....	173
6.5.1.5 Rendi publik.....	173
6.5.2 Kushtet e përcaktuara pas kundërshtimit të palëve.....	174
6.5.3 Bazuar në nenin 7, paragrafi 1 dhe 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kushteve për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare (kushtet kombëtare për njohje dhe ekzekutim janë më të favorshme ose më kufizuese në krahasim me kushtet e parashikuara në nenin 7 të Konventës së Hagës të vitit 2019).....	174
6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	176
6.7 Kostot e procedurave.....	178
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore	178
7.1 Lloji i procedurës përmbauese	178
7.2 Procedura përmbauese në situatat kur përmbauesit përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj.....	178
8. Referenca	179
Shtojca 1 – Fjalorth.....	182
Shtojca 2 – Model për shembuj të praktikave të mira.....	183

Raport kombëtar: Republika e Serbisë..... 186

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	187
1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore.....	187
1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor.....	188
2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	189
2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.....	189

2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	190
2.2.1 Gjykatat	190
2.2.2 Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.)	190
2.2.3 Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.)	191
2.2.4 Agjentët zbatues	191
2.3 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve	191
3. Roli i gjykatave dhe i agjentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	192
3.1 Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	192
3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore	192
3.3 Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve	192
3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor	192
4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	193
4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport	193
4.1.1 Importi	193
4.1.2 Eksporti	193
4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	193
4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	193
4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	194
5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	194
5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)	194
5.2 Caktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur/i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës)	195
5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	195
5.3.1 Vendqëndrimi i zakonshëm	196
5.3.2 Vendi kryesor i biznesit	197
5.3.3 Paraqitja e një kërkesëpadie në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin	198
5.3.4 Dega, agjencia ose institucionet e tjera	198
5.3.5 Miratimi i juridiksionit të gjykatës që ka dhënë vendimin dhe marrëveshja për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës	198
5.3.6 Vendi i përmbushjes së detyrimit kontraktor	199
5.3.7 Vendndodhja e pasurisë së paluajtshme me qira	199
5.3.8 Detyrimi kontraktor i siguruar me një të drejtë reale (in rem)	199
5.3.9 Vendi i veprimit ose mosveprimit në çështjet që lidhen me detyrimet jokontraktore	200
5.3.10 Trustet	200
5.3.11 Kundërpaditë	200
5.3.12 Kontratat konsumatore dhe të punës	201
5.3.13 Kriteret e tjera për juridiksionin e drejtpërdrejtë të gjykatave serbe në kuadër të Konventës së HCCH-së të	

vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	201
5.4 Juridiksioni ekskluziv	201
6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"	202
6.1 Qëllimi material i zbatimit	202
6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare	202
6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkozhshme)	203
6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)	203
6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore	204
6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	204
6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore	206
7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore	207
7.1 Lloji i procedurës përmbartimore	207
7.1.1. Faza e parë	207
7.1.2. Faza e dytë	208
7.2 Procedura përmbartimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj	208
8. Referenca	209

RAPORT KOMBËTAR: SHQIPËRIA

Autore

Aida Gugu Bushati

Përmbledhje ekzekutive

Konventa “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare (Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”)", u miratua më 2 korrik 2019 për të lehtësuar qarkullimin efikas të vendimeve gjyqësore në nivel ndërkombëtar të çështjeve civile ose tregtare. Procesi i ratifikimit nga palët nënshkruese pasohet nga miratimi, me qëllim që të garantohet zbatimi dhe efikasiteti i konventës.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të merret në analizë kuadri ligjor dhe institucional në Shqipëri lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve, për ta mbështetur Shqipërinë që të shkojë drejt një vendimmarrjeje të informuar mbi ratifikimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Studimi ofron një vështrim të përgjithshëm të qëllimit të zbatimit të rregullave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në Shqipëri në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”; të përputhshmërisë së dispozitave kombëtare për juridiksionin ndërkombëtar dhe të kushteve për njohjen dhe ekzekutimin me dispozitat e parashikuara në konventë; të procedurave dhe dokumenteve që duhet të hartohen; të aktorëve kryesorë të përfshirë në proces dhe të partnerëve kryesorë tregtarë.

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri rregullohen përmes dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe marrëveshjeve dypalëshe të ratifikuara nga Shqipëria. Reciprociteti përjashtohet si kusht për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Në përgjithësi, kuadri aktual ligjor është në përputhje me rregullat dhe kushtet e specifikuar në Konventë, dhe procesi i njohjes dhe ekzekutimit është efikas dhe jo shumë i komplikuar.

Shqipëria është pjesë e shumë iniciativave që nxisin tregtinë e lirë rajonale dhe dypalëshe. Shqipëria është vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është në fuqi që prej vitit 2009. Shtetet anëtare të BE-së dhe vendet fqinje mbeten partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë.

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri rregullohen përmes dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (KPC)¹ dhe marrëveshjeve ndërkombëtare/dypalëshe të ratifikuara nga Shqipëria. Reciprociteti përjashtohet nga KPC si kusht për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja.

Në nenet 393-399 të KPC-së parashtrohen rregullat dhe procedurat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri. Si rregull, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore mbështeten në kushtet e përcaktuara nga KPC dhe ligjet e veçanta (neni 393, paragrafi 1 i KPC-së). Megjithatë, në rastet kur është nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare e posaçme, do të zbatohen dispozitat e asaj marrëveshjeje (neni 393, paragrafi 2 i KPC-së). Kushtetuta e Shqipërisë i jep përparësi zbatimit të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, pasi këto të fundit kanë epërsi mbi ligjet e brendshme me probleme përputhshmërie. Ato janë direkt të zbatueshme, me përjashtim të rasteve kur ato përmbajnë dispozita që nuk janë të vetëzbatueshme dhe të cilat kërkojnë nxjerrjen e një ligji (neni 122 i Kushtetutës)².

Shqipëria është pjesë e disa konventave dypalëshe dhe shumëpalëshe të cilat trajtojnë tematikën

¹ Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 138, datë 7.12.1998, i ndryshuar

² Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 9, 10 dhe 11/1996, i ndryshuar

e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Anëtarësimi i Shqipërisë në Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private daton që prej 4 qershorit të vitit 2002. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e datës 1 qershor 1970 “Për njohjen e divorceve dhe të ndarjeve ligjore”; Konventën e Hagës të datës 19 tetor 1996 “Për të drejtën ndërkombëtare private mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”. Shqipëria ka aderuar në Konventën e Hagës së vitit 1971 “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”³. E megjithatë, ky instrument ndërkombëtar nuk rezultoi i suksesshëm dhe, kësisoj, nuk u zbatua në Shqipëri.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe të cilat përmbajnë dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore civile dhe tregtare. Momentalisht janë në fuqi marrëveshjet vijuese dypalëshe: Marrëveshja me Greqinë “Për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale” (1993);⁴ Marrëveshja me Federatën Ruse “Për ndihmë juridike në fushën civile, penale dhe familjare” (1996);⁵ Marrëveshja me Maqedoninë e Veriut “Për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale” (1998);⁶ Marrëveshja me Turqinë “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe tregtare” (1995);⁷ Marrëveshja me Rumaninë “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare” (1961);⁸ Marrëveshja me Hungarinë “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare” (1960);⁹ Marrëveshja me Bullgarinë “Për ndihmë juridike në çështjet civile” (2005).¹⁰ Këto marrëveshje dypalëshe rregullojnë bashkëpunimin mes vendeve në çështjet civile, tregtare dhe penale, si edhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në vendet përkatëse.

Pavarësisht ligjit të zbatueshëm për një çështje të caktuar, nevojitet gjithmonë vendimi nga një gjykatë e apelit në Shqipëri (*Exequatur*) me qëllim që t'i japë fuqi dhe të ekzekutojë një vendim të huaj gjyqësor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Andaj, kërkesa për t'i dhënë fuqi ligjore një vendimi të huaj dorëzohet pranë gjykatës së apelit (neni 395 i KPC-së), qoftë nga palët ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike, kur kjo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e parimit të reciprocitetit (neni 395, paragrafi 1 i KPC-së). Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar një përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën për llogari të tij (neni 395, paragrafi 2 i KPC-së).

Marrëveshjet dypalëshe të renditura më sipër, ofrojnë gjithashtu mundësinë për ta dorëzuar kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë të vendit që e ka dhënë vendimin. Në këtë rast, autoritetet qendrore të parashikuara në marrëveshje (Ministritë e Drejtësisë) janë kompetente për ta përcjellë kërkesën në bazë të procedurave të parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe.¹¹

Në përputhje me nenin 396 të KPC-së, kërkesa për njohjen e vendimit gjyqësor të një shteti të huaj duhet të shoqërohet me një kopje të vendimit që duhet të ekzekutohet, me një vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, me një prokurë, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i palës së interesuar, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.¹² Krahas dokumenteve të lartpërmendura, marrëveshjet dypalëshe u kërkojnë palëve që të paraqesin një vërtetim i cili

3 Miratuar me ligjin nr. 10 194, datë 10.12.2009

4 Ligji nr. 7760, datë 14 tetor 1993, Fletorja Zyrtare nr. 12, e vitit 1993

5 Ligji nr. 8061, datë 8 shkurt 1996, Fletorja Zyrtare nr. 2, e vitit 1996

6 Ligji nr. 8304, datë 12 mars 1998, Fletorja Zyrtare nr. 7, e vitit 1998

7 Ligji nr. 8036, datë 22 nëntor 1995, Fletorja Zyrtare nr. 25, e vitit 1995

8 Dekreti nr. 3250, datë 17 prill 1961, Fletorja Zyrtare nr. 6, e vitit 1962

9 Dekreti nr. 3119, datë 6 qershor 1960, Fletorja Zyrtare nr. 3, e vitit 1961

10 Ligji nr. 9348, datë 24 shkurt 2005, Fletorja Zyrtare nr. 19, e vitit 2005

11 Neni 26 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Greqisë, neni 24 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

12 Në praktikë, vula apostille për dokumentet e paraqitura përgjatë procesit të njohjes dhe të zbatimit, nuk lëshohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, por nga Ministria e Punëve të Jashtme të vendit ku ndodhet gjykata e cila ka dhënë vendimin.

vërteton se pala është njoftuar dhe përfaqësuar siç duhet në proces.¹³

KPC ka një dispozitë specifike (neni 394) e cila tregon kushtet që duhet të plotësojë një vendim i huaj gjyqësor me qëllim që të njihet dhe të ekzekutohet në Shqipëri. Këto kushte përfshijnë autenticitetin e vendimit për të cilin kërkohet njohja, me qëllim krijimin e besimit se vendimi ka marrë formë të prerë dhe ka efektet e *res judicata* në shtetin e origjinës, dhe se legjitimiteti i palës ndërgjyqëse që pretendon njohjen duhet të merret në konsideratë. Refuzimi i njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të huaj mbështetet në parimet e rendit publik dhe të procesit të rregullt ligjor (neni 394 i KPC-së). Togfjalëshi “për t'i dhënë fuqi vendimit të huaj” në nenin 394 të KPC-së, nuk bën dallim mes njohjes dhe ekzekutimit. Arsyet për refuzim që janë renditur në nenin 394 të KPC-së, vlejnë si për proceset e njohjes dhe ato të ekzekutimit.

Në përgjithësi, marrëveshjet dypalëshe kanë arsye të ngjashme për refuzimin e njohjes me ato të parashikuara në KPC, të tilla si mungesa e juridiksionit të gjykatës, mangësitë në procesin e rregullt ligjor, *res judicata* dhe *lis pendens*, shkelja e rendit publik, janë ndër arsyet e përbashkëta të refuzimit që gjenden në marrëveshjet e ndryshme dypalëshe të nënshkruara nga Shqipëria.¹⁴

Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore është objekt i dispozitave të përgjithshme të ekzekutimit të cilat parashikohen në Kodin e Procedurës Civile (neni 510 e në vijim i KPC-së). Neni 510 i KPC-së përcakton se ekzekutimi mund të bëhet mbi bazën e titujve ekzekutivë që renditen në këtë nen. Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja janë tituj ekzekutivë në momentin që atyre u jepet fuqi në bazë të dispozitave të parashikuara në KPC (neni 510, germa “c” e KPC-së). Titulli ekzekutiv vihet në zbatim me kërkesë të kreditorit (neni 511 i KPC-së). Legjislacioni shqiptar parashikon ekzekutim vullnetar të titujve, ndërsa ekzekutimi i detyrueshëm mund të kryhet vetëm pasi të kenë kaluar afatet për ekzekutimin vullnetar. Ekzekutimi i detyrueshëm mund të fillojë përpara kalimit të afateve për ekzekutimin vullnetar vetëm në rastet kur ka rrezik që ekzekutimi të bëhet i pamundur (neni 517 dhe 519 të KPC-së).

Kërkesa e kreditorit duhet që të shoqërohet nga titulli ekzekutiv (titulli origjinal dhe i noterizuar sipas ligjit), pagesa e tarifës së vënies në ekzekutim dhe prokura e personit që përfaqëson palën kreditore (neni 510 i KPC-së). Urdhri duhet të ekzekutohet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës nga kreditori (neni 515 i KPC-së).

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor

Rregullat dhe procedurat shqiptare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore parashikojnë një sistem të ngjashëm me atë të parashikuar në konventat ndërkombëtare ose në çdo legjislacion tjetër të brendshëm. Praktika e gjykatave shqiptare tregon se procesi i njohjes dhe i ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore nuk është i gjatë dhe i komplikuar. Megjithatë, është e vështirë që të parashikohet rezultati dhe kohëzgjatja e procesit të ekzekutimit, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm.

Pavarësisht kësaj, kuadri ekzistues ligjor ka disa kufizime. Ai jep vetëm mundësinë e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore dhe të asnjë titulli tjetër ekzekutiv të lëshuar jashtë Shqipërisë, të tillë si instrumentet autentike. Për më tepër, ai nuk mundëson as ekzekutimin e masave të përkohshme që janë marrë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,¹⁵ dhe as nuk lejon ekzekutimin e marrëveshjeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat përbëjnë titull ekzekutiv sipas vendimit të huaj.¹⁶

13 Neni 22 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, neni 22 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Turqisë.

14 Neni 22 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë, neni 21 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, neni 24 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Greqisë.

15 Përjashtim në këtë rast është Marrëveshja mes Shqipërisë dhe Bullgarisë “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”, ku në nenin e saj 19 parashikon se termi “vendim gjyqësor”, i cili mund të njihet dhe të ekzekutohet, nënkupton si vendimet e formës së prerë, ashtu edhe ato të ndërmjetme.

16 Kola, F. and Çinari. “Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil and Commercial Matters in Albania,” in *Brussels I bis Regulation and Special Rules: Opportunities to Enhance Judicial Cooperation*. Edited by C.E. Tuo, L. Carpaneto, S. Dominelli, March 2021.

https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules.pdf

Gjithashtu, ndërkohë që juridiksioni ndërkombëtar rregullohet në kontekstin e Ligjit të së Drejtës Ndërkombëtare Private të Shqipërisë (LDNPSH),¹⁷ për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja do të zbatohen dispozitat e KPC-së. Ky rregullim është në kontrast jo vetëm me të Drejtën Evropiane të procedurës civile ndërkombëtare, e cila rregullon gjithmonë juridiksionin ndërkombëtar dhe njohjen së bashku, por edhe me rregullimin që përdoret nga ligjet e tjera të brendshme në vendet evropiane. LDNPSH mundëson një regjim më liberal krahasuar me ato që parashikohen në KPC.¹⁸ Në fakt, rregulloret e BE-së në fushën e së drejtës ndërkombëtare private dhe të së drejtës procedurale ndërkombëtare patën një ndikim të madh në reformën e vitit 2011 të së drejtës ndërkombëtare private në Shqipëri,¹⁹ lidhur me ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore dhe jokontraktore, i cili u modelua mbi bazën e Rregulloreve Roma I²⁰ dhe Roma II.²¹ Reforma e vitit 2011 në të drejtën ndërkombëtare private nuk i ndryshoi rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, të cilat vijuan të jenë pjesë e KPC-së.²² KPC u ndryshua vetëm në vitin 2017, kur në Shqipëri u prezantuan për herë të parë rregullat *lis pendens*²³ (procedurat paralele).²⁴ Këto rregulla u miratuan në bazë të zgjidhjeve të Rregullores I bis të Brukselit, duke iu referuar ngushtë nenit 33 të Rregullores I bis të Brukselit.²⁵ Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së cilësohet si prioritet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të procesit të anëtarësimit në BE. Për këtë arsye, KPC është aktualisht duke u rishikuar.

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Aktorët kryesorë që janë të përfshirë në procesin e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri janë gjykatat dhe përmbartuesit. Autoritetet e tjera, të tilla si ministritë, përfaqësuesit ligjorë, noterët, përkthyesit, ekspertët, bankat e të tjerë, japin kontributin e tyre në proces në bazë të kërkesave të legjislacionit të brendshëm ose të marrëveshjeve ndërkombëtare/dypalëshe. Gjykatat e apelit në Shqipëri janë autoritetet gjyqësore kompetente për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja. Neni 395 i KPC-së parashikon se kërkesa për njohjen e një vendimi të huaj, i paraqitet gjykatës së apelit. Kjo dispozitë nuk i përcakton shprehimisht kompetencat territoriale të gjykatës së apelit, megjithatë, në bazë të nenit 49 të KPC-së, gjykata kompetente e apelit është gjykata me juridiksionin territorial ku synohet të ekzekutohet vendimi i huaj.²⁶ Ky formulim mbështetet edhe nga praktika ligjore shqiptare. Ministria e Drejtësisë hyn në lojë vetëm nëse palët mbështeten në marrëveshje dypalëshe dhe kur kërkesa i paraqitet gjykatës që ka dhënë vendimin. Shumica e marrëveshjeve dypalëshe parashikojnë që autoritetet e huaja gjyqësore duhet të komunikojnë përmes Ministrive të Drejtësisë të shteteve të tyre përkatëse.

17 Ligji 10 428, datë 2 qershor 2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", Fletorja Zyrtare nr. 82, 17.6.2011

18 Bushati A., and Jessel Holst Ch., "National Report (Albania)," in Basedow J., Rühl G., Ferrari F., De Miguel Asensio P. (eds), *Encyclopaedia of Private International Law*, Cheltenham, 2017.

19 Ligji 10 428, datë 2 qershor 2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", supra note 17.

20 Rregullorja (KE) nr. 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 qershor 2008 "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore" (Roma I), në FZ L 177, 4.7.2008.

21 Rregullorja (KE) nr. 864/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 korrik 2007 "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore" (Roma II), në FZ L 199, 31.7.2007.

22 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, supra note 1.

23 Ligji nr. 38/2017, datë 30 mars 2017 "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", supra note 1.

24 Kola F., *Lis pendens-a ndërkombëtare në juridiksionin gjyqësor shqiptar si risi në ligjin procedural shqiptar*, in Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës nr. 3, 2017.

25 Rregullorja e BE-së nr. 1215 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012 "Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare", në FZ L351, 20.12.2012.

26 Kola F., Vokshi A., *Procedurë civile*, Pjesa II, Botim II, Tirana, 2018.

Disa marrëveshje dypalëshe, pranojnë edhe mundësinë e përdorimit të kanaleve diplomatike.²⁷

Në procesin e njohjes përfshihen edhe përkthyesit zyrtarë dhe noterët. Sipas nenit 396 të KPC-së, vendimi i huaj gjyqësor dhe dokumentet e tjera të nevojshme për procesin, duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të legalizohen nga noterët. Neni 135 i ligjit "Për noterinë",²⁸ parashikon se përkthimi i një dokumenti nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe dhe *anasjelltas* bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën ai/ajo është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes zyrtarë.

Lista e përkthyesve zyrtarë administrohet dhe përditësohet vit pas viti nga Ministria e Drejtësisë.²⁹ Përkthimet zyrtare që përfshihen në listë kanë një mbulim më të gjerë gjeografik, duke përfshirë aty gjuhë që përdoren në kontinente të ndryshme, nga pakicat dhe gjuhë të rralla. Së fundmi, Ministria e Drejtësisë ka propozuar një projektligj "Për përkthimin zyrtar dhe për profesionin e përkthyesit zyrtar".³⁰ Ligji pritët të miratohet nga parlamenti.

Nga interpretimi i dispozitave përkatëse të ligjit të procedurës civile, prania e avokatëve në fazat e ndryshme të procesit *exequatur* nuk duket të jetë e detyrueshme. Si rregull, palët mund të mbrohen vetë, me përjashtim të rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm (neni 22 i KPC-së). Prania e avokatëve bëhet e detyrueshme kur palët i paraqesin dokumentet përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kryetari i gjykatës së apelit cakton një avokat, nëse pala nuk e ka caktuar një të tillë (neni 395, paragrafi 2 i KPC-së).

Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore është objekt i dispozitave të përgjithshme të ekzekutimit të cilat parashikohen në KPC (neni 510 e në vijim.). Titujt ekzekutivë vihen në zbatim nga shërbimi i përmbartimit shtetëror ose privat, bazuar në kërkesën e bërë nga pala kreditore, sipas parashikimit në KPC. Gjatë ekzekutimit të detyrueshëm, përmbartuesit janë të detyruar që të bashkëpunojnë me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe privatë për të pasur një ekzekutim të suksesshëm.

2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.2.1 Gjykatat

Sistemi i gjyqësorit në Shqipëri përbëhet nga gjykatat e përgjithshme dhe ato të posaçme. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit³¹. Aktualisht janë 6 gjykata apeli, ku secila prej tyre mbulon një ose dy qarqe juridiksionale, përkatësisht: Gjykata e Apelit në Tiranë, Gjykata e Apelit në Durrës, Gjykata e Apelit në Shkodër, Gjykata e Apelit në Korçë, Gjykata e Apelit në Vlorë dhe Gjykata e Apelit në Gjirokastrë.

Gjykatat e apelit shqyrtojnë çështje civile, tregtare dhe penale. Ato shërbejnë si shkalla e parë e gjyqësorit për qëllimin e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Vendimi i gjykatës së apelit, i cili refuzon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, mund të ankimohet në Gjykatën e Lartë (neni 472 i KPC-së). Gjykata e Lartë ndodhet në Tiranë dhe është përgjegjëse për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo e fundit ka nxjerrë vendime të ndryshme, duke përfshirë unifikimin e vendimeve që interpretojnë dispozitat e Kodit

27 Shihni Marrëveshjen mes Shqipërisë dhe Turqisë.

28 Ligji nr. 110/2018 "Për noterinë", i disponueshëm në <http://www.parlament.al/Files/Akte/20181227131907ligj%20nr.%20110%20dt%20%2020%2012%202018.pdf>

29 Lista është e disponueshme në https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/LISTA-E-PERKHTYESVE-TE-JASHTEM-TE-MINISTRISE-SE-DREJTESISSE-PER-VITIN-2021-_-e-perditesuar.pdf.

30 Projektligji i miratuar nga qeveria më 31 janar 2021, është i disponueshëm në <https://kryeministria.al/newsroom/projektligje-te-miratua-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-13-janar-2021/>

31 Neni 3 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i disponueshëm në <https://qkb.gov.al/preview/4669a00c-9477-41da-acc0-548f1a508cbc>

të Procedurës Civile për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

2.2.2 Institucionet administrative

Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme janë përgjegjëse për transferimin e dokumenteve, në varësi të dispozitave të posaçme të KPC-së ose të marrëveshjeve dypalëshe. Policia e Shtetit, njësitë e qeverisjes vendore, agjencia e kadastrës apo qendrat e regjistrimit, e kështu me radhë, mund të luajnë rol gjatë fazës së ekzekutimit, në varësi të elementeve specifike të vendimit ose në varësi të llojit të ekzekutimit.

2.2.3 Përfaqësuesit ligjorë

Avokatët mund ta ushtrojnë profesionin e tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë, përpara çdo gjykate, prokurorie, gjykate arbitrazhi, apo organi publik, në mënyrë individuale dhe të pavarur nga dhoma vendore e avokatisë në të cilën bëjnë pjesë, ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë të organizuar në studio avokatie. Avokati e ushtron profesionin edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e shtetit ku ushtrohet ky profesion, ose bazuar në traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë (neni 6 i ligjit "Për profesionin e avokatit").³² Profesionin e avokatit ushtrohet nga një shtetas shqiptar ose një shtetas i huaj, sipas rregullave dhe procedurave të këtij ligji. Dhoma e Avokatisë në Shqipëri është autoriteti i vetëm përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e strategjisë për formimin profesional të avokatëve në Republikën e Shqipërisë. Kjo e fundit ka ngritur Shkollën e Avokatisë me synimin për të organizuar, përgatitur dhe zbatuar formimin fillestar dhe të vazhduar të avokatëve (neni 55 i ligjit "Për profesionin e avokatit").

Këto trajnime janë një kontribut i drejtpërdrejtë për zhvillimin profesional të avokatëve. Ndihma juridike e garantuar nga shteti gjithashtu mundësohet mbi bazën e rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".³³ Ndihma juridike ofrohet si ndihmë juridike parësore dhe dytësore, si edhe në formë konsulence, duke përfshirë shërbime të ndryshme ligjore të tilla si: ofrimi i asistencës, përfaqësim dhe mbrojtje përpara gjykatës, përpilim i akteve ligjore dhe të tjera.

Përgjithësisht nuk ka një specializim të avokatëve. Megjithatë, avokatët të cilët punojnë në bashkëpunim me studiot ligjore janë të specializuar në çështjet tregtare dhe civile.

2.2.4 Agjentët zbatues

Ekzekutimi garantohet nga përbarimi privat dhe publik. Si përbarimi publik dhe ai privat mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë. Në vitin 2019 u miratua një ligj i ri për shërbimin përbarimor gjyqësor privat.³⁴ Përbaruesit veprojnë në përputhje me rregullat që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile dhe me aktet e tjera ligjore që mbulojnë procesin e ekzekutimit. Përbaruesit privatë organizohen sipas rregullave të Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, e cila ka krijuar një qendër kombëtare për trajnimin e përbaruesve (neni 17 i ligjit "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat). Shërbimet përbarimore ofrohen si veprimtari parësore dhe dytësore. Veprimtaria parësore e përbaruesve është ekzekutimi i titujve ekzekutivë, ndërsa veprimtaria dytësore, ndër të tjera, përfshin njoftimin e akteve gjyqësore, njoftimin dhe kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare, kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik me kërkesë të të interesuarve (neni 2 i ligjit "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat). Nuk ka dispozita të posaçme për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, pasi ato do të ekzekutohen ashtu si çdo titull tjetër ekzekutiv.

2.2.5 Aktorë të tjerë të rëndësishëm

Krahas institucioneve të lartpërmendura, të tilla si gjykatat, noterët dhe avokatët, të cilat janë kryesisht të përfshira në fazën e njohjes, dhe përbaruesit në fazën e ekzekutimit, përfshirja e institucioneve të tjera do të varet nga procedurat dhe lloji i titullit ekzekutiv që duhet të ekzekutohet. Këto institucione mund të përfshijnë bankat, tatimet, qeverisjen vendore, zyrën kadastrale, policinë gjyqësore, ekspertët dhe të tjerë. Ekspertët e pavarur të licencuar luajnë një rol të rëndësishëm gjatë fazës së ekzekutimit. Ata caktohen për të bërë vlerësimin e sendeve të sekuestruara dhe duhet të kenë njohuritë e posaçme në fushat specifike.³⁵ Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për administrimin dhe përditësimin e regjistrit elektronik të ekspertëve të pavarur të licencuar.

2.3 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm përkatës parashikohen në akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore. KPC përcakton rolin e aktorëve kryesorë dhe përfshirjen e tyre në fazat e ndryshme të procesit. Në anën tjetër, faza e ekzekutimit kërkon një bashkëpunim më të mirë ndërmjet përbaruesve dhe institucioneve të tjera shtetërore, siç përmenden dhe më lart. Me qëllim që të garantohet ky bashkëpunim, është krijuar një regjistër elektronik i integruar për menaxhimin e çështjeve, përkatësisht regjistri ALBIS. Ky regjistër është i ndërlidhur me regjistrin e bizneseve, i cili është nën varësinë e Qendrës Kombëtare të Biznesit, me regjistrin e gjendjes civile nën varësinë e zyrës së gjendjes civile, me regjistrin kombëtar të mjeteve, me regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.³⁶ Një tjetër sistem bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme shtetërore garantohet edhe përmes krijimit të SQDNE, i cili është një sistem të lejon qarkullimin e dokumenteve përmes përdorimit të nënshkrimeve elektronike.³⁷ Këto sisteme të integruara kanë si synim që të lehtësojnë dhe të përshpejtojnë procesin e ekzekutimit.

Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë ka miratuar një sërë udhëzimesh, duke unifikuar bashkëpunimin ndërmjet zyrës së përbarimit dhe policisë së shtetit; bashkëpunimin me institucione publike dhe private për mbledhjen e informacionit, për verifikimin e ligjshmërisë së kreditorit, për përcaktimin e përparësisë së ekzekutimit të titujve sipas kërkesës, etj. Sërish vlen të theksohet se këto udhëzime kontribuojnë në nxitjen e një procesi efikas ekzekutimi dhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

3. Roli i gjykatave dhe i agentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Gjykatat dhe shërbimet përbarimore luajnë një rol thelbësor në procesin e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave. Sistemi i drejtësisë në Shqipëri kaloi përmes një procesi të thellë reformues. Si rezultat i kësaj, u miratuan shumë ligje të reja dhe u krijuan institucione të reja. Procesi i reformës mendohet të nxisë një efikasitet të procedurave gjyqësore si edhe të procesit ekzekutues.

³⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 4.12.2020 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm", i disponueshëm në <http://www.nchb.al/>.

³⁶ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018 "Për krijimin, regjistrimin dhe mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përbarimit gjyqësor", i disponueshëm në <http://www.nchb.al/>.

³⁷ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 15.1.2020 "Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, i disponueshëm në <http://www.nchb.al/>.

3.1 Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Siç u përmend më lart, aktualisht, Shqipëria ka 6 gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm. Gjykata e Apelit në Tiranë ka numrin më të madh të gjyqtarëve, me 31 në total, ndërsa gjykatat e tjera janë më të vogla: Gjykata e Apelit në Durrës ka 13 gjyqtarë, Gjykata e Apelit në Vlorë ka 12 gjyqtarë, Shkodra ka 10 gjyqtarë dhe Gjykatat e Apelit të Gjirokastrës dhe të Korçës kanë secila nga 6 gjyqtarë.³⁸ Gjyqtarët e gjykatave të apelit shqyrtojnë çështje civile dhe penale. Nuk ka seksione dhe nuk ka specializim të gjyqtarëve për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Kërkesat shqyrtohen nga gjyqtarë të cilët dihet se janë kompetentë në çështjet civile. Çështjet shqyrtohen nga një trupë prej tre gjyqtarësh. Në punën e tyre gjyqtarët e gjykatës së apelit asistohen nga stafi administrativ i gjykatës dhe nga ndihmësit ligjorë.³⁹

3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Numri i kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, që paraqiten për çdo vit pranë gjykatave të apelit, nuk është shumë i lartë. Statistikat e mbledhura nga secila gjykatë tregojnë se Gjykata e Apelit në Tiranë shqyrton numrin më të madh të çështjeve.⁴⁰ Vlen të theksohet se numri më i madh i çështjeve janë çështje familjare. Numri i kërkesave për çështje civile dhe tregtare është shumë i vogël dhe në shumicën e rasteve, vendimi i huaj vjen nga gjykatat kombëtare të arbitrazhit dhe jo nga gjykatat normale.

Tabela 1: Numri i vendimeve të gjykatave të cilat e pranojnë/refuzojnë njohjen

Gjykatat e Apelit	2016	2017	2018	2019	2020
Tiranë	250	276	270	280	242
Durrës	93	122	128	123	107
Shkodër	112	99	135	120	103
Korçë	24	57	51	63	46
Vlorë	132	103	158	134	79
Gjirokastrë	33	24	41	41	26

Gjyqtarët i cilësojnë vendimet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja si jo të komplikuar. Gjyqtarët nuk hyjnë në themel të vendimit, por ata shqyrtojnë pajtueshmërinë e tij me aspektet formale të kërkesës dhe ata e shqyrtojnë vendimin gjyqësor në ballafaqim me kërkesat e refuzimit. Gjykata e Lartë ka nxjerrë një udhëzues të qartë për zbatimin e dispozitave të KPC-së lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.

Në vendimin unifikues të vitit 2011, Gjykata e Lartë ka relatuar se procedurat gjyqësore përpara gjykatës së apelit përfshijnë dy faza: gjatë fazës së parë gjykata bën shqyrtimin e formaliteteve procedurale të kërkesës. Në rastet kur pala nuk i përmbush këto formalitete, gjykata i jep asaj kohë shtesë për ta plotësuar kërkesën dhe për të plotësuar dokumentet e nevojshme sipas ligjit (neni 395 dhe 396 të KPC-së). Gjykata nuk mund ta refuzojë kërkesën në bazë të mangësive procedurale.

Gjatë fazës së dytë, gjykata e shqyrton vendimin në ballafaqim me kërkesat e refuzimit, dhe

³⁸ Këto të dhëna pasqyrojnë numrin e gjyqtarëve sipas organigramës ekzistuese. Në të ardhmen mund të ndryshojë numri i gjykatave të apelit dhe numri i gjyqtarëve, pasi aktualisht në Shqipëri po diskutohet një hartë e re e organizimit të gjyqësorisë.

³⁹ Neni 42 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

⁴⁰ Statistikat janë marrë nga takimet ballë për ballë dhe virtuale me kancelarët e gjykatave të apelit. Vendimet e gjykatave për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore nuk raportohen si një kategori e veçantë, por në kuadër të nënkategorive të tjera si çështjet civile, familjare ose tregtare. Shihni Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 41, datë 11.2.2021 "Për udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave", i disponueshëm në <http://klgj.al/>.

ajo mund ta refuzojë kërkesën nëse ekziston ndonjë prej pengesave ligjore të përmendura në nenin 394 të KPC-së. Disa pengesa ligjore të tilla si kompetencat e gjykatës ose ordre public (rendi publik), mund të shqyrtohen ex officio nga gjykata. Pengesa të tjera janë ato që lidhen me procesin e rregullt ligjor, res judicata dhe lis pendens, dhe do të shqyrtohen kur kjo të kërkohej nga pala debitorë. Barra e provës i takon debitorit. Gjykata gjithashtu ka pranuar natyrën kontroverse të procesit të njohjes. Në proces duhet të marrë pjesë si pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin (kreditore) dhe pala kundër së cilës kërkohej ekzekutimi (debitore). Kjo çështje u zgjidh më në fund me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 1.6.2011, ku u vendos që gjykata është e detyruar të thërrasë personin kundër së cilit jepet vendimi, në cilësinë e palës së tretë/palës së interesuar, në pajtim me dispozitat e KPC-së.

Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë ka efekt detyrues për gjykatat e shkallës më të ulët. Këto të fundit duhet që të respektojnë interpretimin e saj të dispozitave të KPC-së. Në vendime të tjera, si Gjykata e Lartë ashtu edhe Gjykatat e Apelit janë thelluar edhe më tej në pengesat ligjore të renditura në nenin 394 të KPC-së, rast pas rasti. Vendimet e Gjykatës së Apelit përbëjnë njohje të vendimeve të huaja gjyqësore, dhe, në të njëjtën kohë, janë urdhër ekzekutiv. Në terma të përgjithshëm, mund të arrijmë në përfundimin se cilësia e vendimeve të dhëna deri më tani është mjaftueshëm e mirë për të mundësuar një zbatim të saktë të dispozitave ligjore.⁴¹

3.3 Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Misioni i shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror është ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Institucioni i kryen funksionet e tij përmes përmbartuesve shtetërorë dhe ka një organizim të qendëruar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai vepron përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe ka 22 zyra përmbartimore vendore. Zyra e Tiranës ka numrin më të lartë të përmbartuesve shtetërorë, me rreth 18, ndërsa në zyrat e tjera përmbartimore numri i përmbartuesve shtetërorë është në varësi të madhësisë së juridiksionit vendor që mbulon zyra. Zakonisht, ky numër varion nga 2 deri në 6 përmbartues për zyrë.⁴²

Krahas këtyre, janë 140 përmbartues privatë që ofrojnë shërbimet e tyre në Shqipëri. Shumica e tyre veprojnë në Tiranë, rreth 99 përmbartues privatë.⁴³ Nëse shohim numrin e çështjeve që vijnë për çdo vit në secilën gjykatë apeli, ne mendojmë se numri i përmbartuesve shtetërorë dhe privatë është i mjaftueshëm për të përballuar ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Zhvillimi i tyre profesional është një proces në vazhdimësi, duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet më të fundit sa i përket përmbartuesve privatë. Miratimi i ligjit të ri do të pasohet nga krijimi i infrastrukturës së nevojshme.

3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor

Përgjegjëse për formimin gjyqësor është Shkolla e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë (ShM) është një institucion akademik i pavarur i krijuar në vitin 1997.

Shkolla e Magjistraturës është përgjegjëse për:

- formimin fillestar teorik dhe praktik të kandidatëve për magjistratë dhe profesione të tjera ligjore;

⁴¹ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 1.6.2011, i disponueshëm në <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

⁴² Të dhënat janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbartimor Shtetëror <http://dpp.gov.al/zyrat-permbartimore/>

⁴³ Të dhënat janë marrë nga Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë; informacioni i disponueshëm në gjuhën angleze në <http://www.nchb.al/eng/us/>

- formimin e vazhduar profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, si dhe të profesioneve të tjera ligjore;

Kurrikula e formimit fillestar zgjat tre vite dhe përfshin programin teorik dhe praktik. Dispozitat dhe praktikat ligjore lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore janë pjesë e modulit të procedurës civile dhe të modulit të së drejtës ndërkombëtare private.

Gjatë formimit të vazhduar, shkolla kryen 1 deri në 2 trajnime në vit për të drejtën ndërkombëtare private ose të drejtën procedurale ndërkombëtare, ku diskutohen edhe çështje që kanë të bëjnë me njohjen dhe ekzekutimin.⁴⁴

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë që prej vitit 2000. Shqipëria krijoi zonën e tregtisë së lirë me BE-në përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit⁴⁵ dhe është pjesë e CEFTA-s⁴⁶, EFTA-s⁴⁷ dhe ka një marrëveshje dypalëshe me Turqinë.⁴⁸

4.1.1 Importi

Italia mbetet partneri kryesor i importit për Shqipërinë, me rreth 30% të totalit të importeve (edhe pse ka pasur një tendencë rënieje në 3 vitet e fundit). Partneri i dytë më i madh në import është Turqia, e cila zuri 10% të totalit të importeve në vitet 2019 dhe 2020. Sasia e importeve nga Gjermania dhe Greqia është thujasë e barabartë, ku Gjermania zuri vendin e tretë gjatë periudhës 2016-2017 (një përqindje paksa më e madhe e importeve nga Gjermania krahasuar me ato nga Greqia), por që në periudhën 2018-2020 ka zbritur në vendin e katërt, për shkak të një përqindjeje pak më të lartë të importeve nga Greqia. Pozicionet pasuese mbahen nga Serbia, Franca dhe Rusia (në 7 vendet e para të partnerëve të importit).

Tabela 2: Importet në Shqipëri

Importet sipas vendit (milione lekë)	2016	2017	2018	2019	2020
Italia	169,583	179,236	175,279	164,188	151,978
Turqia	45,654	50,780	54,191	61,797	57,943
Greqia	45,657	49,879	52,101	54,336	54,454
Gjermania	54,959	50,713	49,563	46,482	46,601
Serbia	18,069	24,997	21,710	23,053	22,971

44 Shihni programet e formimit të vazhduar për një vit kalendarik të ShM në <https://www.magjistratura.edu.al/#3>

45 MSA-ja ndërmjet Shqipërisë, BE-së dhe shteteve të saj anëtare hyri në fuqi më 1.4.2009. Këshilli Evropian dhe Komisioni, "Vendimi i Këshillit dhe Komisionit, datë 26 shkurt 2009, "Për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, në njërin krah, dhe Republikës së Shqipërisë, në krahun tjetër (2009/332/KE, Euratom), FZ L 107, 28.4.2009, f. 166.

46 CEFTA hyri në fuqi më 1.5.2007 ndërmjet Shqipërisë, Bonjë-Hercegovinës, Moldavisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, UNMIK-ut/Kosovës. Ky informacion është i disponueshëm në

<http://rtais.wto.org/UI/PublicShowMemberRTAIDCard.aspx?rtid=560>

47 EFTA u nënshkrua më 1.10.2010 ndërmjet Shqipërisë, Islandës, Lihtenshtajnit, Norvegjisë, Zvicrës

<http://rtais.wto.org/UI/PublicShowMemberRTAIDCard.aspx?rtid=560>

48 Marrëveshja dypalëshe me Turqinë hyri në fuqi më 1.5.2008. E disponueshme në

<http://rtais.wto.org/UI/PublicShowMemberRTAIDCard.aspx?rtid=560>

Franca	11,481	10,973	12,409	13,027	11,838
Rusia	10,891	11,779	12,652	11,617	13,513

Burimi: INSTAT

4.1.2 Eksporti

Italia është destinacioni kryesor i Shqipërisë për eksportet, duke zënë gjysmën e totalit të eksporteve të saj në periudhën 2016-2020. Destinacioni i dytë për eksportet është Kosova^{*49} (për të njëjtën periudhë), ndjekur nga Greqia, Gjermania dhe Spanja. Edhe pse Greqia ka qenë në tre destinacionet kryesore për eksport në vitin 2016, vendin e saj e ka zënë Spanja. Spanja ka lënë pas Gjermaninë dhe Greqinë, por në vitin 2020 është kthyer në të njëjtat nivele eksporti si Gjermania.

Në rajonin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, destinacionet kryesore për eksport të Shqipërisë janë Maqedonia e Veriut dhe Serbia, edhe pse në nivele të ulëta (përkatësisht, rreth 3% dhe 2% të totalit të eksporteve).

Tabela 3: Eksportet nga Shqipëria

Eksporti sipas vendit (milione lekë)	2016	2017	2018	2019	2020
Italia	132,890	146,040	149,101	143,105	123,510
Kosova*	16,605	20,924	27,093	29,812	26,247
Gjermania	8,282	10,861	13,437	14,190	16,008
Spanja	7,994	14,992	24,174	23,845	16,601
Greqia	11,150	11,602	13,115	12,781	13,211
Maqedonia e Veriut	6,421	8,431	8,543	8,567	8,855
Serbia	4,700	4,833	8,035	5,386	6,280

Burimi: INSTAT⁵⁰

Sipas të dhënave për stokun hyrës nga Investimet e Huaja Direkte (IHD) për vitin 2019, 5 partnerët kryesorë të Shqipërisë janë: Zvicra (e cila zë 18,4% të stokut total), Holanda (15,3%), Kanadaja (13,7%), Italia (9,4%) dhe Turqia (7,4%).

Analiza e mësipërme tregon se partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë janë vendet e BE-së dhe vendet e rajonit.

4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në BE dhe anëtare e një sërë iniciativash ndërkombëtare për bashkëpunimin ndërkufitar. Nuk ka asnjë pengesë politike ose ligjore për zbatimin e mundshëm të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

49 * “Të gjitha referencat për Kosovën në këtë dokument, qoftë për territorin, institucionet ose popullsinë e saj, do të kuptohen në pajtim të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 dhe pa cenuar statusin e Kosovës”.

50 <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/>

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

Neni 29 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" përcakton kohën kur konventa hyn në fuqi mes dy palëve kontraktore dhe ai lejon një mundësi të kufizuar "daljeje" me qëllim shmangien e vendosjes së marrëdhënieve kontraktore me shtetet e tjera palë të traktatit. Siç u vu në dukje në pjesën e parë të këtij raporti, njohja e vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri nuk varet nga asnjë kërkesë reciprociteti. Nuk ka asnjë rrethanë specifike që do t'i kërkonte Shqipërisë që të bënte njoftim në pajtim me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

Neni 17 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" trajton vetëm situatën e brendshme nga këndvështrimi i shtetit të cilit i paraqitet kërkesa. Ai i lejon shtetit që ta çlirojë veten nga detyrimi për ta njohur dhe ekzekutuar vendimin gjyqësor sipas konventës në këto raste. Konventa zbatohet vetëm për çështjet ndërkombëtare. Dispozitat e KPC-së për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore nuk parashikojnë ndonjë kufizim të shprehur të këtij lloji, por neni 72 (paragrafi "dh") i LDNPSH-së përcakton se gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv mbi çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Juridiksioni ekskluziv i gjykatës shqiptare parashikohet edhe në situata të tjera, sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat reale (in rem) mbi pasuritë që ndodhen në Shqipëri, në çështjet me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, në çështjet me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare, në çështjet me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave të pronësisë intelektuale (neni 72 i LDNPSH-së). Gjithashtu, neni 37 i KPC-së përcakton se juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 18 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" i lejon shtetit që ta zgjerojë listën e çështjeve të përjashtuara nga qëllimi i Konventës. Nuk ka indicie specifike në dispozitat ekzistuese ligjore që Shqipëria mund të bëjë një deklaratë për të përjashtuar çështje të caktuara nga qëllimi i zbatimit të konventës.

Neni 19 i HCCH-së mundëson një trajtim të veçantë për vendimet gjyqësore ku njëra prej palëve ka qenë shtet ose një person fizik i cili vepron për llogari të shtetit, ose një agjenci qeveritare e shtetit apo një person fizik që vepron për llogari të kësaj agjencie qeveritare. Ai i jep mundësinë shtetit që të bëjë një deklaratë se nuk do ta zbatojë konventën për vendimet gjyqësore që burojnë nga çështje në të cilat palë është shteti ose një person fizik që vepron për llogari të shtetit.

Në dispozitat përkatëse të KPC-së nuk ekziston asgjë që mund të interpretohet si dispozitë që parashikon apo e kufizon shtetin nga të qenit palë në çështjet civile. Në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 4 të vitit 2011, lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, Gjykata e Lartë vuri në pah se ministria e përfshirë në çështje duhet të ketë mundësinë që të dëgjohet si palë e tretë dhe të paraqesë faktet e nevojshme.

Nga ana tjetër, pozicioni i shtetit të huaj si palë në çështjet gjyqësore civile në gjykatat shqiptare

rregullohet me nenin 39 të KPC-së për juridiksionin ndaj përfaqësive diplomatike e konsullore. Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur:

a) pranojnë vullnetarisht;

b) ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

Përfshirja e agjencive të huaja shtetërore në çështjet civile ka qenë tematikë e shqyrtuar në disa vendime të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Qëndrimi i gjykatave shqiptare është si në vijim: shteti dhe agjencitë shtetërore gëzojnë imunitet absolut nga juridiksioni i gjykatës shqiptare (edhe në marrëdhëniet e punës), përveçse kur ato e pranojnë vullnetarisht këtë juridiksion, sipas parashikimit në nenin 39, paragrafi "a" i KPC-së,⁵¹ si për shembull, përmes kontratave të punësimit.

Neni 25 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" trajton deklaratën që mund të bëhet nga shteti me një sistem ligjor të paunifikuar. Shqipëria ka një sistem të unifikuar ligjor, prandaj nuk lind nevoja të bëhet një deklaratë e tillë.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar

Juridiksioni ndërkombëtar i gjykatave shqiptare rregullohet nga Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Shqipërisë (LDNPSH). Gjykatat shqiptare kanë juridiksion nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur parashikohet ndryshe (neni 71 i LDNPSH-së). Vendqëndrimi i zakonshëm përkufizohet në LDNPSH si për personat fizikë dhe për ata juridikë. Këto përkufizime janë në pajtim me ato që parashikohen në Rregulloret Roma I dhe Roma II të BE-së.

Sipas nenit 12 të LDNPSH-së, vendqëndrimi i zakonshëm i një personi fizik është vendi, në të cilin ai/a jo ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë dhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij vendi gjykata mban parasysh rrethanat e natyrës personale apo profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend, apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla. Vendqëndrimi i zakonshëm i personave juridikë, i shoqatave apo

organizatave pa personalitet juridik është vendi ku ndodhet selia qendrore. Vendqëndrimi i zakonshëm i një personi fizik, që ushtron veprimtari biznesi, është vendi i tij kryesor i biznesit. Për një degë, agjenci apo çdo institucion tjetër, vendi ku ndodhet dega, agjencia ose çdo institucion tjetër trajtohet si vendi i vendqëndrimit të zakonshëm (neni 17 i LDNPSH-së).

5.2 Caktimi i juridiksionit me marrëveshje

Sa i përket zgjedhjes nga një palë e një trupe të huaj, neni 37 i KPC-së parashikon se juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat e huaj fizikë dhe juridikë është i rregulluar me ligj. Kjo dispozitë përcakton se, si rregull, juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund që me marrëveshje t'i kalohet një juridiksioni të huaj. Megjithatë, lejohen përjashtime nga rregulli i përgjithshëm në rastet kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar apo një personi juridik, pa banim ose qëndrim në Shqipëri dhe kur këto përjashtime janë

⁵¹ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.8, datë 11.6.2011 i disponueshëm në <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Caktimi i juridiksionit në favor të gjykatave shqiptare lejohet nga neni 73 i LDNPSH-së, i cili parashtrohet disa kërkesa lidhur me formën e marrëveshjes. Marrëveshja duhet të jetë me shkrim ose me gojë, por duke u vërtetuar kjo e fundit me shkrim, ose të jetë në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare, të cilat janë ose konsiderohen të njohura nga palët (neni 73, paragrafi 2 i LDNPSH-së). Kjo dispozitë nuk përcakton nëse marrëveshja është e vlefshme vetëm kur ajo bëhet përpara nisjes së çështjes. Andaj, kjo do të varet nga interpretimi që do të bëjë gjykata.

Juridiksioni shqiptar ekziston edhe nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për juridiksionin e gjykatës shqiptare, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore (neni 73, paragrafi 3 i LDNPSH-së).

5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Neni 5 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", parashtrohet disa filtra minimalë juridiksionale nëpër të cilët duhet të kalojnë vendimet gjyqësore të çështjeve në shtetet e origjinës, me qëllim që të kualifikohen për njohje dhe ekzekutim sipas Konventës së Hagës për Vendimet Gjyqësore. Pavarësisht se këto kërkesa juridiksioni të tërthortë nuk kanë peshë për rregullat juridiksionale kombëtare, sërish, dallimi mes tyre mund të rezultojë në një rezultat të pasinkronizuar.⁵² Ndërkohë që konventa nuk ka për qëllim që të ndikojë në ligjet ekzistuese të brendshme për juridiksionin në çështjet ndërkombëtare, vendimet gjyqësore nga shtetet me rregulla juridiksioni të drejtpërdrejtë, të tilla si filtrat në nenin 5 dhe 6, do të kenë më tepër gjasë që të qarkullojnë në kuadër të Konventës⁵³.

Tabela 4: Filtrat e juridiksionit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë

Konventa e HCCH-së e vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"		LDNPSH	
neni 5, paragrafi 1, germa "a"	vendqëndrimi i zakonshëm i personit	neni 71	vendqëndrimi i zakonshëm i të paditurit
neni 5, paragrafi 1, germa "b"	vendi kryesor i biznesit të personit fizik	neni 17	vendi kryesor i biznesit të personave juridikë
neni 5, paragrafi 1, germa "d"	veprimtaritë e degës, agjencisë ose të institucionit	neni 80, paragrafi "ç"	kur padia ka për objekt mosmarrëveshje, që rrjedhin nga veprimtaria e një dege ose agjencie të një personi juridik, me seli
neni 5, paragrafi 1, germa "e"	i padituri e ka pranuar shprehimisht juridiksionin	neni 73, paragrafi 1, pika 2	caktimi i juridiksionit me marrëveshje

neni 5, paragrafi 1, germa "f"	juridiksioni i heshtur	neni 73, paragrafi 3	juridiksioni i heshtur
neni 5, paragrafi 1, germa "g"	vendi ku është realizuar detyrimi apo ku duhet të ishte realizuar	neni 80, paragrafi "b"	vendi, në të cilin është përmbushur ose duhet përmbushur detyrimi
neni 5, paragrafi 1, germa "h"	vendndodhja e pasurisë	neni 72	vendi ku ndodhet pasuria
neni 5, paragrafi 1, germa "j"	vendi ku ka ndodhur veprimi ose mosveprimi i cili ka shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë	neni 80, paragrafi "c"	vendi ku ka ndodhur veprimi
neni 5, paragrafi 2	kontratat konsumatore dhe të punës		Nuk ka
neni 5, paragrafi 3	pasuri të paluajtshme dhe qira banimi	neni 72, paragrafi "a"	pasuri të paluajtshme dhe qiratë mbi pasuritë të paluajtshme

Konventa përdor "vendqëndrimin e zakonshëm" si faktor lidhës. Legjislacioni shqiptar është në pajtim me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", pasi ai përdor vendqëndrimin e zakonshëm si një prej faktorëve lidhës për përcaktimin e juridiksionit. Përkufizimi i vendqëndrimit të zakonshëm, si për personat fizikë dhe për ta juridikë, është në pajtim me rregullat e BE-së të përmendura më lart.

Juridiksionet e shprehura dhe të nënkuptuara rregullohen nga LDNPSH në nenin 73. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare. Gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore (neni 73, paragrafi 3 i LDNPSH-së). Kjo dispozitë është e ngjashme me nenet 25 dhe 26 të Rregullores I bis të Brukselit, megjithatë, ka dallime në faktin se neni 73 i LDNPSH-së e detajon më tepër miratimin e nënkuptuar, dhe në këtë dispozitë nuk ka asgjë që të përjashtojë zbatimin e nenit 73 paragrafi 3, në rastet e miratimit të shprehur në favor të gjykatave shqiptare, ose të juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare.

Rastet e juridiksionit të posaçëm rregullohen në nenet 74-81 të LDNPSH-së. Bazuar në një analizë krahasimore të dispozitave të LDNPSH-së me nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", mund të dalim në përfundimin se filtrat e juridiksionit të tërthortë të parashikuar në konventë janë njësoj me ato të parashikuara në dispozitat e LDNPSH-së, me përjashtim të juridiksionit mbi kontratat konsumatore dhe kontratat e punës. LDNPSH parashikon një regjim shumë të veçantë për kontratat e mbrojtura, si kontratat e punës, konsumatore ose kontratat e sigurimit lidhur me ligjin e zbatueshëm, por jo nën seksionin e juridiksionit.⁵⁴ Me fjalët të tjera, gjykatat shqiptare nuk duhet të kenë probleme me zbatimin e kësaj dispozite krahasuar me filtrat e juridiksionit ndërkombëtar në kuadër të LDNPSH-së.

5.4 Juridiksioni ekskluziv

Neni 6 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" parashikon një bazë

⁵⁴ Shihni për shembull nenin 48 (kontrata individuale e punës), nenin 50 (kontrata e transportit) ose nenin 52 (kontratat konsumatore) të LDNPSH-së.

⁵² Rumenov I. *Implications of the New 2019 Hague Convention on Recognition and Enforcement of Foreign Judgments on the National Legal Systems of Countries in South Eastern Europe*, EU and Comparative Law Issues and Challenges Series – Issue 3, 2020

⁵³ Garcimartín F. and G. Saumier. *Explanatory Report Convention of the 2 July 2019 of the Recognition, and Enforcement of Foreign Judgments in Civil and Commercial Matters*, www.hcch.net

të vetme ekskluzive për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin mbi të drejtat *reale* në pasuritë e paluajtshme. Vendimet gjyqësore që respektojnë filtrin në nenin 6, kualifikohen për njohje dhe ekzekutim. Vendimet gjyqësore që nuk e respektojnë filtrin, nuk duhet as të njihen dhe as të ekzekutohen, qoftë në kuadër të konventës ose në kuadër të ligjit kombëtar. Në fakt, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv mbi të drejtat reale në pasuritë e paluajtshme (neni 72 i LDNPSh-së). Situata të tjera të përmendura më parë në këtë raport janë: vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, themelimi ose mbarimi i personave juridikë, ose vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë; vlefshmëria e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare; vlefshmëria e regjistrimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime janë bërë në Republikën e Shqipërisë; ekzekutimi i titujve ekzekutiv; (neni 72 i LDNPSh-së).

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

6.1 Qëllimi material i zbatimit

Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” zbatohet për vendimet gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare. Përdorimi i termave çështje “civile” dhe “tregtare” ka më tepër rëndësi për sistemet ligjore ku “civile” dhe “tregtare” cilësohen si kategori të veçanta dhe reciprokisht ekskluzive, pavarësisht se përdorimi i të dy termave nuk është i papajtueshëm me sistemet ligjore në të cilët çështjet tregtare janë një nënkategori e çështjeve civile. Kjo nuk përfshin çështjet e të ardhurave, doganore apo administrative dhe fushat e tjera që renditen në nenin 2, paragrafi 1 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Nëse një vendim gjyqësor lidhet me një çështje civile apo tregtare, përcaktohet nga natyra e padisë ose e masës që është objekt i vendimit. Natyra e gjykatës së shtetit të origjinës ose thjesht fakti që një shtet ka qenë palë në proces, nuk janë faktorë përcaktues. Konventa zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin në një shtet kontraktual (palë) të një vendimi që është dhënë nga gjykata e një shteti tjetër. Si shteti i origjinës, i cili është shteti ku ndodhet gjykata që jep vendimin, dhe shteti të cilit i paraqitet kërkesa, i cili është shteti ku kërkohet të njihet dhe të ekzekutohet ai vendim, duhet të jenë shtete palë të konventës (neni 4, paragrafi 1 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”).

Zbatimi i konventës nuk ndikohet nga natyra e palëve, pra persona juridikë ose fizikë, privatë ose publikë. Siç përmendet në nenin 2, paragrafi 4, vendimi nuk përjashtohet nga qëllimi i konventës për faktin e thjeshtë se shteti, duke përfshirë qeverinë, agjencinë qeveritare ose çdo person që vepron për llogari të shtetit, ka qenë palë në proces në shtetin e origjinës.

Megjithatë, asgjë në këtë konventë nuk i cenon privilegjet dhe imunitetet e shtetit ose të organizatave ndërkombëtare, sa i përket vetes së tyre ose pasurive të tyre. Dallimi synon lehtësimin e zbatimit të konventës në shtetet ku nuk ekziston asnjë dallim ndërmjet të drejtës private dhe asaj publike. Kjo konventë nuk zbatohet për çështjet e arbitrazhit apo të ngjashme me to. Një element kyç që bën dallimin mes çështjeve të së drejtës publike nga çështjet “civile ose tregtare”, është fakti nëse njëra prej palëve po ushtron kompetenca qeveritare ose sovranë të cilat nuk i gëzojnë njerëzit e zakonshëm.⁵⁵

6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Rregullat shqiptare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore zbatohen për çështjet civile, tregtare dhe familjare. KPC nuk bën dallim mes çështjeve civile ose tregtare, apo çdo nënkategorie tjetër të çështjeve gjyqësore. Juridiksioni material i gjykatës së apelit përcaktohet nga e drejta procedurale. Kompetencat juridiksionale të gjykatave përcaktohen nga të drejtat procedurale. KPC në Shqipëri shprehet se Kodi parashikon rregulla uniforme për çështjet civile. Të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në ligjet e posaçme, janë pjesë e juridiksionit të gjykatave.⁵⁶ Nënkategorizimi i çështjeve brenda kategorisë së madhe të civile, zakonisht bëhet për qëllime të statistikave gjyqësore, siç shpjegohet në këtë raport. Në këtë rast, ndarja bëhet në varësi të objektit të padisë, pra nëse janë çështje të përgjithshme civile, çështje familjare, çështje tregtare dhe çështje punësimi. Shtetet dhe agjencitë shtetërore, si rregull, janë imune ndaj juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveçse nëse e pranojnë vullnetarisht këtë juridiksion ose nëse ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (neni 39 i KPC-së).

Dispozitat e KPC-së për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj (neni 399 i KPC-së).

6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen

KPC në Shqipëri nuk bën dallim mes llojeve të ndryshme të vendimeve të huaja gjyqësore. Megjithatë, neni 396 i KPC-së kërkon që vendimi i gjykatës së huaj të jetë i formës së prerë (i parevokueshëm) dhe kjo formë e prerë të vërtetohet nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin. Gjithashtu, neni 49 i KPC-së bën dallimin mes padive për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)

Kërkesat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore trajtohen si çështje kryesore. KPC në Shqipëri përcakton se gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme (neni 55 i KPC-së).

6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Kërkesa zyrtare dhe dokumentet që duhet të prodhohen për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, duhet të jenë në pajtim me kushtet e procedurës zyrtare të përcaktuara në nenet 395 dhe 396 të KPC-së. Megjithatë, nëse mes Shqipërisë dhe vendit të gjykatës që ka dhënë vendimin ka një marrëveshje dypalëshe në fuqi, do të mbizotërojnë dispozitat e procedurës zyrtare të marrëveshjes.

Sipas KPC-së në Shqipëri, kërkesa mund t'i paraqitet direkt gjykatës së apelit ose të paraqitet në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare (neni 395 i KPC-së). Kërkesa duhet të përfshijë:

⁵⁵ Garcimartin F. and G. Saumier. *Explanatory Report Convention of the 2 July 2019 of the Recognition, and Enforcement of Foreign Judgments in Civil and Commercial Matters*, www.hcch.net

⁵⁶ Neni 1 i KPC-së, supra note 1.

a) kopjen e vendimit që duhet të ekzekutohet dhe përkthimin e tij në gjuhën shqipe të legalizuar nga noteri;

b) vërtetimin nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimin e legalizimit noterial të tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se ai ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;

c) prokurën, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri (neni 396 i KPC-së).

Nëse kërkesa për njohje dhe ekzekutim paraqitet mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe, kërkesa mund të dorëzohet direkt në gjykatën kompetente, në gjykatën e shkallës së parë e cila ka nxjerrë vendimin, dhe dokumentet që duhet të paraqiten janë si më poshtë:

a) një kopje e vendimit e vërtetuar nga gjykata;

b) në rastin kur vendimi nuk e tregon qartë se është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, atij i bashkëngjitet një dokument i lëshuar nga gjykata që vërteton se vendimi ka hyrë në fuqi;

c) një dokument i lëshuar nga gjykata për ekzekutim të pjesshëm të vendimit në territorin e palës kërkuese, sipas rastit;

d) një dokument që vërteton se pala e cila nuk ka marrë pjesë në proces, apo përfaqësuesi i saj në rast pamundësie, është thërritur në gjykatë në bazë të ligjit.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të shoqërohen me legalizimin e përkthimit në gjuhën e palës kontraktore që bën kërkesën ose në gjuhën angleze, të kryer nga agjencitë diplomatike ose konsullore ose nga çdo person tjetër i autorizuar në secilën palë.⁵⁷

Me qëllim që t'u vihet në ndihmë qytetarëve dhe palëve për të përmbushur siç duhet kërkesat ligjore, disa gjykata apeli kanë krijuar praktikën e këshillimit të palëve për të paraqitur dokumentet vijuese:

- a) kërkesën që përmban gjeneralitetet e palës dhe bazën ligjore;
- b) vendimin e gjykatës së huaj të legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e vendit të gjykatës që ka nxjerrë vendimin, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar;
- c) certifikatën e martesës (për çështjet familjare) të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- d) një vërtetim nga gjykata e shkallës së parë që dëshmon se nuk është shqyrtuar asnjë çështje për zgjidhje martese ndërmjet palëve në gjykatë;
- e) Prokurën, nëse pala nuk është e pranishme.⁵⁸

Nëse palët nuk i përmbushin kërkesat e procedurës zyrtare, gjykata u jep atyre kohë të arsyeshme shtesë për t'i plotësuar kërkesat. Mangësitë në këtë fazë të procesit nuk përbëjnë bazë për refuzimin e kërkesës.⁵⁹

6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore parashikohen në nenin 394 të KPC-së dhe në marrëveshjet dypalëshe për ndihmën e ndërsjellë juridike, të ratifikuara nga Shqipëria. Edhe këtu, do të mbizotërojnë kushtet e marrëveshjeve dypalëshe mbi kushtet e parashikuara në KPC. Në përputhje me nenin 394 të KPC-së, vendimit të huaj gjyqësor nuk i jepet fuqi kur:

⁵⁷ Neni 20 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë.

⁵⁸ Shihni njoftimin publik të Gjykatës së Apelit të Durrësit të datës 31.3.2021, i disponueshëm në <http://www.gjykata.gov.al>

⁵⁹ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 1.6.2011, i disponueshëm në <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;

b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;

c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;

d) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;

e) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;

f) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Sipas nenit 394, paragrafi "a" i KPC-së, njohja e vendimit të gjykatës së huaj refuzohet nëse gjykata e shtetit që e ka nxjerrë vendimin e huaj, nuk ka juridiksion sipas LDNPSH-së ("parimi i pasqyrës"). Rendi publik, si bazë për refuzim, rregullohen nga paragrafi "dh" (parimet bazë të legjislacionit shqiptar) të nenit 394 të KPC-së, pavarësisht se togfjalëshi "rend publik" nuk përmendet në këtë dispozitë. Praktika ligjore shqiptare bën një përkufizim të gjerë të rendit publik, duke përfshirë çështje të së drejtës materiale dhe procedurale. Sipas jurisprudencës shqiptare, bazat materiale të rendit publik nuk i japin rëndësi përmbajtjes së ligjit të huaj, por efekteve eventuale që lindin nga njohja e vendimeve të huaja dhe pajtueshmërisë së tyre me parimet bazë (të cilat jepen në norma materiale) të ligjit shqiptar.

Bazat procedurale të rendit publik mbulohen në paragrafin "b" (vendimet në mungesë) dhe paragrafin "d" (vendimet që marrin formë të prerë në kundërshtim me legjislacionin e vendit të huaj). Paragrafi "c" i nenit 394 të KPC-së trajton çështjen e res judicata, me qëllim shmangien e nxjerrjes së dy vendimeve për të njëjtën mosmarrëveshje. Paragrafi "ç" i nenit 394 i KPC-së paraqet situatën e proceseve paralele dhe duhet të zbatohet në pajtim me rregullat lis pendens të parashikuara në kuadër të KPC-së (neni 37 i KPC-së).⁶⁰

Marrëveshjet dypalëshe që janë ratifikuar nga Shqipëria kanë arsye të ngjashme për refuzimin e njohjes me ato të parashikuara në KPC: mungesa e juridiksionit të gjykatës, mungesa e njoftimit të të paditurit në mungesë, *res judicata* dhe *lis pendens*, mungesa e formës së prerë të vendimit dhe shkelja e rendit publik, janë kërkesat e zakonshme për refuzim.⁶¹

Kërkesat për refuzim të parashikuara në KPC dhe në marrëveshjet dypalëshe të ratifikuara nga Shqipëria, përgjithësisht janë në linjë me arsyet për refuzim që përmban Konventa e HCCH-së e vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

⁶⁰ Kola F, Çinari. *Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil and Commercial Matters in Albania*, in Brussels I bis Regulation and special rules: opportunities to enhance judicial cooperation, Edited by C.E. Tuo, L. Carpaneto, S. Dominelli, march 2021 https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules.pdf

⁶¹ Neni 22 i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë.

Tabela 5. Arsyet për refuzim

Neni 394 i KPC-së	Neni 7 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"
a) mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës që ka dhënë vendimin;	Neni 5 dhe 6 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"
	(a) dokumenti që ka shënuar pikënisjen e procesit ose një dokument i barasvlershëm, duke përfshirë një deklaratë të elementeve thelbësore të kërkesëpadisë
b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;	(i) nuk i është njoftuar të paditurit në kohë të mjaftueshme dhe në mënyrë të atillë që t'i japë atij mundësinë që të mbrohet, përveçse nëse i padituri është paraqitur në gjykatë dhe ka marrë pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për njoftimin e gjykatës që ka dhënë vendimin, me kusht që ligji i shtetit të origjinës të ketë lejuar ngritjen e pretendimeve rreth njoftimit;
	ose (ii) i është njoftuar të paditurit në shtetin ku paraqitet kërkesa në një mënyrë të atillë që nuk pajtohet me parimet themelore të shtetit ku paraqitet kërkesa lidhur me dokumentet e shërbimit;
c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;	(b) vendimi është marrë përmes mashtrimit;
	(f) vendimi nuk është në koherencë me një vendim të mëhershëm të nxjerrë nga gjykata e një shteti tjetër mes të njëjtave palëve për të njëjtin objekt, me kusht që vendimi i mëhershëm të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen e tij në shtetin ku paraqitet kërkesa
ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;	(e) vendimi nuk është në koherencë me vendimin e nxjerrë nga gjykata e shtetit ku paraqitet kërkesa lidhur me çështjen e mosmarrëveshjes ndërmjet po të njëjtave palë; ose
dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar	(c) njohja ose ekzekutimi do të ishte shprehimisht i papajtueshëm me rendin publik të shtetit ku paraqitet kërkesa, duke përfshirë situatat ku procedurat specifike të ndjekura për marrjen e vendimit kanë qenë në papajtueshmëri me parimet themelore të drejtësisë procedurale të atij shteti dhe situatat që përfshijnë shkelje të sigurisë dhe sovranitetit të atij shteti;

Praktikisht, kërkesat më të shpeshta për refuzimin e njohjes janë: mosnjoftimi i të paditurit, pamundësia për të vërtetuar se vendimi ka formë të prerë, lloji i vendimit (civil ose administrativ) dhe mungesa e juridiksionit të gjykatës që e ka nxjerrë vendimin.⁶²

62 Kola F, Çinari., *Recognition and enforcement of foreign judgments in civil and commercial matters in Albania, in Brussels I bis Regulation and special rules:*

6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Në Shqipëri, vendimi i huaj mund të ekzekutohet vetëm pasi ai të jetë njohur nga një gjykatë apeli. Kërkesa e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet pranë gjykatës kompetente të apelit, e cila duhet të jetë sipas përcaktimit në nenin 49 të KPC-së: "Paditë, për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm mbi sende, ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen ato ose pjesa më e madhe e vlerës së tyre. Paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar, ngrihen në gjykatën e vendit ku duhet të përmbushet një detyrim i tillë".

Procedurat për dorëzimin e kërkesës dhe të dokumenteve të nevojshme përshkruhen me detaje përgjatë të gjithë raportit. Pasi kërkesa dorëzohet pranë gjykatës kompetente të apelit, kërkesa do të trajtohet në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Si hap i parë, do të hidhet shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve. Kërkesat për njohjen dhe ekzekutimin zakonisht trajtohen me prioritet dhe, në përgjithësi, procesi nuk merr shumë kohë.⁶³ Kërkesa shqyrtohet nga një trupë prej tre gjyqtarësh, ku njëri prej tyre është relatori i çështjes. Njoftimi i palës kërkuese për t'u paraqitur në gjykatë bëhet në pajtim me nenin 128 e në vijim të KPC-së. Njoftimi bëhet nga nëpunësi i gjykatës, përmes shërbimeve postare, njoftimeve publike ose mjeteve elektronike, nëse pala ka dhënë miratimin e saj paraprak (neni 129 i KPC-së).

Sa i përket detyrimit për të njoftuar personat kundër të cilëve kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit, ka lindur një problem për shkak të termit që është përdorur për këto raste: "kërkesë" në vend të "kërkesëpadi". Andaj, pala kundër së cilës është kërkuar vendimi, nuk mund të thërritet në gjykatë si e palë e paditur në procesin e njohjes. Megjithatë, pjesëmarrja e palës është e nevojshme me qëllim që të vlerësohet ekzistenca, ose jo, e ndonjëres prej kërkesave për refuzim.⁶⁴ Njoftimi i drejtohet personalisht palëve kërkuese, palëve debitore ose palëve të tjera të interesuara, sipas kërkesës së palës kërkuese ose të gjykatës. Zakonisht, çështjet mbyllen me një ose maksimumi me dy seanca dëgjimore.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohjen e një vendimi të huaj, gjykata e apelit zbaton rregullat e shqyrtimit në shkallë të parë. Ndër të tjera, gjykata e apelit verifikon paraprakisht përmbushjen e kushteve formale të depozitimit të një kërkesë për njohjen e një vendimi të huaj. Nëse kërkesa për njohjen e një vendimi të huaj është e paplotë, gjykata duhet të vendosë një afat të arsyeshëm për plotësimin dhe korrigjimin e saj. Më pas, gjykata e apelit e kthen kërkesën pa marrë asnjë veprim tjetër nëse pala kërkuese nuk i plotëson dhe nuk i korrigjon mangësitë formale të kërkesës brenda afatit të përcaktuar nga gjykata. Nëse kërkesa për njohjen e një vendimi të huaj i përmbush kushtet formale, gjykata e apelit do të caktojë një seancë dëgjimore, qëllimi i së cilës do të jetë vetëm vlerësimi i ekzistencës, ose jo, të ndonjëres prej pengesave ligjore të parashikuara në nenin 394 të KPC-së, ose të ndonjëres prej dispozitave të posaçme për këtë qëllim.⁶⁵ Prandaj, gjykata e apelit nuk do të vendosë mbi themelin e çështjes (neni 397 i KPC-së).

Vendimi i gjykatës së apelit për pranimin ose refuzimin e njohjes dhe të ekzekutimit, përbën në të njëjtën kohë një urdhër ekzekutiv. KPC parashikon se vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të huaja të arbitrazhit, nxirren nga gjykata që e njeht vendimin, sipas dispozitave përkatëse (neni 511, paragrafi "b" i KPC-së).

Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë (neni 443 i KPC-së).

opportunities to enhance judicial cooperation, Edited by C.E. Tuo, L Carpaneto, S Dominelli, march 2021

https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules.pdf

63 Informacion i marrë gjatë intervistave me kancelarët e gjykatave të apelit.

64 Kola F, Çinari., "Recognition and enforcement of foreign judgments in civil and commercial matters in Albania," in *Brussels I Bis Regulation and Special Rules: Opportunities to Enhance Judicial Cooperation*, Edited by C.E. Tuo, L Carpaneto, S Dominelli, march 2021

https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules

65 Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.6, datë 1.6.2011 i disponueshëm në www.gjykataelarte.gov.al

Kosto e procedurave gjyqësore për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore përfshin tarifat gjyqësore, tarifat e avokatëve dhe tarifat e tjera që lidhen me shërbime të tilla si noterizimi dhe përkthimi. Tarifat gjyqësore përcaktohen me ligj⁶⁶ dhe me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.⁶⁷ Tarifa gjyqësore për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore është 5000 lekë (rreth 45 euro). Tarifat noteriale përcaktohen në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës.⁶⁸ Tarifat noteriale për vërtetimin e përkthimit dhe njësimin me origjinalin janë rreth 5000 lekë (rreth 45 euro). Tarifat e përkthimit janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë⁶⁹, dhe janë rreth 10 euro për faqe. Kostoja për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore në Shqipëri nuk mund të konsiderohet barrë e rëndë për palët.

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

7.1 Lloji i procedurës përmbartimore

Vendimi i gjykatës së apelit rreth kërkesës për njohjen e një vendimi të gjykatës së huaj i jep fuqi ekzekutimi këtij vendimi të huaj në Shqipëri. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore është objekt i dispozitave të përgjithshme të ekzekutimit të cilat parashikohen në KPC (neni 510 *e në vijim*). Neni 510 i KPC-së përcakton se ekzekutimi mund të bëhet mbi bazën e titujve ekzekutivë që renditen në këtë nen. Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja janë tituj ekzekutivë në momentin që atyre u jepet fuqi në përputhje me dispozitat e parashikuara në KPC (neni 510, paragrafi "c"). Titulli ekzekutiv vihet në zbatim me kërkesë të kreditorit (neni 511 i KPC-së). Urdhri i ekzekutimit nxirret brenda pesë ditëve nga gjykata e apelit (neni 511, paragrafi "b" i KPC-së).

Kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e urdhrit të ekzekutimit, mund të bëhet ankim sipas rregullave mbi ankimet e veçanta (neni 512 i KPC-së). Titulli ekzekutiv vihet në zbatim nga shërbimi i përmbartimit shtetëror ose privat, bazuar në kërkesën e bërë nga pala kreditore. Kërkesa e kreditorit duhet që të shoqërohet nga titulli ekzekutiv (titulli origjinal dhe i noterizuar sipas ligjit), pagesa e tarifës së vënies në ekzekutim dhe prokura e personit që përfaqëson palën kreditore (neni 510 i KPC-së). Urdhri duhet të ekzekutohet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës nga kreditori (neni 515 i KPC-së).

Legjislacioni shqiptar parashikon ekzekutim vullnetar të titujve, ndërsa ekzekutimi i detyrueshëm mund të kryhet vetëm pasi të kenë kaluar afatet për ekzekutimin vullnetar. Ekzekutimi i detyrueshëm mund të fillojë përpara kalimit të afateve për ekzekutimin vullnetar vetëm në rastet kur ka rrezik që ekzekutimi të bëhet i pamundur (neni 517 dhe 519 të KPC-së). Kodi i Procedurës Civile parashikon rregulla të detajuara rreth ekzekutimit të titujve në fusha specifike (Kreu III i KPC-së).

Ekzekutimi me forcë i detyrimit ndaj palës kreditore mund të kryhet në disa forma, të cilat përfshijnë veprime të tilla si bllokimi i llogarive bankare, konfiskimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, e kështu me radhë. Të gjitha veprimet plotësojnë njëra tjetrën dhe i shërbejnë një qëllimi të vetëm: zgjidhjes së detyrimit që gjykata ka vendosur mbi debitorin.

Kostot e ekzekutimit përfshijnë tarifën e përmbartimit, tarifën e ekspertëve, tarifat noteriale e kështu me radhë. Tarifat e përmbartimit janë të përcaktuara në udhëzimin e vitit 2017.⁷⁰ Ato përfshijnë tarifat fikse të ekzekutimit në lekë dhe në përqindje, në varësi të vlerës së detyrimit.

Marzhi i përqindjeve është nga 3% në 10% të vlerës së detyrimit. Sërish, kostot e ekzekutimit nuk duken shumë të larta.

7.2 Procedura përmbartimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj

Nuk ka procedura të posaçme për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Ato rregullohen sipas të njëjtave rregulla dhe procedura si në rastin e titujve vendas.

8. Referenca

Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar

- CEFTA e hyrë në fuqi më 1.5.2007 ndërmjet Shqipërisë, Bonjë-Hercegovinës, Moldavisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, UNMIK-ut/Kosovës.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 4.12.2020 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018 "Për krijimin, regjistrimin dhe mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 15.1.2020 "Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik"
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 641, datë 23.12.2020 "Për tarifat gjyqësore dhe procedurat e mbledhjes së tyre"
- Dekreti nr. 3119, datë 6 qershor 1960, Fletorja Zyrtare nr. 3, e vitit 1961, Marrëveshja me Hungarinë "Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare"
- Dekreti nr. 3250, datë 17 prill 1961, Fletorja Zyrtare nr. 6, e vitit 1962, Marrëveshja me Rumaninë "Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare"
- EFTA u nënshkrua më 1.10.2010 ndërmjet Shqipërisë, Islandës, Lihtenshtajnit, Norvegjisë, Zvicrës
- Udhëzimi i përbashkët nr. 3156, datë 12.5.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretë".
- Udhëzimi i përbashkët nr. 22, datë 20.10.2020 "Për përcaktimin e tarifave të shpërblimit të noterit për kryerjen e veprimeve dhe akteve noteriale"
- Ligji 10 428, datë 2 qershor 2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", Fletorja Zyrtare nr. 82, 17.6.2011
- Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 10 194, datë 10.12.2009
- Dekreti nr. 8036, datë 22 nëntor 1995, Fletorja Zyrtare nr. 25, e vitit 1995, Marrëveshja me Turqinë "Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe tregtare"
- Ligji nr. 8061, datë 8 shkurt 1996, Fletorja Zyrtare nr. 2, e vitit 1996, Marrëveshja me

66 Ligji 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë"

67 Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 641, datë 23.12.2020 "Për tarifat gjyqësore dhe procedurat e mbledhjes së tyre".

68 Udhëzimi i përbashkët nr. 22, datë 20.10.2020 "Për përcaktimin e tarifave të shpërblimit të noterit për kryerjen e veprimeve dhe akteve noteriale"

69 Udhëzimi i përbashkët nr. 3156, datë 12.5.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretë".

70 Udhëzimi i përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 "Për kaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat". Ky dokument mund të ndryshojë pas miratimit të ligjit të ri për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat në vitin 2019.

Federatën Ruse "Për ndihmë juridike në fushën civile, penale dhe familjare"

- Dekreti nr. 8304, datë 12 mars 1998, Fletorja Zyrtare nr. 7, e vitit 1998, Marrëveshja me Maqedoninë e Veriut "Për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale"
- Ligji nr. 9348, datë 24 shkurt 2005, Fletorja Zyrtare nr. 19, e vitit 2005, Marrëveshja me Bullgarinë "Për ndihmë juridike në çështjet civile"
- Ligji nr. 7760, datë 14 tetor 1993, Fletorja Zyrtare nr. 12, e vitit 1993, Marrëveshja me Greqinë "Për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale".
- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 138, e datës 7.12.1998,
- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 9, 10 dhe 11/1996, i ndryshuar
- Ligji nr. 110/2018 "Për noterinë"
- Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".
- Ligji nr. 38/2017, datë 30 mars 2017 "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", Fletorja Zyrtare nr. 98, e datës 5.5.2017, f. 5493
- Ligji nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 8116, datë 29 mars 1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 9, 10, 11, datë 12.5.1996.
- Rregullorja (KE) nr. 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 qershor 2008 "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore" (Roma I), në FZ L 177, 4.7.2008,
- Rregullorja (KE) nr. 864/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 korrik 2007 "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore" (Roma II), në FZ L 199, 31.7.2007,
- MSA-ja ndërmjet Shqipërisë, BE-së dhe shteteve të saj anëtare hyri në fuqi më 1.4.2009. Këshilli Evropian dhe Komisioni, "Vendimi i Këshillit dhe Komisionit, datë 26 shkurt 2009, "Për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, në njërin krah, dhe Republikës së Shqipërisë, në krahun tjetër (2009/332/KE, Euratom), FZ L 107, 28.4.2009,

- Bushati A. Yearbook of Private International Law, Volume 15 (2013/2014)
- Garcimartin, F. and G. Saumier. Explanatory Report Convention of the 2 July 2019 of the Recognition, and Enforcement of Foreign Judgments in Civil and Commercial Matters
- Bushati, A. and Jessel Holst, Ch., National Report (Albania) in Basedow J., Rühl G., Ferrari F., De Miguel Asensio P. (eds), Encyclopaedia of Private International Law, Cheltenham, 2017.
- Kola, F. and S. Çinari. "Recognition and enforcement of foreign judgments in civil and commercial matters in Albania," in Brussels I bis Regulation and Special Rules: Opportunities to Enhance Judicial Cooperation, Edited by C.E. Tuo, L. Carpaneto, S. Dominelli, March 2021. https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules.pdf,
- Kola, F. Lis pendens-a ndërkombëtare në juridiksionin gjyqësor shqiptar si risi në ligjin procedural shqiptar, in Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës nr. 3, 2017.
- Kola, F. and A. Vokshi. Procedurë civile, Pjesa II, Botim II, Tirana, 2018.
- Rumenov I. Implications of the New 2019 Hague Convention on Recognition and Enforcement of Foreign Judgments on the National Legal Systems of Countries in South Eastern Europe, EU and Comparative Law Issues and Challenges Series – Issue 3, 2020

Praktikat ligjore kombëtare

- Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 1.6.2011
- Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 11.6.2011

Botime

- Bushati A. Impact of Brussels I bis Regulation on Recognition and Enforcement of judgments in Albania, in Impact of Brussels I bis Regulation on Recognition and Enforcement of judgments in Albania in Brussels I bis Regulation and special rules: opportunities to enhance judicial cooperation, Edited by C.E. Tuo, L. Carpaneto, S. Dominelli, March 2021 https://dispo.unige.it/sites/dispo.unige.it/files/pagine/OPEN%20ACCESS_Brussels%20I%20bis%20and%20Special%20Rules.pdf, p 381

RAPORT KOMBËTAR: BOSNJË-HERCEGOVINA

Autore

Meliha Povlakić

Përmbledhje ekzekutive

Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve pasqyron kompleksitetin e rendit kushtetues dhe të organizimit shtetëror në Bosnjë-Hercegovinë (në vijim referuar si: BiH). Burimi kryesor i ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në BiH është ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara” (LDNP), i cili është një akt ligjor që prej ish-Jugosllavisë, që është ende në fuqi në BiH pa asnjë ndryshim. Në thuajse katër dekada që nga miratimi i tij, ka pasur zhvillime shumë të rëndësishme në fushën e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, por BiH nuk ka qenë pjesë e këtij procesi. Reforma në ligjin e së drejtës ndërkombëtare private nuk është në qendër të interesit të ligjvënësive. Për më tepër, për shkak të rendit kushtetues në BiH, ka një qëndresë ndaj miratimit të një ligji për të drejtën ndërkombëtare private në nivel shtetëror/federal. Së bashku me faktin që BiH ka një sistem juridik kompleks, miratimi i tre ligjeve të mëvetësishme për të drejtën ndërkombëtare private do ta bënte situatën edhe më komplekse. Akademikët në BiH kanë deklaruar tashmë se një nga alternativat për të reformuar ligjin e së ndërkombëtare private do të ishte përmes pranimit të BiH-së në konventat ndërkombëtare në të cilat BE është palë, për shembull, konventat e miratuara në kuadrin e HCCH-së për ligjin e së drejtës ndërkombëtare private.

Përmbledhja e legjislacionit që është i rëndësishëm për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve, nxjerr në pah disa mangësi përveç rregullores së vjetër për të drejtën ndërkombëtare private. Njëra prej tyre ka të bëjë me rregullimin tepër të dobët të procedurës për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Tjetra lidhet me mosveprimin e procedurës përmbartimore, në rastet kur zbatimi kërkohet në bazë të një titulli të huaj ekzekutiv. Për më tepër, dispozitat për ekzekutimin e titujve të huaj ndryshojnë në LDNP dhe në ligjin për shërbimin përmbartimor.

Struktura ligjore e kuadrit institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në BiH nuk është tejte komplekse në vetvete. Në këtë rast gjykatat luajnë rolin kryesor dhe mbizotërues. Krahas gjykatave, të cilat janë aktorë kryesorë në këtë çështje, Ministria e Drejtësisë e BiH-së, juristët dhe institucionet arsimore janë gjithashtu të rëndësishme.

Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve juridike dhe rritja e tregtisë ndërkombëtare kërkojnë një kuptim dhe përshtatshmëri më të mirë të sistemit ligjor vendas në mënyrë që ai të trajtojë problemet ligjore me një element ndërkombëtar. Raporti në mënyrë të përsëritur thekson se organizimi i ndërlikuar shtetëror dhe rrethanat politike pengojnë jo vetëm miratimin e legjislacionit modern për të drejtën ndërkombëtare private por edhe qasjen në marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare shumëpalëshe që kanë të bëjnë me juridiksionin ndërkombëtar dhe njohjen e ekzekutimin ndërmjet shteteve. Andaj, bashkëpunimi mes aktorëve është jetik. Bashkëpunimi midis aktorëve është i rëndësishëm për shkak të mungesës së mekanizmave për unifikimin e praktikave gjyqësore midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos në BiH. Nuk ka Gjykatë të Lartë në nivel shtetëror, e cila do të kishte autoritetin e Gjykatës së Apelit ose të Kasacionit. Për më tepër, mungesa e një institucioni detyra e të cilit do të ishte unifikimi i praktikave gjyqësore, mund të çojë në njohjen dhe ekzekutimin e ndryshëm juridik të vendimeve të huaja gjyqësore në BiH. Një unifikim *de facto* mund të arrihet përmes bashkëpunimit midis gjykatave të larta të entiteteve dhe gjykatës së Apelit të Distriktit të Bërçkos në BiH.

Bashkëpunimi mund të realizohet edhe përmes arsimit. Qendrat që ofrojnë arsimim për gjyqtarët dhe prokurorët bashkë me universitetet duhet të hartojnë një program me në qendër çështjet e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private, pasi analiza e programeve mësimore të këtyre Qendrave në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës dhe në Republikën Srpska ka treguar se ofrohen vetëm pak trajnime kushtuar çështjeve të ligjit të së drejtës ndërkombëtare private. Trajnime të përbashkëta për ekspertët ligjorë dhe gjyqtarët në të gjithë shtetin mund të organizohen në kuadër të shumë

projekteve që ofrojnë mbështetje për sistemin gjyqësor në BiH. Institucionet qeveritare, Ministria e Drejtësisë e BiH dhe Ministria e Punëve të Jashtme e BiH duhet të përfshijnë akademikët e duhur në procesin e negocimit dhe aderimit në instrumentet ndërkombëtare.

U analizua kapaciteti i gjykatave dhe agjentëve zbatues dhe u vërejtën disa mangësi. Në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës dhe në Republikën Srpska, gjykatat e shkallës së dytë janë kompetente për të vendosur për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore, por nuk ka seksione të specializuara për këtë çështje. Seksionet e së drejtës civile vendosin për një gamë të gjerë çështjesh duke përfshirë edhe njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Ka shumë gjasa të ndodhë që në organizimin e brendshëm të një gjykate të caktuar, një ose disa gjyqtarë janë kryesisht ose ekskluzivisht të ngarkuar të vendosin për njohjen e vendimeve të huaja, por ky vendim është disi rastësor si rezultat i specializimit ose përmbushjes së disa kushteve të veçanta nga një gjyqtar. Në pak fjalë, nuk ka ndonjë specializim midis gjyqtarëve as në fushën e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në përgjithësi dhe as në fushën më të ngushtë të njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore.

Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore nuk mund të vlerësohen. Pamundësia e kërimit të drejtpërdrejtë të praktikës ligjore paraqet një problem të konsiderueshëm. Vendimet e gjykatave nuk publikohen sistematikisht, apo të gjenden në faqet përkatëse të internetit. Për të marrë informacion të thelluar mbi praktikën e një gjykate të caktuar, duhet të paraqitet një kërkesë në përputhje me ligjin e BiH-së "Për aksesin në informacion". Për shkak të këtyre rrethanave, një pjesë shumë e vogël e vendimeve gjyqësore u bë pjesë e objektit të analizës, e cila nuk lejon nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse mbi sasinë dhe cilësinë e vendimeve gjyqësore.

Agjentët zbatues nuk kanë ndonjë kompetencë në proceset e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve. Vetëm gjyqtarët kanë të drejtë të merren me procedurën. Situata në lidhje me procedurën përmbartimore është pothuajse e njëjtë. Gjykatat vendosin nëse do të miratohet kërkesa për ekzekutim mbi bazën e një titulli të huaj; procedura përmbartimore që vijon nuk devijon nga procedura përmbartimore për çdo çështje tjetër. Agjentët zbatues luajnë një rol të vogël brenda procedurës përmbartimore në përgjithësi. Pozicioni i tyre nuk është i rregulluar saktësisht, ndryshon nga gjykata në gjykatë dhe vlerësohet me kritikizëm në literaturën përkatëse. Agjentët zbatues janë punonjës të gjykatës në BiH; ata janë të nënpaguar dhe nuk kanë ndonjë perspektivë për karrierë brenda sistemit. Kërkesat për punën e tyre nuk përcaktohen nga ligji për shërbimin përmbartimor dhe mund të rregullohen në forma të ndryshe nga secila gjykatë. Nuk ka provime të specializuara të pranimit; kandidatët për agjentë zbatues duhet të kalojnë vetëm provimin e nëpunësit civil për punonjësit, i cili nuk përfshin ndonjë njohuri apo aftësi në ligjin për shërbimin përmbartimor. Pas rekrutimit, agjentët zbatues nuk marrin ndonjë trajnim të specializuar. Të gjithë këta faktorë kanë ndikim në kapacitetin e agjentëve zbatues në përgjithësi.

Ka dy qendra për trajnimin për gjyqësorin dhe prokurorinë në BiH, të organizuara në nivel entiteti. Gjyqtarët e emëruar në Distriktin e Bërçkos në BiH mund të marrin pjesë në seminare në Republikën Srpska ose në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës. Gjyqtarët janë të detyruar të ndjekin një numër të caktuar trajnimesh çdo vit. Të dyja Qendrat bashkëpunojnë mirë dhe shpesh organizojnë trajnime të përbashkëta. Nëse kapacitetet e tyre e lejojnë, Qendrat mund të organizojnë trajnime për ata persona që nuk janë të detyruar të përfshihen në programin e trajnimit, për shembull, për nëpunësit e gjykatave që janë të përfshirë në procedurat përmbartimore, por ky lloj trajnimi është anashkaluar deri më tani.

Një analizë e raporteve vjetore të Qendrës në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës dhe të programit të saj për vitet 2020 dhe 2021 ka treguar se nuk ka trajnime standarde, të cilat mbahen rregullisht çdo vit mbi ligjin për të drejtën ndërkombëtare private. Situata është mjaft e paplanifikuar siç tregojnë titujt dhe ritmi i trajnimeve të zhvilluara. Mund të konkludohet se, si rregull (me devijim minimal), ofrohen rreth 20 trajnime në vit në çështjet civile (14-20% e numrit të përgjithshëm të trajnimeve) dhe në fushën e procedurave përmbartimore dhe jokontestimore, janë ofruar një ose

maksimumi dy seminare për secilën (rreth 1% e numrit të përgjithshëm të trajnimeve). Të dhënat çojnë në përfundimin se, në përgjithësi, çështjet civile dhe veçanërisht procedurat përmbartimore dhe jokontestimore nuk përfaqësohen në mënyrë të kënaqshme në formimin e vazhduar të gjyqtarëve. Analiza e temave të paraqitura tregon se njohja dhe ekzekutimi ndërmjet shteteve, që duhet të jepet gjatë trajnimit për ekzekutimin e çështjeve civile dhe jokontestimore, është një fushë e papërfaqësuar dhe shumë e lënë pas dore.

Lidhur me aspektet ekonomike dhe politike të zbatimit të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm nuk shoqërohet me masa të përshtatshme. Partnerët më të rëndësishëm tregtarë të BiH-së janë shtetet anëtare të BE-së, por ligji që lehtëson bashkëpunimin juridik brenda BE-së nuk zbatohet për marrëdhëniet me BiH-në si një shtet joanëtar. Zbatimi i rregulloreve përkatëse të BE-së në këtë fushë në rendin juridik të BiH-së mund të jetë problematik pasi sapo BiH të bëhet shtet anëtar, rregulloret e BE-së do të bëhen menjëherë të detyrueshme për BiH-në. Sidoqoftë, detyrat që lindin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përcaktojnë që shtetet palë duhet të marrin masa për të harmonizuar ligjet e tyre të brendshme me legjislacionin e BE-së. *acquis*. BiH nuk ka arritur ta bëjë këtë në fushën e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private. Siç u përmend, doktrina e konsideron aderimin në konventat ndërkombëtare në fushën e së drejtës ndërkombëtare private si një alternativë të përshtatshme. Fatkeqësisht, pas pavarësisë dhe përfundimit të luftës, BiH ka negociuar dhe është bërë anëtare e vetëm një numri të vogël të konventave ndërkombëtare shumëpalëshe dhe në këtë mënyrë nuk ka arritur të bëhet palë në shumë konventa të HCCH-së.

Rëndësia e nenit 5 të Konventës e kornizon atë si pjesën qendrore të Konventës. Sidoqoftë, ndoshta ndryshimet më të rëndësishme midis LDNP-së dhe Konventës qëndrojnë në juridiksionin ndërkombëtar. Konventa nuk përfaqëson të ashtuquajturën "konventë e dyfishtë/traktat i dyfishtë" por "traktat i thjeshtë", pasi ajo nuk rregullon juridiksionin ndërkombëtar por vetëm ekzekutimin dhe njohjen. Këtu, duhet të përmendet që BiH nuk e ka ratifikuar Konventën "Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës" të vitit 2005 e cila është plotësuese e Konventës. Konventa përcakton kriteret juridiksionale që pranohen në bazë të konventës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në shtetin e kërkuar. Dispozitat e LDNP-së që rregullojnë juridiksionin ndërkombëtar nuk përputhen me kriteret juridiksionale të konventës. Së pari, kriteri i juridiksionit të përgjithshëm dhe mbizotërues në LDNP, i cili është i lidhur me të paditurin, nuk përkon me të njëjtin kriter të konventës, pasi LDNP-ja mbështetet te vendbanimi dhe, me raste, te vendqëndrimi, dhe te Konventa "Për vendqëndrimin e zakonshëm". Vendqëndrimi i zakonshëm, i cili është bërë një nga faktorët më të rëndësishëm lidhës për përcaktimin e ligjeve të zbatueshme, si dhe juridiksionin në ligjin e së drejtës ndërkombëtare private të kohëve moderne, nuk njihet nga LDNP.

Vendqëndrimi i zakonshëm i të paditurit nuk është një kriter i vetëm juridiksional në konventë. Përveç vendqëndrimit të zakonshëm, konventa njeh tre grupe kriteresh juridiksioni si një lidhje me të paditurin. Këto kriterë bazohen në miratimin dhe lidhjen midis kërkesëpadisë dhe shtetit të origjinës. Të njëjtat kriterë mund të gjenden në LDNP, por numri, objekti dhe përmbajtja e kriterëve nuk përputhen.

Konventa bën dallimin midis tre formave të miratimit: miratimi i shprehur gjatë procesit gjyqësor, miratimi i nënkuptuar dhe marrëveshja e palëve për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës. LDNP-ja është pjesërisht në përputhje me konventën në lidhje me caktimin e heshtur të juridiksionit. Ashtu si konventa, LDNP-ja nuk e përmend termin miratim ose caktim i nënkuptuar i juridiksionit. Nga ana tjetër, LDNP-ja ndryshon nga konventa, pranon konceptin e "paraqitjes së argumenteve" ndaj juridiksionit. LDNP-ja lejon caktimin e shprehur të juridiksionit me disa kufizime, ku nuk bën asnjë ndryshim midis zgjedhjes ekskluzive dhe joekskluzive të gjykatës. Ky ndryshim vjen ndoshta si pasojë e ekzistencës së dy Konventave plotësuese të HCCH-së, një e vitit 2019 dhe një e vitit 2005. Për një shtet të tillë si BiH, që nuk është palë në Konventën e Hagës "Për zgjedhjen e gjykatës" të vitit 2005, kjo dispozitë e Konventës së vitit 2019 nuk është në fakt e vlefshme, pasi

nuk mund të veprojë si një pikë fillestare në rregullimin e kësaj çështjeje.

LDNP-ja dhe Konventa ndryshojnë ndjeshëm nga njëra-tjetra në lidhje me kriteret juridiksionale të cilat mbështeten në një lidhje midis kërkesëpadisë dhe gjykatës që ka dhënë vendimin. Këto ndryshime pasqyrojnë ndryshimet midis koncepteve themelore të përdorura nga këto dy instrumente ligjore. Konventa nuk rregullon juridiksionin por filtrat juridiksionalë (juridiksioni i tërthortë) ndërsa LDNP-ja zbaton qasjen e kundërt. Konventa sanksionon kriteret juridiksionale ose, thënë më mirë, "filtrat juridiksionalë" sipas të cilave gjykata e shtetit ku kërkohet njohja ose ekzekutimi vlerëson vendimin gjyqësor të dhënë në shtetin e origjinës. Nga ana tjetër, LDNP-ja parashikon juridiksion të drejtpërdrejtë - gjykata duhet të vendosë nëse është kompetente për të gjykuar çështjet ndërmjet shteteve sipas së ligjit të brendshëm ose një marrëveshjeje ndërkombëtare nëse është rasti.

Për më tepër, lista e kriterëve juridiksionale për lidhjen midis kërkesëpadisë dhe gjykatës që ka dhënë vendimin (gjykata e origjinës) është dukshëm më e gjatë në konventë sesa në LDNP. Kjo e fundit rregullon vetëm çështjet e mëposhtme: detyrimet jokontraktore, kërkesëpaditë mbi pronësinë kur prona e të paditurit ose pasuritë e përzgjedhura ndodhen në BiH, pretendimet e një të huaji për detyrimet që duhet të kryhen në BiH, pronësia dhe të drejtat e tjera reale (*in rem*) për pasuritë e paluajtshme ose avionët dhe anijet/mjetet e lundrimit. Të gjithë filtrat e tjerë juridiksionalë të rregulluar në konventë nuk përmenden në LDNP.

Analiza e procedurës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në BiH ka demonstruar se ka ndryshime të konsiderueshme në krahasim me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

Përcaktimi kryesor i qëllimit material të zbatimit është dhënë në nenin 1 të konventës, i cili sanksionon se konventa zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile ose tregtare në shtetin palë të një vendimi të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër palë. Burimet ligjore kombëtare (p.sh., LDNP) kanë një fushë më të gjerë zbatimi, duke siguruar njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve në çështjet e statusit dhe aftësisë ligjore të personave fizikë, të detyrimeve ushqimore si dhe çështje të tjera të së drejtës familjare, duke përfshirë regjimet e pasurisë martesore dhe të drejta ose detyrime të tjera që lindin nga martesa ose marrëdhënie të ngjashme, si dhe në çështjet e testamentëve dhe trashëgimisë. Për më tepër, LDNP përfshin të drejtat e privatësisë dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Të gjitha këto çështje përjashtohen nga qëllimi i konventës. Konventa parashikon shumë përjashtime nga zbatimi në nenin 6. Lista e arsyeve për moszbatim të konventës u krahasua me ato në LDNP. Në këtë pjesë nuk ka përputhje midis konventës dhe LDNP-së. Dispozitat e LDNP-së janë të zbatueshme për një numër më të madh të çështjeve në të drejtën civile dhe tregtare, si dhe në të drejtën familjare dhe të trashëgimisë. Kështu, qëllimi material i zbatimit të LDNP-së ndryshon nga ai i konventës.

LDNP nuk bën dallim midis vendimeve të huaja gjyqësore dhe nuk parashikon rregulla të ndryshme njohjeje në varësi të llojit të vendimit gjyqësor të huaj. Çdo vendim i huaj gjyqësor mund të njihet nëse ka marrë formë të prerë dhe nëse nuk ka arsye të parashikuara nga ligji për refuzimin e njohjes. LDNP nuk parashikon vetëm njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, por edhe të titujve të tjerë të huaj.

LDNP nuk bën dallim midis procedurës së njohjes si një çështje kryesore ose çështje paraprake dhe parashikon rregullat më të qarta të procedurave për të dyja (neni 101). Ekziston vetëm një ndryshim në lidhje me juridiksionin territorial. Zgjidhja në lidhje me vendimin për një çështje paraprake të përfshirë në nenin 8 të konventës nuk ekziston në LDNP.

LDNP nuk përmban një dispozitë të qartë se kush e parashikon në mënyrë aktive procedurën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Konventa gjithashtu e lë të papërcaktuar se kush ka të drejtë ta fillojë procesin gjyqësor.

Neni 12 i konventës përshkruan një sërë dokumentesh që duhet të paraqesë pala që kërkon

njohjen dhe ekzekutimin. Këtu konventa dhe LDNP nuk përputhen plotësisht. Ashtu si LDNP, ajo kërkon një kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor dhe një dokument shtesë i cili ka shkaktuar nisjen e procedurave në rast të një vendimi në mungesë. Kërkesa: - "çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar që vendimi gjyqësor ka efekt ose, sipas rastit, është i zbatueshëm në shtetin e origjinës" është një zgjidhje e duhur. Një formulim i tillë është shumë i favorshëm dhe siguron fleksibilitetin e nevojshëm, por dispozita përkatëse nuk qëndron në LDNP. Sa i përket zgjidhjeve në gjykatë, konventa parashikon rregulla që janë të përshtatshme për këto lloj titujsh, por nuk është kështu me LDNP-në. Kjo përbën një hendek thelbësor ligjor në ligjin aktual në BiH. Konventa nuk parashikon rregulla për tituj të mëtejshëm ekzekutivë dhe dokumente ekzekutive noteriale. Për më tepër, Raporti Shpjegues sugjeron që dokumentet administrative dhe dokumentet noteriale nuk mund të konsiderohen si vendime gjyqësore, që do të thotë se ato janë lënë jashtë objektit të konventës. Kjo çështje nuk është zgjidhur as në LDNP dhe diskutohet gjallërisht në doktrinë.

Lidhur me procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, konventa merr parasysh rregullat specifike procedurale që janë të zbatueshme në shtetet palë. Ajo gjithashtu u jep shteteve "liri veprimi" të tregohen të gjykueshme në rregullimin e procedurës me disa kufizime të vogla. Meqenëse BiH nuk është (ende) një shtet palë, këto kufizime nuk janë të zbatueshme. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore nuk është e mirërregulluar në LDNP. Vetëm një nen i LDNP-së i kushtohet kësaj çështjeje (neni 101). Kushtet kryesore për njohje janë që vendimi gjyqësor të ketë marrë formën e prerë, personi që kërkon njohjen dhe ekzekutimin të ketë paraqitur provat dhe konfirmimin e zbatueshmërisë së vendimit gjyqësor. LDNP rendit një sërë arsyes që do të rezultojnë në refuzimin e njohjes (ose të ekzekutimit).

Nuk ka dispozita të veçanta për zbatimin e titujve të huaj ekzekutivë. Procedura përmbartimor është gjithmonë e njëjtë, pavarësisht nëse bazohet në një titull të huaj apo titull të brendshëm. Ligji për shërbimin përmbartimor në BiH parashikon vetëm një lloj të procedurës përmbartimor: ekzekutimi që synon shitjen gjyqësore ose transferimin gjyqësor të të drejtave. Nuk parashikohet administrimi/sekuestrimi i detyruar. Metodat e ekzekutimit janë të ndryshme në varësi të pasurive të cilat kreditori i ka caktuar si objekt i ekzekutimit dhe jo nga lloji i titullit ekzekutiv (i huaj ose i brendshëm).

Nuk ka ndonjë veçanti në procedurë nëse gjykata vendos njohjen si çështje kryesore ose si çështje paraprake. Roli i agjentëve zbatues është shumë i kufizuar këtu: ata janë kryesisht të përfshirë në procedurën përmbartimor mbi pasuritë e luajtshme.

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore

BiH është një shtet i organizuar në mënyrë komplekse i përbërë nga dy entitete - Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republika Srpska (në vijim referuar si: RS) dhe Distrikti i Bërçkos në BiH (në vijim referuar si: DB BiH). Kompetencat legjislative janë të ndara midis shtetit dhe pjesëve të tij. Kushtetuta e BiH-së parashikon prezumimin e kompetencës në favor të entiteteve; kompetencat e Shtetit të BiH-së janë vetëm ato që specifikohen qartë në Kushtetutë. Kushtetuta e BiH-së nuk e rendit ligjin e së drejtës ndërkombëtare private, njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve si kompetenca të shtetit. Kjo do të thotë që BiH nuk ka autoritetin e drejtpërdrejtë për të rregulluar temat e përmendura. Në të vërtetë, legjislacioni i ekzekutimit rregullohet në nivelin e entiteteve dhe në Distriktin e Bërçkos në BiH, ashtu siç rregullohet procedura jokontestimore

(procedura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore është për nga natyra një procedurë jokontestimore⁷¹).

Situata me rregullimin e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private mund të jetë krejt e ndryshme. Sado që mund të duket e palogjikshme, hartimi i rreptë i Kushtetutës së BiH-së nënkupton kompetencën e entiteteve në këtë çështje.⁷² Sidoqoftë, Kushtetuta e BiH-së lejon transferimin e kompetencave të entiteteve në shtet (neni III paragrafi 5 i Kushtetutës së BiH-së). Për më tepër, miratimi i legjislacionit të së drejtës ndërkombëtare private mund të mbështetet në nenin I paragrafi 4 i Kushtetutës së BiH-së (i cili përcakton një treg “të përbashkët” me katër liritë themelore si në BE⁷³). Lënda e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private mund të jetë një fushë ku mund të përdoren mekanizmat kushtetues të sipërpërmendur, të përdorur rrallëherë. Një argument në favor të kësaj zgjidhjeje është një analogji me BE-në: për të arritur katër liritë dhe funksionimin e tregut të brendshëm, BE unifikoi një numër çështjesh të ligjit të së drejtës ndërkombëtare private edhe pse traktatet e Bashkimit Evropian nuk e përmendin shprehimisht një autoritet të tillë.⁷⁴

Në nivel shteti:

Burimi themelor i ligjit për njohjen dhe ekzekutimin e titujve të huaj ekzekutivë në çështjet civile dhe tregtare është ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara”⁷⁵ (në vijim referuar si: LDNP). Akti i ish-Jugosllavisë u miratua në rendin juridik të të dyja entiteteve të BiH-së dhe të Distriktit. Edhe pse bazat për përfshirjen e këtij ligji në rendet juridike të entiteteve janë të ndryshme,⁷⁶ për qëllimin e këtij raporti, është e rëndësishme vetëm që të njëjtat rregullore ligjore të zbatohen në të gjithë Bosnjë-Hercegovinën.

LDNP rregullon njohjen dhe ekzekutimin e të gjitha vendimeve gjyqësore dhe të arbitrazhit në terma të përgjithshëm. Neni 1 i LDNP-së rregullon objektin e ligjit që përfshin rregullat e konfliktit dhe juridiksionin ndërkombëtar në çështje të statusit, familjes dhe pronësisë. Megjithëse, duke përcaktuar objektin e rregullores, neni 1 i LDNP-së nuk bën asnjë referencë të qartë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje të statusit, familjes dhe të lidhura me pronësinë, ai rrjedh qartësisht nga ligji në tërësinë e tij. Megjithatë, çështjet e statusit dhe ato të lidhura me familjen, nuk janë me interes për këtë raport, kështu që ngrihet pyetja se çfarë nënkupton termi “marrëdhënie pronësore”, d.m.th., nëse ky nocion përfshin çështje civile dhe tregtare.

Përgjigja këtu duhet të jetë pohuese. Arsyeja për këtë mund të gjendet në ligjin “Për detyrimet” që pason një sistem monist. Prandaj, të njëjtat rregulla zbatohen për kontratat tregtare dhe për kontratat jotregtare, përveç nëse sanksionohet ndryshe shprehimisht në ligjin “Për detyrimet” në lidhje me kontratat tregtare (neni 25, paragrafi 1 i ligjit “Për detyrimet”). Sipas ligjit “Për detyrimet”, një kontratë konsiderohet të jetë tregtare nëse të dyja palët janë tregtarë dhe nëse ato e lidhin kontratën në fjalë brenda fushës së veprimtarisë së tyre të biznesit/aktiviteteve të regjistruara. Përveç kësaj, marrëveshjet dypalëshe për ndihmën juridike ndërmjet shteteve që BiH lidhi me shtetet që u krijuan nga ish-RSFJ-ja rregullojnë, ndër të tjera, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile të dhëna në një shtet tjetër nënshkrues i marrëveshjes, ndërsa çështjet civile nënkuptojnë qartë vendimet e marra edhe në çështjet tregtare.⁷⁷

71 Shihni Muminović, *Procesno međunarodno privatno pravo*, f. 116; Šaula, *Osnovi međunarodnog privatnog prava Republike Srpske*, f. 302.

72 Shihni Šaula, *Reform of Private International Law in Countries Successors of the Former Yugoslavia*, f. 1355, dhe Šaula, *Osnovi međunarodnog privatnog prava Republike Srpske*, f. 54-56.

73 Meškić, Četiri osnovne slobode kao ustavni osnov za harmonizaciju entitetskih propisa, f. 370; Alihodžić, Meškić dhe Duraković. Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot? f. 158.

74 Për analogji me BiH-në, shihni Meyer, *Uvođenje Zajedničkog evropskog prava prodaje*, f. 18.

75 Fletorja Zyrtare e Republikës Socialiste të Jugosllavisë, nr. 43/ 82,72/82.

76 Në Federatën e BiH-së, ky ligj u zëvendësua nga një Rregullore me efekt juridik për njohjen dhe zbatimin e ligjeve federale (Fletorja Zyrtare e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, 2/92). Kjo rregullore më pas u miratua si ligj (Fletorja Zyrtare e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, 13/94).

Në Republikën Srpska, në zbatim të nenit 12 të ligjit „Për zbatimin e Kushtetutës së Republikës Srpska“, të gjitha ligjet federale të ish-RSFJ-së u përfshinë në rendin juridik të Republikës Srpska me kusht që ato të mos binin në kundërshtim me rendin juridik në fuqi (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, nr. 21/92).

77 Pra, neni 24 i Marrëveshjes ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Maqedonisë “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”; neni 2, paragrafi 2 i Marrëveshjes ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Sllovenisë “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”; neni 1, paragrafi 2 i Marrëveshjes midis Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë dhe Malit të Zi “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”; neni 2, paragrafi 2 i Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë, Qeverisë së Bosnjë-Hercegovinës dhe Qeverisë së Federatës së BiH-së “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe

LDNP përmban rregulla të përgjithshme për ekzekutimin e titujve të huaj ekzekutivë, pavarësisht nëse ato kanë të bëjnë me çështjet e statusit, familjes ose pronës, me disa përjashtime kur bëhet fjalë për marrëdhëniet familjare ose çështjet e statusit (shihni 6.1 më poshtë). Sidoqoftë, kjo nuk është temë në interes të këtij projekti. Ky raport përqendrohet në njohjen e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare.

Rregulloret për njohjen dhe ekzekutimin e titujve të huaj ekzekutivë janë përqendruar kryesisht në ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.⁷⁸ Parimi themelor është që një vendim i huaj gjyqësor të bëhet i barasvlershëm me një vendim gjyqësor të brendshëm, nëse i pari është njohur nga një gjykatë vendase.⁷⁹ Prandaj, prototipi i një titulli të huaj ekzekutiv është një vendim i huaj gjyqësor, ndërsa të gjithë titujt e tjerë ekzekutivë mund të njihen pasi ato bëhen të barabarta me një vendim të huaj gjyqësor: një zgjidhje e huaj gjyqësore, një vendim nga një organ tjetër kombëtar i cili është i barasvlershëm me⁸⁰ një vendim gjyqësor ose zgjidhje gjyqësore në vendin e origjinës së tij.⁸¹

Për më tepër, LDNP parashikon posaçërisht njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. LDNP rregullon në detaje parakushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore (neni 87-96 të LDNP-së) dhe vendimeve të huaja të arbitrazhit (neni 91 dhe 100 të LDNP-së), por jo parakushtet për ekzekutimin e titujve të tjerë të huaj ekzekutivë. Titujt e përmendur njihen dhe ekzekutohen nga zbatimi analog i dispozitave që kanë të bëjnë me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve nga gjykatat e huaja. Sidoqoftë, për shkak të natyrave dhe specifikave të ndryshme që mund të kenë këta tituj, ata nuk mund të plotësojnë të gjitha parakushtet e kërkuara për një vendim gjykate (për shembull, një zgjidhje nuk është e formës së prerë, vendimet e një organi administrativ nuk janë të formës së prerë ashtu si vendimet e gjykatave, etj). Prandaj, një zbatim analog i rregullave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore është shpesh problematik. Rregulloret specifike mbi parakushtet për njohjen dhe ekzekutimin e çdo titulli individual ekzekutiv do të lehtësonin shumë njohjen dhe ekzekutimin.⁸²

LDNP sanksionon përparësinë e burimeve ligjore ndërkombëtare ndaj burimeve kombëtare (neni 3); kjo dispozitë duhet të përfshihet në Kushtetutën e BiH-së. Që nga pavarësia e saj, BiH-ja ka qenë mjaft aktive në lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për të drejtën ndërkombëtare private. Sidoqoftë, BiH-ja nuk e filloi nga zeroja. Si një vend i ish-Jugosllavisë, ajo u bë anëtare e mbi njëzet traktateve dypalëshe për ndihmën juridike në çështjet civile, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe procedurave civile. Që nga ajo kohë, BiH-ja ka ratifikuar marrëveshjet dypalëshe për të drejtën civile, kryesisht me shtetet e rajonit, por edhe me shtete të tjera si Kina apo Turqia.⁸³

Nëse BiH bëhet anëtare e Konventës së HCCH-së të vitit 2019, do të lindë pyetja se cila marrëveshje (dypalëshe ose shumëpalëshe – Konventa e HCCH-së) ka përparësi. Marrëveshjet dypalëshe të lidhura me shtetet që dolën nga ish-Jugosllavia rregullojnë, ndër të tjera, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Ekzistojnë dy qëndrime në lidhje me hierarkinë e burimeve ligjore ndërkombëtare. Sipas të parit, një marrëveshje dypalëshe e tejkalon një marrëveshje shumëpalëshe në përputhje me parimin *lex specialis derogat legi generali*.⁸⁴ Sipas qëndrimit të dytë, një marrëveshje dypalëshe nuk duhet të shihet si *lex specialis* pasi mund të rregullojë të njëjtën çështje si një marrëveshje shumëpalëshe, kështu që parimi drejtues duhet

penale”.

78 Kjo është e vërtetë për rregulloret e të gjitha shteteve që dolën nga ish-Jugosllavia. Shihni gjithashtu, Rijavec, *Das internationale Vollstreckungsrecht am Beispiel Sloweniens*, f. 83-84.

79 Neni 86, paragrafi 1 i LDNP-së.

80 Neni 86, paragrafi 2 i LDNP-së.

81 Neni 86, paragrafi 3 i LDNP-së.

82 Povelakić, Izvršenje stranih izvršnih naslova sa posebnim osvrtno na strane notarske isprave, f. 260.

83 Lista e traktateve ndërkombëtare dhe dypalëshe të ratifikuara nga BiH-ja mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë të BiH-së, në: [http://www.mpr.gov.ba/organizacija_nadleznosti/medj_pravna_pomoc/bilateralni_ugovori/Konvencije.aspx?langTag=bs-BA\(28.4.2021\)](http://www.mpr.gov.ba/organizacija_nadleznosti/medj_pravna_pomoc/bilateralni_ugovori/Konvencije.aspx?langTag=bs-BA(28.4.2021)). Shihni gjithashtu: Alihodžić, Meškić dhe Duraković. Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f. 167.

84 Për më shumë shihni Muminović, *Međunarodno privatno pravo*, f. 31. Për këtë qëndrim, shihni: Varadi, Bordaš, Knežević dhe Pavić, *Međunarodno privatno pravo*, f. 78.

të jetë *lex poserior derogat legi priori*.⁸⁵ Konsensusi për këtë çështje nuk është arritur në BiH. Sidoqoftë, literatura më e fundit argumenton se marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe janë në të njëjtën pozitë hierarkike dhe se çdo rast sanksionon se cili nga dy parimet udhëzuese për hierarkinë e burimeve ligjore duhet të zbatohet. (Fakti i thjeshtë që një marrëveshje dypalëshe detyron dy shtete, nuk do të thotë automatikisht se është *lex specialis* në lidhje me një marrëveshje shumëpalëshe që rregullon të njëjtën çështje – nëse është *lex specialis* apo *lex posterior* duhet të përcaktohet në secilin rast.)⁸⁶ Fakti që një marrëveshje dypalëshe detyron një numër më të vogël shtetesh nuk do të thotë se e tejkalon një marrëveshje shumëpalëshe.⁸⁷

Në nivel entiteti/ Distrikti të Bërçkos në BiH

LDNP është burimi i vetëm ligjor kombëtar që është unik për të gjitha pjesët e BiH-së. Burimet e tjera ligjore për çështje juridike të cilat janë të rëndësishme për këtë raport rregullohen nga entitetet dhe Distrikti i Bërçkos në BiH.

Procedura përmbartimore: Ligji “Për procedurën përmbartimore” në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës,⁸⁸ ligji “Për procedurën përmbartimore” në Republikën Srpska,⁸⁹ ligji “Për procedurën përmbartimore” në Distriktin e Bërçkos në BiH.⁹⁰ Përveç LDNP-së, këto ligje mbi procedurën përmbartimore janë të rëndësishme për këtë raport. Ligjet për procedurën përmbartimore rregullojnë vetëm ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.⁹¹ Në fakt, ka të bëjë me një dispozitë që nuk përbën një risi në lidhje me LDNP-në. Përkundrazi, kjo dispozitë është e mangët në disa aspekte krahasuar me dispozitat e LDNP-së. Të tre ligjet për procedurën përmbartimore në BiH specifikojnë që vendimet e marra nga gjykatat e huaja mund të zbatohen nëse vendime të tilla plotësojnë kërkesat për njohje të përcaktuara në ligj, ose në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Këtu kemi një mospërputhje midis ligjeve për procedurën përmbartimore dhe LDNP-së, pasi ligji për shërbimin përmbartimor parashikon vetëm dhe në mënyrë rigorozë mundësinë për të vendosur mbi ekzekutimin e një vendimi të huaj gjyqësor duke e vendosur njohjen si një çështje paraprake. Titujt e tjerë ekzekutivë nuk janë marrë parasysh.

Procedura jokontestimore: Ligji “Për procedurën jokontestimore” i Federatës së BiH-së,⁹² ligji “Për procedurën jokontestimore” i Republikës Srpska,⁹³ ligji “Për procedurën jokontestimore” i Distriktit Bërçkos në BiH.⁹⁴ Këto ligje janë të ndara në dy pjesë: së pari, një pjesë e përgjithshme, e cila rregullon parimet dhe çështjet e përgjithshme dhe institucionet përkatëse për secilën procedurë specifike jokontestimore të rregulluar nga ligjet për procedurën jokontestimore ose ndonjë ligj tjetër dhe pjesa e dytë që rregullon llojet e ndryshme të procedurave jokontestimore (për shembull, një ndarje e bashkëpronësisë, ose një procedurë e miratimit të martesës për individë të mitur). Procedura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore nuk është e rregulluar midis këtyre procedurave specifike jokontestimore. Sidoqoftë, doktrina dhe gjyqësorët konstatojnë se pa diskutim kjo është një procedurë jokontestimore.

Ligji “Për shërbimin publik të noterisë”: Ligji “Për noterinë” i Federatës së Bosnjë-

Hercegovinës,⁹⁵ ligji “Për noterinë” i Republikës Srpska,⁹⁶ ligji “Për noterinë” i Distriktit të Bërçkos në BiH⁹⁷ Ligjet që rregullojnë shërbimet noteriale janë të rëndësishme për këtë raport pasi ato rregullojnë efektet e akteve të huaja noteriale. Sipas këtyre ligjeve, aktet e huaja noteriale kanë të njëjtat efekte juridike si aktet e brendshme noteriale. Parakushti i vetëm për efektin e njëjtë të një akti të huaj noterial është reciprociteti. Meqenëse ligjet “Për noterinë” nuk përmbajnë dispozita të mëtejshme mbi aktet e huaja noteriale dhe reciprocitetin, mund të arrihet në përfundimin se kërkohet reciprociteti faktik i supozuar. Dispozitat e ligjeve “Për noterinë” nuk mund të konsiderohen të mëvetësishme dhe pa lidhje me rregulloret e përgjithshme të LDNP-së ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo do të thotë që aktet noteriale nuk mund të përjashtohen nga rregulloret e përgjithshme që rregullojnë njohjen.

Ligjet që rregullojnë organizimin e gjykatës: Ligji “Për gjykatat” i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës,⁹⁸ ligji “Për gjykatat” i Republikës Srpska,⁹⁹ ligji “Për gjykatat” i Distriktit të Bërçkos në BiH.¹⁰⁰ Këto ligje janë të rëndësishme për këtë raport pasi ato përcaktojnë se cilat gjykata janë kompetente për njohjen dhe ekzekutimin e titujve të huaj ekzekutivë.

Ligjet që rregullojnë procedurën civile: Ligji “Për procedurën civile” i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës,¹⁰¹ ligji “Për procedurën civile” i Republikës Srpska,¹⁰² ligji “Për procedurën civile” i Distriktit të Bërçkos në BiH,¹⁰³ janë të rëndësishme këtu pasi rregullat e procedurës gjyqësore zbatohen për procedurën jokontestimore nëse një çështje e caktuar nuk rregullohet sipas procedurës jokontestimore. Këto ligje janë gjithashtu të rëndësishme pasi ato përmbajnë dispozita për shërbimin e marrjes së dokumenteve gjyqësore jashtë vendit.

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor

Në kohën e miratimit të tij, ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara” konsiderohej një instrument modern me një reputacion të thellë në të drejtën e krahasuar.¹⁰⁴ Në pothuajse katër dekada që nga miratimi i tij, e drejta e krahasuar prodhoi një numër ndryshimesh thelbësore në të drejtën ndërkombëtare private. Janë miratuar shumë ligje dhe instrumente të reja në lidhje me të drejtën ndërkombëtare private materiale dhe procedurale.¹⁰⁵ BiH-ja nuk ka qenë pjesë e këtij procesi,¹⁰⁶ që do të thotë se LDNP është vjetëruar dhe duhet të reformohet. Fatkeqësisht, reforma në ligjin e së drejtës ndërkombëtare private nuk është në fokusin e interesit të ligjvënësive (eve), megjithëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në këtë fushë në rajon dhe në të drejtën e krahasuar në përgjithësi në dekadat e kaluara. Dështimi i vazhdueshëm i reformës mund të shihet gjithashtu në dritën e dështimit të BiH-së për të përmbushur detyrimet e saj që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, pasi futja e standardeve të së drejtës ndërkombëtare private të BE-së në legjislacionin e BiH-së po shtyhet.¹⁰⁷

95 Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, 45/02, 30/16 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

96 Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 86/04, 2/05, 74/05, 76/05 - korrigjim, 91/06, 37/07, 74/07 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 50/10, 78/11, 20/14, 68/17, 113/18 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 82/19.

97 Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 9/03, 17/06.

98 Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, 38/05, 22/06, 63/10, 72/10.

99 Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 37/2012, 14/2014 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 44/2015, 39/2016 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe 100/2017.

100 Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 80/20 - version i konsoliduar.

101 Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, 53/03, 73/05, 19/06, 98/15.

102 Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 58/03, 85/03, 74/05, 63/07, 105/08 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 45/09 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 49/09 dhe 61/13.

103 Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 28/18.

104 Šarčević, The New Yugoslav Private International Law Act, f. 283-296.; Lipowscheck, Das neue jugoslawische Internationale Privat- und Prozessrecht im Bereich des Vermögensrecht, pp. 426.; Firshing, Das neue jugoslawische IPR-Gesetz, f. 1-5; Župan, Novi Zakon o međunarodnom privatnom pravu, f. 2.

105 Ligji i ri u miratua në Slloveni në vitin 1999, Bullgari në 2005, Maqedoni e Veriut në 2007 me ndryshime në 2010 dhe më pas një ligj plotësisht i ri në 2020, Shqipëri në 2011, Rumania në 2011, Poloni në 2011, Republikën Çeke në 2012, Mal të Zi në 2014, Hungari dhe Kroaci në 2017.

106 Instead of many others: Jessel-Holst, The Reform of Private International Law Acts in South East Europe, with particular Regard to the West Balkan Region, f. 139.

107 Alihodžić, Meškić dhe Duraković: Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f. 178.

Në shumë shtete me një rend juridik kompleks, e drejta ndërkombëtare private rregullohet në nivel shtetëror/federal (për shembull në Gjermani, Zvicër, Austri). Është më tepër një përjashtim që kjo çështje të jetë në kompetencën e shteteve federale (për shembull në SHBA). Sidoqoftë, për shkak të kornizës specifike kushtetuese të BiH-së, reforma e së drejtës ndërkombëtare private nuk është në axhendën e ligjvënësit në nivelin shtetëror. Së bashku me faktin që BiH ka një sistem juridik kompleks, miratimi i tre ligjeve të mëvetësishme për të drejtën ndërkombëtare private do ta bënte situatën edhe më komplekse. Kufizimet kushtetuese dhe mungesa e vullnetit politik ruajnë status quo-në. Një nga mënyrat alternative mund të jetë pranimi i BiH-së në konventat ndërkombëtare në të cilat BE është palë, për shembull, konventat e miratuara në kuadrin e HCCH-së për ligjin e së drejtës ndërkombëtare private.¹⁰⁸

Procedura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore rregullohet me vështirësi si një procedurë jokontestimore, e cila nuk mund të vlerësohej pozitivisht.

Mungesa e harmonizimit midis ligjeve "Për procedurën përmbartimore" dhe LDNP-së duhet të shihet si problematike. Ligjet "Për procedurën përmbartimore" i referohen vetëm ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore, ndërsa LDNP lejon ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, të zgjidhjeve të huaja gjyqësore, të vendimeve të huaja të ekuivalentuara me vendimet gjyqësore në vendin e caktuar, si dhe të vendimeve të huaja të arbitrazhit dhe marrëveshjeve të arbitrazhit. Në shikim të parë, dispozitat e ligjeve për procedurën përmbartimore përfshijnë një objekt më të ngushtë të titujve të huaj ekzekutivë se LDNP.¹⁰⁹ A nënkupton ngushtimi i titujve të huaj ekzekutivë në ligjet për procedurën përmbartimore se është e mundur vetëm të ekzekutohen vendimet e huaja gjyqësore? Një interpretim i tillë nuk mund të mbrohej. Kjo dispozitë ligjore disi e çuditshme e ligjeve për procedurën përmbartimore duhet të interpretohet sistematikisht në lidhje me dispozitat e LDNP-së, pasi vendimi i huaj gjyqësor është një nocion i përgjithshëm për të gjithë titujt e huaj ekzekutivë të renditur në LDNP. LDNP i referohet vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë të konsideruar si vendime gjyqësore (neni 86 i LDNP-së).

Nëse BiH bëhet anëtare e BE-së, një numër rregulloresh mbi të drejtën ndërkombëtare private do të ishin drejtpërdrejt të zbatueshme. Nuk ka pengesa, madje është në favor të BiH-së të harmonizojë tani ligjin e saj të së drejtës ndërkombëtare private me BE-në. Kjo është realizuar tashmë nga Mali i Zi,¹¹⁰ Maqedonia e Veriut,¹¹¹ Serbia (e cila është në fazën e fundit të miratimit të ligjit të ri)¹¹² dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor.¹¹³ Sidoqoftë, nuk ka asnjë projekt legjislativ për këtë çështje në BiH për shkak të rendit specifik kushtetues.

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Në përputhje me Kushtetutën e BiH-së dhe legjislacionin përkatës, njohja dhe ekzekutimi ndërmjet shteteve janë procedura të caktuara për gjykatat. Meqenëse palët zakonisht

¹⁰⁸ Alihodžić, Meškić dhe Duraković: Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f. 178.

¹⁰⁹ Ky është rasti me të gjitha ligjet e tjera të ish republikave Jugosllave, me disa ndryshime në Slloveni dhe Serbi. Për më shumë, shihni Povlakić, Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Mobiliarsicherheiten in Südosteuropa, f. 257-282.

¹¹⁰ Mandić, Montenegro in: IEL, f. 17, nënparagrafi 7 - 11.; Šaula, Reform of Private International Law in Countries Successors of the Former Yugoslavia, New Legal Challenges v. Legal Tradition, f. 1354; Meškić-Dordević, Međunarodno privatno pravo, f. 30.

¹¹¹ Jessel-Holst, Makedonija na putu ka modernom međunarodnom privatnom pravu, f. 7.

¹¹² Shihni më shumë rreth reformës në ligjin e së drejtës ndërkombëtare private në rajon: Šaula, Reform of Private International Law in Countries Successors of the Former Yugoslavia, New Legal Challenges v. Legal Tradition, f. 1348. et al.; Jessel-Holst, Makedonija na putu ka modernom međunarodnom privatnom pravu, f. 7 et al.

¹¹³ Jessel-Holst, The Reform of Private International Law Acts in South East Europe, with particular Regard to the West Balkan Region, f. 134.

përfaqësohen në procedurat para gjykatave nga avokatët, ata gjithashtu mund të vlerësohen si aktorë të rëndësishëm në këtë fushë. Ministria e Drejtësisë e BiH-së luan një rol të rëndësishëm në negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Struktura ligjore e kuadrit institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në BiH nuk është tejet komplekse në vetvete: "lojtarët e mëdhenj" janë gjykatat. Komplexiteti shkaktohet nga organizimi i ndërlikuar shtetëror i BiH-së. Me përjashtim të Ministrisë së Drejtësisë së BiH-së, të gjithë aktorët e tjerë "luajnë" në nivelin e entiteteve ose të Distriktit. Sistemi gjyqësor është i organizuar brenda entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos në BiH pa Gjykatën e Lartë të BiH-së, e cila ka juridiksionin e apelit ose të kasacionit.¹¹⁴ Për këtë arsye, jurisprudenca në lidhje me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore mund të ndryshojë midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos në BiH. Nuk ka asnjë mekanizëm për unifikimin e praktikës gjyqësore në këtë çështje.

2.2. Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.2.1. Gjykatat

Në të tre pjesët e BiH-së gjykatat luajnë rolin kryesor në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve. Ligjet për gjykatat kanë dispozita mbi organizimin, kompetencën dhe funksionimin e gjykatave. Në Federatën e BiH-së dhe në Republikën Srpska, njohja e vendimeve të huaja gjyqësore është brenda kompetencës së gjykatave të shkallës së dytë (këto janë gjykatat e Kantoneve në Federatë dhe Gjykatat e Distriktit në Republikën Srpska). Ato kanë të drejtë të vendosin për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore në çështje civile dhe tregtare dhe të vendimeve të huaja të arbitrazhit.¹¹⁵ Në të dyja entitetet, Gjykatat e Larta janë kompetente për të vendosur në proceset e apelit.

Situata në Distriktin e Bërçkos në BiH është disi specifike: ekziston vetëm një gjykatë e shkallës së parë (gjykata bashkiake) dhe vetëm një gjykatë e shkallës së dytë (gjykata e apelit). Për këto arsye, d.m.th., për të garantuar një procedurë me dy shkallë, gjykata bashkiake është kompetente të vendosë për njohjen e titujve të huaj. Sidoqoftë, kjo çështje nuk është rregulluar shprehimisht në ligjin "Për gjykatat" të Distriktit të Bërçkos në BiH, por ky përfundim mund të nxirret në bazë të dispozitave ligjore me të cilat gjykata bashkiake zhvillon dhe vendos në procedura jokontestimore,¹¹⁶dhe kur procedurat që njohin titujt e huaj konsiderohen procedura jokontestimore. Përveç kësaj, objekti i kompetencës së gjykatës bashkiake të Distriktit të Bërçkos përfshin gjithashtu ndihmën juridike ndërkombëtare,¹¹⁷dhe këto dy dispozita ligjore lejojnë përfundimin e lartpërmendur.

Procedura përmbartimore u caktohet gjykatave të shkallës së parë. Në gjykatat me një vëllim të lartë çështjesh, seksionet speciale janë të ngarkuara me ekzekutimin dhe janë të specializuara për këtë detyrë, ndërsa nuk ka asnjë seksion të veçantë në gjykatën e shkallës së dytë për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.

Sa më sipër tregon se procedurat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore janë procedura plotësisht të ndara dhe të kryera nga gjykata të ndryshme. Këto procedura mund të bashkohen nëse gjykata e zbatimit vendos për njohjen si një çështje paraprake me efekt vetëm për procedurën konkrete të ekzekutimit (shihni 6.3).

¹¹⁴ Gjykata e BiH-së ka një fushë shumë specifike të kompetencës dhe nuk vendos për apelin ose zgjidhje të tjera juridike kundër gjykatave të zakonshme të entiteteve/Distriktit të Bërçkos në BiH.

¹¹⁵ Neni 28, paragrafi 3, germa „e“ e ligjit „Për gjykatat“ të Federatës së BiH-së; neni 31, paragrafi 3, germa „d“ e ligjit „Për gjykatat“ e RS-së.

¹¹⁶ Neni 21, paragrafi 3 i ligjit „Për gjykatat“ të Distriktit të Bërçkos në BiH.

¹¹⁷ Neni 21, paragrafi 4, germa „f“ e ligjit „Për gjykatat“ të Distriktit të Bërçkos në BiH.

2.2.2. Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore, etj.)

Ministria e Drejtësisë e Bosnjë-Hercegovinës u krijua në vitin 2003, në përputhje me ligjin "Për ministrinë dhe organet e tjera administrative të BiH-së".¹¹⁸ Objekti i përgjegjësisë së saj përfshin, *ndër të tjera*, bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe midis entiteteve (ndihmë e ndërsjellë juridike dhe kontakte me gjykata ndërkombëtare, hartim i legjislacionit përkatës lidhur me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe midis entiteteve, duke garantuar që legjislacioni i BiH-së dhe zbatimi i tij në të gjitha nivelet organizative në BiH të jenë në përputhje me detyrimet e BiH-së që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare. Për më tepër, kjo Ministri është e autorizuar të bashkëpunojë si me Ministrinë e Punëve të Jashtme të BiH-së, edhe me entitetet në hartimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Kjo Ministri mund të shihet si një gur themeli për vendimin/diskutimin e mëpasshëm mbi aderimin në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore".

2.2.3. Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.)

Palët në procedura jokontestimore nuk janë të detyruara të përfaqësohen nga një avokat. Sidoqoftë, palët zakonisht përfaqësohen nga një avokat në procedurat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, veçanërisht nëse kërkuesi është një person fizik ose juridik që nuk është folës i gjuhëve zyrtare dhe i cili nuk është i njohur me ligjin në BiH. Kështu ndodh shpesh kur persona të huaj fizikë ose juridikë kërkojnë njohje dhe ekzekutim në BiH. Për procedime gjyqësore me cilësi më të lartë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, bashkëveprimi midis gjykatave/gjyqtarëve dhe avokatëve e përfaqësuesve ligjorë është shumë i rëndësishëm. Ndërsa gjyqtarët janë të detyruar të marrin pjesë në arsimin e detyruar të organizuar nga Qendrat për arsimimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (s. 3.4.), avokatët nuk janë, gjë që sjell disa mangësi. Përveç kësaj, në BiH, specializimi mes avokatëve është mjaft i rrallë, ndërsa specializimi në të drejtën ndërkombëtare private është pothuajse inekzistent.

2.2.4. Agjentët zbatues

Agjentët zbatues në BiH janë punonjës gjyqësorë me kompetenca shumë të kufizuara në procedurën përmbartimore dhe pa kompetenca në procedurën e njohjes. Kur ata janë aktivë në procedurën përmbartimore, ata kanë të njëjtat të drejta dhe detyra pavarësisht nga titujt ekzekutivë (tituj të huaj ose të brendshëm ekzekutivë). Për më shumë rreth statusit të agjentit zbatues shihni 3.3. më poshtë.

2.2.5 Aktorë të tjerë të rëndësishëm

Personat/njësitë që mund të organizojnë dhe ofrojnë arsim për njohjen dhe ekzekutimin duhet të konsiderohen aktorë të rëndësishëm. Roli i Qendrave për arsimimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të diskutohet më hollësisht në seksionin 3.4.

Universitetet mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm së paku në dy drejtime: së pari, duke ofruar programe mësimore të përshtatshme për një arsimim themelor të konsoliduar në të drejtën private ndërkombëtare (dhe ligjin për shërbimin përmbartimor). Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore është një pjesë standarde e kurrikulës në të drejtën ndërkombëtare private dhe zakonisht mësohet në semestrin e fundit të studimeve. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore rrallë është objekt i arsimit në klinika ligjore, çka mund të shihet si një mangësi. Së dyti, meqenëse doktrina ka deklaruar se te gjyqtarët vërehen mangësi të konsiderueshme të njohurive në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, kjo mund të jetë një arsye përse kurset

e specializuara mund të ofrohen si pjesë e të nxënës gjatë gjithë jetës nga universitetet.

2.3. Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve

Ndërsa dëshmojmë për ndërkombëtarizimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve juridike dhe rritjen e tregtisë ndërkombëtare, këto procese kërkojnë një kuptim më të mirë të sistemit ligjor vendas dhe përshtatshmërisë së tij në trajtimin e problemeve ligjore me një element ndërkombëtar. Është e rëndësishme t'i qasemi këtij problemi në mënyrë sistematike. Bashkëpunimi midis aktorëve është jetik në këtë proces. Rritja e cilësisë së shërbimeve ligjore të ofruara nga juristët dhe vendimet e marra nga gjykatat në BiH varen nga arsimimi i tyre. Në këtë fazë, një arsimim i konsoliduar është i nevojshëm. Qendrat që ofrojnë arsimim për gjyqtarët dhe prokurorët mund të zhvillojnë një program të fokusuar në të drejtën ndërkombëtare private. Siç u përmend më lart, një rol shumë të rëndësishëm duhet të luajë akademia, pasi pedagogët e universiteteve në BiH janë të pajisur me njohuri mbi të drejtën ndërkombëtare private. Për më tepër, meqenëse shtetet në rajon kanë më shumë përvojë legjislative me zhvillimet e fundit në të drejtën ndërkombëtare private, bashkëpunimi me organet e tyre arsimore dhe ekspertët mund të jetë shumë i dobishëm.

Meqenëse nuk ka mekanizma për unifikimin e praktikave gjyqësore midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos në BiH, një unifikim *de facto* mund të arrihet përmes bashkëpunimit të Gjykatave të Larta të entiteteve dhe gjykatës së Apelit të Distriktit të Bërçkos në BiH. Trajnime të përbashkëta për ekspertët ligjorë dhe gjyqtarët në të gjithë shtetin mund të organizohen në kuadër të shumë projekteve që ofrojnë mbështetje për sistemin gjyqësor në BiH. Institucionet kryesore qeveritare, Ministria e Drejtësisë e BiH-së dhe Ministria e Punëve të Jashtme e BiH-së, duhet të përfshijnë akademikët e duhur në procesin e negocimit dhe aderimit në instrumentet ndërkombëtare.

3. Roli i gjykatave dhe i agjentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

3.1. Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Në BiH organizimi i gjykatave ndryshon në pjesë të ndryshme të BiH-së (Federata e Bosnjë-Hercegovinës, Republika Srpska, Distrikti i Bërçkos në BiH). Siç u tha më lart në seksionin 2.2.1, ekziston një gjykatë e shkallës së parë dhe një gjykatë e shkallës së dytë në Distriktin e Bërçkos në BiH dhe nuk ka gjykata të specializuara (për shembull, gjykata për çështjet familjare, gjykata për çështjet e punës, gjykata administrative ose tregtare). Federata e BiH-së ofron të njëjtën situatë: nuk ka gjykata të specializuara, megjithëse doktrina advokon vazhdimisht për specializimin.¹¹⁹ Në Republikën Srpska, janë krijuar gjykata të specializuara tregtare.

Brenda gjykatave ka seksione të së drejtës penale, civile dhe administrative; procedura përmbartimore dhe jokontestimore shpesh përfshihen në seksionin e së drejtës civile. Shpërndarja e çështjeve brenda gjykatave kryhet automatikisht bazuar në Sistemin për Menaxhimin Automatik të Çështjeve (në vijim referuar si: CMS). CMS pasqyron organizimin e brendshëm të përmendur më parë të gjykatave dhe të gjitha çështjet caktohen sipas një fushe specifike ligjore. Proceset për njohje janë të një natyre jokontestimore dhe këto çështje klasifikohen me "V" për "vanparnični postupak" - procedurë jokontestimore. Sistemi CMS bën shpërndarjen automatike dhe rastësore të çështjeve te gjyqtari i një seksioni të caktuar gjykate. Në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikën Srpska, gjykatat e shkallës së dytë janë kompetente për të vendosur mbi njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor, por nuk ka seksion të specializuar për këtë çështje; seksionet e së drejtës civile vendosin për gamën e gjerë të çështjeve civile, duke përfshirë njohjen e vendimeve

¹¹⁸ Fletorja Zyrtare e BiH-së, nr. 5/2003.

¹¹⁹ Për më shumë shihni: Martinović, Potreba za reformom pravosuđnih sustava u BiH.

të huaja gjyqësore. Ka shumë gjasa të ndodhë që në organizimin e brendshëm të një gjykate të caktuar, një ose disa gjyqtarë janë kryesisht ose ekskluzivisht të ngarkuar të vendosin për njohjen e vendimeve të huaja, por ky vendim është disi rastësor si rezultat i specializimit ose përmbushjes së disa kushteve të veçanta nga një gjyqtar. Në pak fjalë: nuk ka ndonjë specializim midis gjyqtarëve në fushën e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në përgjithësi dhe as në fushën më të ngushtë të njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore.

Një analizë e vendimeve gjyqësore të disponueshme për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor jepet në seksionin 3.2. Është analizuar një kampion i vogël (një numër i vogël vendimesh) dhe nuk ka qenë e mundur të nxirren përfundime përkatëse, por më tepër të merret një përshtypje ose indicie mbi sasinë dhe cilësinë e vendimeve gjyqësore për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve. Këtu vlen të theksohet se gjykatat janë të mbingarkuara, se ato kanë (veçanërisht në qytete më të mëdha) një mbingarkesë të madhe pune dhe ngarkesë të çështjeve të prapambetura, e cila mund të ketë ndikim të madh në cilësinë e vendimeve gjyqësore.

3.2. Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Për fat të keq, nuk është e mundur të hulumtohet praktika gjyqësore në një mënyrë sistematike në BiH. Së pari, gjykatat nuk i publikojnë sistematikisht aktgjykimet e tyre dhe ato nuk janë të arritshme në faqet përkatëse të internetit. Për të marrë informacion të thelluar mbi praktikën e një gjykate të caktuar, duhet të paraqitet një kërkesë në përputhje me ligjin e BiH-së "Për aksesin në informacion". Nëse gjykata kompetente e pranon këtë kërkesë, ajo jep vendime anonime për shkak të kërkesave për mbrojtjen e të dhënave. Në të njëjtën mënyrë, kërkesa mund t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Prokurorisë në BiH (KLGJP).

Më datë 16.3.2021, kërkesa iu dërgua KLGJP-së për të dhëna nga CMS-i (Sistemi për Menaxhimin Automatik të Çështjeve) në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare.¹²⁰ Kërkesa nuk u pranua, me shpjegimin se sistemi nuk e njeh këtë lëndë. Më konkretisht, "njohja/ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore" nuk është një kriter i lejuar i kërkimit në motorin e kërkimit.¹²¹ KLGJP-ja në përgjithësi është shumë mbështetëse dhe e dobishme, por, nëse sistematizimi i të dhënave nuk përputhet me kriterin e kërkimit, asnjë e dhënë përkatëse nuk mund të sigurohet nga KLGJP-ja. Për këto arsye, nuk është e mundur të bëhet analiza përkatëse e të dhënave statistikore (inekzistente).

Kërkesat për informacion të thelluar mbi vendimet e njohjes ndërmjet shteteve të dhëna nga gjykatat përkatëse u dërguan në gjykatat e Kantoneve në Sarajevë, Tuzla, Zenicë, Travnik, Mostar dhe në Gjykatën e Distriktit të Banja Lukës. Duke pasur parasysh që ato nuk posedojnë të dhëna të mbledhura dhe të strukturuara në mënyrë sistematike, kërkesa u kufizua në pesë vitet e fundit (1.1.2016-31.12.2020).

Gjykatat e Kantoneve në Sarajevë dhe Zenicë iu përgjigjën pozitivisht kërkesës dhe dërguan një numër të caktuar çështjesh. Gjykata e Kantonit në Travnik e miratoi kërkesën, por për shkak të pandemisë ende nuk i ka dhënë vendimet e saj. Ato do të dorëzohen më vonë. Për më tepër, kjo gjykatë nuk e kryen këtë procedurë falas. Kërkesa u diskutua me presidentët e gjykatave të Kantoneve në Zenicë dhe Travnik dhe me presidentin e Seksionit të së Drejtës Civile të Gjykatës së Kantonit në Sarajevë. U identifikua i njëjti problem i cili u shfaq në komunikimin me KLGJP-në: të dhënat nuk janë sistemuar mirë dhe nuk mund të kërkohen drejtpërdrejt me fjalët kyçe përkatëse.

Në periudhën nga 1.1.2016 deri më 31.12.2020, Gjykata e Kantonit në Zenicë dha 583 vendime

për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.¹²² Shtatëmbëdhjetë vendime gjyqësore u dhanë me kërkesë për qëllime të këtij studimi.

Në periudhën nga 1.1.2016 deri më 31.12.2020, Gjykata e Kantonit në Sarajevë dha më shumë se 800 vendime për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore.¹²³ Njëzet e katër vendime gjyqësore u dhanë me kërkesë për qëllime të këtij studimi. Diskutimi me Presidentin e Seksionit të së Drejtës Civile të Gjykatës së Kantonit në Sarajevë zbuloi se pothuajse 80% e vendimeve u morën në çështje familjare (divorcet, fëmijët, d.m.th., detyrimet ushqimore). Një grup i vogël vendimesh trajtojnë çështje civile dhe tregtare.

Vendimet e gjykatës për të cilat u dhanë informacione të thelluara mund të vlerësohen pozitivisht:

- Rrjedhimisht, gjykatat u përqendruan në kërkesat formale për njohje dhe refuzuan shprehimisht në një rast të kryen *revision au fond*;
- Një herë, gjykata refuzoi të njihte një vendim mbi pasuritë e paluajtshme të lëshuar nga një gjykatë austriake duke argumentuar se gjykata në BiH, ku ndodhet pasuria e paluajtshme, ka juridiksion ekskluziv ndërkombëtar;
- Gjykatat rendisin saktë kërkesat përkatëse në të gjitha rastet, por ato thjesht riprodhojnë dispozitat përkatëse pa shpjegime të hollësishme të arsytimit të tyre;
- Si rregull, ato thjesht deklarojnë se vendimi i huaj nuk është në shkelje të Kushtetutës së BiH-së (e cila nuk ka qenë e diskutueshme në asnjë rast);
- Në çështjet kur gjykata hetoi nëse ishin përmbushur kërkesat e përcaktuara, ajo gjithashtu deklaroi se ekzistonte reciprociteti. Në të gjitha këto çështje, vendimet përkatëse u morën në vendet në rajon ku ishin në fuqi marrëveshjet dypalëshe për bashkëpunimin gjyqësor, të lidhura midis shtetit përkatës dhe BiH-së. Formulimi i përdorur nga gjykata theksoi ekzistencën e reciprocitetit ndërsa të dy shtetet kishin një marrëveshje dypalëshe. Është e padiskutueshme që në këto çështje ekziston reciprociteti diplomatik, por duhet të jetë gjithashtu e qartë se reciprociteti mund të ketë burime të tjera (ligji, ose reciprociteti *de facto*);
- Në çështjet që lidhen me njohjen e vendimeve nga vendet në rajon ku marrëveshjet dypalëshe për bashkëpunimin gjyqësor kishin qenë në fuqi, gjykata iu referua njëkohësisht dispozitave të LDNP-së dhe marrëveshjes dypalëshe. Marrëveshjet dypalëshe të lidhura me shtetet e dala nga ish-Jugosllavia nuk ofrojnë kërkesa më liberale sesa LDNP-ja nëse rregullojnë çështjen e njohjes dhe ekzekutimit. Dispozitat janë identike në një masë të madhe. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që gjykata duhet t'u referohet të dyja burimeve të ligjit. Nëse e njëjta çështje është e rregulluar nga LDNP-ja dhe marrëveshja dypalëshe, përparësi duhet t'i jepet kësaj të fundit pasi ajo është një burim ndërkombëtar i ligjit (neni 3 i LDNP-së).

Numri i vogël i trajnimeve në këtë fushë (seksioni 3.4.) çon në një përfundim të tërthortë se çështjet nuk diskutohen në masën përkatëse, ose nuk shpërndahen përmes trajnimeve të gjyqtarëve që zhvillohen nga qendrat e trajnimit të gjyqësorit dhe prokurorive të entitetit. Rrjedhimisht, gjyqtarët ndoshta nuk janë të informuar mirë për interpretimet përkatëse të dispozitave ligjore të bëra nga Gjykatat e Larta të entitetit. Nëse sistemi nuk lejon që "njohja/ekzekutimi në çështje civile dhe tregtare" të përdoret me sukses si një kriter kërkimi, gjyqtarët nuk mund të kenë qasje në vendimet përkatëse nga sistemi CMS.

Si përfundim: shumë pak çështje janë analizuar për të lejuar nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse mbi sasinë dhe cilësinë e vendimeve gjyqësore. Një problem i madh është pamundësia e kryerjes së një kërkimi të drejtpërdrejtë të praktikës gjyqësore.

¹²⁰ Kërkesës duhet t'i përgjigjet Presidenti i KLGJP-së në përputhje me ligjin e BiH-së „Për aksesin në të dhëna“

¹²¹ Vendimi i KLGJP-së nr. 01-07-10-6-74 / 2021 i datës 25.3.2021.

¹²² Urdhri i Gjykatës së Kantonit në Zenicë 004-0-SUSpi-21-000017 i datës 9.4.2021.

¹²³ Urdhri i Gjykatës së Kantonit në Zenicë 004-0-SUSpi-21-000017 i datës 9.4.2021.

3.3. Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Agjentët zbatues nuk kanë ndonjë kompetencë në procedurat për njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore. Vetëm gjyqtarët kanë të drejtë të merren me këtë çështje. Situata me procedurën përmbartimore është pothuajse e njëjtë. Në procedurën përmbartimore, gjyqtarët janë ata që vendosin dhe zhvillojnë procedurën përmbartimore, ndërsa agjentët zbatues janë të autorizuar të ekzekutojnë disa veprime përmbartimore, veçanërisht në lidhje me pasuritë e luajtshme (për shembull, konfiskimi i një pasurie të luajtshme ose sekuestrimi). Nëse nuk merret vendimi gjyqësor për njohje, por personi i interesuar kërkon drejtpërdrejt ekzekutim, është e mundur të vendoset për njohjen e vendimit të huaj si një çështje paraprake, por kjo është ekskluzivisht në kompetencën e gjyqtarëve dhe jo të agjentëve zbatues. Pasi gjykata të vendosë për njohjen si çështje kryesore, ose pasi gjyqtari përgjegjës për ekzekutimin të vendosë për një kërkesë për ekzekutim bazuar në një vendim të huaj gjyqësor dhe për njohjen si një çështje paraprake, dhe të lëshojë një urdhër ekzekutimi, procedura përmbartimore që vijon nuk devijon nga procedura përmbartimore për çdo çështje tjetër.

Për këto arsye, nuk është e mundur të flitet për kapacitetet e agjentëve zbatues në kuadrin e njohjes ose të ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve, por vetëm për aftësinë e tyre për të vepruar brenda procedurave përmbartimore në përgjithësi.

Reforma e ligjit për shërbimin përmbartimor e realizuar në BiH në vitin 2003 dhe në Distriktin e Bërçkos në BiH kishte si detyrë kryesore rritjen e efikasitetit të procedurës përmbartimore.¹²⁴ Numri i madh i çështjeve përmbartimore të pazgjidhura demonstroi se ky qëllim nuk mund të arrihet.¹²⁵ Një nga arsyet e kësaj situatë është pozicioni i papërshtatshëm i agjentëve zbatues, i cili vlerësohet me kritikizëm në literaturë. Agjentët zbatues janë punonjës të gjykatës në BiH. Një studim mbi ekzekutimin në çështjet civile në Ballkanin Perëndimor, i përqendruar pjesërisht në BiH, ka deklaruar se agjentët zbatues janë të nënpaguar dhe nuk kanë ndonjë perspektivë karriere në sistem.¹²⁶ Situata e agjentëve zbatues është përshkruar si jo e strukturuar dhe e paqartë, si dhe e ndryshme nga gjykata në gjykatë. Kërkesat për punën e tyre nuk përcaktohen nga ligji për shërbimin përmbartimor: ato u nënshtrohen rregulloreve në nivelin e kantoneve (Federata e BiH-së) dhe gjithashtu mund të rregullohen në formë të ndryshme nga secila gjykatë. Nuk ka provime të specializuara të pranimit; kandidatët për agjentë zbatues duhet të kalojnë vetëm provimin e nëpunësit civil për punonjësit, i cili nuk përfshin ndonjë njohuri ose aftësi në ligjin për shërbimin përmbartimor.¹²⁷ Pas rekrutimit, agjentët zbatues nuk marrin ndonjë trajnim të specializuar (seksioni 3.4. më poshtë).

Këto fakte janë një përgjigje e qartë në lidhje me kapacitetet e agjentëve zbatues në BiH në kuadër të procedurës përmbartimore në përgjithësi dhe të ekzekutimit bazuar në vendimet e huaja gjyqësore që janë njohur.

3.4. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor

Ka dy qendra për trajnimin për gjyqësorin dhe prokurorinë në BiH të organizuara në nivel entiteti: Qendra e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë e Federatës së BiH-së (në vijim referuar si:

¹²⁴ Shihni më shumë nga Povlakić, Die praktischen Probleme des Vollstreckungsrechts - dargestellt am Beispiel von Bosnien und Herzegowina, f. 82-84.

¹²⁵ Sipas informacionit të marrë nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe i Prokurorisë së BiH-së në Vendimin numër 01-07-10-77-114/2019 të datës 22.5.2019, lëshuar në bazë të kërkesës për akses në informacion, nga numri i përgjithshëm i çështjeve të pazgjidhura në BiH, çështjet përmbartimore përbëjnë 84%. Numri i çështjeve përmbartimore në BiH është rreth 1,8 milionë dhe sipas Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Prokurorisë së BiH-së për vitin 2017, ato u ndanë midis gjykatave më të mëdha në BiH si më poshtë: Gjykata Themelore në Banja Luka - 50 549; Gjykata Bashkiake në Sarajevë - 900 324; Gjykata Bashkiake në Zenicë - 113 386; Gjykata Themelore në Bijeljina - 148 841; Gjykata Bashkiake në Mostar - 34 833; dhe Gjykata Bashkiake në Tuzla - 134 156. Situata nuk ka ndryshuar ndjeshëm në dy vitet e fundit.

¹²⁶ Uitdehaag/Vincken, Civil Enforcement in the Western Balkan, An overview of the present situation and future developments in the various legal systems in the Western Balkan, f. 98.

¹²⁷ Po aty.

CEST në Federatën e BiH-së), themeluar nga ligji "Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Federatës së BiH-së"¹²⁸ dhe Qendra e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë e Republikës Srpska (në vijim referuar si: CEST në RS), themeluar nga ligji "Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Republikës Srpska".¹²⁹ Këto dy akte janë pothuajse plotësisht të harmonizuara që kur u imponuan nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë për Bosnjë-Herzegovinën (ZPL) në vitet 2002/2003. Më pas, u miratuan vetëm disa ndryshime të vogla. Gjyqtarët e emëruar në Distriktin e Bërçkos në BiH mund të marrin pjesë në seminare në Republikën Srpska ose në Federatën e BiH-së. Këto dy Qendra kanë krijuar një bashkëpunim të mirë dhe shpesh organizojnë trajnime të përbashkëta.

Qendrat synojnë të sigurojnë arsim dhe progres të vazhdueshëm të gjyqësorit, duke u përpjekur të përmirësojnë nivelin e tij të profesionalizmit. Në përmëshje të kësaj detyre, Qendrat zhvillojnë kurrikula trajnime dhe organizojnë trajnime nën kujdesin e KLGJP-së. Trajnimi duhet të ofrojë njohuri për interpretimin dhe zbatimin e akteve juridike materiale dhe procedurale, të standardeve etike, të informacionit mbi zhvillimet e fundit në shkencë dhe jurisprudencë, si dhe në të drejtën e krahasuar.¹³⁰

Të dy ligjet ofrojnë dispozita identike lidhur me detyrimin e gjyqtarëve për të marrë pjesë në trajnim. Kërkesa minimale në lidhje me pjesëmarrjen në trajnimin e detyrueshëm nuk përcaktohet nga vetë ligji por përcaktohet për çdo vit nga KLGJP-ja dhe Qendrat. KLGJP ka përcaktuar se gjyqtarët janë të detyruar të marrin pjesë në trajnime tre-ditore (deri në vitin 2014, katër ditë trajnim ishin të detyrueshme).¹³¹ Raporti për vitin 2013 deri në vitin 2017, i botuar në faqen e internetit të CEST në Federatën e BiH-së, tregon se nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve (rreth 900 – 1000), një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve nuk e përmësh këtë detyrim çdo vit.¹³²

Qendrat ofrojnë disa lloje të ndryshme të trajnimeve gjyqësore (dhe për prokurorinë): a) arsimi fillestar ose trajnime bazë, i cili synon gjyqtarët rekrutë dhe b) programet e formimit të vazhduar, të cilat synojnë gjyqtarët në detyrë. Nëse kapacitetet e lejojnë, Qendrat lejohen të organizojnë trajnime për personat që nuk janë të detyruar të përfshihen në programet e trajnimit, për shembull, për nëpunësit e gjykatave që janë të përfshirë në procedurat përmbartimore. Sidoqoftë, nuk ka asnjë të dhënë që trajnime të tilla të jenë organizuar në Federatën e BiH-së në periudhën 2013-2017 (raportet për këto vite ishin botuar në faqen e internetit të CEST në Federatën e BiH-së¹³³).

Megjithëse nuk parashikohet drejtpërdrejt nga ligji, ekziston mundësia për të ofruar trajnime të specializuara. Trajnime të tilla organizohen për gjyqtarët dhe prokurorët që merren me çështje të të miturve.¹³⁴ Doktrina është ankuar shpesh për mungesën e njohurive në fushën e së drejtës ndërkombëtare private mes gjyqtarëve¹³⁵, e cila mund të jetë një arsye e justifikuar për të ofruar trajnim të specializuar në temën e së drejtës ndërkombëtare private në përgjithësi, e cila gjithashtu përfshin arsimin për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve.

Sipas të dhënave të marra nga Akademia Gjyqësore e Federatës së BiH-së në 10 vitet e fundit (2009-2019), tetë trajnime iu kushtuan njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve në çështjet civile. Në momentin e hartimit të këtij raporti, raporti për vitin 2020 nuk kishte përfunduar dhe ai për vitin 2021 ishte në proces. Për këto arsye, u analizuan programet e trajnimit për këto dy vjet dhe jo raportet.

¹²⁸ Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, nr. 24/02, 40/02, 59/02 dhe 21/03.

¹²⁹ Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, nr. 34/02, 49/02, 77/02 dhe 30/07.

¹³⁰ Neni 16 i ligjit „Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Federatës së BiH-së“, neni 16 i ligjit „Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Republikës Srpska“.

¹³¹ I disponueshëm në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/o-centru> (29.4.2021).

¹³² Në vitin 2013, 88 gjyqtarë nuk morën pjesë në arsimin e detyrueshëm; në vitin 2014, 61; në vitin 2015, 88; në vitin 2016, 115.

¹³³ Të disponueshëm në: <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/dokumenti-centra/category/18-izvjestaji-o-radu> (28.4.2021).

¹³⁴ Shihni programin për vitin 2016 (f. 8). dhe 2017 (f. 7). Programet janë të disponueshme në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/dokumenti-centra/category/18-izvjestaji-o-radu#> (28.4.2021).

¹³⁵ Për shembull, Dorđević, Kratak kritički osvrt na tumačenje odredaba čl. 13 ZRSZ o utvrđivanju sadržine stranog prava u odlukama bivšeg Višeg trgovinskog suda u Beogradu (sada: Privrednog apelacionog suda u Beogradu), 36- 40. Šaula, Razvoj međunarodnog privatnog prava u regionu – Nacionalni izvještaj za Bosnu i Hercegovinu, f. 137; Povlakić, Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Mobiliarsicherheiten in Südosteuropa, f. 275.

Trajnimet e mëposhtme u zhvilluan në Federatën e BiH-së nga viti 2009 deri në 2019: "Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore" (2009), "Trajnim në fushën e ekzekutimit të kërkesëpadive të huaja për detyrimin ushqimor" (2012), "Ekzekutimi ndërmjet shteteve" (2013), "Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet familjare, civile dhe tregtare" (2013), "Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet e së drejtës civile" (2015), "Ekzekutimi ndërmjet shteteve" (2016), "E drejta ndërkombëtare private në praktikën gjyqësore" (2016) dhe "Procedura në rastet e trashëgimisë me një element të huaj" (2019).¹³⁶ Rishikimi i trajnimit të planifikuar për vitet 2020 dhe 2021 ofron të njëjtën panoramë: në vitin 2020 ishin planifikuar vetëm dy seminare për temën (njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit dhe brenda një seminari dy-ditor kushtuar mbajtjes së fëmijëve dhe organizuar nga të dyja Qendrat, tema tjetër ishte njohja dhe ekzekutimi i kërkesave të huaja për mbajtjen e fëmijëve¹³⁷). Në vitin 2021, janë planifikuar vetëm trajnime mbi temën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit.¹³⁸

Dy seminare u organizuan dhe u mbështetën nga institucione të huaja (IRZ - Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Gjyqësor Ndërkombëtar, Ministria e Punës e Republikës së Sllovenisë). Kjo pjesë e marrë në studim është shumë e vogël për të arritur në përfundimin se partnerët e huaj i kanë njohur mangësitë në këtë fushë, por kjo mund të jetë një arsye për t'u marrë parasysh në atë drejtim. Seminari i organizuar nga Ministria e Punës e Sllovenisë i kushtojë ekzekutimit të kërkesëpadive të huaja për pagesën ushqimore dhe mbajtjen e fëmijëve. Intervista me presidentin e Seksionit Civil të Gjykatës së Kantonit në Sarajevë sugjeron që shumica e kërkesave për njohje kanë të bëjnë me çështje familjare. Është më se e kuptueshme pasi që edhe pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së, shtetet e reja vazhdojnë të jenë shumë të lidhura. Përveç kësaj, pothuajse brenda natës, shumë martesë dhe marrëdhënie familjare kanë fituar një element të huaj.

Këto seminare u zhvilluan nga profesorë të universitetit që jepen në drejtën ndërkombëtare private, nga nëpunës publikë nga Ministria e Drejtësisë e BiH-së, nga gjyqtarë si dhe nga ekspertë të huaj nëse trajnimi ishte bashkëorganizuar dhe mbështetur nga institucionet ndërkombëtare.

Nuk mund të thuhet se kurrikulat e programit të Qendrave në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve apo edhe mbi të drejtën ndërkombëtare private në përgjithësi, janë zhvilluar ose përmirësuar më shumë që nga 2009 e deri më sot. Në këtë fushë, nuk ka asnjë trajnim standard që të zhvillohet rregullisht çdo vit. Situata është mjaft e paplanifikuar siç tregojnë titujt dhe ritmi i trajnimeve të zhvilluara. Përveç kësaj, nga raportet vjetore për vitet 2013 deri në 2017, të cilat janë të disponueshme në faqen e internetit të CEST në Federatën e BiH-së,¹³⁹ mund të thuhet se si rregull (me devijim minimal), ofrohen rreth 20 trajnime në vit në çështjet civile (14-20% e numrit të përgjithshëm të trajnimeve) dhe në fushën e procedurave përmbartimore dhe jokontestimore, janë ofruar një ose maksimumi dy seminare për secilën (rreth 1% e numrit të përgjithshëm të trajnimeve).¹⁴⁰ Këto të dhëna çojnë në përfundimin se, në përgjithësi, çështjet civile dhe veçanërisht procedurat përmbartimore dhe jokontestimore nuk përfaqësohen në mënyrë të kënaqshme në formimin e vazhduar të gjyqtarëve. Analiza e temave të paraqitura demonstroi se njohja dhe ekzekutimi ndërmjet shteteve, që duhet të jepet gjatë trajnimit për ekzekutimin e çështjeve civile dhe jokontestimore, është më tepër se sa një fushë e papërfaqësuar dhe shumë e lënë pas dore.

Për sa i përket Federatës së BiH-së, nuk ka të dhëna statistikore se sa gjyqtarë kanë marrë pjesë në trajnimin për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve, por me siguri disa nga gjyqtarët e shumtë që nuk plotësojnë numrin e caktuar të ditëve të trajnimit, nuk e kanë ndjekur trajnimin në fushën e njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve.

Agjentët zbatues nuk përfshihen në trajnimin e detyrueshëm të Qendrave, por Qendrat mund

të ofrojnë trajnime edhe për ta nëse kanë kapacitete të mjaftueshme. Në Republikën Srpska, u zhvillua¹⁴¹ një trajnim për agjentët zbatues të gjykatave, ndërsa në Federatë nuk ka pasur ndonjë trajnim të veçantë për agjentët zbatues. Në faqet e internetit të Qendrës,¹⁴² Udhëzues Praktikë për agjentët zbatues të gjykatave u botuan në vitin 2011. U botuan nga KLGJP-ja në kuadër të projektit "Mbështetje për Gjyqësorin e BiH-së" dhe financuar nëpërmjet fondeve IPA.¹⁴³ Udhëzuesit nuk mund të vlerësohen si shumë pozitivë (ata janë shumë përshkrues, me hulumtime të dobëta, dispozitat ligjore kryesisht janë riprodhuar pa analiza më të thella, etj.). Udhëzuesit gjithashtu nuk përfshijnë njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve.

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

BiH-ja përshkruhet si një "ekonomi në tranzicion" nga Shërbimi Tregtar i Jashtëm i SHBA-së dhe Departamenti Amerikan i Shtetit.¹⁴⁴ PBB-ja totale nominale në vitin 2019 ishte afërsisht 20,05 miliardë dollarë amerikanë. Në vitin 2019, ajo u rrit me 3% dhe PBB-ja për frymë ishte 5740 dollarë amerikanë. Para pandemisë nga COVID-19, ekonomia kishte parashikuar një rritje prej 3,6% për vitin 2020 dhe 4% rritje për vitin 2021. Parashikimi i Bankës Botërore pas pandemisë nga COVID-19 sugjeron që PBB-ja e Bosnjë-Hercegovinës ishte gati të ulej me 4% në vitin 2020, por të ringrihej me 4,28% në vitin 2021 dhe 4,5% në vitin 2021.¹⁴⁵

Statistikat lidhur me partnerët kryesorë tregtarë të përdorura në këtë dokument bazohen në botimin e Agjencisë për Nxjitjen e Investimeve të Huaja në Bosnjë-Hercegovinë.¹⁴⁶ Informacioni bazohet në hulumtimin e kryer nga Agjencia e Statistikave të Bosnjë-Hercegovinës.

Partnerët kryesorë tregtarë të Bosnjë-Hercegovinës janë Gjermania, Serbia, Italia, Kroacia, Sllovenia, Austria, Kina, Turqia, Polonia, Hungaria, Franca, Holanda, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Federata Ruse, Republika Çeke. Vlera e tregtisë me partnerët e lartpërmendur ishte 11 463 154 000 EUR në vitin 2020 dhe 13 073 163 EUR në vitin 2019.¹⁴⁷

¹⁴¹ I disponueshëm në <http://www.rs.cest.gov.ba/index.php/seminari-2018/58-226banja-luka-aktuelna-pitanja-iz-oblasti-izvrnog-postupka-s-posebnim-osvrtom-na-rad-sudskih-izvritelja> (30.4.2021). (29.4.2021).

¹⁴² Të disponueshme në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/edukativni-materijali/category/8-praktikum-za-sudske-izvrsoce>; <http://www.rs.cest.gov.ba/index.php/dokumenti/prirucnici-za-sudske-izvrsoce> (30.4.2021).

¹⁴³ <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/edukativni-materijali/category/8-praktikum-za-sudske-izvrsoce> (28.4.2021).

¹⁴⁴ I disponueshëm në <https://ba.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/270/BiH-2020-Country-Commercial-Guides.pdf> (30.4.2021).

¹⁴⁵ I disponueshëm në: <https://data.worldbank.org/country/BA>. (29.4.2021).

¹⁴⁶ I disponueshëm në: http://www.fipa.gov.ba/informacije/statistike/izvoz_uvoz/default.aspx?id=211&langTag=hr-HR (29.4.2021).

¹⁴⁷ Po aty.


¹³⁶ Të dhëna të ofruara nga përfaqësuesi i CEST në Federatën e BiH-së.

¹³⁷ I disponueshëm në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/dokumenti-centra/category/9-programi-obuke>.

¹³⁸ I disponueshëm në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/dokumenti-centra/category/9-programi-obuke>.

¹³⁹ Të disponueshme në <http://www.fbih.cest.gov.ba/index.php/dokumenti-centra/category/9-programi-obuke> (28.4.2021).

¹⁴⁰ Në vitin 2014, u zhvilluan 6 seminare për çështjet jokontestimore për faktin se ishte miratuar ligji i ri «Për trashëgiminë».



Raporti i mbulimit ndërmjet importit dhe eksportit në Bosnjë-Hercegovinë

Burimi: Agjencia e Statistikave të Bosnjë-Hercegovinës¹⁴⁸

4.1.1 Importi

Vlera totale e importeve në vitin 2020 ishte 8 633 803 000 EUR. Vendet e zhvilluara kapin vlerën e 6 144 244 000 EUR, vendet në zhvillim vlerën e 2 485 652 000 EUR dhe shuma e papërcaktuar është 3 907 000 EUR.¹⁴⁹Në periudhën janar-mars 2021, importi arriti në rreth 2,4 miliardë EUR, që është 2,7% më i lartë se për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.¹⁵⁰

Partnerët kryesorë të importit të Bosnjë-Hercegovinës në vitin 2020 ishin:

- Gjermania me një pjesëmarrje prej 12,2%
- Italia me një pjesëmarrje prej 11,5%
- Serbia me një pjesëmarrje prej 11,3%
- Kroacia me një pjesëmarrje prej 9,02%
- Kina me një pjesëmarrje prej 8,03%
- Turqia me një pjesëmarrje prej 5,32%
- Sllovenia me një pjesëmarrje prej 4,98%
- Austria me një pjesëmarrje prej 4,04%
- Polonia me një pjesëmarrje prej 3%
- Hungaria me një pjesëmarrje prej 2,75%¹⁵¹

4.1.2 Eksporti

Vlera totale e eksportit në vitin 2020 ishte 5 376 385 000 EUR. Vendet e zhvilluara kapin vlerën e 4 309 722 000 EUR, vendet në zhvillim vlerën e 1 059 268 000 EUR dhe shuma e papërcaktuar është 7 395 000 EUR.¹⁵²Në periudhën janar-mars 2021, eksporti arriti në rreth 1,8 miliardë EUR, që është 16,6% më i lartë se për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.¹⁵³

Partnerët kryesorë të eksportit të Bosnjë-Hercegovinës në vitin 2020 ishin:

- Gjermania me një pjesëmarrje prej 15,4%
- Kroacia me një pjesëmarrje prej 12,9%
- Serbia me një pjesëmarrje prej 11,6%
- Italia me një pjesëmarrje prej 9,66%
- Austria me një pjesëmarrje prej 9,54%
- Sllovenia me një pjesëmarrje prej 9,08%
- Turqia me një pjesëmarrje prej 3%
- Mali i Zi me një pjesëmarrje prej 2,77%
- Zvicra me një pjesëmarrje prej 2,53%
- Franca me një pjesëmarrje prej 2,47%¹⁵⁴

Të dhënat e parashikuara nga Observatori i Kompleksitetit Ekonomik demonstrojnë prirjen në rritje të eksporteve për periudhën nga viti 2014 deri në 2019. Eksporti u rrit me 955 milionë dollarë amerikanë, nga 6,2 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2014 në 7,15 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2019.¹⁵⁵

Ndërsa BiH nuk është shtet anëtar i BE-së, partnerët e saj kryesorë tregtarë janë, për shembull Gjermania, Austria, Italia, Kroacia, Sllovenia, siç tregojnë tabelat më lart. Sidoqoftë, rregulloret e BE-së që sigurojnë njohje dhe ekzekutim lehtësisht të arritshëm nuk janë të zbatueshme në BiH. Prandaj, nuk ka asnjë instrument që do të bënte të mundur njohjen dhe ekzekutimin më të lehtë të vendimeve të huaja gjyqësore midis BiH-së dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë. Ky është një argument i fortë në favor të aderimit në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 dhe në konventat e tjera të Hagës ose marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe, veçanërisht kur BE-ja është pjesë e tyre.

4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

BiH ka një rend kushtetues kompleks. Autoritetin e aderimit në marrëveshjet ndërkombëtare e ka qeveria e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Federata e BiH-së dhe RS-ja si entitete mund të hyjnë në marrëveshje me shtete dhe organizata ndërkombëtare, por vetëm nëse jepet miratimi paraprak nga Asambleja Parlamentare, një organ legjislativ në nivel shtetëror.

Kështu, autoriteti kryesor për të aderuar në traktate ndërkombëtare i takon qeverisë në nivel shtetëror. Ndërveprimi midis organeve qeveritare në nivel shtetëror është si më poshtë: Presidenca ka pushtetin për të negociuar, denoncuar dhe ratifikuar traktatet ndërkombëtare,

¹⁴⁸ I disponueshëm në http://fipa.gov.ba/informacije/statistike/izvoz_uvoz/Statistika%20vanjske%20trgovine%202019%20juli%202020_Bos.pdf (28.4.2021).

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Mallrave të BiH-së, janar-mars 2021, Agjencia e Statistikave të Bosnjë-Hercegovinës, 20 prill 2021, të disponueshme në: http://www.bhas.gov.ba/data/Publikacije/Saopštenja/2021/ETR_02_2021_03_1_HR.pdf (29.4.2021).

¹⁵¹ I disponueshëm në <https://trendeconomy.com/data/h2/BosniaAndHerzegovina/TOTAL> (24.4.2021).

¹⁵² I disponueshëm në: http://www.fipa.gov.ba/informacije/statistike/izvoz_uvoz/Statistika%20vanjske%20trgovine%202020%20veljaca%202021.pdf (28.4.2021).

¹⁵³ Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Mallrave të BiH-së, janar-mars 2021, Agjencia e Statistikave të Bosnjë-Hercegovinës, 20 prill 2021, të disponueshme në: http://www.bhas.gov.ba/data/Publikacije/Saopštenja/2021/ETR_02_2021_03_1_HR.pdf.

¹⁵⁴ I disponueshëm në <https://trendeconomy.com/data/h2/BosniaAndHerzegovina/TOTAL> (28.4.2021).

¹⁵⁵ I disponueshëm në <https://oec.world/en/profile/country/bih?tradeScaleSelector2=tradeScale2> (28.4.2021).

në përputhje me nenin V, paragrafi 3, germa “d” e Kushtetutës së BiH-së. Një parakusht për ratifikimin është miratimi i Asamblesë Parlamentare, siç përshkruhet në nenin IV, paragrafi 4, germa “d” e Kushtetutës së BiH-së. Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat e sipërpërmendura për një traktat ndërkombëtar, ai duhet të botohet në Fletoren Zyrtare. Pas kësaj, ai bëhet pjesë integrale e sistemit juridik të BiH-së.

Një numër i madh i traktateve ndërkombëtare janë në fuqi në BiH për shkak të trashëgimisë nga ish-Jugosllavia. Vendi ka aderuar më pas në disa prej tyre. Megjithatë, ekziston një problem në funksionimin e qeverisë dhe të institucioneve të tjera në nivel shtetëror që krijon një ngërç. Problemi është kryesisht (*par excellence*) me natyrë politike. Këto rrethana pasqyrohen në faktin se që nga pavarësia e saj në vitin 1995, BiH nuk ka arritur të bëhet palë kontraktore në një numër të konsiderueshëm të traktateve ndërkombëtare të hartuara në kuadrin e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Për shembull, nuk është palë kontraktore e Protokollit të 23 nëntorit 2007 lidhur me ligjin e zbatueshëm “Për detyrimet ushqimore”, ndërsa shumica e shteteve të tjera që dolën nga ish-Jugosllavia janë së bashku me Bashkimin Evropian dhe shumë shtete evropiane. E njëjta gjë vlen për Konventën e 5 korrikut 2006 lidhur me ligjin e zbatueshëm “Për disa të drejta në lidhje me letrat me vlerë të mbajtura me një ndërmjetës”, për Konventën e 30 qershorit 2005 “Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës” dhe Konventën e 19 tetorit 1996 “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”. Nga ana tjetër, BiH është palë kontraktore në Konventën e 23 nëntorit 2007 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”.

Frenimi nga ratifikimi i konventave të HCCH-së, për shkak të pengesave politike që shkaktojnë mosfunksionim në shtetin e BiH-së, ka efekte të shumëfishta negative. BiH mbetet një përjashtim në rajon pasi shtetet e tjera që janë pjesë e BE-së kanë ratifikuar disa konventa të HCCH-së ose BE-ja e ka bërë këtë.¹⁵⁶ Shtetet që nuk janë anëtare (të tilla si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut) kanë një rol më proaktiv dhe kanë ratifikuar një numër të konventave të HCCH-së. Sidoqoftë, është e padiskutueshme që shteti ka autoritetin për të aderuar në konventat ndërkombëtare (me kusht që të jenë kryer konsultime me entitetet), megjithatë kompetenca legjislative e parlamentit të shtetit për të miratuar akte ligjore të cilat nuk janë të renditura shprehimisht në Kushtetutë si kompetencë e shtetit është e diskutueshme. Kjo ndalon miratimin e ligjit të ri e modern për të drejtën ndërkombëtare private (shihni 1.2). “Ratifikimi i Konventave të Hagës tashmë të ratifikuara nga BE-ja ose nga të gjitha shtetet anëtare të saj është aktualisht mënyra më e përshtatshme për BiH-në për t’u harmonizuar me legjislacionin e BE-së në fushën e së drejtës ndërkombëtare private.”¹⁵⁷

Nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës së 2 korrikut 2019 “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare” sapo është përfshirë në axhendën e organeve kompetente.

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

Meqenëse Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” nuk është pjesë e sistemit juridik të Bosnjë-Hercegovinës dhe aderimi në Konventë nuk është parashikuar apo diskutuar, është e vështirë të ngrihet ndonjë pretendim në këtë drejtim derisa vendi të bëhet pjesë. Gjithashtu mungon diskutimi lidhur me këtë çështje nga zyrtarët që mund të përmendeshin.

4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklarata në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Meqenëse Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” nuk është pjesë e sistemit juridik të Bosnjë-Hercegovinës dhe aderimi në Konventë nuk është parashikuar apo diskutuar, është e vështirë të ngrihet ndonjë pretendim në këtë drejtim derisa vendi të bëhet pjesë. Gjithashtu mungon diskutimi lidhur me këtë çështje nga zyrtarët që mund të përmendeshin.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Konventa nuk përfaqëson të ashtuquajturën “konventë e dyfishtë/traktat i dyfishtë” por “traktat i thjeshtë”, pasi ajo nuk rregullon juridiksionin ndërkombëtar por vetëm ekzekutimin dhe njohjen.¹⁵⁸ Këtu duhet të përmendet që BiH nuk e ka ratifikuar Konventën «Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës» të vitit 2005 e cila është plotësuese e Konventës së HCCH-së të vitit 2019. Rëndësia e nenit 5 të Konventës e kornizon atë si pjesën qendrore të Konventës.¹⁵⁹ Raporti Shpjegues sugjeron që arkitektura e këtij neni ndan tre çështje.¹⁶⁰ Pjesa e parë rendit kriteret juridiksionale që pranohen sipas Konventës për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi në një shtet të kërkuar dhe pjesa e dytë përqendrohet në kriteret juridiksionale në marrëdhëniet që përfshijnë palë më të dobëta (konsumatorë, punonjës). Pjesa e tretë përcakton filtrin e vendimeve gjyqësore mbi qiranë e pasurive të paluajtshme për qëllim banimi (qiramarrjen) ose regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, të cilat mund të vlerësohen si juridiksion ekskluziv (shihni 5.4). Filtrat juridiksionale në nenin 5 veprojnë duke i dhënë juridiksion gjykatës nëse ekziston një lidhje midis shtetit të origjinës dhe të paditurit (shihni 5.1), nëse ka një marrëveshje mes palëve (të shprehur ose të nënkuptuar) (shihni 5.2), ose nëse ka një lidhje midis kërkesëpadisë dhe shtetit të origjinës (shihni 5.3).¹⁶¹

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)

Vendbanimi i të paditurit është një kriter për përcaktimin e juridiksionit të përgjithshëm ndërkombëtar. Qasja dominuese e LDNP-së në lidhje me juridiksionin e përgjithshëm ndërkombëtar është vendbanimi i paditurit (neni 46).¹⁶² Juridiksioni ndërkombëtar i një gjykate të Bosnjë-Hercegovinës ekziston nëse i padituri e ka vendbanimin në BiH, ose në mungesë të vendbanimit, ka vendqëndrim në BiH.

Vendqëndrimi i zakonshëm, i cili është bërë një nga faktorët më të rëndësishëm lidhës për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe juridiksionin,¹⁶³ as nuk përmendet në LDNP. Prandaj, LDNP-ja nuk përdor kriteret e vendqëndrimit të zakonshëm. Kjo mund të shpjegohet, siç është përmendur vazhdimisht në këtë raport, si pasojë e mungesës së modernizimit të ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në BiH. Nga ana tjetër, Konventa mbështetet në nocionin e “të

¹⁵⁸ Arsyet për miratimin e një konvente të tillë gjenden në: van Loon, Towards a global Hague Convention on the Recognition and Enforcement of Judgments in Civil or Commercial Matters, f. 16.

¹⁵⁹ Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 88.

¹⁶⁰ *Po aty*.

¹⁶¹ Stewart, The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters, f. 778.

¹⁶² Për më shumë rreth këtij kriteri mbi juridiksionin në konventa të ndryshme dhe në të drejtën e krahasuar, shihni van Loon, Towards a global Hague Convention on the Recognition and Enforcement of Judgments in Civil or Commercial Matters, f. 23.

¹⁶³ Kostić-Mandić, Međunarodno privatno pravo, f. 254; Alihodžić, Meškić dhe Duraković, Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f.154; Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – Is the “heart” of the Convention in the right place?, f. 18-19.

¹⁵⁶ Për më shumë shihni: Alihodžić, Meškić dhe Duraković, Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f. 161.

¹⁵⁷ Për më shumë shihni: Alihodžić, Meškić dhe Duraković, Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?, f. 165.

paditurit” dhe “vendqëndrimin e zakonshëm” të tij/të saj, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 2 si një nga tre kriteret juridiksionale në Konventë

Kjo dispozitë ligjore përcakton rregullat për përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm të një subjekti ose personi të ndryshëm nga një person fizik, duke përcaktuar në mënyrë alternative katër kriteret për përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm. Një person juridik, një subjekt ose person i ndryshëm nga një person fizik konsiderohet rezident i zakonshëm në shtetin në të cilin ndodhet selia e tij juridike, administrata qendrore, qendra kryesore e biznesit, ose nëse ato janë të themeluara ose të krijuara në këtë shtet. Në të kundërt, përkufizimi i vendqëndrimit të zakonshëm të personave fizikë lihet jashtë Konventës.¹⁶⁴

Mund të thuhet se kriteri i juridiksionit të përgjithshëm dhe mbizotërues i lidhur me të paditurin në LDNP nuk përkon me të njëjtin kriter të Konventës, pasi LDNP-ja mbështetet në vendbanim ose, në të kundërt, në vendqëndrim, kurse Konventa në vendqëndrimin e zakonshëm.

Vendqëndrimi i zakonshëm i të paditurit nuk është një kriter i vetëm juridiksioni në Konventë. Përveç vendqëndrimit të zakonshëm, Konventa njeh tre grupe të kriterëve të juridiksionit si faktorë lidhës me të paditurin: këto janë kriteret e bazuara në miratimin dhe lidhjet midis kërkesëpadisë dhe shtetit të origjinës.¹⁶⁵ Të njëjtat kriteret u gjenden në LDNP por numri, objekti dhe përmbajtja e kriterëve nuk përputhen. Për më shumë shihni 5.2 dhe 5.3.

5.2 Caktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur, i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës)

LDNP-ja e njeh caktimin e juridiksionit me marrëveshje vetëm në një shkallë të kufizuar. Në përgjithësi, për shkak të mungesës së reformës së LDNP-së, BiH-ja shfaq rezistencë ndaj zhvillimeve moderne të së drejtës ndërkombëtare private që nënkuptojnë, *ndër të tjera*, forcimin e autonomisë së palës në sfera më të gjera të së drejtës ndërkombëtare private.

Së pari, në përgjithësi caktimi i juridiksionit me marrëveshje është i ndaluar për çështjet familjare (neni 49, paragrafi 3 në lidhje me nenin 61-70 të LDNP-së). Së dyti, kjo marrëveshje nuk lejohet në rastin kur gjykatat në BiH kanë juridiksion ekskluziv. Për më tepër, edhe në çështjet jo të së drejtës familjare dhe kur çështja nuk ka të bëjë me juridiksionin ekskluziv, autonomia e vullnetit në këtë fushë i nënshtrohet kufizimeve që lidhen me kombësinë e palëve. Palët mund të bien dakord mbi juridiksionin e një gjykate në BiH vetëm nëse njëra prej tyre është shtetase e BiH-së apo ka selinë në BiH. *Anasjelltas*, palët mund të bien dakord për juridiksionin e një gjykate të huaj vetëm nëse njëra prej tyre është shtetase apo ka selinë në shtetin e huaj përkatës.

LDNP-ja ka vetëm një dispozitë ligjore për këtë aspekt dhe trajton lejueshmërinë e caktimit të juridiksionit me marrëveshje, por jo kërkesat formale ose kohën e lidhjes së marrëveshjes. Vetëm neni 50 përcakton se caktimi i juridiksionit me marrëveshje mund të dakordësohet në heshtje dhe pas fillimit të procedurës. Përkatësisht, kur kompetenca e gjykatës vendase varet nga miratimi i të paditurit, do të supozohet se ekziston miratimi nëse i padituri jep një deklaratë mbrojtjeje pa kundërshtuar kompetencën e gjykatës vendase ose hyn në procesin e trajtimit të çështjes në themel.

Konventa njeh tri forma të miratimit: miratimi i shprehur gjatë procesit gjyqësor (neni 5, paragrafi 1, germa “e”), miratimi i nënkuptuar (neni 5, paragrafi 1, germa “f”), dhe marrëveshja e palëve për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës (neni 5, paragrafi 1, germa “m”).

Një vendim i huaj gjyqësor mund të njihet nëse i padituri ka dhënë miratimin e shprehur për juridiksionin e gjykatës që ka dhënë vendimin gjatë procesit gjyqësor në të cilin është dhënë

vendimi. LDNP-ja supozon miratimin e dhënë para fillimit të procesit. Ky ndryshim është pasojë e faktit se ekziston një Konventë tjetër e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH), plotësuese e Konventës së HCCH-së të vitit 2019, përkatësisht Konventa “Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës” e vitit 2005, e cila rregullon caktimin *ex- ante* të juridiksionit.

Lidhur me caktimin e heshtur të juridiksionit, neni 5, paragrafi 1, germa “f” e Konventës nuk përmend termat “caktim me marrëveshje i juridiksionit”, “miratim i nënkuptuar” ose “paraqitje e argumenteve”.¹⁶⁶ Ajo parashikon që një vendim gjyqësor është i pranueshëm për njohje dhe ekzekutim nëse a) i padituri ka dhënë argumente mbi themelin përpara gjykatës që ka dhënë vendimin; b) nuk ka kundërshtuar juridiksionin brenda afatit të parashikuar në ligjin e shtetit të origjinës, përveç nëse është e qartë se një kundërshtim ndaj juridiksionit ose ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte pasur sukses sipas atij ligji. Këtu, Konventa merr parasysh që e drejta procedurale në shtetin e origjinës mund të jetë kufizuese, domethënë, ajo vendos një prag të lartë për kundërshtimin e juridiksionit.¹⁶⁷ Termi “ligji i shtetit të origjinës” duket shumë i gjerë, nëse i referohet një shteti me një sistem juridik kompleks, pasi entitetet e ndryshme territoriale brenda një shteti mund të kenë afate të ndryshme kohore.¹⁶⁸

LDNP-ja është pjesërisht në përputhje me konventën në lidhje me caktimin e heshtur të juridiksionit. Ashtu si konventa, LDNP-ja nuk e përmend termin miratim ose caktim i nënkuptuar i juridiksionit. LDNP-ja, ndryshe nga Konventa, pranon konceptin e “paraqitjes së argumenteve” ndaj juridiksionit. Sipas LDNP-së, ekziston caktimi i heshtur i juridiksionit nëse i padituri paraqet një përgjigje ndaj kërkesëpadisë (paraqitja e argumenteve) dhe në këtë mënyrë kundërshton juridiksionin. Konventa kërkon që i padituri të argumentojë mbi themelin para gjykatës që ka dhënë vendimin dhe të kundërshtojë juridiksionin, ndërsa argumentimi mbi themelin pa kundërshtuar juridiksionin është i mjaftueshëm sipas LDNP-së. LDNP-ja e konsideron argumentimin mbi themelin *në vetvetë* si caktim të heshtur të juridiksionit. Një ndryshim tjetër është se LDNP nuk i referohet kushtit për kundërshtimin e juridiksionit në shtetin e origjinës. Kjo zgjidhje është më pak e favorshme për të paditurin në procesin “exequatur”.

Neni 5, paragrafi 1, germa “m” përcakton marrëveshjen e zgjedhjes joekskluzive të gjykatës si kriter për juridiksionin, duke e sanksionuar si vendim i cili është dhënë nga një gjykatë e përcaktuar në një marrëveshje të lidhur ose dokumentuar me shkrim ose me çdo mjet tjetër komunikimi, që e bën informacionin të arritshëm për të qenë i përdorshëm për referencë të mëvonshme, përveç një marrëveshjeje për zgjedhjen ekskluzive të gjykatës. Jepet gjithashtu përkufizimi i “marrëveshjes për zgjedhjen ekskluzive të gjykatës”. LDNP-ja lejon caktimin me marrëveshje të juridiksionit, por sipas kufizimeve të përmendura më lart, ku nuk bëhet asnjë dallim midis marrëveshjeve për zgjedhjen ekskluzive dhe joekskluzive të gjykatës. Ky dallim është ndoshta pasojë e ekzistencës së dy Konventave plotësuese të HCCH-së, pra ajo e vitit 2019 dhe e ajo e vitit 2005 mbi zgjedhjen e gjykatës. Për një shtet të tillë si BiH, që nuk është palë në Konventën e Hagës “Për zgjedhjen e gjykatës” të vitit 2005, kjo dispozitë e Konventës së vitit 2019 nuk është në fakt e vlefshme, pasi nuk mund të veprojë si një pikë fillestare në rregullimin e kësaj çështjeje.

5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Nuk është e lehtë të bëhet një krahasim ndërmjet LDNP-së dhe Konventës në lidhje me kriteret

¹⁶⁶ Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – Is the “heart” of the Convention in the right place?, f. 25.

¹⁶⁷ *Po aty*.

¹⁶⁸ Garcimartin and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 160.

juridiksionale duke u mbështetur në lidhjen midis kërkesëpadisë dhe gjykatës që ka dhënë vendimin. Problemi qëndron në nivele të ndryshme të krahasimit. Konventa nuk rregullon juridiksionin, kurse LDNP-ja po; Konventa parashikon kritere juridiksionale ose, thënë më mirë, “filtra juridiksionalë” në bazë të të cilave gjykata e shtetit ku kërkohet njohja ose ekzekutimi vlerëson vendimin e dhënë në shtetin e origjinës.¹⁶⁹ LDNP-ja rregullon juridiksionin e drejtpërdrejtë – gjykata duhet të vendosë nëse ka të drejtë të gjykojë në marrëdhëniet ndërmjet shteteve sipas ligjit të brendshëm ose një marrëveshjeje ndërkombëtare nëse është rasti.

Në pamje të parë, lista e kriterëve juridiksionale për lidhjen midis kërkesëpadisë dhe gjykatës që ka dhënë vendimin, është dukshëm më e gjatë në Konventë sesa në LDNP. Kjo e fundit rregullon vetëm çështjet e mëposhtme: detyrimet jokontraktore, kërkesëpaditë mbi pronësinë kur prona e të paditurit ose pasuritë e përzgjedhura ndodhen në BiH, pretendimet e një të huaji për detyrimet që duhet të kryhen në BiH, pronësia dhe të drejtat e tjera reale (*in rem*) për pasuritë e paluajtshme ose avionët dhe anijet/mjetet e lundrimit. Të gjithë filtrat e tjerë juridiksionalë të rregulluar në konventë nuk përmenden në LDNP. Për këtë arsye, bëhet vetëm një krahasim i çështjeve që mbivendosen, edhe pse është ende e mundur që të njëjtat kritere të trajtojnë kushtet, kërkesat dhe kufizimet e ndryshme përkatëse.

Detyrimet jokontraktore (neni 5, paragrafi 1, germa “j” e Konventës dhe neni 53 i LDNP-së). Nuk ka konvergjencë në lidhje me kriteret e juridiksionit. Konventa e vë veprimin ose mosveprimin që shkakton dëm (vdekje, lëndime fizike, dëmtime ose humbje të pasurisë fizike) në fokus, jo pasojat e një ngjarjeje të dëmshme (“pavarësisht se ku ka ndodhur ai dëm”). LDNP-ja, në të kundërt, mbështetet në vendin ku ka ndodhur dëmi. Nëse dëmi ka ndodhur në BiH, gjykatat e Bosnjë-Hercegovinës kanë të drejtë të gjykojnë. Fusha e zbatimit të nenit 5, paragrafi 1, germa “j” e konventës është shumë e kufizuar pasi dëmi duhet të manifestohet në vdekje, lëndim fizik ose dëmtim të një sendi. Neni 53 i LDNP-së nuk parashikon ndonjë kufizim në lidhje me llojin e dëmeve. Ky kufizim zbutet nga mundësia që filtra të tjerë juridiksionalë të aplikohen, siç është vendqëndrimi i zakonshëm. LDNP-ja gjithashtu njuh filtra të tjerë juridiksionalë në rast të një përgjegjësie jashtëkontraktore: vendqëndrimi i përhershëm dhe vendqëndrimi i përkohshëm plotësues. Duhet të jemi të vetëdijshëm se shumë burime dëmi janë lënë jashtë fushëveprimit të konventës (p.sh., dëmi bërthamor, ndotja detare, etj – shihni 6.1.1).

Pasuritë e paluajtshme. Konventa ka rregulla të veçanta për detyrimet kontraktore të siguruara nga një e drejtë reale (*in rem*) në pasurinë e paluajtshme. Një aktgjykim i dhënë kundër një të padituri për një detyrim kontraktor të siguruar me një të drejtë reale në pasurinë e paluajtshme që gjendet në shtetin e origjinës mund të njihet nëse kërkesëpadia kontraktore është ngritur kundër të njëjtit të paditur së bashku me një kërkesëpadi në lidhje me të drejtën *in rem* (neni 5, paragrafi 1, germa “i”). LDNP-ja mbështetet në objekte të paluajtshme. Ndërsa konventa mund të interpretohet në mënyrë të tillë që juridiksioni mbi detyrimet kontraktore të mund të konsiderohet veçmas nëse kërkesëpadia kontraktore nuk është depozituar së bashku me kërkesëpadinë që rrjedh nga e drejta reale (*in rem*), zgjidhja në LDNP është e ndryshme: për të drejtën reale (*in rem*) dhe disa detyrime kontraktore në lidhje me sendet e paluajtshme, zbatohet rregulli i vendndodhjes së pronës (*situs*) dhe juridiksioni ekskluziv pretendohet nga gjykatat e BiH-së (neni 56). Doktrina e zgjeron këtë rregull në të gjitha detyrimet kontraktore që lidhen me pasurinë e paluajtshme.¹⁷⁰ Konventa sanksionon që një aktgjykim në lidhje me dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme (qiramarrje) i dhënë nga gjykata e shtetit në të cilin ndodhet prona mund të njihet dhe ekzekutohet. Kjo situatë trajtohet ndryshe sipas LDNP-së, e cila parashikon juridiksionin ekskluziv të gjykatave të BiH-së kur pasuria e paluajtshme ndodhet në BiH.

Trusti, neni 5, paragrafi 1, germa “k”. Rendi juridik në BiH nuk është i njohur me institucionin e trustit dhe nuk ka ndonjë konflikt të veçantë mes rregullave të ligjit dhe rregullave të juridiksionit

ndërkombëtar në lidhje me këtë çështje.

Kundërpadia. Neni 5, paragrafi 1 (I) siguron një filtër juridiksional në lidhje me kundërpaditë. Ndryshe nga Konventa, LDNP-ja nuk përmban rregulla juridiksioni për raste të tilla.

Lidhur me detyrimet kontraktore si kritere juridiksionale siç parashikohet në nenin 5, paragrafi 1, germa “g” e Konventës, nuk ka konvergjencë midis Konventës dhe LDNP-së. Domethënë, LDNP-ja nuk përmban rregulla të ngjashme për juridiksionin në lidhje me detyrimet kontraktore. Vetëm kur detyrimi kontraktor duhet të kryhet në BiH dhe personi i huaj fizik ose juridik që operon një degë ose agjenci në BiH kërkohet në BiH, ekziston një rregull që gjykata e BiH-së ka juridiksion (neni 55 i LDNP-së). Kjo mund të kuptohet si një kombinim i kriterëve juridiksionale të parashikuara në nenin 5, paragrafi 1, germa “g” dhe nenin 5, paragrafi 1, germa “d”, por dispozitat nuk janë identike.

Ndryshe nga konventa (në nenin 5, paragrafi 2), LDNP-ja nuk përmban rregulla specifike për konsumatorët. Juridiksioni i drejtpërdrejtë në rastet kur konsumatori padit tregtarin nuk ofrohet në LDNP por në ligjet për procedurën civile. Ato parashikojnë mundësinë e paraqitjes së një kërkesëpadie para gjykatës së vendbanimit/vendqëndrimit të konsumatorit.

Mund të konkludohet se LDNP-ja dhe konventa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra-tjetra në lidhje me kriteret juridiksionale të cilat mbështeten në një lidhje midis kërkesëpadisë dhe gjykatës që ka dhënë vendimin.

5.4 Juridiksioni ekskluziv

LDNP-ja përcakton situata të ndryshme ku gjykatat në BiH kanë juridiksion ekskluziv. Gjykata në BiH ka juridiksion ekskluziv në rastet në lidhje me pasuritë e paluajtshme me adresë në BiH (neni 56 i LDNP-së). LDNP përshkruan juridiksionin ekskluziv në rrethana të caktuara për mosmarrëveshjet martesore, mosmarrëveshjet amtare dhe atërore, procedurat e trashëgimisë pas vdekjes kur pasuritë e paluajtshme janë pjesë e pronës, por kjo nuk është e rëndësishme për këtë raport pasi këto çështje nuk janë në objektin e konventës. Juridiksioni ekskluziv është baza për refuzimin e njohjes së një vendimi gjyqësor i cili është dhënë nga një gjykatë e huaj në vend të një gjykate ekskluzivisht kompetente në BiH (neni 89, paragrafi 1 i LDNP-së).

Ndryshe nga LDNP-ja, në dispozitat mbi kërkesat e refuzimit të njohjes dhe ekzekutimit (neni 7), Konventa nuk përmend shprehimisht juridiksionin ekskluziv të shtetit të kërkuar. Vetëm neni 5 i konventës përcakton që një vendim gjyqësor që ka vendosur për të drejtat *in rem* në pasurinë e paluajtshme do të njihet dhe ekzekutohet nëse dhe vetëm nëse pasuria ndodhet në shtetin e origjinës, gjë që çon në përfundimin se ekziston një juridiksion ekskluziv i gjykatave në çështjen e të drejtave *in rem* në pasuritë e paluajtshme. Ekziston një konvergjencë midis konventës dhe LDNP-së për këtë çështje, megjithëse koncepti i përgjithshëm i konventës, i cili nuk rregullon juridiksionin, por filtrat e juridiksionit (juridiksioni i tërthortë) dhe koncepti i LDNP-së nuk përputhen.

Neni 5 i konventës përcakton standardet minimale për njohjen dhe ekzekutimin. Në përgjithësi, ai përshkruan filtra të zbatueshëm për të gjitha çështjet ligjore në objektin e kësaj konvente. Për të zvogëluar diskrecionin e qeverive dhe gjykatave kombëtare, ai përcakton rregulla specifike në lidhje me lloje të caktuara të marrëdhënieve juridike (kontratat konsumatore, qiramarrja, kontratat e punës).¹⁷¹ Një zgjidhje specifike është parashikuar në konventë në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Neni 5, paragrafi 1 i konventës parashikon mundësinë e juridiksionit të njëkohshëm të më shumë se një gjykate në rastet e çështjeve juridike në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Megjithatë, neni 5, paragrafi 3 përcakton shprehimisht juridiksionin ekskluziv në çështjet e një qiraje të pasurisë së paluajtshme për qëllime banimi (qiramarrja) dhe regjistrimin e pasurisë

¹⁶⁹ Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – Is the “heart” of the Convention in the right place?, f. 17.

¹⁷⁰ Muminović, Procesno međunarodno privatno pravo, str. 46.

¹⁷¹ Stewart, The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters, f. 778.

së paluajtshme nga gjykata e shtetit ku ndodhet prona. Prandaj, neni 5, paragrafi 3 vepron si një rrugë e mesme midis juridiksionit të njëkohshëm të garantuar në nenin 5, paragrafi 1 dhe juridiksionit ekskluziv të garantuar në nenin 6.¹⁷²

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

6.1 Qëllimi material i zbatimit

6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Përcaktimi kryesor i qëllimit material të zbatimit është dhënë në nenin 1 të Konventës, i cili sanksionon se Konventa zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile ose tregtare në një shtet palë të një vendimi të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër palë. Qëllimi material i kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe burimet ligjore kombëtare nuk janë plotësisht të krahasueshme. Burimet ligjore kombëtare duhet të sigurojnë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe titujve të tjerë ekzekutivë në të gjitha çështjet dhe jo vetëm në çështjet civile dhe tregtare dhe pavarësisht nga fakti se cili vend e ka lëshuar titullin ekzekutiv (një shtet palë apo një shtet i tretë). Është e qartë se për këto arsye burimet ligjore kombëtare kanë një shtrirje më të gjerë zbatimi.

LDNP-ja si burimi kryesor ligjor në fushën e gjerë të së drejtës private siguron rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në marrëdhëniet ligjore, familjare dhe pronësore, që do të thotë se LDNP-ja ka një fushë zbatimi më të gjerë sesa konventa. Neni 2 i konventës parashikon përjashtimet e qëllimit material të konventës. Këtu konventa dhe LDNP nuk përputhen. Ndryshe nga konventa, LDNP-ja rregullon njohjen dhe ekzekutimin jo vetëm në fushën kryesore të së drejtës civile dhe në të drejtën tregtare, por edhe njohjen dhe ekzekutimin e statusit dhe aftësisë ligjore të çështjeve të personit fizik, detyrimeve ushqimore si dhe çështje të tjera të së drejtës familjare, duke përfshirë regjimet e pasurisë martesore dhe të drejta ose detyrime të tjera që lindin nga martesa ose marrëdhënie të ngjashme, si dhe në çështjet e testamenteve dhe trashëgimisë. Për më tepër, LDNP përfshin të drejtat e privatësisë dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Të gjitha këto çështje përjashtohen nga zbatimi i konventës (neni 2, paragrafi 1, germat “a-d”, “l”, “m”).

LDNP-ja nuk bën asnjë ndryshim duke përshkruar parakushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në cilëndo nga fushat e lartpërmendura të së drejtës private. Të njëjtat kërkesa duhet të përmbushen në çdo rast të ekzekutimit dhe njohjes, me disa përjashtime në lidhje me statusin juridik dhe aftësinë e personit fizik (neni 93- 95 i LDNP-së).¹⁷³

LDNP-ja, ashtu si konventa, nuk parashikon zbatimin e kërkesëpadive lidhur me të ardhurat, doganat ose çështjet administrative (neni 1, paragrafi 2 i konventës).

¹⁷² Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – Is the “heart” of the Convention in the right place?, f. 18.

¹⁷³ Nëse një vendim i huaj ka të bëjë me statusin e një shtetasi vendas, vendimi i huaj do të njihet nëse ligji i huaj nuk devijon në mënyrë thelbësore nga ligji i brendshëm. Nëse një vendim i huaj ka të bëjë me statusin e qytetarit të atij shteti, ai nuk do të vlerësohet sipas juridiksionit ekskluziv, pajtueshmërisë me Kushtetutën e Bosnjë-Hercegovinës dhe kërkesës për reciprocitet. Nëse një vendim i huaj ka të bëjë me statusin e shtetasit të një shteti të tretë, ai do të njihet, sipas LDNP-së, nëse plotëson kërkesat për njohje në shtetin e qytetarit në fjalë.

Njohja dhe ekzekutimi në fushën e falimentimit përjashtohen nga objekti i rregulloreve të konventës dhe të LDNP-së. Falimentimi ndërkombëtar i nënshtrohet rregullimit të kodeve të falimentimit të entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos në BiH, i cili kritikohet në doktrinë.¹⁷⁴

Rregullorja për përbërjen, zgjidhjen e institucioneve financiare dhe çështjet analoge, të përfshira kryesisht në ligjet për bankat dhe institucionet e tjera financiare të entiteteve dhe të Distriktit të Bërçkos në BiH, nuk përfshin çështje të së drejtës ndërkombëtare private. E njëjta gjë vlen për llojet e ndryshme të transportuesve të udhëtarëve dhe mallrave në trafikun ajror, hekurudhor dhe rrugor. Ligjet ose marrëveshjet përkatëse në fushën e transportit në përgjithësi nuk parashikojnë rregullore specifike të së drejtës ndërkombëtare private, por ka disa përjashtime. Disa rregullore të së drejtës ndërkombëtare private për trafikun ajror gjenden në të Drejtën Kontraktuale të Aviacionit Civil¹⁷⁵ dhe ato përmbajnë disa rregulla juridiksioni për dëmet e shkaktuara në transportin ajror (neni 49, 77). LDNP do të zbatohet për të gjitha çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj.

Konventa mbi Kontratën për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave është në fuqi në BiH për shkak të trashëgimisë nga ish-Jugosllavia.¹⁷⁶ Ajo përmban disa rregulla të së drejtës ndërkombëtare private mbi kontratat për transportin rrugor të mallrave me automjete për shpërbllim, por nuk ka dispozita mbi juridiksionin ndërkombëtar, kështu që mund të arrihet në përfundimin se këtu zbatohen rregullat e përgjithshme të juridiksionit të LDNP-së.

Ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zona përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare e shkaktuar prej anijeve, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare (neni 2, paragrafi 1, germa “g”, trajtohen ose nga rregulla specifike të konfliktit të ligjeve ose nga rregulla specifike mbi juridiksionin ndërkombëtar; do të zbatohen rregullat e përgjithshme të juridiksionit të LDNP-së.

Përgjegjësia civile për dëmet bërthamore i nënshtrohet rregullores së ligjit “Për përgjegjësinë për dëmin bërthamor”.¹⁷⁷ Ky ligj është i përafëruar me Konventën e Vjenës mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin Bërthamor të vitit 1963¹⁷⁸ dhe përmban disa rregulla mbi çështjet e së drejtës ndërkombëtare private, pikërisht mbi ligjin e zbatueshëm, mbi juridiksionin dhe njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Gjykata e BiH-së ka juridiksion ekskluziv nëse incidenti ose dëmi bërthamor ka ndodhur në territorin e saj. Nëse nuk është e sigurt nëse incidenti bërthamor ka ndodhur në territorin e BiH-së, juridiksioni për të përcaktuar dëmet lind nga gjykata e shtetit ku gjendet centrali bërthamor (neni XI i Konventës së Vjenës, neni 10 i ligjit “Për përgjegjësinë për dëmin bërthamor”). Këto çështje përjashtohen gjithashtu nga zbatimi i LDNP-së; këtu konventa dhe LDNP përputhen.

Lidhur me rregullat e juridiksionit që kanë të bëjnë me vlefshmërinë, pavlefshmërinë ose shpërbërjen e personave juridikë ose shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe me vlefshmërinë e vendimeve të organeve të tyre (neni 2, paragrafi 1, germa “i”), dhe me vlefshmërinë e regjistrimeve në regjistrat publikë (neni 2, paragrafi 1, germa “j”), mund të thuhet se LDNP-ja nuk ofron rregulla specifike dhe LDNP-ja nuk i përjashton këto çështje nga qëllimi material i zbatimit.

Ligjet “Për shpifjen” në nivelin e entiteteve janë miratuar. Ligji i Federatës së BiH-së për mbrojtjen nga shpifja¹⁷⁹ dhe ligji i RS-së për mbrojtjen nga shpifja¹⁸⁰ përmbajnë dispozita të krijuara posaçërisht për përgjegjësinë për shpifje, por nuk ka rregulla për ligjet e zbatueshme, juridiksionin ndërkombëtar ose njohjen apo ekzekutimin ndërmjet shteteve. Ndryshe nga konventa, çështja e shpifjes midis shteteve u nënshtrohet rregullave të përgjithshme të juridiksionit të LDNP-së.

¹⁷⁴ Shihni Muminović, Procesno međunarodno privatno pravo, f. 100.

¹⁷⁵ Fletorja Zyrtare e BiH-së, nr. 51/15.

¹⁷⁶ Fletorja Zyrtare e RSFJ-së, nr. 11/58.

¹⁷⁷ Fletorja Zyrtare e BiH-së, nr. 87/13.

¹⁷⁸ Kjo Konventë u ratifikua në vitin 1977, Fletorja Zyrtare e RSFJ -së, 5/77.

¹⁷⁹ Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 19/03, 73/05.

¹⁸⁰ Fletorja Zyrtare e RS-së, 37/2001.

Aktivitetet e forcave të armatosura, duke përfshirë aktivitetet e personelit të tyre në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare, aktivitetet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë aktivitetet e personelit ligjzbatues në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare nuk rregullohen me rregulla specifike të së drejtës ndërkombëtare private dhe, më konkretisht, nuk ka rregulla specifike juridiksioni ndërkombëtar për këto çështje; zbatohen rregullat e përgjithshme të juridiksionit.

Ligji "Për konkurrencën në BiH"¹⁸¹ nuk parashikon rregulla të së drejtës ndërkombëtare private në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, në mënyrë që çështjet anti-trust (konkurrencë) të mos i nënshtrohen ndonjë rregulli specifik. E njëjta vlen edhe për ristrukturimin e borxhit sovran përmes masave të njëanshme të shtetit.

Ndryshe nga konventa, e cila nuk zbatohet për arbitrazhin dhe procedurat e lidhura me të, LDNP-ja e rregullon këtë çështje. Janë parashikuar kërkesa të veçanta për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit. BiH është palë kontraktore (për shkak të trashëgimisë nga ish-Jugosllavia) në Konventën e Nju-Jorkut për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit. Dispozitat e LDNP-së janë shumë të harmonizuara me dispozitat e Konventës së Nju-Jorkut. Të dy instrumentet kërkojnë paraqitjen e vendimit origjinal ose një kopje të noterizuar siç duhet, si dhe marrëveshjet origjinale të arbitrazhit ose një kopje të noterizuar të tyre në gjuhën zyrtare të shtetit në të cilin mbështetet vendimi. Për më tepër, njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet për shkak të të njëjtave arsyeve, të tilla si mungesa e arbitraritetit të një çështjeje të caktuar, rendi publik, etj. Nëse autoriteti kompetent vendos të shtyjë vendimin për ekzekutim, ai mund kërkojë siguri të përshtatshme nga pala që e kërkon atë.

Për më tepër, vendimet gjyqësore, në rastet kur një shtet, qeveri, agjenci qeveritare ose person që vepron për një shtet kanë qenë palë në proces, nuk përjashtohen nga objekti i kësaj konvente vetëm nga fakti që shteti ose ndonjë person/entitet tjetër i së drejtës publike kanë qenë palë në një proces të caktuar. Nuk ka asnjë dispozitë të drejtpërdrejtë që rregullon këtë çështje, por në BiH nuk ka dyshim se nëse shteti, qeveria, agjencia qeveritare ose persona të ngjashëm janë palë në marrëdhënie private, ata kanë të njëjtin status si çdo person tjetër juridik ose fizik.¹⁸² Këtu konventa dhe LDNP nuk ecin paralelisht.

Nëse një çështje për të cilën konventa nuk zbatohet lind si çështje paraprake nëpërmjet mbrojtjes, një ngjarje e tillë nuk përjashton një vendim gjyqësor nga konventa nëse kjo çështje nuk ka qenë objekt i procesit. Një përjashtim i tillë nuk është i pranishëm në sistemin ligjor të BiH-së.

Me pak fjalë, neni 6 i konventës parashikon shumë përjashtime në zbatimin e saj. Lista e arsyeve për moszbatim të konventës është shumë e gjatë dhe nuk është në përputhje me listën e LDNP-së e cila është shumë e kufizuar. Dispozitat e LDNP-së janë të zbatueshme për një numër më të madh çështjesh në të drejtën civile dhe tregtare, si dhe në të drejtën familjare dhe të drejtën e trashëgimisë. Qëllimi material i zbatimit të LDNP-së ndryshon kështu nga ai i konventës.

6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme)

LDNP-ja nuk bën asnjë ndryshim midis vendimeve të huaja gjyqësore dhe nuk parashikon rregulla të ndryshme njohjeje në varësi të llojit të vendimit të huaj gjyqësor. Çdo vendim i huaj gjyqësor mund të njihet nëse është i formës së prerë dhe nëse nuk ka kërkesa, të përcaktuara me ligj, për kundërshtimin e njohjes.

LDNP-ja nuk parashikon vetëm njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, por edhe të titujve të tjerë të huaj, gjithashtu. LDNP-ja ekuivalenton zgjidhjet e gjykatave të huaja me vendimet e gjykatave të huaja; zgjidhjet e gjykatave të huaja mund të njihen gjithashtu. Vendimet

e organeve të tjera shtetërore në çështjet familjare, ligjore dhe pronësore (kjo është fusha e zbatimit të LDNP-së) mund të njihen gjithashtu nëse ato ekuivalentohen me vendimet gjyqësore dhe zgjidhjet gjyqësore në shtetin e origjinës. Doktrina ka diskutuar nëse aktet noteriale të huaja ekzekutive mund të zbatohen në BiH.¹⁸³

Njohja dhe ekzekutimi i masave të përkohshme është një çështje problematike si në doktrinë ashtu edhe në praktikën gjyqësore. LDNP-ja nuk përmban asnjë dispozitë për këtë pikë të veçantë. Për të shmangur problemet në praktikë, do të ishte e nevojshme të rregullohej kjo çështje. Fatkeqësisht, marrëveshjet dypalëshe të lidhura midis shteteve të ish-RSFJ-së nuk përmbajnë asnjë dispozitë për këtë qëllim. Ndryshe nga LDNP-ja, konventa shprehimisht thotë se masat e përkohshme nuk janë vendime gjyqësore, që do të thotë se ato nuk do të njihen dhe ekzekutohen sipas këtij instrumenti.¹⁸⁴ Edhe pse nuk ka një dispozitë të qartë në LDNP, rezultatet janë të njëjta: meqenëse masa e përkohshme nuk mund të jetë një vendim i formës së prerë, ato nuk janë të përshtatshme për njohje dhe ekzekutim.

Vendimi gjyqësor përkufizohet sipas konventës në nenin 3 si "çdo vendim në themel i dhënë nga një gjykatë, sido që të quhet ai vendim, duke përfshirë një dekret ose urdhër, dhe një përcaktim të kostove ose shpenzimeve të procedurave nga gjykata (përfshirë një zyrtar të gjykatës), me kusht që përkufizimi të lidhet me një vendim në themel, i cili mund të njihet ose ekzekutohet sipas kësaj konvente." Për të qenë në përputhje me punën e mëparshme të HCCH-së, veçanërisht me Konventën e HCCH-së së vitit 2005 "Për zgjedhjen e gjykatës", konventa ofron një test me dy pjesë për të përcaktuar se cili vendim konsiderohet vendim gjyqësor: ""Vendimi gjyqësor duhet të jetë (i) "një vendim në themel" dhe (ii) i dhënë nga një "gjykatë"". ¹⁸⁵ Qasja e konventës nënkupton që një vendim procedural që nuk trajton themelin dhe kur gjykata nuk e rrëzon kërkesëpadinë nuk janë brenda fushëveprimit të kësaj konvente. Vendimet e gjykatave brenda fushëveprimit të konventës janë ato që kanë të bëjnë me vendimet pasurore dhe jopasurore, vendimet në mungesë dhe vendimet në veprimet kolektive. Pjesa e dytë e testit kërkon që vendimi të merret nga një gjykatë. Sidoqoftë, konventa nuk arrin të përcaktojë termin gjykatë duke krijuar kështu paqartësi në lidhje me fushëveprimin e këtij termi.¹⁸⁶ LDNP-ja është e ndryshme në këtë drejtim pasi parashikon në nenin 86 që një vendim i një organi tjetër i cili njihet në shtetin ku është marrë si vendim gjyqësor mund të njihet si vendim gjyqësor edhe nga gjykatat e BiH-së. Kështu, LDNP-ja nuk kërkon që një vendim gjyqësor të jetë patjetër një vendim i marrë nga një gjykatë.

Zgjidhjet gjyqësore ekuivalentohen gjithashtu me vendimet gjyqësore dhe mund të njihen sipas LDNP-së (për më shumë shihni 1.1). Njësoj si LDNP-ja, disa zgjidhje gjyqësore trajtohen si vendime gjyqësore, siç parashikohet në nenin 11 të konventës.

6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)

LDNP nuk bën dallimin midis procedurës së njohjes si çështje kryesore ose si një çështje paraprake dhe parashikon rregullat më të qarta të procedurave për të dyja (neni 101). Është vendosur vetëm një ndryshim në lidhje me juridiksionin territorial. Për procedurën e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore si një çështje kryesore, LDNP-ja përcakton juridiksionin territorial: gjykata ku duhet kërkuar ekzekutimi ka kompetencën për të vendosur mbi të. Juridiksioni *ratione materiae* rregullohet nga ligjet të cilat rregullojnë organizimin e gjykatave në entitete dhe Distriktin e Bërçkos në BiH (shihni 1.1 dhe 2.2.1). Por, nëse njohja e një vendimi të huaj gjyqësor nuk i nënshtrohet procedurës së njohjes dhe është kërkuar ekzekutimi, gjykata, ku kërkohet ekzekutimi, mund të vendosë për njohjen si çështje paraprake me efekte vetëm për procesin

¹⁸³ Povlakić, Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Mobiliarsicherheiten in Südosteuropa, f. 172; Rijavec, Problematika ovršnog notarskog akta na primjeru Slovenije, f. 157.

¹⁸⁴ Shihni: Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 73.

¹⁸⁵ Po aty.

¹⁸⁶ Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 75.

përkatës (neni 101, paragrafi 5).

Zgjidhja në lidhje me vendimin për një çështje paraprake të përfshirë në nenin 8 të konventës nuk ekziston në LDNP në BiH.

LDNP-ja nuk përmban një dispozitë të shprehur se kush është i autorizuar në mënyrë aktive për të filluar procedurën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. LDNP-ja i referohet vetëm rasteve që lidhen me statusin personal, duke përcaktuar që çdo palë me interes ligjor mund të fillojë një procedurë (neni 101, paragrafi 6 i LDNP-së). Doktrina nuk e kundërshton që ky rregull të zbatohet në të gjitha rastet e tjera, pra në çështjet civile dhe tregtare dhe se një procedurë mund të fillohet nga personat për të cilët vendimi gjyqësor në fjalë ka një kuptim juridik.¹⁸⁷ Në jurisprudencë mbizotëron interpretimi që në çështjet civile dhe tregtare, personat e autorizuar janë palët në procedurë (pasuesit universalë dhe të vetëm të palëve), ndërsa vetëm për çështjet e lidhura me statusin, personat që nuk kanë marrë pjesë në procedurë, por kanë interes ligjor në këtë çështje, fillojnë procedurën e njohjes.¹⁸⁸¹⁸⁹

Konventa gjithashtu e lë të papërcaktuar se kush ka të drejtë të fillojë procedurën. Është interesante se si neni 3 e përmban përkufizimin e të paditurit, ndërsa përkufizimi i palës që kërkon njohje dhe ekzekutim nuk gjendet. Kjo palë përmendet vetëm në nenin 12 të konventës, i cili rendit dokumentet që duhet të prodhohen.

6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Personi i autorizuar për të kërkuar njohjen duhet t'i paraqesë një kërkesë gjykatës kompetente duke paraqitur tekstin origjinal ose një kopje të noterizuar të vendimit të huaj gjyqësor. Nëse vendimi gjyqësor nuk është në një gjuhë zyrtare të BiH-së, ai do të shoqërohet me përkthimin e noterizuar në njërin nga gjuhët zyrtare. Këto dy kërkesa nuk kërkojnë shprehimisht nga ligji, por të gjitha vendimet e analizuara (shihni 3.2) demonstrojnë se gjykatat kërkojnë paraqitjen e këtyre dokumenteve.

Vendimi gjyqësor duhet të jetë i pajisur me një klauzolë e cila konfirmon se vendimi ka marrë formën e prerë, i lëshuar nga gjykata ose ndonjë organ tjetër kompetent sipas ligjit të shtetit të origjinës (neni 87 i LDNP-së). Kur pala e autorizuar aplikon për ekzekutim, ajo duhet të paraqesë vendimin gjyqësor me klauzolën për ekzekutim të lëshuar në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës (neni 96 i LDNP-së).

Neni 12 i konventës përshkruan një sërë dokumentesh që duhet të paraqesë pala e cila kërkon njohjen dhe ekzekutimin. Ai rendit sa vijon:

- një kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor;
- nëse vendimi gjyqësor është dhënë në mungesë, origjinali ose një kopje e noterizuar e një dokumenti që vërteton se dokumenti i cili ishte baza e fillimit të procesit, ose një dokument i barasvlershëm, i është njoftuar palës që nuk është paraqitur;
- çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar se vendimi gjyqësor ka efekt ose, sipas rastit, është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës.

Ashtu si LDNP, ajo kërkon një kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor dhe një dokument shtesë i cili ka shkaktuar nisjen e procedurave në rast të një vendimi në mungesë.

Kërkesa e tretë - "çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar që vendimi gjyqësor ka efekt ose, sipas rastit, është i zbatueshëm në shtetin e origjinës" është një zgjidhje e duhur. Një formulim i tillë është shumë i favorshëm dhe siguron fleksibilitetin e nevojshëm. Ai vë në fokus praktikën e shtetit të origjinës, duke parandaluar kështu gjykatat vendase nga kërkitimi i dorëzimit të dokumenteve që mund të jenë të padisponueshme. LDNP-ja nuk siguron një fleksibilitet të tillë duke kërkuar konfirmimin e zbatueshmërisë nga shteti i origjinës.

Në rast të zgjidhjeve gjyqësore, kërkesa shtesë është "një vërtetim i një gjykate (duke përfshirë një oficer të gjykatës) të shtetit të origjinës që deklaron se zgjidhja gjyqësore ose një pjesë e saj ekzekutohet në të njëjtën mënyrë si një vendim në shtetin e origjinës". Nuk është e domosdoshme që vërtetimi të lëshohet nga gjykata e cila është përfshirë në zgjidhje, kështu që është e mundur që një gjykatë tjetër ta lëshojë atë.¹⁹⁰ LDNP-ja i trajton ndryshe dokumentet e kërkuara në zgjidhjet gjyqësore. Në fakt, ajo nuk përcakton aspak kërkesa për zgjidhjet gjyqësore (shihni 6.5).

Konventa ndryshon nga LDNP-ja për atë sa parashikon që nëse vendimi gjyqësor nuk lejon që gjykata të verifikojë nëse janë plotësuar kushtet për njohjen dhe ekzekutimin, ajo mund të kërkojë ndonjë dokument të nevojshëm. LDNP-ja nuk ua jep gjykatave këtë mundësi, e cila duhet të korrigjohet në të ardhmen.

Për më tepër, ndryshe nga LDNP-ja, Konventa parashikon që një kërkesë për njohje ose ekzekutim mund të shoqërohet nga një dokument i lidhur me vendimin gjyqësor, lëshuar nga një gjykatë e huaj (duke përfshirë një oficer të gjykatës) në formën e rekomanduar dhe botuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. LDNP-ja duhet të përmirësohet pas zgjidhjes së dhënë në konventë.

Konventa parashikon që dokumentet në lidhje me kërkesën duhet të dorëzohen të përkthyer e të noterizuar në gjuhën zyrtare të shtetit të kërkuar, përveç nëse ligji i shtetit të kërkuar parashikon ndryshe. LDNP-ja përmend vetëm përkthimin e noterizuar në dispozitat që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit. Sidoqoftë, është një praktikë e ngulitur në BiH që të gjitha dokumentet e paraqitura në gjykatë duhet të jenë në gjuhët zyrtare dhe të vërtetuara nga një përkthyes i njohur nga shteti, dhe se ato duhet të dorëzohen së bashku me dokumentet origjinale.

6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Kushtet kryesore për njohje janë që vendimi gjyqësor të ketë marrë formën e prerë, personi që kërkon njohjen dhe ekzekutimin të ketë paraqitur provat dhe konfirmimin e zbatueshmërisë së vendimit gjyqësor. LDNP-ja rendit një sërë arsyesh që do të mohonin njohjen (ose ekzekutimin).

Një vendim i huaj gjyqësor i formës së prerë nuk do të njihet:

- nëse gjykata që ka dhënë vendimin nuk ka juridiksion, domethënë, nëse ka të bëjë me një çështje në juridiksionin ekskluziv të një gjykate ose institucioni tjetër në BiH;
- nëse është shkelur e drejta e një pale për t'u dëgjuar. Kjo e drejtë konsiderohet se është shkelur nëse një person nuk ka mundur të marrë pjesë në procedurë (për shembull, një padi ose veprim tjetër nuk është dorëzuar personalisht, domethënë, as nuk është tentuar shërbimi personal. Kjo bazë për refuzimin e njohjes rrëzohet nëse personi i caktuar është i përfshirë në një mosmarrëveshje për çështjen kryesore në procedurën e shkallës së parë);
- nëse ka një vendim gjyqësor të mëparshëm të formës së prerë dhe detyrues në lidhje me të njëjtin shkak veprimi nga një gjykatë vendase ose ndonjë organ

187 Petrović, Anerkennung und Vollstreckung ausländischer (deutscher) Gerichtsentscheidungen, f. 418.

188 Informacija "Priznanje i izvršenje stranih sudskih i arbitražnih odluka" Projekt Kantonalnog suda u Tuzli u saradnji sa USAID/Justice sector Development Project, March, 2008.

189 Interpretimi më i gjerë i doktrinës në lidhje me subjektet e autorizuar për të filluar një procedurë për njohjen dhe ekzekutimin duhet të pranohet kur të hartohet një version i ri i LDNP-së. Në çdo rast të fillimit të një procedure për njohjen dhe ekzekutimin, personi i autorizuar duhet të jetë një person me interes ligjor.

190 Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 137.

tjetër në BiH, ose një vendim të huaj gjyqësor të njohur tashmë për të njëjtin shkak veprimi;

- nëse njohja nuk do të ishte në përputhje me rendin kushtetues në BiH;
- nëse nuk ka reciprocitet midis shtetit të origjinës dhe shtetit të destinacionit (reciprocitet faktik dhe i supozuar).

Neni 86 i LDNP-së (siç shtjellohet në 1.1) në përgjithësi parashikon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Kushti dhe procedura për njohjen dhe ekzekutimin janë bërë në përputhje me vendimet gjyqësore, edhe pse tituj të tjerë mund të njihen dhe ekzekutohen (zgjidhje gjyqësore, tituj të tjerë). Dispozitat e LDNP-së nuk janë plotësisht në përputhje me njohjen e zgjidhjeve gjyqësore dhe të titujve të tjerë. Së pari, ky titull nuk mund të jetë i formës së prerë siç mund të jenë vendimet gjyqësore dhe marrja e formës së prerë është parakushti kryesor për njohjen. Kjo mangësi demonstroi se duhet të miratohen rregulla të veçanta për ekzekutimin dhe njohjen e zgjidhjeve dhe titujve të tjerë. Kjo përbën një hendek thelbësor ligjor në ligjin aktual. Kritikët e funksionimit të HCCH-së argumentojnë se ka shumë formalizëm pasi kreditorët mund të paragjykojnë nga mungesa e dokumenteve.¹⁹¹ Dispozitat e LDNP-së janë edhe më të ngurta dhe krijojnë një situatë edhe më pak të favorshme për kreditorët.

Ndryshe nga LDNP-ja, neni 11 i konventës rregullon njohjen e zgjidhjeve gjyqësore (*transactions judiciaires*). Zgjidhjet gjyqësore të cilat një gjykatë e një shteti palë ka miratuar, ose të cilat janë përfunduar gjatë procedurave para një gjykate të një shteti palë dhe të cilat janë të ekzekutueshme në të njëjtën mënyrë si një vendim në shtetin e origjinës, do të zbatohen sipas kësaj konvente në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor.

Fatkeqësisht, megjithëse konventa “nuk i harroi” zgjidhet gjyqësore, ajo ka hequr dorë nga hartimi i rregullave për titujt e tjerë ekzekutivë dhe dokumentet ekzekutive noteriale. Për më tepër, Raporti Shpjegues sugjeron që dokumentet administrative dhe dokumentet noteriale nuk mund të konsiderohen si vendime gjyqësore, që do të thotë se ato janë lënë jashtë objektit të konventës.¹⁹²

6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Procedura për njohjen, deklarimin e ekzekutueshmërisë ose regjistrimin për ekzekutim, dhe ekzekutimin e një vendimi rregullohet nga ligji i shtetit të kërkuar, përveç nëse konventa parashikon ndryshe (neni 13). Vetëm dy udhëzime të drejtpërdrejta sipas konventës i drejtohen gjykatës vendase. Gjykata e shtetit të kërkuar do të veprojë shpejt dhe nuk do të refuzojë njohjen ose ekzekutimin e një vendimi sipas kësaj konvente me arsyetimin se njohja ose ekzekutimi duhet të kërkohej në një shtet tjetër. Kjo qasje tregon se hartuesi i konventës kishte marrë parasysh rregullat specifike të procedurës që janë të zbatueshme në shtete. Ajo gjithashtu u siguron liri veprimi shteteve për të ushtruar diskrecion në rregullimin e procedurës,¹⁹³ e cila është e kufizuar vetëm në një masë të caktuar, siç është kërkesa për përjashtimin e kundërshtimeve të *forum non conveiens* në nenin 13, paragrafi 2.¹⁹⁴ Meqenëse BiH nuk është ende një shtet palë, këto dy rregulla nuk janë të zbatueshme në BiH, por të dyja janë të nevojshme, veçanërisht dispozita sipas së cilës kjo procedurë duhet të kryhet me shpejtësi.

Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore nuk është e mirërregulluar

¹⁹¹ Hartley and Dogauchi, Explanatory Report on the 2005 HCCH Choice of Court Agreements Convention, f. 211.

¹⁹² Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 75.

¹⁹³ Garcimartín and Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report, f. 139.

¹⁹⁴ David P. Stewart, The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters, f. 778.

në LDNP. Vetëm një nen i LDNP-së i kushtohet kësaj çështjeje (neni 101).

Përveç dispozitës për juridiksionin territorial (shihni 6.1.1), dhe personin e autorizuar për të filluar procedurën e njohjes (shihni 6.3), vetëm dy çështje janë të rregulluara. Është e paraparë që nuk do të ketë rishikim të themelit të vendimit gjyqësor. Këtu LDNP-ja dhe konventa përputhen. Por një përjashtim, i vendosur nga konventa (neni 11), nuk parashikohet në LDNP. Konventa parashikon që mund të ketë vetëm një rishikim të themelit të vendimit gjyqësor nëse është e nevojshme për zbatimin e konventës. Si çështje e dytë, çështja e mjetit juridik kundër një vendimi për njohje është e rregulluar. Ankesa mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dhënia e vendimit gjyqësor.

Procedurat për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore janë jokontestimore. Kjo nuk është e diskutueshme as në teori dhe as në praktikë, ndonëse nuk ka ndonjë dispozitë të qartë ligjore për këtë qëllim. Ky përfundim nuk mund të rrjedhë drejtpërdrejt nga ligjet që rregullojnë procedurat jokontestimore. Për më tepër, ligjet e entiteteve për procedurën jokontestimore, si dhe ligji “Për procedurën jokontestimore” i Distriktit të Bërçkos në BiH, nuk e parashikojnë këtë procedurë si një procedurë të veçantë jokontestimore. Sidoqoftë, të tre tekstet juridike specifikojnë se rregullat e procedurës jokontestimore duhet të zbatohen në çështje të tjera juridike brenda juridiksionit të gjykatave për të cilat ligji nuk specifikon shprehimisht se duhet të zgjidhen në një procedurë jokontestimore, por që nuk lidhen me mbrojtjen e të drejtave të cenuara ose të kërcënuara ose për shkak të karakterit të një çështjeje juridike ose palëve në procedurë, dhe dispozitat e ligjit që rregullojnë procedurën gjyqësore nuk mund të zbatohen.

Si LDNP-ja ashtu edhe konventa nuk trajtojnë situatat kur debitori kërkon një deklaratë të refuzimit të njohjes ose ekzekutimit të një vendimi nga gjykata.

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

7.1 Lloji i procedurës përmbartimore

Megjithëse kompetencat për rregullimin e procedurës përmbartimore në BiH nuk i janë dhënë shtetit të BiH-së, tre aktet përmbartimore (entitetet dhe Distrikti i Bërçkos në BiH) janë të së njëjtës origjinë dhe nën ndikimin e ligjit për shërbimin përmbartimor të ish-Jugosllavisë dhe më tej, të ligjit austriak për shërbimin përmbartimor.¹⁹⁵ Sidoqoftë, ndryshe nga *Executionsordnung*¹⁹⁶ austriak, ligji i Bosnjë-Hercegovinës për shërbimin përmbartimor parashikon vetëm një lloj të procedurës përmbartimore – ekzekutimi i cili synon shitjen ose transferimin gjyqësor të të drejtave. Nuk parashikohet administrimi/sekuestrimi i detyruar.

Metodat e ekzekutimit janë të ndryshme në varësi të pasurisë të cilën kreditori ka propozuar si objekt për ekzekutim, por jo në varësi të llojit të titullit ekzekutiv (i huaj ose i brendshëm). Vendimi i huaj gjyqësor/titulli ekzekutiv përmendet vetëm në një nen të kodit përkatës për shërbimin e përmbartimit;¹⁹⁷ nuk ka dispozita të veçanta për zbatimin e titujve të huaj ekzekutivë.

7.2 Procedura përmbartimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj

Procedura përmbartimore është gjithmonë e njëjtë, pavarësisht nëse bazohet në një titull të huaj apo jo. Procedura fillon nga kreditori i cili duhet të paraqesë mocionin për ekzekutim të

¹⁹⁵ Për më shumë shihni Povlakić, Die Entwicklung des Zivilprozessrechtes in BiH (1918 – 2008), f. 208.

¹⁹⁶ Para. 94, Stand der Gesetzesgebung: 02.01.2021, Gesetz vom 27. Mai 1896, über das Exekutions- und Sicherungsverfahren (Executionsordnung), StF: RGBI. Nr. 79/1896. I disponueshëm në: <https://www.jusline.at/gesetz/eo/gesamt> (30.4.2021).

¹⁹⁷ Neni 19 i ligjit „Për procedurën përmbartimore“ në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës, neni 19 i ligjit „Për procedurën përmbartimore“ në RS, neni 21 i ligjit „Për procedurën përmbartimore“ në Distriktin e Bërçkos në BiH.

shoqëruar me titullin ekzekutiv. Kur ekzekutimi kërkohet në bazë të një vendimi të huaj gjyqësor, dy situata janë të mundshme, siç është shtjelluar tashmë më lart: kreditori dorëzon vendimin e huaj, i cili tashmë është njohur nga gjykata kompetente, i cili, në këtë rast, është i barabartë me vendimin e gjykatave kombëtare/vendase. Në këtë rast nuk ka ndonjë veçanti në procedurë. Nëse gjykata, e ngarkuar me ekzekutimin, duhet të vendosë për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor si një çështje paraprake, gjykata do të vendosë për çështjen paraprake, përpara se të vendosë nëse do të miratojë mocionin për ekzekutim apo jo. Ky vendim është ekskluzivisht në kompetencën e gjykatës. Për më tepër, procedura përmbartimore do të kryhet si çdo procedurë tjetër përmbartimore dhe oficerët/agentët zbatues do të përfshihen nëse ligji parashikon një përfshirje të tillë. Siç është theksuar në pikën 3.3, agjentët zbatues janë të përfshirë kryesisht në procedurën përmbartimore të pasurive të luajtshme.

8. Referenca

Literatura

- Alihodžić, Jasmina, Zlatan Meškić dhe Duraković. "Accepting EU Private International Law Standards into the Legal System of Bosnia and Herzegovina: What Can Be Done While Waiting for Godot?" *LeXonomica*, Vol. 11, No. 2, 2019.
- Đorđević. "Kratak kritički osvrt na tumačenje odredaba čl. 13 ZRSZ o utvrđivanju sadržine stranog prava u odlukama bivšeg Višeg trgovinskog suda u Beogradu (sada: Privrednog apelacionog suda u Beogradu)." *Nova pravna revija* NPR, 2/2016.
- Firshing, Karl. Das neue jugoslawische IPR-Gesetz. IPRax, 1983.
- Garcimartín, Francisco dhe Genevieve Saumier. Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters - Explanatory Report. E disponueshme në: <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>
- Hartley, Trevor, Dogauchi dhe Masato. Explanatory Report on the 2005 HCCH Choice of Court Agreements Convention, 2005. I disponueshëm në: <https://www.hcch.net/en/publications-and-studies/details4/?pid=3959>.
- Jessel-Holst, Christa. "Makedonija na putu ka modernom međunarodnom privatnom pravu." *Nova pravna revija*, 2/2016.
- Jessel-Holst, Christa. "The Reform of Private International Law Acts in South East Europe, with particular Regard to the West Balkan Region." 18 Annals Fac. L.U. Zenica 133, 2016.
- Kostić Mandić, Maja. "Montenegro." *IEL Private International Law*, 2020.
- Kostić Mandić, Maja. *Međunarodno privatno pravo*. Podgorica, 2017.
- Lipowscheck, Anton. "Das neue jugoslawische Internationale Privat- und Prozessrecht im Bereich des Vermögensrecht." *RebelsZ* 49, 1985.
- Martinović, Davor. "Potreba za reformom pravosudnih sustava u BiH." *Mostariensia : časopis za društvene i humanističke znanosti*, Vol. 19 Nr. 2, 2015.
- Meškić, Zlatan dhe Slavko Đorđević. *Međunarodno privatno pravo*. Privredna štampa Sarajevo, 2016.
- Meškić, Zlatan. "Četiri osnovne slobode kao ustavni osnov za harmonizaciju entitetskih propisa, Ustavno-pravni razvoj Bosne i Hercegovine (1910-2010)." *Zbornik radova Pravnog fakulteta Univerziteta u Tuzli*, 2011.
- Meyer, Thomas. "Uvođenje Zajedničkog evropskog prava prodaje." *Nova pravna revija* 1/2013.
- Muminović, Edin. *Međunarodno privatno pravo*. Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2008.
- Muminović, Edin. *Procesno međunarodno privatno pravo*. Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2007.
- Petrović, Milena. "Anerkennung und Vollstreckung ausländischer (deutscher) Gerichtsentscheidungen." *WGO. Monatshefte für osteuropäisches Recht*, 2003.
- Povlakić, Meliha. "Izvršenje stranih izvršnih naslova sa posebnim osvrtom na strane notarske isprave." *Pravna riječ, Banja Luka* vol. 42, 2015.
- Povlakić, Meliha. "Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Mobiliarsicherheiten in Südosteuropa." *LeXonomica*, Revija za pravo in ekonomiju, Let. II, št. 2, 2010.
- Povlakić Meliha. "Die Entwicklung des Zivilprozessrechtes in BiH (1918 – 2008)." W. Rechberger. *Die Entwicklung des Zivilprozessrechts in Mittel- und Südosteuropa vom 1918 bis 2008*, Wien, 2011.
- Povlakić, Meliha. Die praktischen Probleme des Vollstreckungsrechts - dargestellt am Beispiel von Bosnien und Herzegowina in: Compilation of works of the Conference „The Rule of Law and Civic Society – Requirements for a modern Judiciary“, Dubrovnik 4.12. – 8.12.2002, published by German Ministry of Justice and IRZ Foundation, 2002.
- Rijavec, Vesna. "Das internationale Vollstreckungsrecht am Beispiel Sloweniens." *Evropski pravnik* 1/2007.
- Rijavec, Vesna. "Problematika ovršnog notarskog akta na primjeru Slovenije." *Zbornik radova Aktualnosti građanskog i trgovačkog zakonodavstva i pravne prakse*, Mostar, 2007.
- Rumenov, Ilija. "The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – Is the "heart" of the Convention in the right place?" *SEELS Law Journal* 1:8, 2021.
- Šarčević; Petar. "The New Yugoslav Private International Law Act." *Revista Amerikane e së Drejtës Krahasese*, Vol. 33, 2/1985, 1985.
- Šaula, Valerija. Osnovi međunarodnog privatnog prava Republike Srpske - 3. izmijenjeno i dopunjeno izdanje. Pravni fakultet Univerziteta u Banjoj Luci, 2019.
- Šaula, Valerija. "Reform of Private International Law in Countries Successors of the Former Yugoslavia." *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Novom Sadu*, 4/2019.
- Šaula, Valerija. "Razvoj međunarodnog privatnog prava u regionu – Nacionalni izvještaj za Bosnu i Hercegovinu." Zbornik radova/Collected Papers, sa Sedme Konferencije za međunarodno privatno pravo – Proširenje „Evropskog pravosudnog prostora“ na države članice CEFTA, Novi Sad, 2010.
- Stewart, David P. "The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters." *The American Journal of International Law* 113(04):772-783, 2019.
- Uitdehaag, Jos dhe Eric Vincken. Civil Enforcement in the Western Balkan. An overview of the present situation and future developments in the various legal systems in the Western Balkan. Balkans Enforcement Reform Project – BERP, 2011.

- van Loon, Hans. "Towards a global Hague Convention on the Recognition and Enforcement of Judgments in Civil or Commercial Matters." *Collection of Papers of the Faculty of Law, Niš*, No 82, Year LVIII, 2019.
- Župan, Mirela. "Novi Zakon o međunarodnom privatnom pravu." *Hrvatska pravna revija*, 2018.

Tabela e legjislacionit

BiH

- Ligji "Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara" (Fletorja Zyrtare e RSFJ-së, 43/82,72/82)
- Ligji "Për ministritë dhe organet e tjera administrative të BiH-së" (Fletorja Zyrtare e BiH-së, 5/2003)
- E Drejta Kontraktuale e Aviacionit Civil (Fletorja Zyrtare e BiH-së, 51/15)
- Ligji "Për përgjegjësinë për dëmin bërthamor" (Fletorja Zyrtare e BiH-së, 87/13)
- Ligji "Për konkurrencën në BiH" (Fletorja Zyrtare e BiH-së, 48/05, 76/07, 80/09)

Federata e BiH-së

- Ligji "Për procedurën përmbartimore" në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 32/03, 52/03, 33/06, 39/06, 39/09, 35/12, 46/16, 42/18)
- Ligji "Për procedurën jokontestimore" i Federatës së BiH-së (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 2/98 39/04, 73/05, 80/14, 11/21)
- Ligji "Për noterinë" i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 45/02, 30/16)
- Ligji "Për procedurën gjyqësore në Federatën e BiH-së" (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 53/03, 73/05, 19/06, 98/15)
- Ligji "Për gjykatat" i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 38/05, 22/06, 63/10, 72/10)
- Ligji "Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Federatës së BiH-së" (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 24/02, 40/02, 59/02, 21/03)
- Ligji "Për mbrojtjen nga shpifja" në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja Zyrtare e Federatës së BiH-së, 19/03, 73/05)

Republika Srpska

- Ligji "Për procedurën përmbartimore" në Republikën Srpska (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 59/03, 85/03, 64/05, 118/07, 29/10, 57/12, 67/13, 98/14, 5/17, 58/18, 66/18)
- Ligji "Për procedurën jokontestimore" në Republikën Srpska (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 36/09, 91/16)
- Ligji "Për noterinë" i Republikës Srpska (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska 86/04, 74/05, 76/05, 91/06, 37/07, 50/10, 78/11, 20/14, 68/17, 113/18, 82/19)

- Ligji "Për procedurën gjyqësore në Republikën Srpska" (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska 58/03, 85/03, 74/05, 63/07, 45/09, 49/09, 61/13)
- Ligji "Për gjykatat" i Republikës Srpska (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 37/2012, 14/2014 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 44/15, 39/16 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 100/17)
- Ligji "Për Qendrën e Trajnimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë të Republikës Srpska" (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 34/02, 49/02, 77/02, 30/07)
- Ligji "Për mbrojtjen nga shpifja" në Republikën Srpska (Fletorja Zyrtare e Republikës Srpska, 37/2001)

Distrikti i Bërçkos në BiH

- Ligji "Për procedurën përmbartimore" në Distriktin e Bërçkos në BiH (Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 39/13, 47/17)
- Ligji "Për procedurën jokontestimore" në Distriktin e Bërçkos në BiH (Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 5/01, 36/17)
- Ligji "Për noterinë" në Distriktin e Bërçkos në BiH (Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 9/03, 17/06)
- Ligji "Për procedurën gjyqësore në Distriktin e Bërçkos në BiH" (Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 28/18)
- Ligji "Për gjykatat" në Distriktin e Bërçkos në BiH (Fletorja Zyrtare e Distriktit të Bërçkos në BiH, 80/20 - version i konsoliduar)

Marrëveshjet dypalëshe përkatëse për ndihmën juridike (vendet e Ballkanit Perëndimor):

- Bosnjë-Hercegovinë-Serbi

Marrëveshja midis Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë dhe Malit të Zi "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale" e datës 24.2.2005. Kjo marrëveshje është ndryshuar dhe aktualisht është detyruese vetëm për BiH-në dhe Serbinë. (Fletorja Zyrtare e BiH-së - Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 11/2005, 8/2010)

Protokolli për bashkëpunimin midis Ministrisë së Drejtësisë së BiH-së dhe Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë i datës 28.4.2006.

- Bosnjë-Hercegovinë-Mal i Zi

Marrëveshja midis Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale" e datës 9.7.2010 (Fletorja Zyrtare e BiH-së - Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 7/2011)

Protokolli për bashkëpunimin midis Ministrisë së Drejtësisë së BiH-së dhe Ministrisë së Drejtësisë së Malit të Zi, i datës 11.4.2008.

- Bosnjë-Hercegovinë–Kroaci

Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë, Qeverisë së Bosnjë-Hercegovinës dhe Qeverisë së Federatës së Bosnjë-Hercegovinës "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale" e datës 26.2.1996. (Fletorja Zyrtare e BiH-së - Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 1/96, 11/2005)

- Bosnjë-Hercegovinë–Maqedoni e Veriut:

Marrëveshja midis Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Maqedonisë "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale" e datës 17.9.2005. (Fletorja Zyrtare e BiH-së - Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 16/2006)

- Bosnjë-Hercegovinë–Slloveni

Marrëveshja midis Bosnjë-Hercegovinës dhe Republikës së Sllovenisë "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale" e datës 21.10.2009. (Fletorja Zyrtare e BiH-së - Marrëveshjet ndërkombëtare, nr. 7/2010)

RAPORT KOMBËTAR: KOSOVA

Autore

Donikë Qerimi

Përmbledhje ekzekutive

Raporti në vijim ofron një vështrim mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në Republikën e Kosovës. Duke qenë se kjo është çështje e së drejtës ndërkombëtare private, Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i Kosovës - i trashëguar nga epoka Jugosllave - është në qendër të kësaj analize. Raporti i thekson mangësitë e ndryshme të këtij ligji të vjetruar dhe gjithashtu i prezanton ndryshimet që mund të ndodhin me një reformë të ardhshme të DNP-së.

Vendimet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në Kosovë janë kompetencë e Gjykatave Themelore, por përmbarimi i tyre përfshin gjithashtu përmbaruesit privatë. Kushtet për njohje dhe ekzekutim janë mjaft të drejtpërdrejta dhe të krahasueshme me Aktet e DNP-së në shtetet e tjera: përfundimi i vendimit gjyqësor, mungesa e shkeljeve të rendit publik (politikës publike), mungesa e shkeljeve të të drejtave procedurale, mungesa e vendimeve gjyqësore kontradiktore dhe, më e rëndësishmja, reciprociteti. Raporti tregon se përvoja e gjykatave të Kosovës në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, veçanërisht në rastet civile dhe komerciale, është e kufizuar dhe jokonsistente.

Një nga dispozitat kryesore të Konventës së HCCH të vitit 2019 për vendimet gjyqësore, neni 5, i përcakton themelet e juridiksionit në bazë të të cilave mund të njihet një vendim gjyqësor i dhënë. Për ta mundësuar një krahasim midis këtyre bazave dhe atyre të zbatueshme në Kosovë, ofrohet një analizë e plotë e kriterëve për kompetencë apo juridiksion të përgjithshëm, të veçantë dhe ekskluziv në Kosovë. Gjersa Konventa e Vendimeve Gjyqësore e përdorë vendqëndrimin e zakonshëm (ndryshe i njohur edhe si “vendqëndrimi i rregullt”) si fakt vendimtar për juridiksionin e përgjithshëm, LDNP i Kosovës e përdor vendbanimin. Baza për juridiksion të veçantë në çështjet kontraktore është gjithashtu mjaft e ndërlikuar në Kosovë, duke pasur parasysh mungesën e qartësisë së dy dispozitave kryesore. Aktualisht nuk ka dispozita të veçanta të juridiksionit për çështjet që lidhen me kontratat e konsumatorit. Një pikë e përbashkët midis rregullave të juridiksionit indirekt të Konventës së Vendimeve Gjyqësore dhe LDNP-së së Kosovës janë bazat për juridiksionin ekskluziv bazuar në vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme.

Pritet shumë më shumë përputhshmëri e kriterëve gjyqësore ndërmjet Konventës së Vendimeve Gjyqësore dhe Kosovës pasi të miratohet LDNP i ri – që shpresojmë të ndodhë së shpejti. Dispozitat e (draft) LDNP-së së re bazohen të gjitha në rregulloren e Brukselit I *bis*. Kjo përputhshmëri është e rëndësishme për qarkullimin e lirë të vendimeve gjyqësore me origjinë nga Kosova ose të atyre për të cilat kërkohet njohja në Kosovë, me shpresën që do të lehtësojë këtë mision për të cilin ka aktualisht shumë pengesa për shkak të ndërlikimeve që lidhen me njohjen e Kosovës si shtet i pavarur jashtë vendit.

Në fund, raporti gjithashtu ofron një analizë mbi procedurën e njohjes dhe ekzekutimit, si dhe kornizën ligjore dhe institucionale përmes së cilës kryhen proceset e tilla.

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Njohja dhe ekzekutimi ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore në Kosovë është çështje e së Drejtës Ndërkombëtare Private. Kjo fushë e ligjit në Kosovë rregullohet me Ligjin për Zgjidhjen e Konfliktit të Ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera në marrëdhënie të caktuara,¹⁹⁸ që njihet si Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private. Që të kuptohet më lehtë, ky raport do t'i referohet atij si «Ligji i DNP-së në Kosovë.» Është një nga ligjet e pakta të ish-periudhës së RSFJ-së që vazhdon të zbatohet në Kosovën e pasluftës.¹⁹⁹ Ligji nuk është lehtësisht i qasshëm

¹⁹⁸ Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 43/82 dhe 72/82, 23 korrik 1982.

¹⁹⁹ Zbatimi i këtij ligji mundësohet nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12. 1999/24 e 12 dhjetorit 1999, e cila lë në fuqi të gjitha ligjet para Marsit 1989, të cilat nuk kishin asnjë dispozitë diskriminuese. I njëjti ligj është integruar dhe vazhdon të zbatohet në Republikën e Serbisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

në gjuhën shqipe dhe nuk ka asnjë version të konsoliduar²⁰⁰ të publikuar në internet për nevojat e profesionistëve ligjorë. Ky ligj, megjithëse është mjaft i vjetër, përmban rregulla që i rregullojnë të gjitha aspektet e marrëdhënieve juridike civile me një element të huaj: rregullat për përcaktimin e së drejtës kompetente, rregullat për përcaktimin e kompetencës (juridiksionit) të gjykatave tona në procedurat civile me një element të huaj si dhe rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Për më tepër, ky ligj nuk ka traditë shumë të gjatë të ekzekutimit në Kosovë dhe nuk është analizuar me përpikëri as nga studiuesit. Prandaj, për t'i interpretuar dispozitat e këtij ligji, është e nevojshme të merren parasysh interpretimet e studiuesve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe praktika gjyqësore e këtyre vendeve.²⁰¹

Ndërkohë, Kosova është në proces të miratimit të një ligji të ri për të Drejtën Ndërkombëtare Private.²⁰² Dispozitat e këtij ligji dhe ndryshimet që do t'i sjellin këto dispozita janë përfshirë në këtë Raport aq sa ka qenë e mundur.

Siç do ta ilustrojë analiza më poshtë, Ligji i DNP i Kosovës lë shumë pyetje pa përgjigje. Si i tillë, është shumë e nevojshme të përdoren ligje të tjera vendore për t'i plotësuar këto dispozita. Një burim i tillë i rëndësishëm është Ligji për Procedurën Kontestimore²⁰³ – ekuivalent me Ligjin e Procedurës Civile - i cili është plotësim i dobishëm në çështjet e procedurës gjyqësore dhe njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Në përgjithësi, ky ligj ofron një bazë funksionale. Sidoqoftë, duhet të theksohet se versioni në gjuhën angleze është përkthim mjaft i dobët dhe leximi i tij duhet të shoqërohet gjithmonë me një lexim në një nga gjuhët vendore.

Duke pasur parasysh që procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja është procedurë jashtë-gjyqësore,²⁰⁴ një nga burimet kryesore është Ligji për Procedurën Jokontestimore.²⁰⁵ Për më tepër, duke pasur parasysh që Ligji i DNP-së në Kosovë ka vetëm dy dispozita themelore për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, roli që ka Ligji për Procedurën Përmbarimore²⁰⁶ në shpjegimin e mëtutjeshëm të kësaj procedure është tejet thelbësor.

Ligjet dhe rregulloret e tjera të veçanta gjithashtu i referohen këtij Raporti kur është e nevojshme që të sqarohen çështje të rëndësishme, e veçanërisht në Kapitullin 5 mbi Juridiksionin Ndërkombëtar.

Është e nevojshme që të kryhet një shqyrtim i thellë për ta vlerësuar rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe Kosovës.²⁰⁷ Për shkak të shtetësisë së diskutueshme të saj, Kosova nuk është anëtare e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe është vetëm shtet i lidhur. Kosovës iu lejua të aderonte në Konventën e parë në 2015,²⁰⁸ gjë që u pasua nga kundërshtime dhe deklarata të shumta nga Serbia dhe, më vonë, edhe palët e tjera kontraktuese.²⁰⁹

Meqenëse Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë, e cila ishte nënshkruese e shumë Konventave,²¹⁰ shumë prej konventave të nënshkuara në atë kohë janë zbatuar edhe në Kosovë. Edhe pse

200 Të gjitha versionet e publikuara ende përmbajnë termat «Jugosllavi», «Gjykata Jugosllave» dhe të ngjashme.

201 Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia vazhdojnë ta zbatojnë këtë ligj deri më sot. Para kësaj, Ligji(et) DNP i Maqedonisë Veriore ishte pothuajse fjalë për fjalë adoptim i të njëjtit akt. Prandaj, praktikat dhe doktrina e tyre gjyqësore përmenden vazhdimisht në këtë raport.

202 Një version i mëhershëm i këtij drafti është në dispozicion në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/08/PROJEKTLIGJI-P%C3%8BR-T%C3%8B-DREJT%C3%8BN-ND%C3%8BRKOMB%C3%8BTARE-PRIVATE.pdf>. Një version më i ri dhe i përmirësuar i këtij drafti është diskutuar së fundmi në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 19 nëntor, 2020. Autori është një nga anëtarët e grupit punues që e ka hartuar ligjin, dhe referencat në këtë raport i bëhen versionit të fundit të Draftit.

203 Ligji Nr. 03 / L-006 për Procedurën Kontestimore, në dispozicion në Gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583>

204 Shih Kapitullin 6.3 në vijim.

205 Titulli zyrtar në gjuhën angleze është Law No. 03/L-007 on Out Contentious Procedure, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2608>. Sidoqoftë, ky nuk është termi i duhur dhe kështu termi „procedurë jokontestimore” do të përdoret këtu.

206 Ligji Nr. 04 / L-139 për Procedurën e Përmbarimit, në dispozicion në Gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870>.

207 Për një qasje të përmbledhur të kësaj çështje, shih Donikë Qerimi, “Western Balkans,” in *Choice of Law in International Commercial Contracts*, Private International Law, Oxford University Press, 2021.

208 Konventa e Hagës e 5 tetorit 1961 për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve të huaja publike („Konventa Apostille”); Shih <<https://www.hcch.net/de/news-archive/details/?varevent=438>>.

209 Shih

<<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/notifications/?csid=1319&disp=resdn>>.

210 Stanivuković, Maja and Mirko Živković. “Serbia,” in *Kluwer Encyclopedia of Private International Law*. Wolters Kluwer, 2018, p. 22.

studiuesit vendorë pohojnë se këto konventa janë përvetësuar nga Kosova,²¹¹ kjo nuk pasqyrohet në faqen e internetit të Konferencës ku gjenden dhe përditësohen statutet e secilës Konventë.²¹² Kjo nuk reflektohet ose pretendohet as nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.²¹³ Kjo çështje do të trajtohet në detaje të mëtejshme në Kapitullin 4.2.

Ndryshe nga vendet e rajonit që kanë nënshkruar një numër marrëveshesh bilaterale ndërkombëtare, Kosova ka një numër të kufizuar të marrëveshjeve bilaterale që rregullojnë fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare private. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kosova ka kaluar nëpër procesin e ratifikimit të marrëveshjeve me Austrinë, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikën, Gjermaninë, Finlandën dhe Republikën Çeke.²¹⁴ Sidoqoftë, vetëm notat verbale të suksesit të marrëveshjeve me Austrinë²¹⁵ dhe Mbretërinë e Bashkuar²¹⁶ janë publikuar në *Gazetën Zyrtare*. Përmbajtja e saktë e këtyre marrëveshjeve nuk dihet pasi marrëveshjet nuk janë publikuar²¹⁷. Marrëveshjet që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore mund të jenë ato mbi bashkëpunimin juridik ndërkombëtar për çështjet civile në përgjithësi²¹⁸.

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore që përcaktojnë palët e interesit në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Në përgjithësi, njohja dhe ekzekutimi ndërmjet shteteve i vendimeve të huaja në Kosovë nënkupton përfshirjen e gjykatave, përmbauesve privatë dhe, me raste, edhe Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Korniza ligjore që përcakton palët e interesit në këto çështje kërkon një qasje shumë gjithëpërfshirëse, pasi që dispozitat janë të shpërndara në një numër ligjesh, ndër të cilat: Ligji i DNP, Ligji për Gjykatat, Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji për Procedurën Përmbarimore, Ligji për Procedurën Jokontestimore dhe Ligji mbi Arbitrazhin. Referencë specifike për këto është bërë në Kapitullin vijues.

211 Shihni, së fundmi, Kuçi, Hajredin. “E Drejta Ndërkombëtare Private në Kosovë.” *Hyrje Në Sistemin Ligjor në Kosovë*. Prishtine, Kosovo, Akademia e Drejtësisë, 2019, pp. 103–40.

212 Shihni statusin e të gjitha teksteve këtu: <https://www.hcch.net/en/instruments/status-charts>.

213 Pas një kërke drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në tetor 2020 për qasje në këto dokumente publike, autorit iu dërgua një listë e marrëveshjeve të suksesshme me shumë vende, por asnjëri prej tyre nuk është Konventa e Konferencës së Hagës. Ka një citim të tre marrëveshjeve për të lehtësuar zbatimin e tre Konventave të Hagës midis Francës dhe Jugosllavisë.

214 Shih <http://www.mfa-ks.net/al/ministria/541/marrveshjet-ndrkombtare/541>.

215 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8520>

216 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8543>

217 Pas një kërke drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në tetor 2020 për qasje në këto dokumente publike, autores iu dërgua një listë e marrëveshjeve të suksesshme (shih listën në fusnotën më poshtë), si dhe tekstet origjinale të marrëveshjeve të suksesshme.

218 Sipas praktikës së Departamentit për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, këto janë marrëveshjet përkatëse të suksesshme: Me Republikën Federale të Austrisë: Marrëveshja për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Ndërsjella Gjyqësore dhe Krahaset në Çështjet Tregtare e datës 18 mars 1960; Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e detyrimeve ushqimore e datës 10 tetor 1961;

Me Mbretërinë e Bashkuar: Konventa midis Madhërisë së Tij në emër të Britanisë së Madhe dhe Mbretit të Jugosllavisë për Procedurat Ligjore në Çështje Civile dhe Tregtare (Londër, 27 shkurt 1936).

Me Mbretërinë e Belgjikës: Marrëveshja ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë për Ndihmën e Ndërsjellë Gjyqësore në Çështje Civile dhe Tregtare (24 shtator 1971); Konventa midis Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë në lidhje me Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Detyrimet Ushqimore (12 dhjetor 1972);

Me Republikën Çeke: Marrëveshja midis RSFJ-së dhe RS-së së Çekoslovakisë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në çështje civile, familjare dhe penale;; Me Republikën Franceze: Marrëveshja midis Republikës Franceze dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë me qëllim lehtësimin e zbatimit të Marrëveshjes së Hagës e datës 1 mars 1954 mbi Procedurën Civile, nënshkruar më 29 tetor 1969; Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Franceze dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë për Ligjin mbi Juridiksionin mbi të Drejtat e Individëve dhe Familjeve, nënshkruar në Paris më 18 maj 1971; Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Franceze dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve për Çështje Civile dhe Tregtare, nënshkruar në Paris më 18 maj 1971.

2.2 Palët e interesit që e zbatojnë në praktikë njohjen ndërmjet shteteve dhe vendimet e huaja gjyqësore

2.2.1. Gjykatat

Ligji i Kosovës për Gjykatat,²¹⁹ neni 12, paragrafi 2, i mandaton Gjykatat Themelore me fuqinë për të “ofruar ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur mbi pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.” Çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja bien në juridiksionin e Departamentit të Përgjithshëm, me përjashtim të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit të cilat bien nën kompetencat e Departamentit për Çështje Ekonomike.²²⁰ Ky i fundit është i autorizuar që t’i gjykojë kontestet midis organizatave vendore dhe të huaja të biznesit në të gjitha çështjet komerciale si dhe pengimin e posedimit (me përjashtim të pasurisë së paluajtshme).²²¹

Ekziston një iniciativë ligjore në zhvillim e sipër për të krijuar një Gjykatë Tregtare të re dhe të veçantë.²²² Neni 3, paragrafi 3 i Projektligjit parashikon që dhomat e shkallës së parë të kësaj Gjykate të fuqizohen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Duke qenë se kjo Gjykatë pritet të mbushet me gjyqtarë të specializuar në çështje komerciale, ky lajm është padyshim i mirëpritur. Kjo është veçanërisht e dobishme kur merren parasysh sfidat e deritanishme në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat do të analizohen më poshtë në Kapitullin 3.

2.2.2 Institucionet administrative

Neni 92 i Ligjit të DNP-së i Kosovës kërkon që gjykata t’i referohet “autoritetit përgjegjës për administrimin e drejtësisë” kur ka dyshime nëse ekziston reciprociteti me një shtet të caktuar. Një udhëzim administrativ për procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale dhe civile²²³ e fuqizon Departamentin për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë me një autoritet të tillë. Duke pasur parasysh të metat e shumta të Udhëzimit Administrativ, është përgatitur një Ligj mbi Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështjet Civile i cili shpresojmë që të miratohet së shpejti.²²⁴ Ky ligj²²⁵ sqaron, ndër të tjera, rolin e Ministrisë së Drejtësisë si Autoritet Qendror në transmetimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike ndërmjet gjykatave në Kosovë dhe jashtë vendit, por gjithashtu siguron bazën ligjore që gjykatat të komunikojnë drejtpërdrejt kur është e nevojshme.

2.2.3 Juristët - avokatët dhe noterët

Në një procedurë për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të huaj, palët shpesh ndihmohen nga avokatët, duke pasur parasysh veçantinë e çështjeve të tilla. Sidoqoftë, përfaqësimi ligjor nga një avokat nuk është i detyrueshëm në një procedurë të tillë. Avokatët në Kosovë konsiderohen si profesion i lirë juridik dhe rregullohen me Ligjin për Avokatinë.²²⁶ Avokatët e huaj lejohen ta praktikojnë profesionin e tyre në Kosovë vetëm me kushtin e reciprocitetit²²⁷

Një profesion tjetër i rëndësishëm juridik falas në Kosovë është ai i noterit që luan një rol të

rëndësishëm në procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Funksionet e noterëve rregullohen me Ligjin për Noterët.²²⁸ Të dyja këto profesione menaxhohen nga Dhomat e tyre përkatëse dhe mbikëqyren nga Departamenti i Profesioneve Ligjore Falas të Ministrisë së Drejtësisë.

2.2.4 Përmbaruesit privatë

Ligji për Procedurën Përmbarimore i përcakton si gjykatat ashtu edhe përmbaruesit si agentë përmbarimi.

Çështjet në lidhje me ligjin e familjes dhe rivendosjen në punë të punonjësve dhe nëpunësve civilë (dhe kompensimin e tyre) bien brenda kompetencave ekskluzive të gjykatave. Çështjet e tjera u lihen përmbaruesve privatë, prandaj roli i tyre në procedurën për ekzekutimin e vendimeve të huaja është vendimtar. Pavarësisht kësaj, përmbaruesit privatë janë të punësuar në momentin që gjykata kompetente në Kosovë merr vendim për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj gjyqësor. Siç do të tregohet më poshtë, vendimi i huaj gjyqësor i nënshtrohet procedurave të njohjes dhe përmbarimit pranë Gjykatës Themelore të një territori të veçantë në Kosovë, dhe ekzekutimi i tij, përfshirë afatin e fundit për ekzekutim vullnetar, specifikohet në vendimin e Gjykatës.²²⁹ Një vendim i huaj gjyqësor bëhet dokument përmbarimi vetëm pasi të jetë njohur nga gjykatat në Kosovë.²³⁰ Përmbaruesi privat më pas jep shkresën bazuar në propozimet për kryerjen e përmbarimit (të bëra nga pala) dhe kryen përmbarimin për ta përmbushur pretendimin e debitorit bazuar në një dokument përmbarimi.²³¹

Profesioni i përmbaruesve privatë rregullohet kryesisht nga Ligji për Procedurën Përmbarimore dhe legjislacioni tjetër sekondar.²³² Menaxhimi i tyre ditohet bëhet nga Oda e Përmbaruesve Privatë dhe mbikëqyren nga Ministria e Drejtësisë.

3. Roli i gjykatave dhe përmbaruesve privatë në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Ky raport do t’i paraqesë mangësitë e shumta të kornizës ligjore në Kosovë në fushën e së drejtës ndërkombëtare private në përgjithësi. Sidoqoftë, çështja më shqetësuese është profesionalizmi i gjyqtarëve²³³ në trajtimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Si mangësi, së pari duhet të theksohet se asnjë nga vendet në rajon nuk e njeh praktikën gjyqësore si burim i së drejtës.²³⁴ Pak më shumë rëndësi u kushtohet shkrimeve doktrimore, megjithëse autorët pajtohen se edhe këto nuk përfaqësojnë burim të së drejtës.²³⁵

Si mangësi e dytë, duhet të theksohet se vetëm kohët e fundit, vendimet e gjykatave në Kosovë kanë filluar të publikohen në Kosovë²³⁶. Pavarësisht se ekzistojnë mekanizmat e kërkimit, ato shpesh janë joefektive. Për shembull, një kërkim i fjalëve kyçe rrallë herë i jep të gjitha rezultatet e mundshme pasi shumë vendime gjyqësore janë publikuar si fotografi të skanuara. Për më tepër, çdo hulumtim në internet do të ishte i mangët pasi që vetëm vendimet nga viti 2018 e tutje janë publikuar. Më e rëndësishmja, rastet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore, të regjistruara nën kategorinë “civile të ndryshme” ose “çështje të ndryshme civile”,

219 Ligji Nr. 06 / L-054 për Gjykatat, në dispozicion në Gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>.

220 Neni. 39 paragrafi 2 i Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin, në dispozicion në Gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2579>

221 Neni 12, para. 2, neni 1, paragrafi 1 dhe neni 1, paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatat.

222 Shih Projektligjin në dispozicion në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40935>.

223 Udhëzimi Administrativ për Procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare për çështje penale dhe civile, nr. 01-1265 (2009).

224 Shih Koncept Dokumentin, i cili i detajon të metat e situatës aktuale dhe paraqet zgjidhjet e propozuara, në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/12/Koncept-Dokumenti-p%C3%ABr-Fush%C3%ABn-e-Bashk%C3%ABpunimit-Juridik-Nd%C3%ABrkomb%C3%ABtar-n%C3%AB-%C3%87%C3%ABshtjet-Civile-MD-Shqip.pdf>

225 Autorja ishte pjesë e grupit punues të hartimit. Ligji është hartuar dhe pritet të përpunohet së shpejti për miratim.

226 Ligji Nr. 04 / L-193 mbi Avokatinë, në dispozicion në gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673>.

227 Neni 40 i Ligjit për Avokatinë.

228 Ligji Nr. 06 / L –010 për Noter, në dispozicion në Gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18334>.

229 Neni 24 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

230 Neni 22, para. 1, pika 5 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

231 Neni 5, para. 3 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

232 Në dispozicion në «Shfletoni akte nën-normative»: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870>

233 Kosova së fundmi ka publikuar një Draft Strategji kombëtare për Sundimin e Ligjit, e cila identifikon mangësi të mëdha në profesionalizmin e gjyqtarëve në përgjithësi në Kosovë. Drafti është në dispozicion në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41053>.

234 Shikoni Raportet Kombëtare për këto vende në *Elgar Enciklopedia e së Drejtës Ndërkombëtare Private* (2017) të cituar në këtë raport. Nuk ka asnjë raport kombëtar për Kosovën.

235 Po aty.

236 Shikoni p.sh. uebfaqen e Gjykatës Themelore të Prishtinës: <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/?r=M>

nuk publikohen.²³⁷

Prandaj, referencat e praktikës gjyqësore në këtë raport janë rezultat i hulumtimit të vetë autores në Gjykatën Themelore të Prishtinës në shumë raste gjatë periudhës prej vitit 2017 deri në vitin 2020.²³⁸ Hulumtimi në terren tregon se ka mospërputhje të mëdha në qëndrimet kundrejt njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Ky përfundim qëndron të paktën për Gjykatën Themelore të Prishtinës. Sidoqoftë, si Gjykatë Themelore e kryeqytetit, natyrisht që është e pritshme që vendimet e saj të jenë shembullore për gjykatat e tjera në vend.

Shumica dërrmuese e vendimeve gjyqësore për të cilat kërkohet njohja apo ekzekutimi janë vendime për çështje familjare, e veçanërisht shkurorëzime.²³⁹ Megjithatë, edhe në këto çështje familjare, ka qasje kontradiktore ku disa vendime me origjinë nga shtetet që nuk e njohin Kosovën, me të drejtë, janë njohur²⁴⁰ ndërsa disa të tjera janë refuzuar për shkak të mungesës së reciprocitetit.²⁴¹ Për më tepër, ekziston një mungesë thelbësore e qartësisë brenda vetë vendimeve. Vendimet janë zakonisht shumë të shkurtra dhe gjykata jep shumë pak arsyetime se pse vendimi është refuzuar. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të një forme standarde të gjuhës që mund të jetë kopjuar dhe ngjitur tek vendimet - p.sh., paragrafët që përsëritin kërkesat e nevojshme zyrtare të dokumenteve që duhet të dorëzohen. Kjo ndodh shpesh kur i njëjti vendim përfundon me «prandaj, pasi propozimi nuk përmbush kriteret ligjore për njohje ...» dhe pastaj përfundon përsëri me «pra, pasi që paditësi nuk ka vepruar në përputhje me njoftimin e gjykatës...».²⁴² Para përfundimeve të tilla, kur kemi të bëjmë me vendime nga vendet që nuk e njohin Kosovën, Gjykata gjithashtu përsërit të njëjtin paragraf se nuk ka reciprocitet dhe nuk ka marrëveshje ndërkombëtare midis Kosovës dhe atij shteti të veçantë.²⁴³ Kjo e bën të vështirë që lexuesi ta kuptojë nëse është refuzuar njohja e vendimit bazuar në kërkesat zyrtare ose për shkak të mungesës së reciprocitetit.

Në vend të një përfundimi, për fat të keq, duhet të pajtohemi me deklaratat e studiuesve homologë shqiptarë të cilët vunë në dukje se “është herët të diskutohet për jurisprudencë të qëndrueshme të gjykatave shqiptare në këtë fushë.”²⁴⁴ Ky përfundim padyshim vlen edhe për Kosovën.

Ka shumë pak ose aspak të dhëna që e adresojnë performancën e procedurave të përmbarimit, ose rolin e përmbaruesve privatë në veçanti. Sfida të shumta praktike janë identifikuar në procedurën e përmbarimit, e cila më pas çoi në amendamentimin e saj në vitin 2017.²⁴⁵ Strategjia Kombëtare për Sundimin e Ligjit vëren se ekziston një domosdoshmëri për ta fuqizuar Odën e Përmbaruesve Privatë, për ta rritur numrin e përmbaruesve privatë dhe për të siguruar një shpërndarje më të mirë gjeografike, si dhe një sistem uniform për mbledhjen e të dhënave për të mundësuar një pasqyrë më të mirë të performancës së përgjithshme të sistemit.²⁴⁶

Institucioni i ngarkuar me trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve në Kosovë është Akademia e Drejtësisë e Kosovës. Nuk ka trajnime të specializuara për çështje të së drejtës ndërkombëtare private. Çështjet me një element të huaj shpesh trajtohen brenda trajnimeve për tema të tjera më të gjera. Për shembull, trajnimi mbi juridiksionin e gjykatave në çështjet komerciale tani do të jetë pjesë përbërëse e një trajnimi mbi instrumentet e huaja të zbatueshme

në fushën e së drejtës komerciale.²⁴⁷ Trajnimi për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ofrohet vetëm si një nga temat brenda trajnimit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.²⁴⁸ Trajnime të tjera të specializuara për këtë temë të veçantë nuk janë kryer.

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

Kosova është shtet nënshkrues i Marrëveshjes CEFTA.²⁴⁹ Ajo ka një deficit të madh tregtar prej rreth 3,113 miliardë euro.²⁵⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës kohët e fundit ka raportuar një rritje të madhe prej 92.2% në eksportin e mallrave dhe një rritje prej 51.8% në import, krahasuar me vitin 2020.²⁵¹

Partnerët kryesorë tregtarë janë disa vende të BE-së dhe vendet e CEFTA-s në rajon. Eksportet janë më të larta në vendet e CEFTA sesa në vendet e BE-së.²⁵² Partnerët kryesorë të eksportit dhe anëtar të CEFTA-s janë Shqipëria (16.2%), Maqedonia Veriore (12.2%), Serbia (5.8%) dhe Mali i Zi (3.3%). Partnerët kryesorë të eksportit midis vendeve të BE janë Italia (10.6%), Gjermania (7.1%) dhe Holanda (2.5%).²⁵³

Partnerët kryesorë tregtarë të importit midis anëtarëve të CEFTA janë Serbia (5.9%), Maqedonia Veriore (5.6%) dhe Shqipëria (5.5%). Partnerët tregtarë të importit të BE janë Gjermania (14.8%), Italia (6.1%), Greqia (5.9%) dhe Sllovenia (3.6%).²⁵⁴

Partnerë të tjerë kryesorë tregtarë të eksportit janë SHBA (14.3%) dhe Zvicra (7.8%), ndërsa Turqia (12.8%) dhe Kina (8.7%) janë partnerët kryesorë të importit.²⁵⁵

Ministria e Tregtisë ka identifikuar disa nga sfidat kryesore që e pengojnë eksportin dhe varësinë nga importi, përfshirën: sektorin e dobët të prodhimit, progresin e kufizuar në cilësi dhe inovacion, kërkesat për viza udhëtimi, pengesat jo-tarifore dhe pengesat e tjera institucionale si mungesa i stafit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës së Kosovës.²⁵⁶

Megjithatë, ka më shumë shpresë në tregtinë e shërbimeve. Shërbimet përbëjnë sektorin më të madh të ekonomisë së Kosovës, kontributi i të cilit në gjenerimin e përgjithshëm të vlerës së shtuar vendore është vazhdimisht në rritje.²⁵⁷ Raportet tregojnë se eksportet e shërbimeve kishin arritur në 78.2% të tregtisë totale në këtë sektor në vitin 2017, dhe 80.96% në vitin 2018.²⁵⁸ Të njëjtat raporte tregojnë se në vitin 2018, 75.7% e eksporteve totale të shërbimeve të Kosovës në mbarë botën ishin regjistruar në vendet anëtare të BE-së dhe CEFTA-s. Në vitin 2018, 61.44% e importeve totale të shërbimeve të Kosovës kanë origjinën në BE dhe në vendet e CEFTA-s.

237 Deri më 3 maj 2020, vetëm një rast për „çështje të ndryshme civile“ shfaqet në faqen e internetit.

238 Përveç këtij hulumtimi, autorja kishte përvojën personale të kryerjes së hulumtimeve në terren në gjykatat e Kosovës kur zhvillonte hulumtime të praktikës gjyqësore për tezën e saj të doktoratës dhe kontributet në revista. Përpjekja për të kryer një hulumtim të tillë zakonisht përcillet me pengesa të thella burokratike dhe vështirë se jep rezultatet e dëshiruara. Kohët e fundit, disa kompani në rajon kanë filluar shërbimet e abonimit të përmblendhjeve të praktikës gjyqësore nga vendet e tjera, pa mundësinë e shikimit të vendimit të plotë gjyqësor.

239 Edhe gjer në Brazil; Shih vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës CN nr. 8/2015 të datës 16.02.2015.

240 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë CN nr. 42/17 i datës 17.07.2017, që e njeh një vendim me origjinë nga Serbia

241 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë CN nr. 383/19 i datës 01.11.2019 që e refuzon një vendim gjyqësor mbi divorcin të lëshuar në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës CN nr. 349/19 të datës 10.12.2019, refuzon një gjykim mbi divorcin të lëshuar në Sllovaki.

242 Po aty, të dyja vendimet.

243 Po aty, të dyja vendimet.

244 Aida Gugu Bushati and Nada Dollani. „Albanian PIL Act and Its Implementation in Judicial Practice.“ 18 Annals of the Faculty of Law of University of Zenica, 2016, p. 147.

245 Projekti i BE „Mbështetje për Profesionet Juridike Falas dhe Dhomën e Avokatëve“ (EuropeAid / 136612 / DH / SER / XK) - „Raporti Preliminar mbi Sfidat për Profesionet Juridike Falas“, Mars 2017

246 Draft faqet 17 dhe 31-32; në dispozicion në <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41053>.

247 Trajnimi i pare testues nga autorja, do të ofrohet në qershor të vitit 2021 me temën „Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, direktivave dhe rregulloreve të BE-së mbi çështjet tregtare, fiskale dhe ato doganore.“

248 Përgjigja e Akademisë së Drejtësisë në pyetjen e autores për këtë çështje, më 26 prill 2021.

249 <https://cefta.int/cefta-parties/>

250 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës, „Analiza e politikës tregtare: faktorët që pengojnë ritjen e eksportit të mallrave“, gusht 2020, në dispozicion në: <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/9AA24A4B-6ECF-4D67-91ED-A9D29F23D004.pdf>

251 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Tregtia e Jashtme e Mallrave, Mars 2021.

252 Po aty, f. 8, 24. 3 milionë EUR për vendet e CEFTA dhe 19.8 milionë për vendet e BE.

253 Po aty, f. 8.

254 Po aty.

255 Po aty.

256 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, „Analiza e politikës tregtare: faktorët që e pengojnë ritjen e eksportit të mallrave“, gusht 2020, në dispozicion në: <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/9AA24A4B-6ECF-4D67-91ED-A9D29F23D004.pdf>

257 Luis Abugattas, Shqipe Jashari Sekiraga dhe Xhorxhina Bami „Tregtia e Kosovës në Shërbime me vendet anëtare të BE dhe CEFTA“, në dispozicion në: <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/7010F0DF-B3D8-42C3-9C59-CBCC2565A04F.pdf>.

258 Po aty, f. 1.

4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Siç u pasqyrua shkurtimisht më lart, anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, të tilla si HCCH, pengohet nga statusi i saj i diskutueshëm politik. Këto Konventa operojnë në një sistem të ngjashëm me një “binjakëzim”, ku vendet anëtare bien dakord t’i unifikojnë rregullat e së drejtës ndërkombëtare midis tyre, në mënyrë që kjo të çojë në një bashkëpunim më të lehtë midis tyre në procedura të ndryshme para organeve përkatëse kompetente të secilit shtet dhe, në fund, për njohjen e vendimeve të njëri-tjetrit. Ky privilegj nuk shtrihet automatikisht në ato shtete që nuk janë anëtare të Konferencës, në një formë apo tjetër.

Megjithëse Konventa e HCCH e vitit 2019 për Vendimet Gjyqësore është gjithashtu e hapur për nënshkrim për shtetet jo-anëtare, aderimi i Kosovës në këtë Konventë mund të shoqërohet me sfida të shumta. Jo vetëm që ekziston një proces i gjatë dhe i ndërlikuar i aderimit në Konferencë, por secila Konventë gjithashtu u ofron mundësinë shteteve nënshkruese të asaj konvente të paraqesin rezerva dhe deklarata për zbatimin e një instrumenti (ose një pjese të tij) për një shtet të caktuar. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi me të vetmen Konventë, në të cilën Kosova zyrtarisht është nënshkruese - Konventa e Apostilles - në të cilën Serbia ka bërë një deklaratë që e kundërshton nënshkrimin e saj nga Kosova.²⁵⁹

Natyrisht, Serbia është një nga vendet më aktive në kundërshtimin e shtetësisë së Kosovës. Sipas Kushtetutës së saj, Kosova është pjesë përbërëse e saj si krahinë autonome.²⁶⁰ Ndonëse ky qëndrim mund të jetë në kontrast të plotë me realitetin politik²⁶¹ apo me aspekte të së drejtës ndërkombëtare publike,²⁶² megjithatë kjo e pengon qarkullimin e vendimeve midis këtyre dy vendeve. Vendimet e marra nga gjykatat e Republikës së Kosovës nuk njihen nga gjykatat serbe dhe madje mund të konsiderohen kundër rendit të tyre kushtetues. Nëse Kosova dhe Serbia zgjedhin që të dyja t’i përmbahen Konventës së Vendimeve, ka shumë të ngjarë që Serbia do të shpallte një njoftim në përputhje me nenin 19 (Deklaratat në lidhje me vendimet që i përkasin një shteti), në përputhje me nenet. 29 dhe 30.

Vendet e tjera që mund të nxiten të shpallin njoftime të tilla do të ishin Bosnja dhe Hercegovina në rajon, pesë shtete anëtare të BE që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës - Spanja, Greqia, Qipro, Sllovakia dhe Rumania - dhe Kina dhe Rusia si dy kundërshtarë të tjerë politikë të mëdhenj të pavarësisë së Kosovës.

Megjithëse Kosova nuk ka arsye (përveç ndjeshmërisë politike) për të shpallur një njoftim të tillë ndaj Serbisë, një njoftim nga ndonjë prej këtyre vendeve do të mjaftonte për të çaktivizuar funksionimin e Konventës së Vendimeve Gjyqësore ndërmjet dy vendeve. Kjo sepse neni 29, paragrafi 1 përcakton që Konventa do të ketë efekt midis dy Shteteve Kontraktuese vetëm nëse asnjëri prej tyre nuk e ka njoftuar depozituesin në lidhje me tjetrin në përputhje me paragrafin 2 ose 3.

Në anën tjetër, Kosova mund të shpallë njoftim bazuar në nenin 18 (Deklaratat në lidhje me çështje specifike) në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave paralele që kanë funksionuar në Kosovë për një periudhë të gjatë kohore, por *de facto* nën autoritetin e qeverisë serbe dhe juridiksionin mbi Kosovën të Serbisë, ose që kanë operuar në territorin e Kosovës.²⁶³ Sidoqoftë, çështjet e këtyre gjykatave janë adresuar gjithashtu në një proces të

²⁵⁹ Shih

<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/notifications/?csid=1319&disp=resdn, and see, for example, the response of Switzerland: https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/notifications/?csid=349&disp=resdn>.

²⁶⁰ Neni. 182, Kushtetuta e Republikës së Serbisë e vitit 2006. Statusi i „Kosovës dhe Metohisë” i një krahine autonome barazohet me territorin e Vojvodinës brenda Serbisë.

²⁶¹ Kosova njihet nga 117 shtete si vend i pavarur; Shih <https://www.mfa-ks.net/politika/484/lista-e-njohjeve/484>.

²⁶² Shih Opinionin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi „Përputhjen me të drejtën ndërkombëtare të deklaratës unilaterale të pavarësisë së Kosovës”, e datës 22 korrik 2010.

²⁶³ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, “Strukturat Paralele në Kosovë”, f. 5, në dispozicion në:

negociatave politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përmes një marrëveshje për drejtësinë dhe integritimin e strukturave gjyqësore paralele në Kosovë²⁶⁴. Prandaj, kjo çështje mund të ketë nevojë për një analizë më të thellë duke pasur parasysh procesin e negociatave kur të vijë koha.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH të vitit 2019 “për vendimet gjyqësore”²⁶⁵

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi)

Përderisa Konventa e HCCH e vitit 2019 “për vendimet gjyqësore” përdor vendqëndrimin e zakonshëm të personit ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi (me gjasë i padituri) si pikë të lidhjes për kompetencën e përgjithshme, Ligji Jugosllav i DNP përdor vendbanimin. Neni 46 iu jep autoritet gjykatave vendore për të përcaktuar juridiksion në rastet kur i padituri ka vendbanim në shtet ose, në rast të personave juridikë, e ka selinë aty. Përndryshe, nëse nuk arrin të vërtetojë vendbanimin në një shtet tjetër, gjykatat e Kosovës do të kenë juridiksion nëse personi *ka vendqëndrim* në njërin prej këtyre shteteve.

Megjithatë, vendqëndrimi (jo vendqëndrimi i zakonshëm) është po ashtu bazë për juridiksion këtu, por vetëm nëse personi është edhe shtetas i vendit. Prandaj, pavarësisht vendqëndrimit të personit, nëse i padituri është shtetas i Kosovës dhe banon aty, gjykatat e Kosovës do të kenë juridiksion.

Është e rëndësishme të ceket që terminologjia që Ballkani Perëndimor e shfrytëzon si bazë për të përcaktuar juridiksionin e përgjithshëm mund të jetë hutuese për juristin apo studiuesin e huaj. Ligji jugosllav i DNP, që deri para një dekade ishte i zbatueshëm edhe në shtete të tjera të ish-Jugosllavisë, është një prej burimeve të këtij hutimi. Në gjuhën serbe, (një prej) gjuha(ëve) origjinale të ligjit, neni 46 i ligjit përdor termin “prebivalište” si bazë e juridiksionit të përgjithshëm për gjykatat jugosllave. Termi është përkthyer si “permanent residence” në versionet në gjuhën angleze që ende janë të disponueshme në internet.²⁶⁶ Megjithatë, studiuesit duket ta kenë vërejtur këtë “keqkuptim” dhe, kur shkruajnë në gjuhën angleze, i referohen këtij kriteri juridiksional si “vendbanim.”²⁶⁷ Shkalla e hutimit mund të përkeqësohet edhe më shumë për shkak të mungesës së përkufizimit të termit “vendbanim” apo të termit në gjuhët zyrtare. Kjo çështje, si atëherë si sot, iu është lënë ligjeve të tjera – vendore – gjë që, siç do të shihet më vonë, e pengon uniformitetin.²⁶⁸

Studiuesit serbë e kanë interpretuar termin “vendbanim” në nenin 46 të ADNË në përputhje me të drejtën e tyre vendor.²⁶⁹ Studiuesit shpjegojnë që:

“(…) përbëhet nga dy elemente standarde të nocionit të vendbanimit – elementi objektiv dhe subjektiv (corpus dhe animus). Përbërësi objektiv i vendbanimit është ndërtimi i shtëpisë në një vend të caktuar dhe përbërësi subjektiv është qëllimi i një personi për tu vendosur përgjithmonë

<https://www.osce.org/files/f/documents/9/1/42584.pdf>

²⁶⁴ Shih <https://balkaninsight.com/2015/02/10/belgrade-pristina-reach-deal-on-judiciary/>

²⁶⁵ Versionet e mëhershme të analizës që ndodhet në këtë kapitull janë publikuar si pjesë e tezës së Doktoratës së autorit në Donikë Qerimi, “Jurisdiction in International Disputes in Commercial Matters: A Comparison between the Brussels Ibis and the Western Balkans” (Gent University, 2019).

²⁶⁶ Ende nuk ka përkthim zyrtar të ligjit. Versioni i cituar këtu është i disponueshëm përmes uebfaqes së Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë, i disponueshëm në: http://arhiva.mpravde.gov.rs/images/Law%20on%20resolving%20conflict%20of%20law_180411.pdf. Në disa versione të disponueshme në internet, duke përfshirë rastet kur ligji është i bashkangjitur si Shtojcë e një raporti zyrtar të qeverisë malazeze, ekziston kjo formë e përkthimit. Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka një përkthim më të përmirësuar, me gjasë i ripërkthyer nga Misioni i Kombeve të Bashkuara që ka shërbyer si kanal komunikimi me shtetet e tjera dhe kompetencat, rastet e materialet e të cilit janë trashëguar më vonë nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës. Ky version i përmirësuar e përdor termin ‘vendqëndrim’ në mënyrë të veçantë. Po ashtu ofron përkthim më të mirë të shumë termave të tjera të analizuar në këtë Kapitull, që do të elaborohen këtu.

²⁶⁷ Shih p.sh. Maja Kostić, Maja Stanivuković, and Mirko Živković, “Montenegro,” in *Kluwe Encyclopedia of Private International Law*, 2013. Maja Stanivuković and Mirko Živković, “Serbia,” in *Kluwe Encyclopedia of Private International Law*, 2009; Kostić, Stanivuković, and Živković, “Montenegro.”

²⁶⁸ Nuk është e pazakonshme që përkthimi të shkaktojë probleme praktike. Raporti i Schlosser e përmend problemin e hasur nga Malta në interpretimin e vendqëndrimit. Kodi maltez i Organizimit, i shkruar në gjuhën italiane, përdor termin “domicilio” që do të thotë “vendbanim”. Megjithatë, disa raste janë përkthyer në gjuhën angleze si “vendqëndrim” dhe ka shkaktuar huti. Shih paragrafin 176 të Raportit.

²⁶⁹ Ligji i Republikës së Serbisë për Vendqëndrimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve.

në atë vend. Duke e interpretuar [nenin 3, paragrafin 2], mund të përfundohet se askush nuk mund ta ketë më shumë se një vendbanim në të njëjtën kohë. Po ashtu, nga neni 2 dhe 6 i këtij Ligji del se çdo person duhet ta ketë një vendbanim diku dhe që është e pamundur që një person të mos ketë vendbanim sepse vendbanimi i vjetër nuk mund të humbë derisa të gjendet i riu.²⁷⁰

Është po ashtu e mundur, sipas praktikës së gjykatave serbe, që një person të ketë vendbanim në dy vende në të njëjtën kohë. Në një rast që kishte përfshirë të paditur të shumtë, juridiksioni u sfidua për shkak të kundërshtimit të të paditurve se i padituri kryesor ishte me vendbanim në Bosnjë e Hercegovinë e jo në Serbi. Pas shqyrtimit të dëshmive të vendbanimit të ofruara nga Ministritë e Punëve të Brendshme të të dy shteteve, Gjykata e Apelit në Beograd konkludoi që i padituri kishte vendbanim në Serbi, pa e hedhur poshtë dëshminë që ai kishte vendbanim edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.²⁷¹ Dëshmitë e vendbanimit në të cilin gjykata e bazoi vendimin e saj ishin konfirmime të adresave nga Ministritë përkatëse të Punëve të Brendshme. Kështu, Gjykata konkludoi që kishte juridiksion jo vetëm mbi të paditurin, por edhe mbi të paditurit e tjerë, bazuar në të njëjtën dispozitë.

Gabime në zbatimin e kësaj dispozite kanë ndodhur në të kaluarën. Në vitin 1998, Gjykata e Lartë Tregtare në Beograd e përmirësoi gabimin e një gjykate të një instance më të ulët që kishte konkluduar se nuk e kishte juridiksionin për ta *zbatuar* një vendim të huaj sepse i padituri nuk ishte me vendbanim në Serbi. Gjykata shpjegoi që dy çështjet nuk kishin lidhje me njëra tjetrën dhe që dispozita që është dashur të zbatohet ishte nenin 101 i procedurës së përmbartimit, në vend të nenit 46 që merret me juridiksionin e një gjykate për ta gjykuar rastin në merita.²⁷²

Kur është fjala për personat juridikë, Ballkani Perëndimor në përgjithësi anon kah selia e personit juridik si bazë për juridiksion të përgjithshëm mbi ta. Edhe pse e përmend selinë si bazën për juridiksion të përgjithshëm, Ligji jugosllav i DNP e përdor termin “nacionalitet” apo “kombësi” në tërë ligjin. Kur është fjala për nacionalitetin e personave juridikë, në studimet dhe praktikën jugosllave gjithmonë ka pasur mungesë njëtrajtshmërie sa i përket terminologjisë dhe përdorimit të saj.²⁷³ Studiuesit vënë në pah që doktrina rajonale përdor termat “kombësi” “shtetësi” ose “përkatësi” për të njëjtat raste²⁷⁴. Madje, termi serb “pripadnost,” që mund të shihet edhe në studimet shqiptare si “përkatësia,”²⁷⁵ mund të përkthehet fjalë për fjalë si “belonging” në gjuhën angleze. Stanivuković ofron të vetmin shpjegim për përdorimin e termit kombësi në tërë ligjin jugosllav: “nacionaliteti i personave juridikë nuk ekziston si fakt i vërtetuar në mënyrë administrative, por përcaktohet nga gjykatat përmes pikave të tjera të lidhjes (vendi i themelimit, selia e personit juridik, vendi që përdor kriteret e kontrollit mbi personin juridik) [...]”²⁷⁶.

Përveç mungesës së përkufizimit për vendbanimin, Ligji jugosllav i DNP nuk ofron as përkufizim për “selinë” siç përmendet në nenin 46. Megjithatë, sa i përket statusit të personave juridikë, Ligji përdor termin “përkatësi” që, sipas nenit 17, do të “përcaktohet sipas së drejtës së shtetit në bazë të të cilit është themeluar”. Tutje vazhdon duke përcaktuar që “nëse një person juridik e ka selinë e vërtetë të biznesit në një shtet tjetër dhe jo aty ku është themeluar dhe sipas së drejtës së atij shteti tjetër ka përkatësinë e tij, do të konsiderohet person juridik i atij shteti”. Prandaj, ligji jugosllav i njehtë këto dy teori për përkatësinë e personave juridikë – teorinë e themelimit dhe atë të selisë së vërtetë. Megjithatë, kjo është kritikuar nga disa prej studiuesve më të njohur të rajonit:

“Interpretimet e ndryshme doktrinoe të Nenit 17 të Kodit të DNP tregojnë fuqishëm dështimin e legjislatorit për të dhënë një përkufizim të duhur të konceptit të nacionalitetit të një personi juridik. Gjykatat vendore do të duhet të

përcaktojnë shpesh përmbajtjen e së drejtës së huaj me qëllim për ta përcaktuar Shtetin të cilit i përket personi juridik. Po ashtu, disa pyetje mbesin pa përgjigje të drejtpërdrejtë. Për shembull, një kompani e themeluar në Serbi mund ta ndryshojë selinë përmes një rezolute të organit drejtues në aktet e saj nënligjore (statut). Nëse një kompani e ka transferuar administratën qendrore jashtë vendit, a do të konsiderohet ende si kompani vendore? Përgjigja është me siguri po, por gjykata do të duhej të konsultohet me të drejtën e selisë së vërtetë për të parë nëse kompania konsiderohet shtetase atje. Çfarë do të ndodhte, në anën tjetër, nëse një person juridik i themeluar jashtë vendit do ta transferonte selinë e tij të vërtetë në Serbi? A do të konsiderohet personi i tillë juridik që përket në Serbi sipas ligjit vendor? As Kodi i DNP në nenin 17, as ligjet e tjera nuk japin përgjigje të qartë për këtë pyetje.”²⁷⁷

Edhe pse autorët e pranojnë paqartësinë që krijon ligji lidhur me të drejtën që do të duhej të zbatohet gjatë zgjidhjes së pyetjes për personin juridik, as ligji e as studiuesit nuk kanë ofruar ndonjë shembull që gjyqësori ta vlerësojë se çfarë është “selia e vërtetë”. Cilat elemente duhet t’i marrë parasysh gjyqësori gjatë vlerësimit nëse një kompani e ka përdorur sistemin serb apo kosovar vetëm për regjistrimin apo themelimin zyrtar, mbase për qëllime tatimore, por *de facto* selia e tij është diku tjetër? Si duhet të vlerësojë gjykatësi nëse selia në Serbi apo në Kosovë është “e vërtetë” apo “fiktive” dhe pastaj ta dijë cilin ligj ta zbatojë për të? Kjo mbetet e paqartë, së paku në mesin e studiuesve deri më sot.

Një vendim i gjykatës serbe duket se sugjeron që fakti se një filial vendor është themeluar vetëm nga një person juridik i huaj, kombinuar me dëmin që ia kanë shkaktuar bashkë paditësit serb, i përmbush kushtet për juridiksion mbi atë kompani mëmë të huaj. Një kompani e huaj gjermane e kishte kundërshtuar juridiksionin mbi të si të paditur të përbashkët i dorës së dytë. Megjithatë, Gjykata e Lartë Tregtare konkludoi që gjykatat e instancave më të ulëta kishin pasur të drejtë kur kishin dhënë juridiksion mbi rastin pasi që filiali vendor ishte themeluar drejtpërdrejtë nga kompania gjermane dhe pasi që ata së bashku kishin vepruar në shkelje të detyrimeve kontraktore në shitjen e mallrave ndaj paditësit.²⁷⁸

Të njëjtat vështirësi që lindin nga mungesa e përkufizimit të vendbanimit në LDNP shihen edhe në Kosovë. Megjithatë, Kosova e ka bërë këtë vështirësi shumë më të lartë. Kjo për shkak se, versionin në gjuhën angleze i Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin titullohet Ligji për “banimin dhe vendosjen” apo “dwelling and emplacement”.²⁷⁹

Termet “vendbanim” dhe “vendqëndrim” janë tejet problematike kur shikohen fillimisht në një kontekst të tillë. Kërkimi i thjeshtë i termit “dwelling” jep rezultate si “oil dwelling” (shpim apo nxjerrje e naftës) apo fusha të ngjashme, por jo vendbanimi. Përdorimi më i përafërt i këtij termi është parë në Librin e Parë të Konfliktit të Ligjeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 1934 i cili shpjegon që “kur një person ka një shtëpi dhe vetëm një shtëpi, vendbanimi i tij i përhershëm do të jetë vendi ku ndodhet shtëpia e tij” dhe që “shtëpi është vendi i qëndrimit të një personi, që dallohet nga vendqëndrimet e tjera të atij personi përmes intimitetit të marrëdhënies mes personit dhe vendit”.²⁸⁰

Pak më e qartë bëhet kur përkufizimi i “vendbanimit” në nenin 2 të ligjit është “vendi në të cilin ndodhet banori për të jetuar atje përgjithmonë”. Ngjashëm, “vendqëndrimi” po ashtu përkufizohet qartë si “një vend në të cilin banori ndodhet përkohësisht për shkak të punës, arsimit, apo për arsye të tjera, por nuk ka qëllim të jetojë atje përherë”. Ligji vlen për shtetasit e Kosovës dhe të huajt sipas nenit 2.

277 Po aty, f. 240.

278 Vendimi i Gjykatës së Lartë Tregtare, P.Z. br. 4897/2004-1 i datës 15.7.2004.

279 Ligji nr. 02 /L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Viti III, Nr. 40, tetor 2008, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2589>.

280 Libri (i Parë) i Konfliktit të Ligjeve § 12 dhe §13 (1934) i cituar në Susan Frelich Appleton, “Leaving Home? Domicile, Family, and Gender,” *U.C. Davis Law Review*, 2014, 1954.

Megjithatë, ekziston një shpjegim për këtë përdorim ngatërrues të termave tejet problematikë, që buron në historinë e re të Kosovës. Ky Ligj është miratuar nga "Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes së Kosovës" të asaj kohe të monitoruara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2007. Në atë kohë, Kosova nuk e kishte shpallur ende pavarësinë, prandaj çdo element i shtetësisë, madje edhe aq i thjeshtë sa përmendja e "vendbanimit" duhet të shmangej. Siç ka shpjeguar një autor,

"(...) ka raste kur UNMIK-u i ka dekretuar ligjet e Kuvendit me disa ndryshime të kërkuara në mënyra që të shmangeshin të gjitha deklaratimet apo indikacionet që Kosova mund të jetë shtet i pavarur. Rregullorja e UNMIK-ut që e shpall ligjin për vendbanim dhe vendqëndrim e ndryshon, në tërë ligjin, fjalën "Kosova" me "Kosovo", fjalën "qytetar" me fjalët "banor", fjalët Ministria e Drejtësisë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës" me fjalët "institucionet e tjera qeveritare" dhe fjalët "forcat mbrojtëse" me fjalët "Trupat Mbrojtëse të Kosovës".²⁸¹

Një lehtësim mund të shihet në versionet shqipe dhe serbe të ligjit, ku janë mbajtur termet klasike "vendbanim" dhe "vendqëndrim". Kjo, së paku, e bën të qartë për gjykatësit vendorë por jo për juristët apo studiuesit e huaj të cilëve iu nevojitet.

Prandaj, në mungesë të një përkufizimi në LDNP, termi vendbanim duhet të kuptohet në përputhje me ligjin vendor të Kosovës, i cili do të ishte Ligji i lartpërmendur për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin.²⁸² Edhe pse Kosova ka një Ligj për të Huajt,²⁸³ ky ligj nuk e rregullon vendbanimin e të huajve. Ligji, ndër të tjera, rregullon çështje të tilla si lejet e qëndrimit, llojet e vizave dhe kushtet për këto çështje, si dhe statusin e personave pa shtetësi. Prandaj, vendbanimi i shtetasve të Kosovës si dhe i atyre të vendeve të tjera është i rregulluar në të, pasi që neni 2 i ligjit i përkufizon "qytetarët" si "shtetas të Kosovës ose të huaj". I njëjti nen përcakton vendbanimin si "vendi në të cilin qytetari ndodhet dhe synon të jetojë përgjithmonë aty". Përsëri, duhet të theksohet se ky interpretim buron nga versionet në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe të ligjit - jo nga versioni në gjuhën angleze.

Të njëjtat elemente duhet të përdoren kur vlerësohet nëse një person është me vendbanim jashtë vendit, p.sh. gjatë vlerësimit nëse juridiksioni mund të ushtrohet bazuar në vendbanimin e atij personi. Vendbanimi i huaj zakonisht dëshmohet nga vetë pala duke siguruar dokumentet e nevojshme. Ky, megjithatë, është supozim një supozim se personi është me të vërtetë i vendosur në atë vendbanim dhe mund të dëshmohet e kundërta.²⁸⁴

Siç u përmend më lart, është e mundur, dhe gjithashtu kjo gjë njihet nga gjykatat në rajon, që një person të mund të ketë vendbanim në dy shtete. Kjo ndodhë në rastet kur ligjet e të dy vendeve e konsiderojnë personin me vendbanim në shtetin e tyre përkatës.²⁸⁵ Ligji nuk adreson në mënyrë specifike zgjidhjen e një konflikti pozitiv lidhur me vendbanimin - d.m.th., cili fakt vendimtar do të zbatohet në raste të tilla. Kjo gjithashtu nuk është çështje e adresuar plotësisht në doktrinën rajonale. Sidoqoftë, ky është një më i faktor i rëndësishëm për përcaktimin e së drejtës kompetente, se sa për çështje juridiksioni.²⁸⁶ Nëse i padituri konsiderohet se ka vendbanim në një shtet të caktuar, ai shtet do ta konsiderojë veten kompetent për ta ushtruar juridiksionin.

Lajme shumë më të mira vijnë nga Draft Ligji i ri i DNP i Kosovës²⁸⁷, i cili i rregullon këto kriterë në një mënyrë më të sofistikuar. Zgjedhja e re e Kosovës për faktin vendimtar - e ngjashme me

Maqedoninë dhe Serbinë - tani është kombinim i vendbanimit dhe vendqëndrimit të zakonshëm. Duke pasur parasysh problemet e mësipërme me përkufizimin e tyre në ligjet e brendshme, është mirë të shihet se projektligji i ri tani ofron përkufizime për vendbanimin dhe vendqëndrimin e zakonshëm, për personat fizikë dhe juridikë veç e veç. Gjersa vendqëndrimi i zakonshëm përcaktohet si "qendra e përhershme e aktiviteteve të tij / saj jetësore,"²⁸⁸ vendbanimi është vendi "ku ai person është vendosur me synim për të jetuar atje përgjithmonë."²⁸⁹

5.1.1. Pluraliteti i palëve

Në rastet që përfshijnë të paditur të shumtë, ka gjasa që vendimi gjyqësor mund të rezultojë me palë të shumta përgjegjëse dhe kështu kërkohet zbatimi i vendimit kundër të gjithë atyre. Konventa e HCCH e vitit 2019 "për vendimet gjyqësore" kërkon që kriteret e përcaktuara në nenin 5 të vlerësohen individualisht për secilën palë – d.m.th., kërkohet vlerësimi i ndërlidhjes së secilit të paditur përgjegjës me shtetin e origjinës.²⁹⁰ Siç shpjegon Raporti, "vet fakti se vetëm njëri prej tyre ka, për shembull, vendqëndrim të zakonshëm në Shtetin e origjinës (neni 5 (1) (a)) nuk është i mjaftueshëm që të bashkëpaditurit e tjerë të konsiderohen si banorë të përhershëm në atë shtet. Në një rast të tillë, vendimi nuk do të jetë i pranueshëm për njohje dhe ekzekutim ndaj dy të bashkëpaditurve të tjerë nëse nuk plotësohet një kriter tjetër i Nenit 5."²⁹¹

Kjo mund të paraqesë shumë sfida në zbatimin e vendimeve nga rajoni në të ardhmen, pasi një nga elementët ku vendet e Ballkanit Perëndimor (dhe Rregullorja e Brukselit I *bis*) janë në harmoni është çështja e juridiksionit mbi shumë të paditur. Në këto raste, gjykatat e Ballkanit Perëndimor - ngjashëm me Rregulloren e Brukselit I *bis*, përdorin të paditurit me vendbanim në shtetin e tyre për ta ushtruar juridiksion mbi të paditurit e tjerë që nuk janë me vendbanim atje.

Neni 46 i Ligjit të DNP përcakton që gjykata e Kosovës ka juridiksion mbi rastin me disa të paditur pasi juridiksioni mund të ushtrohet mbi ta në bazë të juridiksionit të përgjithshëm të parashikuar në këtë nen. Në zbatimin e këtij neni të njëjtë, Gjykata e Lartë Tregtare Serbe kishte vendosur që kompania gjermane mëmë me të drejtë të konsiderohej si e paditur në një rast kur filiali i saj serb kishte shkelur detyrimet e saj kontraktore ndaj paditësit. Gjykata arriti në përfundimin se "ka juridiksion në këtë kontest si për të paditurin e parë ashtu edhe për atë të dytë, pasi që së bashku punuan dhe vepruan për t'i sjellë dëm paditësit, i cili rezultoi në bashkimin e të paditurve."²⁹²

I njëjti parim përcaktohet në nenin 80 të Ligjit shqiptar të DNP, nenin 16 të Draft Ligjit serb të DNP, në nenin 111 të Draft Ligjit të DNP të Kosovës, nenin 100 të Ligjit të DNP të Malit të Zi dhe në nenin 107 të Ligjit të ri të DNP të Maqedonisë së Veriut.

Natyrisht, meqenëse këto janë akte kombëtare të DNP-së, ato vlejnë për të gjithë të paditurit në mënyrë të barabartë; zbatueshmëria e tyre nuk është e kufizuar në vetëm disa të bashkëpaditur, gjë që është rasti i nenit 8 të Rregullores së Brukselit *bis*.

5.2 Prorogimi i juridiksionit (drejtpërdrejtë/tërthorazi, para ose pas fillimit të procedurës)

5.2.1. Prorogimi i juridiksionit përmes marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës kompetente

Ish-Ligji jugosllav i DNP – tani Ligji aktual i DNP në Kosovë – parasheh gjuhë të qartë lidhur me

281 Alexander Orakhelashvili, "The International Court's Advisory Opinion on the UDI in Respect of Kosovo: Washing Away the 'Foam on the Tide of Time,'" *Max Planck Yearbook of United Nations Law* 15 (2011).

282 Ligji Nr. 02 / L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Viti III, nr. 40, tetor 2008, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2589>.

283 Ligji Nr. 04 / L-219 për të Huajt, *Official Gazette of The Republic of Kosovo*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 35, Shtator 2013, në dispozicion: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>.

284 Aleksandar Jakšić. *Međunarodno privatno pravo, opšta teorija*. Beograd, 2017, f. 326.

285 Ulrich Magnus, Peter Mankowski, and Richard Fentiman, *Brussels I Regulation*. Sellier, 2007, pp. 669–70.

286 Në rastet e ligjit në fuqi, mund të ketë nevojë bi referohemi «shtresave» të parashikuara në nenin 11 ose 12, të hartuara për rastet me kombësi të dyfishtë. Në raste të tilla, si mjet i fundit, gjykatat mund të zbatojnë «lidhjen më të afërt»

287 Projektligji për herë të fundit është diskutuar në Parlament në nëntor 2020. Për shkak të rënies së Parlamentit dhe Qeverisë, Projektligji do të ridërgohet për miratim në vitin 2021.

çështjen e prorogimit të juridiksionit. Në nenin 49, Ligji rregullon si çështjen e marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës drejt gjykatave të një prej vendeve që e zbatojnë këtë ligj, ashtu edhe caktimin e juridiksionit drejt një gjykate të huaj. Paragrafi i parë parasheh që palët mund të pajtohen për juridiksionin e një gjykate të huaj me dy kushte: së pari, që njëra prej palëve të jetë “shtetas ose person juridik i huaj me seli jashtë vendit” dhe e dyta, që “kontesti në fjalë nuk është një kontest për të cilën gjykatat e [Kosovës kanë] juridiksion ekskluziv sipas dispozitave të këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër federal”. Paragrafi i dytë po ashtu parasheh një kufizim për përcaktimin e juridiksionit në favor të gjykatave të cilitdo prej këtyre vendeve: njëra prej palëve duhet të jetë person fizik ose juridik me seli në Kosovë.

Dispozita është mjaft e qartë në atë se gjykatat e Kosovës nuk janë të hapura për raste të shtesave të huaj dhe as nuk lejojnë që t’iu “merret” juridiksioni nëse të dy palët e marrëveshjes janë të shtetësisë së tyre. Pjesa e fundit e kushtit dallon thelbësisht nga neni modern 25 i Brukselit I *bis* që vlen për marrëveshjet mbi juridiksionin në favor të një gjykate të një Shteti Anëtar të BE-së, pa kufizime për vendbanimin e palëve. Pasi që neni 49 i Ligjit të DNP në Kosovë është ende në fuqi, palët nga Kosova ende mund të paditen me sukses në Kosovë, pavarësisht se kanë marrëveshje për zgjedhjen e gjykatës lidhur në favor të një gjykate të BE-së.

Përderisa gjykatat e Kosovës janë më pak të njoftuara me rastet që përfshijnë klauzolat e zgjedhjes së gjykatës (forumit),²⁹³ gjykatat serbe kanë pasur më shumë mundësi për ta zbatuar këtë dispozitë. Këto gjykata kanë qenë shumë strikte në zbatimin e rregullave të tyre procedurale, madje edhe në kurriz të një marrëveshjeje për juridiksionin e një gjykate të huaj. Gjykata Tregtare e Apelit refuzoi apelin e një të padituri në bazë të juridiksionit sepse kundërshtimi i tij me arsye që palët kanë pasur marrëveshje për juridiksion u paraqit në një fazë më të vonshme në procesin gjyqësor para Gjykatës Themelore Tregtare.²⁹⁴ Në një opinion tjetër ligjor që u dha nga Divizioni për Kontestet Tregtare i Gjykatës Supreme Tregtare në Serbi, gjykata vendosi që dy palë të huaja mund ta ngrinin një rast para Gjykatave serbe nëse kanë të drejtë për këtë mbi baza të tjera ligjore, p.sh. neni 54, paragrafi 2 në këtë rast, sepse nuk do të lejoheshin në bazë të nenit 49, paragrafi 2 të pajtoheshin për juridiksionin e këtyre gjykatave pasi që asnjëra prej tyre nuk e kanë selinë në Republikën e Serbisë.²⁹⁵ Interpretimi i njëjtë ka të ngjarë të përdoret nga gjykatat e Kosovës, nëse ballafaqohen me një rast të tillë.

Ligji i DNP, megjithatë, *nuk* e ka adresuar çështjen e vlefshmërisë së marrëveshjes në veçanti, e as nuk ka lënë hapësirë për mundësinë që të jetë e mundur një marrëveshje të pavlefshme për zgjedhjen e gjykatës. Një dispozitë e përgjithshme që e vlerëson vlefshmërinë e “një pune juridike ose të një veprimi juridik” sa i përket formës është paraparë në nenin 7. Sipas dispozitës, një punë juridike apo veprim juridik konsiderohet të jetë i vlefshëm qoftë sipas të drejtës së vendit ku është bërë aji punë ose ku është ndërmarrë veprimi ligjor, apo sipas të drejtës që është i kompetente për përmbajtjen e punës juridike apo veprimit ligjor. Do të dukej praktike të zbatohej kjo dispozitë edhe për vlefshmërinë e marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatave. Megjithatë, studiuesit në rajon nuk duket se pajtohen që kjo dispozitë adreson çështjen e vlefshmërisë së marrëveshjeve të prorogimit në veçanti. Ata argumentojnë se përkundër mungesës së kushteve formale në Ligjin e DNP, “duhet të interpretohet që (...) marrëveshja duhet të jetë me shkrim – *ad solemnitatem*.”²⁹⁶ Ky argument bazohet në një analogji me dispozitat e Arbitrazhit nga i njëjti Ligj i DNP dhe dispozitat e së drejtës (serbe) të Procedurës Kontestimore, që parasheh kushte të tilla formale. Ata po ashtu përcaktojnë që dëshmia e ekzistimit të një marrëveshjeje mund të bëhet me shkrim *ad probationem* apo me forma të tjera të shkruara. Megjithatë, ky kriter i fundit duhet të interpretohet në mënyrë “elastike” që t’i përfshijë këmbimet e letrave, telegrameve dhe

293 Gjatë një faze të hetimit të praktikës gjyqësore në Kosovë, të kryer nga autorja në vitin 2015, një rast u vu re para Gjykatës Themelore në Prishtinë për Çështje Tregtare, në të cilën palët e kishin zgjedhur juridiksionin e kësaj gjykate përmes një marrëveshjeje. Rasti Nr. 535/14, ku një kompani lokale si paditëse e ka paditur një kompani të huaj konsulence për kthim të borxhit, ishte ende i hapur përgjatë fazës së hulumtimit dhe megjithëse kishte një marrëveshje, asnjë argument tjetër në juridiksion nuk kishte ndodhur deri në atë kohë.

294 Vendimi i Gjykatës Tregtare të Apelit në Serbi (Privredni Apelacioni Sud), Pž. 10343/2011 i datës 18 janar 2012.

295 Opinioni Ligjor (Pravno švatanje) i dhënë nga Divizioni i Kontesteve Tregtare i Gjykatës së Lartë Tregtare, më 26 mars 2007, Praktika Ligjore e Gjykatave Tregtare, Buletini Nr. 1/2007.

296 Tibor Varadi, Bernadet Bordaš, and Gašo Knežević, *Međunarodno Privatno Pravo*, V (Novi Sad: Forum, 2001), p. 494.

formave të tjera të komunikimit.²⁹⁷ Autorët e tjerë, në anën tjetër, pohojnë që forma e shkruar e marrëveshjes për prorogim *nuk* është kusht për vlefshmërinë e saj formale.²⁹⁸ Megjithatë, një Aktvendim i Gjykatës Federale të Jugosllavisë në vitin 1997 jo vetëm që kishte kërkuar formë të shkruar të marrëveshjes por edhe kishte konstatuar që “marrëveshja ishte e vlefshme vetëm nëse vendoset nënshkrimi dhe nëse ka të bëjë me kontestin në fjalë ose konteste të tjera që rrjedhin nga marrëdhënia përkatëse juridike. Një marrëveshje mbi juridiksionin që nuk është e nënshkruar nga të dy palët e marrëveshjes nuk duhet të konsiderohet e vlefshme.”²⁹⁹ Nuk është e qartë se çfarë baze ligjore kanë përdorur gjykatësit për ta vlerësuar vlefshmërinë formale të marrëveshjes në atë kohë³⁰⁰ dhe kjo nuk është e qartë as tani.

Grupi i parë i autorëve ka parashtuar po ashtu çështjen e ndashmërisë së marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatës.³⁰¹ Ata po ashtu udhëzojnë që e drejta kompetente për çështjen e vlefshmërisë materiale është *lex fori prorogati* por nuk tregojnë bazën ligjore nga e cila rrjedh ky rregull.³⁰²

Ndonëse jo veçanërisht për çështjen e marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës kompetente në rastet me elemente të huaja, neni 66, paragrafi 3 i së Drejtës Kosovare të Procedurës Civile (E drejta e Procedurës Kontestimore) qartas kërkon që marrëveshja e zgjedhjes së gjykatës të jetë “me shkrim dhe e nënshkruar nga të dy palët”. As Ligji e as komentari³⁰³ nuk e shohin potencialin problematik të kushtit që marrëveshja të jetë “e nënshkruar nga të dy palët” në botën moderne. Në botën e sotme, kur shumica e marrëveshjeve arrihen pa praninë e palëve në të njëjtin vend, një kusht i tillë mund të rezultojë në pavlefshmëri të shumicës së marrëveshjeve. Mbetet vetëm të shpresohet që gjykatat e Kosovës do ta interpretojnë një kusht të tillë gjerësisht, që të përfshijë edhe forma të tjera të nënshkrimit, duke përfshirë ato elektronike ose të përfshijë edhe marrëveshjet që zakonisht nuk nënshkruhen por ku konsiderohet që është dhënë pëlqimi i palëve.³⁰⁴

Konkluzioni (rekomandimi) që një marrëveshje për juridiksionin sipas Ligjit aktual të DNP duhet të jetë me shkrim është gjithsesi konkluzion logjik, por edhe i guximshëm. Në mungesë të një kushti të tillë, nuk do të kishte shumë dallim midis saj dhe marrëveshjes së heshtur për juridiksion, ose paraqitjes apo pëlqimit vullnetar të të paditurit për juridiksion. Mungesa e specifikimeve të tilla në ligj mbase mund t’i atribuohet kohës kur është hartuar ligji. Përkundër logjikës, të thuhet me siguri se ekziston një kusht i qartë për një formë të caktuar të marrëveshjes, madje edhe një kusht aq bazik siç është forma me shkrim e nënshkruar nga të dy palët, megjithatë do të ishte një konkluzion me dozë guximi në të pasi që i njëjti ligj megjithatë *parasheh* kushte formale mbi rregullimin e marrëveshjeve të arbitrazhit.

5.2.1.1 Prorogimi i juridiksionit të paraparë në Projektligjin e ri të DNP në Kosovë

Ndryshimet thelbësore që sjell Drafti i ri i Ligjit të DNP në Kosovë mund të grupohen në tri pika kryesore; së pari, drafti nuk e kufizon zgjedhjen e gjykatave vendore apo të huaja me asnjë kusht të shtetësisë, vendbanimit apo të vendqëndrimit,³⁰⁵ së dyti, megjithëse konsideron që një

297 Varadi, Bordaš, and Knežević, p. 494.

298 Maja Stanivuković and Mirko Živković. *Međunarodno Privatno Pravo*. Belgrade, 2004, p. 193.

299 Stanivuković and Živković, p. 193. duke cituar aktvendimin e Gjykatës Federale nr. Gsn 5/97, 3 prill 1997.

300 Autorët nuk kanë dhënë shpjegim të mëtejshëm për rastin as nuk kanë dhënë më shumë informata rreth tij.

301 Tibor Varadi et al. *Međunarodno Privatno Pravo* XIII. Belgrade, 2010, pp. 508–9.

302 Po aty.

303 Iset Morina and Selim Nikci. *Komentar: Ligji Për Procedurën Kontestimore*. 1st Edition. Deutche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2012, p. 149.

304 Shih p.sh. interpretimet e GJKE-së të kushteve të formës në kuadër të Konventës së Brukselit (tani Bruksel Ibis) në MSG v Gravières Rhénanes, Case C-106/95 (1997).

305 Neni 123 “1.Për çështje me element ndërkombëtar për të cilat sipas të drejtës së Republikës së Kosovës palëve u lejohet të disponojnë me të drejtat e veta, palët mund të merren vesh për kompetencën e gjykatës të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e kontestit që ka lindur ose mund të lindë nga marrëdhënia konkrete juridike”; dhe neni 124, që e rregullon juridiksionin e gjykatave të huaja “1.Për marrëdhënie me element ndërkombëtar për të cilat, sipas të drejtës së Republikës së Kosovës, palëve u lejohet që të disponojnë lirshëm me të drejtat e tyre, palët mund të merren vesh për kompetencën e gjykatës, ose gjykatave të shtetit të huaj për zgjedhjen e kontestit që ka lindur ose mund të lindë nga marrëdhënia konkrete juridike”.

marrëveshje është ekskluzive përveç nëse janë marrë vesh ndryshe,³⁰⁶ e pranon po ashtu që mund të zgjidhet më shumë se një gjykatë me të njëjtin efekt,³⁰⁷ dhe së treti, përveç rregullimit të kushteve formale të marrëveshjeve,³⁰⁸ e rregullon vlefshmërinë materiale të marrëveshjeve në favor të një gjykate të Kosovës³⁰⁹ dhe atyre në favor të një gjykate të huaj në mënyrë të ndarë dhe, më e rëndësishmja, ndryshe nga njëra-tjetra.³¹⁰ Kjo e fundit – teknika e adresimit të këtyre dy llojeve të marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës në mënyra të ndryshme – është me të vërtetë një përpjekje mbresëlënëse që sigurisht se do të ketë ndikim pozitiv praktik.

Qartazi, vlefshmëria materiale e një marrëveshjeje për zgjedhjen e gjykatës drejt një gjykate të Kosovës do të vlerësohet sipas së drejtës së Kosovës. Në anën tjetër, vlefshmëria formale dhe materiale e një marrëveshjeje që zgjedh një gjykatë të huaj do të vlerësohet sipas të drejtës së forumit të zgjedhur. Megjithatë, kjo dispozitë po ashtu shton që lejueshmëria apo pranueshmëria e një marrëveshjeje të tillë që do të arrihet do të vlerësohet “edhe në përputhje me të drejtën (ligjin) e Serbisë”.³¹¹ Kjo pjesë e fundit lidhet drejtpërdrejtë me mënyrën në të cilën marrëveshjet mbi juridiksionin kushtëzohen me draftin e ri; ngjashëm me Draft Ligjin të DNP në Serbi, Ligjin e DNP në Mal të Zi, këto marrëveshje duhet të jenë marrëveshje “për marrëdhënie me element ndërkombëtar për të cilat, sipas të drejtës së Republikës së Kosovës, palëve u lejohej që të disponojnë lirshëm me të drejtat e tyre”. Kjo mund të bëjë që marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës t’iu nënshtrohen ligjeve të tjera në vend të Ligjit të DNP-së dhe mund ta zvogëlojë parashikueshmërinë për palët. Përveç kësaj, ligjvënësi kosovar shihet se ka synuar ta kufizojë njohjen e juridiksionit në përputhje me marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës për çështje të ndryshme nga ato që i lejon vetë ligji i tij duke futur një klauzolë në nenin 124 i cili parasheh që pranueshmëria e një marrëveshjeje të tillë do të vlerësohet edhe sipas të drejtës së Kosovës.

Sa i përket formës, Draft Ligji i DNP të Kosovës parasheh kushtet e zakonshme: marrëveshje me shkrim ose marrëveshje me gojë e evidentuar më pas në shkrim si dhe marrëveshje elektronike; apo në përputhje me praktikën e palëve ose me ato të tregtisë.³¹² Në fund, parasheh po ashtu drejtpërdrejt ndashmërinë e marrëveshjes mbi juridiksionin dhe të marrëveshjes si tërësi.³¹³

5.2.2. Pëlqimi i shprehur dhe i nënkuptuar

Një prej bazave për të lejuar zbatimin e një vendimi në një shtet kontraktues, sipas Konventës së HCCH të vitit 2019 për vendime gjyqësore, neni 5, paragrafi 1(e), është nëse “i padituri qartësisht ka dhënë pëlqim për juridiksionin e gjykatës së origjinës gjatë procedurave gjyqësore në të cilat është dhënë vendimi gjyqësor”. Për më tepër, një formë tjetër e pëlqimit, siç është dhënë në nenin 5, paragrafi 1(f), është nëse “i padituri argumentoi mbi meritat përpara gjykatës së origjinës pa e kontestuar juridiksionin brenda afatit të parashikuar në të drejtën e Shtetit të origjinës, përveç nëse është e qartë se një kundërshtim i juridiksionit ose veprimtarisë së juridiksionit nuk do të kishte pasur sukses sipas asaj të drejte.”

Sa i përket pëlqimit të shprehur, të rregulluar me pikën (e), nuk ka formë të përcaktuar: mund të jepet me gojë ose me shkrim, por “kërkon një veprim pozitiv (me gojë ose me shkrim), përndryshe nga pamundësia për të ngritur një shqetësim, për shembull, ose thjesht tërheqja e një sfide për juridiksionin e gjykatës së origjinës.”³¹⁴ Në lidhje me pëlqimin e nënkuptuar, sipas pikës (f),

306 Neni 123 “2. *Kompetenca e gjykatës së huaj sipas paragrafit 1 të këtij neni është ekskluzive, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.*”

307 Shih më sipër, para. 2 “përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe” ose, në nenin 124, paragrafi 1 “gjykatës apo gjykatave.”

308 Neni 125.

309 Neni 123 para. 3 “Për plotfuqishmërinë materiale e marrëveshjes për kompetencën e gjykatës së Republikës së Kosovës kompetente është e drejta e Republikës së Kosovës”.

310 Neni 124 para. 4 “Për plotfuqishmërinë materiale dhe formale të marrëveshjes për kompetencë të gjykatës së huaj, kompetente është e drejta e shtetit të gjykatës së zgjedhur, ndërsa për lejueshmërinë e marrëveshjes kompetente është e drejta e Republikës së Kosovës.

311 Po aty.

312 Neni 123.

313 Neni 123 “3. *Marrëveshja për zgjedhjen e gjykatës kompetente e cila është pjesë e kontratës konkrete konsiderohet si e pavarur në raport me dispozitat e tjera të kontratës. 4. Plotfuqishmëria e marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatës kompetente nuk mund të kontestohet, vetëm mbi bazën e paplotfuqishmërisë së kontratës.*”

314 Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier. “Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention).” para. 162.

konsiderohet të jetë lloji i pëlqimit “që zakonisht rrjedh kur i padituri argumenton mbi meritat dhe nuk arrin ta kontestojë juridiksionin e gjykatës së origjinës”.³¹⁵

Akti i DNP të Kosovës e trajton këtë çështje pak më ndryshe – me një dispozitë të vetme – por me një efekt tejet të ngjashëm. Nuk e adreson çështjen e pëlqimit të shprehur për juridiksionin, përveç përmes një marrëveshjeje për zgjedhjen e gjykatës. Neni 50 i Ligjit të DNP konsideron “që i padituri e ka dhënë pëlqimin e tij/saj duke paraqitur formalisht një përgjigje për veprimin ose kundërshtimin e një urdhër-pagese pa e kontestuar juridiksionin ose nëse ai/ajo është përfshirë në proces gjyqësor”. “Paraqitja formale e një përgjigjeje” duhet të kuptohet jo vetëm si paraqitje e një kundërpadië por edhe çdo përgjigje tjetër ku nuk e shpreh sfidimin e tij të juridiksionit.

Në zbatimin e së njëjtës dispozitë në Ligjin (aktual) të DNP të Serbisë, praktika e gjykatave serbe dëshmon për një zbatim më të rreptë të kësaj dispozite. Gjykata Tregtare e Apelit refuzoi apelin e një të padituri bazuar në një marrëveshje ekzistuese për zgjedhjen e gjykatës në favor të gjykatave austriake pasi që i padituri e kishte pranuar bindshëm juridiksionin e gjykatës serbe. Duke iu referuar nenit 50, gjykata theksoi që “ligji e rregullon me kohë periudhën brenda së cilës mund të sfidohet juridiksioni”, duke sugjeruar që ky kundërshtim është dashur të jetë ngritur në fillim të procedurës.³¹⁶ Parimi i njëjtë është konfirmuar nga Gjykata e Lartë Tregtare, duke e konfirmuar vendimin e gjykatës së një instance më të ulët, duke cekur që “veprimi i parë që [i padituri] e kishte marrë në këtë proces gjyqësor ishte në kundërshtim me juridiksionin e gjykatës, duke kërkuar zbatimin e ligjit slloven dhe procedurave gjyqësore në K. dhe kërkoj sheshazi të mos pranohej juridiksioni i kësaj gjykate”.³¹⁷

Interpretimi i njëjtë pritet nga gjykatat e Kosovës: në një vendim të ngjashëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykata refuzoi kërkesën e një të padituri për shkak të mungesës së juridiksionit mbi të, duke theksuar që kërkesa është dashur të bëhet më herët në proces, megjithëse pa përcaktuar se kur saktësisht.³¹⁸ Një e metë e madhe që është gjetur në Ligjin e Procedurës Civile të Kosovës (Ligji i Procedurës Kontestimore) është që nuk e specifikon momentin e saktë deri kur një i paditur mund ta kundërshtojë juridiksionin e gjykatës. Neni 18 para. 3 parasheh që gjykata nuk ka nevojë ta hedhë poshtë rastin nëse “juridiksioni i gjykatës varet nga miratimi i të paditurit dhe i padituri tashmë e ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj”, por momenti i “dhënies së pëlqimit” nuk specifikohet. Komentimi i Ligjit, nga ana tjetër, e sheh pëlqimin brenda kësaj dispozite duke u bazuar në një marrëveshjeje ndërmjet palëve si një marrëveshje prorogimi.³¹⁹ Disa udhëzime mund të gjenden në nenin 20, paragrafi 2 të këtij Ligji, i cili kërkon që i padituri ta kundërshtojë mungesën e juridiksionit të gjykatës *për shkak të ekzistimit të një marrëveshjeje arbitrazhi*, deri në momentin kur i është “përgjigjur padisë.”³²⁰ Megjithatë, kjo paqartësi mbetet edhe në rastet që nuk kanë lidhje me arbitrazhin.

Dispozitat e Draft Ligjit të ri të DNP të Kosovës i rregullojnë këto çështje në mënyrë shumë të qartë dhe është mjaft e ngjashme me dispozitat e Konventës së HCCH të vitit 2019 për vendimet gjyqësore të cituara në këtë kapitull. Neni 126 i Draftit të Kosovës parasheh që i padituri konsiderohet të jetë pajtuar bindshëm me juridiksionin nëse: ka paraqitur përgjigje me shkrim ndaj padisë ose ka paraqitur kundërshtim për urdhër pagesën, pa e kontestuar juridiksionin; ose i ka pranuar meritat në seancën përgatitore, ose nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore, në seancën e parë për meritat, pa e kontestuar juridiksionin; apo nëse ka ngritur kundërpadi. Paragrafët e dytë të këtyre dispozitave po ashtu parashohin detyrimin e gjykatës për t’i informuar

315 Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier, para. 165.

316 Vendimi i Gjykatës Tregtare të Apelit në Serbi (Privredni Apelacioni Sud), Pž. 10343/2011 i datës 18 janar 2012.

317 Vendimi i Gjykatës së Lartë Serbe (Viši trgovinski Sud) Pž. 8989/2009 i datës 18 nëntor 2009.

318 Departamenti i Çështjeve Tregtare, Rasti 55/13. Gjykata e hedh poshtë argumentin e të paditurit mbi juridiksionin për shkak të mungesës së bazës ligjore të palës. Gjykata vuri në dukje se kjo çështje duhej të ishte ngritur më herët në proces. Megjithatë, nuk e përcaktonte bazën ligjore të atij konkluzioni.

319 Morina and Nikci. *Komentar: Ligji Për Procedurën Kontestimore*, p. 60.

320 Theksimi i shtuar nga autorja, neni 20 (versioni origjinal në gjuhën angleze) “1. Nëse palët ndërgjyqëse kanë kontraktuar një arbitrazh për ta zgjidhur mosmarrëveshjen, gjykata së cilës i është paraqitur kërkesa që përfshin të njëjtat palë në kontest, bazuar në kundërshtimin e të paditurit do të shpallet jo kompetente, të gjitha procedurat do të anulohen dhe padia do të hidhet poshtë. Gjykata nuk do të veprojë në këtë mënyrë nëse përcakton që kontrata për arbitrazhin nuk është e vlefshme, vlefshmëria e kontratës ka përfunduar ose nuk mund të zbatohet. 2. Kundërshtimi nga pjesa 1 e këtij neni, i padituri mund ta paraqesë duke iu përgjigjur kësaj padie”.

të paditurit që konsiderohen të jenë palë më të dobëta – konsumatorët, punonjësit apo një person i siguruar, në mënyrë identike si në nenin 26, paragrafi 2 të Rregulloren e Brukselit I *bis*.

5.3 Pajtueshmëria e kritereve të tjera të juridiksionit në Konventë me Ligjin e DNP të Kosovës

5.3.1. Juridiksioni i bazuar në aktivitetet e degës, agjencisë ose një institucioni tjetër

Konventa e Vendimeve gjyqësore, neni 5, paragrafi 1(d) parasheh bazat për njohje nëse “i padituri e ka mbajtur një degë, agjenci apo ndonjë institucion pa karakteristika të posaçme ligjore në Shtetin e origjinës në kohën kur personi është bërë palë në procesin gjyqësor në gjykatën e origjinës dhe padia në të cilën bazohet vendimi gjyqësor është ngritur si rrjedhojë e aktiviteteve të asaj dege, agjencie apo institucioni”. Këto kushte nuk janë përcaktuar dhe Raporti Shpjegues vë në pah që “një institucion nënkupton karakteristika fizike të qëndrueshme të të paditurit në Shtetin e origjinës ku i padituri ushtron një veprimtari”.³²¹

Nuk ka dispozitë ekuivalente me këtë bazë të juridiksionit në Ligjin aktual të DNP në Kosovë. Ka dispozita që parashohin juridiksion të veçantë brenda këtij Ligji por ato nuk kushtëzohen me detyrimet kontraktore dhe jokontraktore në fjalë dhe me vendin e kontratës dhe realizimit të tyre. Prandaj, ato nuk janë të orientuara drejt të paditurit por drejt detyrimit – qoftë ai kontraktor apo jokontraktor. Këto baza do të analizohen në kapitullin në vijim.

Megjithatë, në vendet e Ballkanit Perëndimor janë paraqitur disa dispozita të ngjashme me ato të Rregullores së Brukselit I *bis*. Kjo është parë për herë të parë në Ligjin e DNP të Shqipërisë, neni 80, në Ligjin malazez, në nenin 102 dhe në reforma më të fundit të DNP në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Kosovë. Draft Ligji i ri i DNP në Kosovë neni 150 përmban dispozita që janë pothuajse kopje fjalë për fjalë nga Rregullorja e Brukselit I *bis* neni 7, paragrafi 5.

Një dallim i rëndësishëm mes kësaj dispozite të Ligjit të ardhshëm të DNP në Kosovë dhe Konventës së Vendimeve Gjyqësore neni 5, paragrafi 1(d) është që “institucioni” nuk kufizohet me “institucione pa karakteristika ligjore.” Kjo përjashton filialet dhe çdo pjesë tjetër të një organizate tregtare që përbëhet si subjekt i veçantë juridik.³²² Kjo është mjaft ndryshe nga neni 7, paragrafi 5 i Rregullores së Brukselit I *bis*, që është interpretuar nga GJDBE-së që i përfshin edhe filialet.³²³

Termi “institucion” ishte në fokus të GJDBE-së rishtazi,³²⁴ edhe pse në kontekstin e një rregulloreje tjetër. Gjykatës i është dashur të vendosë se a është “institucion” në BE një filiale e veçantë e një kompanie mëmë jashtë BE-së, në Rregulloren për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.³²⁵ Avokati i Përgjithshëm në atë rast u mbështet fuqishëm në përkufizimin e termit “institucion” në Rregulloren e Brukselit I *bis* në nenin 7, paragrafi 5 dhe thelbësisht vuri në dukje udhëzimin e katër rasteve kryesore që formojnë kuptimin e termit institucion në nenin 7, paragrafi 5. Së pari, në *De Bloos*, Gjykata vendosi që “një prej karakteristikave themelore të koncepteve të degës apo agjencisë është fakti i të qenit nën drejtimin dhe kontrollin e organit mëmë”.³²⁶ Së dyti, AG rikujtoi gjuhën e vendimit të Gjykatës në *Somafer*, për ta theksuar rëndësinë e «lidhjes së veçantë» që kanë veprimet e një institucioni të tillë me forumin dhe rëndësinë e “dukjes së përhershme”.³²⁷ Së treti, në *Blanckaert*, Gjykata nënvizoi që institucioni “duhet të duket para

palëve të treta si një organ lehtë i dallueshëm i organit mëmë”.³²⁸

Prandaj, gjatë vlerësimit të zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore të tjera të Kosovës mbi një bazë të tillë juridiksioni, gjykatat pranuese duhet ta marrin parasysh kuptimin e gjerë të kësaj dispozite të ardhshme.

Ndërkaq neni 150 i Draft Ligjit të DNP të Kosovës, ashtu si neni 7, paragrafi 5 i Rregullores së Brukselit I *bis*, i mbulon “kontestet që lindin nga veprimtaria” e një institucioni, duhet të bëhet kujdes në rast të ngjashmërive mes tij dhe një dispozite tjetër. Domethënë, neni 130, ngjashëm me nenin 24, paragrafi 2 i Rregullores së Brukselit I *bis*, që i mbulon kontestet lidhur me “vlefshmërinë e përbërjes, nulitetit apo shpërbërjes së kompanive (...), apo vlefshmërinë e vendimeve të organeve të tyre”. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet llojeve të kontesteve të mbuluara nga dy dispozitat kur është fjala për “veprimtarinë” e një personi juridik dhe “vlefshmërinë e vendimit” të organeve të tyre. Në rastet që bëjnë pjesë në nenin 24, paragrafi 2, juridiksioni ekskluziv ka të bëjë me gjykatat ku e ka selinë një institucion i tillë, i cili përcaktohet nga rregullat e DNP të gjykatës në lidhje me çështjen. Kjo rregull nuk duhet të interpretohet gjerësisht.³²⁹

5.3.2. Juridiksioni i bazuar në vendin e realizimit të një detyrimi kontraktor

Neni 5 para. 1(g) i Konventës së Vendimeve Gjyqësore lejon njohjen e vendimeve gjyqësore që janë dhënë nga gjykatat e vendit ku është realizuar një detyrim kontraktor. Kjo dispozitë, që pasqyron rregullat tipike të veçanta të juridiksionit,³³⁰ kërkon që vendimi gjyqësor “i dhënë për një detyrim kontraktor” duhet të jepet nga gjykata e Shtetit “në të cilën është përmbushur ai detyrim”. Ky vend i caktuar duhet të përcaktohet qoftë me marrëveshje të palëve ose me të drejtën kompetente për kontratën në mungesë të marrëveshjeve të tillë. E tërë kjo kushtëzohet – “përveç nëse është e qartë që aktivitetet e të të paditurit në lidhje me transaksionin nuk përbënin një lidhje të qëllimshme dhe të qëndrueshme me atë Shtet”.

Kjo bazë e veçantë e juridiksionit është mjaft e veçantë në Ligjin e DNP të Kosovës. Përpjekja për t’i identifikuar dispozitat për juridiksionin e veçantë për çfarëdo çështjeje komerciale ose kontraktore brenda këtij ligji nuk është shumë e drejtpërdrejtë. Një përpjekje e tillë kërkon një analizë të kombinuar të nenit 54 dhe 55 të Ligjit. Si pikënisje në vlerësimin e kritereve të juridiksionit të veçantë, duhet shikuar neni 54, që përmban dy dispozita kyçe: dispozita e parë përdor pasurinë si fakt vendimtar, ndërsa dispozita e dytë flet për detyrimet dhe përdor fakte vendimtare që kanë të bëjnë me detyrimet e palëve. Ngjashëm me disa dispozita të tjera,³³¹ kjo dispozitë është përkthyer ndryshe në versione të ndryshme të ligjit, që e bën edhe më të vështirë “studimin” e juridiksionit të veçantë për çështje komerciale. Në disa versione³³² dispozita është përkthyer si padi “*mbi kërkesat pronësore-juridike*” i cili është një përkthim i ngushtë i termit origjinal serb “imovinskopravnim zahtevima.” Në versionet e tjera, studiuesit³³³ dhe praktika e ka interpretuar si “kërkesa pasurore”—mendim që e mban edhe kjo autore.

Si pikënisje, pjesa e parë e nenit parasheh që “në kontestet për kërkesa pasurore, gjykata e Republikës Federale të Jugosllavisë ka juridiksion nëse pasuria ose sendi i pretenduar i të paditurit ndodhet në territorin e Republikës Federale të Jugosllavisë”. Padyshim, kjo dispozitë ngrit pyetjen e asaj që përfshihet në “pasuri” me këtë dispozitë. Sigurisht, kjo ngrit shqetësimin

Ferngas AG, Case 33/78 (1978).

328 Hummel Holding A/S v Nike Inc., Nike Retail BV, Case C-617/15.

329 Adrian Briggs, *Civil Jurisdiction and Judgments*, Sixth (Informa Law, 2015). Berliner Verkehrsbetriebe (BVG), v JPMorgan Chase Bank NA, Frankfurt Branch, Case C-144/10 (2011). Nicole Hassett v South Eastern Health Board and Cheryl Doherty v North Western Health Board, Case C-372/07 (2008).

330 Një lloj juridiksioni “i bazuar në ekzistimin e një faktori të veçantë lidhës mes marrëveshjes dhe gjykatave përveç atyre të Shtetit të vendqëndrimit të të paditurit”, Andrew Owusu v N.B. Jackson, trading as ‘Villa Holidays Bal-Inn Villas’, Mammee Bay Resorts Ltd, Mammee Bay Club Ltd, The Enchanted Garden Resorts & Spa Ltd, Consulting Services Ltd, Town & Country Resorts Ltd, Case C-281/02 (2005).

331 Shih Kapitullin 5.1. më sipër, që shpjegon dallimet në përkthimin e “vendqëndrimit” nëpër versionet e ligjit të secilit vend.

332 Shih p.sh., versionin e disponueshëm në uebfaqen e Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë: http://arhiva.mpravde.gov.rs/images/Law%20on%20resolving%20conflict%20of%20law_180411.pdf

333 Të gjithë autorët e cituar në këtë pjesë.

se a mund të shihet kjo dispozitë si dispozitë e ngjashme me atë që ndodhet³³⁴ në Kodin e Procedurës Civile të Gjermanisë, në nenin 23³³⁵ i cili parasheh juridiksion mbi të paditurit e huaj përderisa pasuria e tyre ndodhen brenda territorit të Gjermanisë.³³⁶ Ky nen, duke mishëruar parimin *forum patrimonii*, u shtua për të lejuar padi kundër të huajve dhe u pa si tejte i tepruar.³³⁷

Supozohet se dispozita jugosllave ishte e frymëzuar nga dispozita gjermane e cekur pasi që përmbajtja e tyre është identike.³³⁸ Një prej aspekteve më të rëndësishme që duhet të shqyrtohen është çfarë lloji i pronës apo pasurisë duhet të shërbejë si fakt vendimtar, duke qenë një paqartësi normative që gjithsesi kërkon sqarim. Prof. Stanivuković dhe Živković sugjerojnë që neni 54 iu jep juridiksion gjykatave serbe “në kontestet lidhur me pretendimet pasurore, nëse pasuria e prekshme apo e paprekshme e të paditurit ndodhet në territorin e Serbisë”.³³⁹ Njëjtë pajtohen edhe Varadi, Bordaš dhe Knežević, të cilët shpjegojnë që vlera e pasurisë, krahasuar me atë të kontestit, nuk është e rëndësishme dhe edhe pasuria që është në disproporcion me vlerën e kontestit mund të përdoret për këto qëllime.³⁴⁰ Padyshim, e njëjta supozohet të vlejë për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën, autorët e të cilëve nuk kanë dhënë interpretime të tjera. Në zbatimin e kësaj dispozite, Gjykata e Lartë Tregtare e Serbisë ka ritheksuar që Gjykatat nuk do të ushtrojnë juridiksion mbi një kompani të huaj kur një i paditur i tillë nuk ka pasuri në shtet dhe palët nuk kanë përcaktuar me kontratë juridiksion për të.³⁴¹

Përgjigja për këtë pyetje mund të nxirret nga një Opinion Ligjor i Divizionit të Kontesteve Tregtare të Gjykatës Supreme Tregtare të Serbisë, në të cilin ka dhënë një interpretim mjaft të gjerë lidhur me atë se çfarë pasurie përfshihet në kuptimin e këtij neni. Duke vlerësuar se a mund të kenë juridiksion gjykatat vendore në një rast mes dy subjekteve të huaja ligjore në një çështje të cenimit të markës tregtare, Gjykata vendosi që juridiksioni mund të vendoset në përputhje me nenin 54 sepse malli, shkatërrimi i të cilit ishte në fjalë, ndodhej në Serbi dhe, më e rëndësishmja, që “pretendimet për shkatërrimin e mallit përmes të cilit është dëmtuar dhe për të dëshmuar këtë dëm, respektivisht për ta parandaluar këtë dëm, mund të konsiderohen të jenë pretendime mbi pasurinë në kuptim të gjerë të fjalës.”³⁴² Me fjalë të tjera, termi “pasuri” sipas kuptimit të nenit 54 nuk përdoret vetëm për ta përcaktuar pronën e paluajtshme, por edhe pasurinë e luajtshme, siç janë mallrat apo produktet e shitura mes palëve.³⁴³

Një dispozitë po aq interesante për qëllimet e juridiksionin e veçantë në çështje komerciale është fjalia e dytë e nenit 54, që po ashtu iu jep gjykatave kosovare juridiksion “në kontestet lidhur me detyrimet e *krijuara* në kohën kur i padituri ka qenë i pranishëm në Kosovë” respektivisht. Ashtu si shumë dispozita të tjera në këtë Ligj, kjo dispozitë nuk është diskutuar plotësisht në praktikë ose në shkrimet e studiuesve të rajonit.³⁴⁴ Praktika e saj në gjykata duket të ketë qenë po ashtu mjaft e qartë. Në rastin e një qytetari të Bosnjës dhe Hercegovinës që kishte lidhur kontratë në Serbi, Gjykata e Lartë në Suboticë kishte vendosur që gjykatat e instancave më të ulëta kishin

të drejtë në ushtrimin e juridiksionit bazuar në nenin 54, fjalia e dytë, edhe pse i padituri ishte shpërngulur në Bosnjë.³⁴⁵

Nuk është e qartë se a është “i padituri” në sferën e kësaj dispozitë vetëm person fizik apo edhe juridik. Gjatë adresimit të kësaj çështjeje, një autor konsideron që kjo pjesë e dispozitës vlen vetëm për personat fizikë.³⁴⁶ Duke supozuar që kjo është e saktë, pyetja tjetër që duhet të përgjigjet është se çfarë do të ndodhte në situatat ku personat e huaj juridikë, për shembull, kanë vepruar në njërin prej këtyre vendeve për një periudhë të shkurtë kohore (p.sh., ditë) dhe i kanë krijuar detyrimet e çdo lloji aty? Më e rëndësishmja, cili do të ishte arsyetimi pas lejimit të personave fizikë për t’iu përgjigjur gjykatave kosovare por për ta refuzuar një bazë të tillë juridiksionale për personat juridikë?³⁴⁷ Dispozita e përdor vetëm “prezencën” në shtet si fakt vendimtar – një faktor që mund të supozohet si nga personat fizikë si nga ata juridikë. Prandaj, opinioni i paraqitur këtu është që dispozita duhet të vlejë njëjtë për personat juridikë dhe fizikë.

As neni tjetër që përcakton juridiksion të veçantë për çështjet kontraktore, neni 55, nuk është pa të meta. Në vend se të parashohë një situatë tjetër, p.sh. duke paraparë vetëm vendin e përmbushjes së detyrimeve si fakt vendimtar, kjo dispozitë parasheh të dy këta faktorë, duke e komplikuar çështjen edhe më shumë. Shkurtimisht, neni iu jep juridiksion gjykatave kosovare për të vendosur për kontestet lidhur me detyrimet e krijuara ose që janë përmbushur në këto shtete kundër një të padituri të huaj, nëse një person i tillë ka një agjenci apo përfaqësues në shtet.³⁴⁸ Paqartësitë mbi këtë dispozitë rrjedh nga paqartësia për llojin e juridiksionit që e rregullon ky nen. Pjesa e parë e nenit përcakton një qëllim për ta rregulluar juridiksionin e veçantë – lloji i juridiksionit epiqendra e të cilit është natyra e kontestit ose lidhja apo faktet e rastit³⁴⁹ – ndërsa pjesa e dytë përdor një fakt vendimtar që zakonisht i atribuohet juridiksionit të përgjithshëm, pra, lokacionit të agjencisë ose përfaqësuesit të personit.

Ky dallim nuk është vetëm teorik pasi që përgjigja e tij jep rezultatin për tërë “ekuacionin” e juridiksionit të veçantë në çështje komerciale në këto vende. Nëse neni 55 e përcakton juridiksionin e përgjithshëm, atëherë nuk i kufizon autorizimet e nenit 54 për gjykatat për të gjykuar kontestet kur pasuria ose detyrimet janë të lidhura, pavarësisht nga selia e të paditurit. Ose, nëse neni 55 e rregullon juridiksionin e veçantë në çështje kontraktore, atëherë është dispozita që i kufizon autorizimet e nenit 54 për gjykatat në rastet kur i padituri është një person i huaj.

Situata do të kishte qenë më e qartë sikur neni 55 ta kishte përfshirë fjalën “vetëm” ose “po ashtu”. Konkretisht, sikur të kishte paraparë dispozita që “gjykata e Republikës Federale e Jugosllavisë kanë juridiksion *vetëm* nëse ai person e ka zyrën apo agjencinë përfaqësuese” atëherë drejtpërdrejtë do të nënkuptonte që qëllimi i saj është t’i kufizojë autorizimet e dhëna në nenin 54, fjalia e dytë. Në të kundërtën, po të kishte paraparë dispozita që “gjykata e Republikës Federale e Jugosllavisë ka *po ashtu* juridiksion nëse ai person e ka zyrën apo agjencinë përfaqësuese”, atëherë do të interpretohej sikur i zgjeron autorizimet në nenin 54, fjalia e dytë. Opsioni i fundit do të ishte, vërtetë, më i ngjashëm me qasjen e Rregullores së Brukselit I *bis* dhe me qasjen e Konventës së HCCH të vitit 2019 “për vendimet gjyqësore”.

Pikëpamja e mbështetur këtu është që neni 55 duhet të interpretohet si *vazhdim* i nenit 54, që nënkupton se e rregullojnë të njëjtin lloj të juridiksionit. Në nenin 54, ligjvënësi ka pasur për qëllim ta përshkruajë legjislacionin përgjithësisht mbi vendin e krijimit ose realizimit të detyrimit,

334 Versioni aktual tregon që dispozita është shfuqizuar: https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/englisch_bgb.html#p0058 por ende referohet si ekzistuese, p.sh. te Varadi, Bordaš, and Knežević, *Međunarodno Privatno Pravo*.

335 Kjo bazë juridiksionale është analizuar në detaje në kapitullin vijues, juridiksioni i orientuar drejt pasurisë.

336 Ralf Michaels, “Jurisdiction, Foundations.” *Elgar Encyclopedia of Private International Law*, n.d.

337 Peter Hay, “Notes on the European Union’s Brussels-I ‘Recast’ Regulation.” *The European Legal Forum Forum Iuris Communis Europae* 13, no. 1, 2013, pp. 1–36.

338 Michaels, “Jurisdiction, Foundations.”

339 Toni Deskoski, “The New Macedonian Private International Law Act of 2007,” *Yearbook of Private International Law* 10 (2008), pp. 441–58, 231.

340 Stanivuković and Živković, “Serbia,” 2009.

341 Vendimi i Gjykatës Supreme Tregtare (Viši Privredni Sud) Nr. P.Ž. 415/97 i datës 5 mars 1997, Buletini Nr. 2/1998: 18.

342 Opinioni Ligjor (Pravno švatanje) i dhënë nga Divizioni i Mosmarrëveshjeve Tregtare i Gjykatës së Lartë Tregtare, më 26 mars 2007, Praktika Ligjore e Gjykatave Tregtare, Buletini Nr. 1/2007.

343 Ky interpretim i termit “pasuri” në sferën e nenit 54 është në përputhje me termin pasuri në kuadër të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky term është përdorur në qindra vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut praktika ligjore e së cilës vazhdimisht është pajtuar që termi “pasuri” duhet të përfshijë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, asetet e prekshme dhe të paprekshme, madje edhe pretendimet që kanë prirje legjitime për t’u bërë prona; Shih p.sh., rastin më të fundit kundër Serbisë lidhur me shkëlqen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, Rasti i Koka Hybro Komerc Doo Broyler kundër Serbisë (Aplikacioni nr. 59341/09), vendimi i datës 14 mars 2017.

344 Shkurtimisht, Hrvoje Sikirić shkruan që „vendi i realizimit” të detyrimit në fjalë, për qëllimet e kësaj rregulle, duhet të rregullohet me *lex causae* të përcaktuar me këtë Ligj të DNP. Sidoqoftë, duhet të theksohet se kjo dispozitë nuk flet për juridiksionin bazuar në vendin e realizimit, por përkundrazi për atë ku është krijuar detyrimi; Shih Varadi, Bordaš, and Knežević, *Međunarodno Privatno Pravo*. Pyetjet e paraqitura këtu nuk u përgjigjën as në Artikullin më të hollësishëm të shkruar për këtë çështje nga Profesori Milena Petrović, “Posebna Međunarodna Nadležnost Za Sporove Iz Ugovornih Odnosa Prema Pravu EU i Pravu Republike Srbije,” *Anal of the Faculty of Law of University of Belgrade*, no. 1, 2014, pp. 41–61.

ndërsa në nenin. 55 e ka kufizuar këtë autoritet për rastet ku i padituri është një person i huaj. Kjo mund të nxirret edhe nga një vendim tjetër i Gjykatës Tregtare të Apelit në Serbi, në të cilin Gjykata përsëriti se nëse nuk kishte prova se një person i caktuar juridik serb ishte përfaqësues i regjistruar ose agjent i të paditurit sloven, gjykatat Serbe nuk kishin juridiksion të vendosin mbi çështjen e tyre kontraktore, pa i shqyrtuar bazat sipas nenit 54.³⁵⁰

Ky interpretim i lë gjykatat *pa* juridiksion të veçantë bazuar në detyrimet e krijuara ose të realizuara në territor, mbi të paditurit e huaj (përveç nëse i kanë lidhjet e përmendura). Megjithatë, gjykatat ende mund të jenë të fuqizuara me juridiksion mbi *forum contractus* dhe/ose *forum solutionis* falë të Drejtës së Procedurës Civile (E Drejta e Procedurës Kontestimore).

Neni 61 parasheh që “kontestet ku një person fizik apo juridik me vendbanim ose seli jashtë vendit tonë lidhur me *detyrimet e krijuara në Kosovë* ose që *duhet të përmbushen në Kosovë*, padia mund të ngrihet me gjykatën në të territorin e së cilës ndodhet zyra e përhershme përfaqësuese e tij ose e saj apo selia e organit të besuar për ekzekutimin e detyrave të tilla”. Për më tepër, kjo e drejtë po ashtu lejon dispozitat e juridiksionit vendor territorial për t’u zbatuar në situatat e juridiksionit ndërkombëtar për kontestet e parregulluara nga ligje apo marrëveshje të tjera ndërkombëtare.³⁵¹ Këto dispozita mund të ndihmojnë t’i plotësojnë mangësitë apo paqartësitë e lëna të hapura në nenin 54, 55 ose diku tjetër në Ligjin e DNP.

Një çështje tjetër është nëse “detyrimi” i përmendur në nenet e mësipërme e ka shkaktuar kontestit apo nëse rregulli përdor një qasje të performancës karakteristike.³⁵² Sipas një autori, interpretimi i saktë duhet të jetë që detyrimi është ai që i ka shtyrë palët në gjyq pasi që, nëse ligjvënësi do të kishte dashur ta zgjidhte performancën karakteristike, “do ta kishte paraparë këtë në mënyrë të qartë”.³⁵³ E njëjta pikëpamje mbështetet këtu pasi që është edhe pikëpamja e GJDBE-së e dhënë më herët.³⁵⁴

Në fund, duhet të theksohet që ekziston edhe një derë tjetër e hapur që këto tri vende ta vendosin juridiksionin në çështjet e lartpërmendura: retorsioni. Ligji i DNP të Kosovës ka paraparë, në nenin 48, mundësinë që gjykatat e saj ta shtrijnë juridiksionin si çështje ose retorsion ndaj shtetasve të një vendi që ka fuqi për ta ushtruar një bazë tjetër të juridiksionit mbi shtetasit e tij:

Në qoftë se në shtetin e huaj ekziston kompetenca e gjykatës së huaj në kontestet kundër shtetasve të Republikës së Kosovës sipas kriterëve mbi kompetencën që nuk ekzistojnë në dispozitat mbi kompetencën e gjykatave të Republikës së Kosovës, këto kriterë do të jenë kompetente për ekzistimin e kompetencës së gjykatave të Republikës së Kosovës në kontestet në të cilat i padituri është shtetas i atij shteti të huaj.

Pasi që nuk ka të dhëna se kjo dispozitë është zbatuar më herët, nuk dihet nëse zbatimi i saj ka gjasë të rezultojë në ushtrimin e juridiksionit sot. Megjithatë, duket të jetë një mundësi teorike dhe një e cila duhet të etiketohet si e tepruar. Kjo bazë e juridiksionit përsëritet edhe në Të Drejtën e Procedurës Kontestimore, neni 62.

Akti i DNP të Kosovës nuk parasheh as rregulla specifike mbrojtëse të juridiksionit për kontratat e konsumatorëve, kontratat individuale të punës apo sigurimet.

Duke pasur këtë kornizë të tërë jo të kënaqshme të bazës juridiksionale në prapavijë, është shumë ngushëlluese të shohim që Kosova tani ka marrë hapa seriozë drejt adresimit të këtyre çështjeve në Draft Ligjin e ri të DNP. Neni 146 i Draft Ligjit të DNP të Kosovës është bartje fjalë për fjalë e nenit 7, paragrafi 1 të Rregullores së Brukselit I *bis* dhe, si i tillë, është më i përafërt me bazën e juridiksionit të paraparë në nenin 5, paragrafi 1(g) të Konventës së Vendimeve

Gjyqësore.

Në nenin 146, paragrafi 1, Drafti thekson se gjykatat në Kosovë kanë juridiksion “në çështjet që kanë të bëjnë me një kontratë, ku arsyeja për padi është një detyrim që është kryer ose duhej të ishte kryer në Republikën e Kosovës.” Identik me nenin 7, paragrafi 1(b) të Rregullores së Brukselit I *bis*, para. 2 i Draftit neni 146 e përkufizon vendin e zbatimit të kontratës si vendi i dorëzimit të mallrave, ose i ofrimit të shërbimeve, kur ka të bëjë me kontrata të tilla. Draft Ligji i DNP po ashtu parasheh rregulla të veçanta mbrojtëse për juridiksionin në kontratat e konsumatorëve, kontratat individuale të punës dhe në çështjet e sigurimeve. Të gjitha janë të bazuara në rregullat ekuivalente të Rregullores së Brukselit I *bis*. Prandaj, interpretimi i tyre pritet të bëhet sipas interpretimit të Rregullores së Brukselit I *bis*, siç është dhënë në nenin 1 të Draftit, ku Rregullorja është radhitur në mesin e akteve me të cilat është harmonizuar Draft Ligji i DNP.

5.3.3. Juridiksioni i bazuar në detyrimet jokontraktore

Është tejet e qartë që neni 5, paragrafi 1(j) i Konventës së Vendimeve Gjyqësore është mjaft i kufizuar në fushëveprim (dëmet ndaj personave dhe pronës) dhe është i kufizuar me lëndimin fizik (duke përfshirë vdekjen) për personat fizikë ose humbjen dhe dëmtimin për pronë.³⁵⁵ Si i tillë, nuk vlen kur vendimi gjyqësor jepet për një padi të bazuar në humbjet që nuk kanë të bëjnë me një lëndim fizik apo dëmtim të pronës së prekshme.³⁵⁶ Në anën tjetër, dispozitat kombëtare të DNP, siç janë ato të Ligjit të DNP të Kosovës, nuk kanë kufizime të tilla.

Neni 54, që u analizua më lart në hollësi, parasheh juridiksionin e gjykatave të Kosovës kur një *detyrim* është krijuar këtu. Duke pasur parasysh përfshirjen e çështjeve jokontraktore në kuadër të konceptit të detyrimeve nga të gjitha këto vende, është e qartë se kjo dispozitë është e dedikuar të zbatohet për çështjet jokontraktore të juridiksionit. Përderisa përmbushet faktori i «detyrimeve», neni 54 mund të vlejë edhe për detyrimet jokontraktore.³⁵⁷

Siç u tha më lart, në çështjet kontraktore, neni 55 duhet të interpretohet si *vazhdim* i nenit 54. Një prej argumenteve që e mbështet këtë interpretim të paraqitur këtu është që e njëjta logjikë synohet të zbatohet edhe për çështjet jokontraktore gjatë vlerësimit të raportit mes nenit 54 dhe nenit 53.

Neni 53 parasheh një rregull specifike për juridiksionin për përgjegjësitë jokontraktore për dëme. Dispozita parasheh një kombinim mes juridiksionit të përgjithshëm dhe të veçantë, duke shtuar edhe një spirancë (nen) të bazuar në fakte, duke përcaktuar që “në kontestet për përgjegjësitë jonktraktuale për dëme gjykata e Kosovës do të ketë juridiksion nëse juridiksioni i tillë ekziston në bazë të dispozitave të nenit 46³⁵⁸ dhe neneve 50³⁵⁹ deri në 52³⁶⁰ të këtij Ligji ose *nëse dëmi ka ndodhur në territorin e Republikës së Kosovës*”.³⁶¹ Pjesa e dytë e kësaj dispozite po ashtu flet për zbatueshmërinë e dispozitës në veprime të viktimave të dëmtuara drejt kompanive të sigurimit për kompensim të dëmeve.

Përderisa dispozitat për të drejtën kompetente mbi çështjet jokontraktore janë shumë më të hollësishme,³⁶² dispozita mbi juridiksionin për çështje të tilla nuk mund të konsiderohet e tillë. Është me rëndësi të ceket mungesa e specifikimeve se çfarë përfshihet në vendin “ku ka ndodhur dëmi”. Mund të përfundohet që i njëjti frymëzim si në rastin *Bier*³⁶³ mund t’i jepet edhe

³⁵⁵ Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier. “Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention),” para. 196.

³⁵⁶ Po aty.

³⁵⁷ Hrvoje Sikirić, Određivanje međunarodne nadležnosti Uredbe Vijeća (EZ) br. 44/2001, p. 60. Shih të njëjtin qëndrim të advokuar në Petrović, “Posebna Međunarodna Nadležnost Za Sporove Iz Ugovornih Odnosa Prema Pravu EU i Pravu Republike Srbije.”

³⁵⁸ Juridiksioni i përgjithshëm për vendqëndrimin apo selinë e të paditurit.

³⁵⁹ Dispozita për pëlqimin e të paditurit.

³⁶⁰ Dispozita për juridiksionin mbi shtetasit që jetojnë jashtë vendit në detyrë zyrtare.

³⁶¹ Theksimi i shtuar nga autorja.

³⁶² Shih dispozitat specifike mes neneve 25-29 të Ligjit.

³⁶³ Handelskwekerij G. J. Bier BV v Mines de potasse d’Alsace SA., Case 21/76 (1976).

kësaj dispozite, por qëllimi i ligjvënësit bëhet i paqartë kur merret parasysh neni 28 i së drejtës kompetente për përgjegjësinë jokontraktore për dëme. Në nenin 28, ligjvënësi shumë qartë e parasheh zbatimin e të dy ligjeve në mënyrë alternative, përkatësisht “të drejtën e vendit ku është ndërmarrë veprimi ose të drejtën e vendit ku kanë ndodhur pasojat, varësisht se cila prej këtyre dy ligjeve është më e favorshme për personin e lënduar”. Megjithatë, kjo zgjidhje nuk pasqyrohet në rregullat e juridiksionit të këtyre çështjeve. Kjo mund të shihet si indikacion drejt qëllimit, apo mungesës së tij, të ligjvënësit për t’i fuqizuar gjykatat e të dy lokacioneve me juridiksion siç e ka bërë me të drejtën kompetente. Disa studiues e përmendin vetëm kompetencën në vendin “ku është shkaktuar dëmi” pa e elaboruar.³⁶⁴ Duke e aplikuar të njëjtën dispozitë, Gjykata Tregtare e Apelit në Serbi ka vendosur po ashtu për juridiksionin e gjykatave vendore në rastet kur dëmi është shkaktuar në territorin e Serbisë, përkundër që veprimi që e ka shkaktuar atë është kryer jashtë territorit të saj.³⁶⁵ Gjykata vendosi që gjykatat serbe kanë juridiksion mbi të paditurit e huaj, bazuar në nenin 53, për dëmin që i është shkaktuar një subjekti vendor përmes reduktimit të fondeve në llogarinë e tij bankare si rrjedhojë e faturimit të gabuar përmes abuzimit të autoritetit nga i padituri.³⁶⁶

Përveç kësaj, neni 54 që e përcakton juridiksionin në përgjithësi për të gjitha detyrimet, flet vetëm për “detyrimet e krijuara në kohën kur i padituri ka qenë i pranishëm në Kosovë”. A do të thotë kjo që këto gjykata nuk kanë juridiksion mbi, p.sh., një pretendim të padrejtë pasuror ndaj një të padituri të huaj pasi që ka rrjedhuar më vonë, jashtë territorit të saj, ose pasi që i padituri nuk ka qenë më i pranishëm në territor? Një interpretim i thjeshtë i kësaj dispozite do të sugjeronte që ajo që nevojitet është vërtetë shumë e kufizuar dhe paditësit që duan të kërkojnë kompensim për pretendime të tilla jokontraktore.

Një zgjidhje më e mirë tani gjendet në nenin 149 të Draft Ligjit të DNP të Kosovës, që është bartje fjalë për fjalë e Rregullores së Brukselit I *bis* neni 7, paragrafi 3. Shkurtimisht, parasheh juridiksionin e këtyre gjykatave nëse: a) ngjarja që e ka shkaktuar dëmin ose dëmi ka ndodhur aty; ose b) nëse ka të ngjarë të ndodhë një ngjarje e dëmshme apo një dëm aty.

5.4 Juridiksioni ekskluziv

Akti i DNP të Kosovës parasheh nëntë raste në të cilat gjykatat kanë juridiksion ekskluziv. Përderisa shtatë prej tyre kanë të bëjnë me statusin dhe çështje familjare, një juridiksion ekskluziv ka të bëjë me administrimin e pronës së paluajtshme që ndodhet në Kosovë, pavarësisht shtetësisë së të ndjerit, siç përcaktohet me nenin 71,72 dhe 73 dhe një ka të bëjë me të drejtat *in rem* për pronën e paluajtshme që ndodhet në Kosovë, duke përfshirë lizingun dhe qiranë.³⁶⁷ Siç do të paraqitet në analizën e mëposhtme, kur ekziston një bazë e tillë e juridiksionit ekskluziv këtu, aktgjykimet e huaja nuk mund të njihen apo të zbatohen, prorogimi i juridiksionit nuk është i mundur dhe gjykatat vendore nuk mund t’i pushojnë procedurat e tyre në rast të *lis pendens*.³⁶⁸

Në pikat e mëvonshme, Ligji i DNP të Kosovës dhe neni 5, paragrafi 1(h) dhe (i) të Konventës së Vendimeve Gjyqësore janë mjaft të ngjashme. I pari, në nenin 56, parasheh juridiksion ekskluziv në “kontestet mbi të drejtën e disponimit të sendeve të paluajtshme në pronësisë dhe mbi të drejtat reale për sendet e paluajtshme në pronë qytetarëve dhe personave civilë juridik, disponimit të sendeve të paluajtshme në pronësinë shoqërore dhe mbi të drejtat tjera reale për sendet e paluajtshme në pronësi të qytetarëve dhe të personave juridikë, në kontestet për shkak të pengesës së posedimit të sendeve të paluajtshme, si dhe në kontestet e shkaktuara nga marrëdhëniet e qirasë ose të huasë lidhur me sendet e paluajtshme ose nga kontrata mbi

shfrytëzimin e banesës apo të lokaleve afariste, në qoftë se sendi i paluajtshëm ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës”. Prandaj, juridiksioni ekskluziv është i paraparë për të drejtat *in rem* për të gjitha çështjet lidhur me pronën e paluajtshme, pa përjashtuar qiradhënien.

Me ndikim të lartë të Rregullores së Brukselit I *bis*, Draft Ligji i DNP i Kosovës parasheh një qasje tjetër kur është fjala për qiradhënien. Përderisa pjesa e parë e nenit 142 parasheh juridiksion ekskluziv bazuar në lokacionin e pasurisë në territorin e saj, paragrafi 2 ka përdorur zgjidhjen e Rregullores së Brukselit I *bis*. Ai parasheh që “gjykata e Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion ekskluziv në proceset që e kanë pronën e paluajtshme si objekt qiradhënieje për përdorim të përkohshëm privat për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh radhazi, me kusht që qiramarrësi të jetë person fizik dhe qiradhënësi dhe qiramarrësi të kenë vendbanim në të njëjtin shtet”. Kjo pjesë e fundit, përsëri, është ku do të dallojnë baza e juridiksionit të Konventës së Vendimeve Gjyqësore dhe ajo e Draft Ligjit të DNP të Kosovës, siç dallojnë me Rregulloren e Brukselit I *bis*.

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

6.1 Fushëveprimi material i zbatimit

Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “për vendimet gjyqësore” është e kufizuar me aktgjykimet në raste civile ose tregtare (nenin 1) dhe madje edhe ky ka më shumë kufizime të specifikuara në nenin 2. Konventa ka një listë mjaft të gjerë të përjashtimeve nga fushëveprimi i saj, duke filluar nga statusi, mirëmbajtja, pronësia e përbashkët e bashkëshortëve, trashëgimia dhe madje shpifja.

Duke qenë një ligj vendor që i rregullon këto çështje si burim primar, Ligji i DNP të Kosovës nuk ka kufizime të tilla. Vlen për të gjitha çështjet që përjashtohen nga neni 2. Domethënë, patjetër, përderisa vendimi gjyqësor jepet në çështje “private” – çështje që bien nën fushëveprimin e ligjit. Si të tilla, aktgjykimet e vendeve të huaja të dhëna në procese penale nuk mund të njihen dhe të zbatohen përveç në pjesën në të cilën përmbajnë një vendim mbi pretendimet pasurore të viktimës.³⁶⁹ Aktgjykimet e huaja të dhëna për qëllim të mbledhjes së tatimeve të Shtetit nuk janë të zbatueshme.³⁷⁰

Megjithatë, një përjashtim i njëjte mes këtyre dy anëve të krahasimit është përjashtimi i vendimeve të arbitrazhit. Edhe pse versionin origjinal i Ligjit të DNP ka dispozita për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit (neni 97-100), këto dispozita nuk vlejnë më për shkak të miratimit të Ligjit të ri për Arbitrazhin.³⁷¹

6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme)

Një çështje tjetër e rëndësishme që duhet të shqyrtohet është se cilat lloje të dokumenteve duhet të kalojnë nëpër procedurat e njohjes dhe ekzekutimit. Konventa e Vendimeve Gjyqësore ofron një përkufizim për “aktgjykimin” apo “vendimin gjyqësor” në nenin 3, paragrafi 1(b), për të nënkuptuar çdo vendim për merita i dhënë nga një gjykatë (...). Raporti Shpjegues vë në pah që “termi ‘gjykatë’ duhet të interpretohet në mënyrë autonome dhe i referohet autoriteteve

³⁶⁴ Varadi, Bordaš, and Knežević, *Međunarodno Privatno Pravo*.

³⁶⁵ Vendimi i Gjykatës Tregtare të Apelit, Pž 715/2013 i datës 30 janar 2013 – Praktika Gjyqësore e Gjykatës Tregtare – Buletini Nr. 4/2013.

³⁶⁶ Po aty.

³⁶⁷ Elementet e radhitura në Zlatan Meškić. “Bosnia and Herzegovina.” *Elgar Encyclopaedia of Private International Law*. Elgar European Law, 2017, p. 184, për Bosnjë dhe Hercegovinë, ku zbatohet i njëjti ligj i trashëguar nga ish-Jugosllavia.

³⁶⁸ Po aty.

³⁶⁹ Stanivuković and Živković, “Serbia,” 2018, p. 289.

³⁷⁰ Po aty, duke e cituar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kroacisë, Gž. 561/80 i datës 6 maj 1980, Zbirka sudskih odluka Nr. 2, 1980, p. 155.

³⁷¹ Ligji për Arbitrazhin, Nr. 02/L-75, i disponueshëm në gjuhën angleze në: <https://gzkr.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2579>.

ose organeve që janë pjesë e degës ose sistemit gjyqësor të një Shteti dhe që ushtrojnë funksione gjyqësore. Ai nuk i përfshin autoritetet administrative, noterët publikë apo autoritetet jo-shtetërore".³⁷² Ngjashëm, brenda kuptimit të nenit 86 të dispozitave të zbatimit të Ligjit të DNP të Kosovës, vendim i huaj konsiderohet edhe një vendim i një autoriteti tjetër që është *i barabartë* me një vendim të gjykatës në vendin ku është marrë, apo me një marrëveshje gjyqësore. Kjo ngre çështjen e akteve noteriale, që nuk është shumë e qartë nga leximi i thjeshtë i dispozitave. Ligji i Kosovës për Noterinë parasheh që aktet e huaja noteriale janë të zbatueshme në Kosovë me kusht të reciprocitetit,³⁷³ por procedura nuk është e përcaktuar. Kjo është e kushtëzuar me atë që të drejtat e dhëna në të të mos e shkelin rendin ligjor në Kosovë. Megjithatë, nëse akti noterial e ka të njëjtën fuqi si një vendim i një gjykate në shtetin e origjinës, njohja e tij duhet të kërkohej nga gjykata para procedurës së ekzekutimit.³⁷⁴ Si i tillë, çdo akt noterial që e njeh një të drejtë, i jep efekt përcaktimit të një të drejte apo detyrimi, do të kishte të njëjtën fuqi si aktgjykimi apo vendimi i një gjykate, prandaj do të duhej të kalonte nëpër procedurat e njohjes dhe zbatimit me Ligjin e DNP. Kjo është e qartë edhe nga praktika gjyqësore në Kosovë, edhe pse e limituar, por që tregon raste kur aktet noteriale janë njohur përmes një procedure gjyqësore.³⁷⁵

Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, aktgjykimet që i japin efekt përcaktimit të një të drejte apo detyrimi ligjor, siç është vendimi se a gëzon paditësi një të drejtë apo jo, duke përfshirë këtu aktgjykimet deklarative, bien nën fushëveprimin e Konventës.³⁷⁶ E njëjta vlen për aktgjykimet që e urdhërojnë debitorin të kryejë apo e parandalojnë që ta kryejë një veprim të caktuar, siç është një ndalesë (injuction) apo urdhër për zbatimin specifik të një kontrate (urdhër për përmbushje të detyrimit).³⁷⁷ Konventa në mënyrë të qartë i përjashton masat e përkohshme të mbrojtjes në nenin 3.

Ligji i DNP i Kosovës nuk e adreson në mënyrë specifike çështjen nëse vendimet pozitive apo negative njihen apo zbatohen me të, as nuk është trajtuar kjo temë në mesin e studiuesve. Mund të supozohet që si vendimet pozitive ashtu edhe ato negative duhet të njihen me këto dispozita, pasi që të dyja e përcaktojnë një të drejtë dhe/ose detyrim ligjor. Ngjashëm, nuk diskutohet as mundësia e njohjes së masave të përkohshme. Megjithatë, neni 77 i Ligjit të DNP iu jep autoritet gjykatave të Kosovës për të marrë masat e përkohshme të nevojshme për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të një shtetasi të huaj që është i pranishëm ose ka pasuri në Kosovë, por kjo ka të bëjë me çështjet e mbrojtjes. Opinioni i ndarë këtu është i ngjashëm me qëndrimin e Konventës së Vendimeve Gjyqësore – që masat e përkohshme kanë dy qëllime: të ofrojnë masa preliminare të sigurimit të aseteve prej të cilave mund të nxirret një aktgjykim i formës së prerë, apo të mbahet në pritje përcaktimi i status kuosë së një rasti në gjykim.³⁷⁸ Si të tilla, nuk janë të barabartë me vendimin gjyqësor, siç parashihet në nenin 86 të Ligjit të DNP.

6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)

Procedurat e njohjes dhe ekzekutimit nisen si tema kryesore e procesit gjyqësor para një gjykate. Ligji për Gjykatat, neni 12, i mandaton Gjykatat themelore me pushtetin për të zbatuar vendimet e huaja. Aktgjykimet për çështje civile dhe komerciale do të njihen dhe do të zbatohen përmes një procedure jo-gjyqësore, në të cilën kërkohej kombinimi i procedurave kryesisht nga E drejta

e Procedurës Jo-kontestimore³⁷⁹ dhe Ligji për Procedurën Përmbartimore.³⁸⁰ Tutje, neni 101, paragrafi 5 i Ligjit të DNP të Kosovës përcakton që "nëse nuk është dhënë vendim i veçantë për njohjen e një vendimi të huaj, çdo gjykatë mund të vendosë për njohjen e atij vendimi si çështje preliminare në proces, por vetëm me efekt për atë proces."

Të gjitha vendimet e huaja, qofshin në lidhje me çështje familjare apo statutore apo tregtare paraqiten për njohje dhe ekzekutim në departamentin përkatës të përgjithshëm të Gjykatës Themelore në përputhje me rregullat e juridiksionit territorial brenda Kosovës. Këtu hynë edhe vendimet për çështje komerciale.³⁸¹ Deri vonë, çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja janë konsideruar të jenë kompetencë vetëm e Kryetarit të Gjykatës.³⁸² Ishte e paqartë në atë kohë dhe ende mbetet e paqartë prej nga rrjedh (ka rrjedhur) ai autoritet specifik, pasi që asnjë prej ligjeve parësore nuk e parashohin. Një Rregullore e Organizimit të Brendshëm të Gjykatave vetëm përcakton që kërkesat për ekzekutimin e vendimeve të huaja regjistrohen në një regjistër të "rasteve të tjera civile" së bashku me rastet e tjera të shumta civile.³⁸³

6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Kërkesat zyrtare themelore për dokumentet e nevojshme janë radhitur në nenin 87, i cili kërkon që pala e cila kërkon zbatim ta dorëzojë vetë vendimin gjyqësor, së bashku me një certifikatë të lëshuar nga gjykata e huaj kompetente apo nga një autoritet tjetër që vërteton se vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë (nuk mund të apelohej) sipas të drejtës së Shtetit ku është dhënë.

Praktika e Gjykatës Themelore të Prishtinës tregon që gjykata e pranon vendimin gjyqësor origjinal, apo një kope të vërtetuar,³⁸⁴ së bashku me dëshminë e lartpërmendur të formës së prerë, apo "klauzolën e përmbartueshmërisë".³⁸⁵ Edhe pse vendimet i referohen nenit 87 të Ligjit të DNP kur e cekin këtë, gjuha e përdorur aty duket të jetë huazuar nga neni 36 e Ligjit për Procedurën Përmbartimore, që përcakton "propozimi për përmbartim duhet të dorëzohet tek organi përmbartues i shoqëruar me dokumentet e përmbartimi, në origjinal ose kopje të vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për zbatim". Një kërkesë tjetër zyrtare është përkthimi i vërtetë, edhe pse kjo nuk është renditur në mënyrë specifike në Ligjin e DNP apo në Ligjin për Procedurën Përmbartimore. Kjo mund të gjendet në nenin 331, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, dispozitat e së cilës vlejné, bazuar në nenin 18 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Ka raste të shumta në të cilat është refuzuar njohja pasi që paditësi nuk i ka përmbushur këto kritere.³⁸⁶

6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Kërkesat kyçe për njohje, përveç atyre të analizuara në këtë pjesë, janë: forma e prerë, mungesa e juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Kosovës, ekzistimi i reciprocitetit, mungesa e shkeljes procedurale që e ka parandaluar palën nga pjesëmarrja në procedura, mungesa e shkeljes së

372 Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier, "Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention)," para. 102.

373 Neni 3.5 i Ligjit Nr. 06/L –010 mbi Noterinë, i disponueshëm në gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18334>.

374 Slavko Đorđević, "Kratak Kritički Osvrt Na Priznanje i Izvršenje Stranih Javnobeležničkih Isprava Prema Zakonu o Javnim Beležnicima Srbije," *Nova Pravna Revija*, no. 1 (2014), pp. 81–84.

375 Shih Vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. 472/15, i datës 10.11.2015, për njohjen e një akti noterial të lëshuar në Nju Xhersi, SHBA.

376 Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier, "Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention)," para. 113.

377 Po aty, para 96.

378 Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier, "Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention)," para. 99.

379 Titulli zyrtar në gjuhën angleze është Law No. 03/L-007 on Out Contentious Procedure, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2608>. Sidoqoftë, ky nuk është termi i duhur dhe kështu termi „procedurë jokontestimore“ do të përdoret këtu.

380 I disponueshëm në gjuhën angleze në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2608>.

381 Shih p.sh., Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës Nr. C.N. nr. 508/2015 i datës 22.03.2016, për njohjen e një aktgjykimi me origjinë në Slloveni, kundër një kompanie vendore; Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës n.r. C.N. Nr. 184/17 i datës 06.10.2017 për çështjen e njohjes dhe zbatimit të një aktgjykimi nga Gjykata Tregtare në Pançevë, Serbi.

382 Përvoja e autores në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë realizimit të hulumtimit mbi zbatimin e vendimeve të huaja. Autorja është informuar së fundi joformalisht që kjo nuk vlen më dhe që rastet e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të huaja tani ndahen mes gjykatësve të Departamentit të Përgjithshëm, divizioni civil.

383 Neni 2 para. 4 Rregullorja e Këshillit Gjyqësor Nr. 02/2020 për funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Gjykatave në Republikën e Kosovës.

384 Gjuha e përdorur në vendime është "përkthim i vërtetuar".

385 Shih p.sh., Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. C.N. 287/14, i datës 27.07.2017.

386 Po aty; Shih po ashtu Vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. 541/14.

rendit publik dhe mungesa e një vendimi vendor të formës së prerë apo një vendimi të huaj që tashmë është njohur për të njëjtën çështje.³⁸⁷ Kushte tejet të ngjashme janë paraparë në Draft Ligjin e DNP, me disa dallime shumë të rëndësishme: tërheqja e kërkesës së reciprocitetit, prezantimi i “parimit reflektues” në juridiksionin jashtë kompetencave të një gjykate të huaj (neni 161) dhe dispozitat e elaboruara për shkeljen e të drejtës për mbrojtje (neni 164). Fatkeqësisht, këto dispozita të veçanta kanë kaluar nëpër ndryshime tejet të diskutuara në Kuvend³⁸⁸ dhe ka gjasa të ndryshohen. Prandaj, nuk do të analizohen në hollësi.

Pas vlerësimit të formës së prerë të vendimit gjyqësor (të diskutuar në nënkapitullin 6.4 më lart), gjykata sipas nenit 89, paragrafi 1 duhet të vlerësojë nëse gjykatat apo autoritetet tjera në Kosovë kanë juridiksion ekskluziv mbi atë çështje.³⁸⁹ Nëse përgjigja është pozitive, atëherë vendimit do t’i refuzohet njohja. Gjykata Themelore e Prishtinës e refuzoi njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi nga Gjykata Tregtare në Serbi sepse, sipas ligjit të Kosovës, çështja bën pjesë në kompetencat ekskluzive të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.³⁹⁰

Reciprociteti është një prej kërkesave kyçe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, i paraparë në nenin 92. Reciprociteti në kuptimin e këtij neni është faktik – që nënkupton se nuk kërkon një traktat për njohje të përbashkët që të mund të konsiderohet se ekziston.³⁹¹ Edhe pse reciprociteti nuk kërkohej në çështje martesore apo në caktimin e paternitetit apo maternitetit (neni 92, paragrafi 2) ka raste kur vendimeve të tilla iu është refuzuar njohja bazuar në mungesën e reciprocitetit.³⁹² Edhe shumë rasteve të tjera iu është refuzuar njohja për shkak të reciprocitetit.³⁹³ Gjykata Themelore e Prishtinës shfaq aktivizëm të veçantë në theksimin e mungesës së reciprocitetit kur ka të bëjë me raste nga Serbia.³⁹⁴ Megjithatë, supozohet ekzistimi i reciprocitetit. Kjo është parë të aplikohet mirë në praktikë.³⁹⁵ Studiuesit e mbështesin pikëpamjen që reciprociteti duhet të kontrollohet vetëm me kërkesën e palës, edhe pse në praktikë shpesh kontrollohet *ex officio*.³⁹⁶ Kur kanë dyshime, gjykatat mund ta pyesin Ministrin e Drejtësisë për të sqaruar se a ekziston reciprociteti.³⁹⁷

Reciprociteti në njohje dhe ekzekutim është veçanërisht sfidues për Kosovën, statusi politik i së cilës ende nuk është njohur nga shumë Shtete të BE-së – Greqia, Spanja, Sllovakia, Qipro dhe Romania – dhe fqinjët e saj të afërt – Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Kjo e fundit është po ashtu një prej partnerëve të saj më të afërt në tregti, siç u përmend më herët. Është advokuar fuqishëm që reciprociteti duhet të largohet si kërkesë për njohjen e vendimeve të huaja në Kosovë, që do ta lehtësonte dukshëm procesin e njohjes së vendimeve të Kosovës në mbarë botën.³⁹⁸ I njëjti qëndrim advokohet edhe në këtë raport.

Një përpjekje për ta larguar këtë kusht është bërë nga grupi punues i Draft Ligjit të DNP të Kosovës në Draftin e tij të parë. Grupi punues e kishte zëvendësuar kërkesën për reciprocitet me “parimin e pasqyrimit” në nenin 161. Megjithatë, gjatë ripërpunimit të Draftit në qershor 2021,

387 Të radhitura ngjashëm në Stanivuković and Živković, “Serbia,” 2018, p. 290.

388 Për herë të fundit janë diskutuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 19 nëntor 2020.

389 Shih Nënkapitullin 5.4. më lartë për një listë të plotë të dispozitave për të cilat parashihet juridiksion ekskluziv me Ligjin e DNP të Kosovës.

390 Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. C.N. nr. 184/17, i datës 06.10.2017. Gjykata nuk i referohet në mënyrë specifike nenit 89, paragrafi 1 për vlerësimin e juridiksionit të saj por iu referohet vetëm ligjit vendor që e rregullon juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

391 Stanivuković and Živković, “Serbia,” 2018, p. 292.

392 Shih p.sh., aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 349/19 i datës 10.12.2019, që refuzon një gjykim mbi shkurorëzimin të lëshuar në Sllovaki dhe aktgjykimin i Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 383/19 të datës 01.11.2019 që refuzon një gjykim mbi shkurorëzimin të lëshuar në Bosnjë dhe Hercegovinë.

393 Shih gjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 377/18 të datës 10.04.2019; aktgjykimin i Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 184/18 të datës 25.04.2019; aktgjykimin i Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 277/18 të datës 23.11.2018.

394 Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës CN. nr. 184/17 i datës 06.10.2017, që refuzon njohjen e një vendimi serb, *mes tjerash*, për mungesën e reciprocitetit dhe mungesën e një marrëveshje për të kundërtën. Ndryshe prej një vendimi të gjykatës së njëjtë CN. nr. 692/13 ku nuk e kontrollojnë çështjen e reciprocitetit me Serbinë dhe vetëm thekson që dokumenti për të cilin kërkohej njohje nuk është “vendim i huaj” brenda kuptimit të Ligjit, pasi që është vetëm kopje e legalizuar e një kontrate.

395 Shih p.sh., Vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës C.N. nr. 508/2015 të datës 22.03.2016, mbi njohjen e një aktgjykimi me origjinë në Slloveni kundër një kompanie vendore.

396 Meškić, “Bosnia and Herzegovina,” p. 194.

397 Neni 92, i kombinuar me një Udhëzim Administrativ mbi Procedurën e ofrimit të ndihmës ligjore ndërkombëtare për çështje penale dhe civile, Nr. 01-1265 (2009).

398 Donikë Qerimi dhe Samuel Fulli-Lemaire, 7th Journal of Private International Law Conference, Gusht 2017, Rio de Janeiro, Brazil.

Ministria e Drejtësisë ka vendosur përsëri reciprocitetin në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.³⁹⁹ Jo vetëm që është rivendosur, por edhe është forcuar më shumë në krahasim me versionin e reciprocitetit që është aktualisht në fuqi. Siç u tha më sipër, reciprociteti në versionin aktual të Ligjit të ish-Jugosllavisë kërkohej vetëm për çështje jashtë çështjeve martesore. Por, dispozita e saposhtuar në Draft Ligjin e DNP nuk e parasheh këtë përjashtim. Nëse dispozita mbetet siç është tani, reciprociteti do të kërkohej për të gjitha çështjet brenda fushëveprimit të ligjit. Duke pasur parasysh që kjo çështje është tejet e rëndësishme dhe e diskutueshme, ka shumë të ngjarë që do të propozohen ndryshime për ta larguar atë. Prandaj, nuk dihet nëse dispozita që e ka rikthyer reciprocitetin do të miratohet apo do të hidhet poshtë dhe, nëse bëhet kjo, duhet të ofrohen analiza të mëtejshme për këtë çështje më vonë.

Vendimi gjyqësor që kërkon njohje nuk duhet ta shkelë rendin publik sipas nenit 91. Sipas studiuesve në rajon, gjykatat vendore rrallëherë mbështeten në këtë përjashtim dhe, kur e bëjnë këtë, është për çështje lidhur me statusin.⁴⁰⁰ Që një vendim gjyqësor të jetë i barabartë me një shkelje të rendit publik, do të duhej të kishte “mospërputhje të jashtëzakonshme dhe të qartë me parimet thelbësore që janë të vlefshme në Republikën e Kosovës”.⁴⁰¹ Madje, ka indikacione që gjykatat e Kosovës mund të jenë mjaft liberale kur është fjala për interpretimin e nocionit të rendit publik. Një shembull i veçantë i njohjes së një vendimi të një gjykate gjermane për shpërbërjen e një partneriteti civil mes një çifti të gjinisë së njëjtë, që është njohur nga Gjykata Themelore e Prishtinës.⁴⁰² Duhet të jetë e pritshme që gjykatat do të jenë liberale në interpretimin e rendit publik në çështjet komerciale.

Tutje në listën e pikave, gjykata duhet të sigurojë që vendim gjyqësori nuk përmban shkelje procedurale që e parandalojnë palën (kundër së cilës është kërkuar njohja) të marrë pjesë në procedurat siç kërkohej me nenin 88. Pjesa e dytë e këtij neni shpjegon që parregullsitë në fjalë janë ato që kanë të bëjnë me shërbimin e procesit dhe ftesa e gjykatës nuk kanë arritur ende tek pala. Edhe pse kjo është çështje e ndjeshme, nuk është trajtuar në më shumë hollësi nga studiuesit dhe nuk duket të jetë ngritur as nga gjykatat.

E fundit, gjykatat duhet të kontrollojnë nëse çështja tashmë konsiderohet të jetë *res judicata* në Kosovë. Neni 90 parasheh që një vendim gjyqësor duhet t’i refuzohet njohja nëse është dhënë një gjykim i formës së prerë për të njëjtën çështje nga gjykatat në Kosovë ose nëse ndonjë gjykim tjetër i huaj i dhënë për të njëjtën çështje është njohur në Kosovë. E njëjta dispozitë e autorizon gjykatën për t’i *pezulluar apo pushuar* procedurat e njohjes nëse një rast për të njëjtën çështje është në pritje para gjykatave në Kosovë, derisa të vendoset për atë rast. Kjo dispozitë është e barabartë me nenin 7, paragrafi 2 të Konventës së Vendimeve Gjyqësore. Megjithatë, dispozita e Ligjit të DNP nuk *parasheh* arsye për ta *refuzuar* njohjen dhe zbatimin, siç bën neni 7, paragrafi 2 i Konventës. Ligji i DNP vetëm i ofron gjykatës arsye për të pezulluar procedurën derisa të jepet vendimi i formës së prerë në atë kontest.⁴⁰³

Siç përcaktohet me nenin 101, paragrafi 2, gjykata kufizohet me një kontrollim nëse kushtet e parashikuara në nenin 86 deri në 100 janë përmbushur dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, mund të kërkojë shpjegim qoftë nga gjykata vendimmarrëse apo nga palët.

Në përputhje me nenin 101, paragrafi 3 dhe 4, vendimet për njohje dhe ekzekutim mund të apelojnë brenda 15 ditësh para Gjykatës së Apelit në Kosovë.

399 Ky ndryshim është bërë pa konsultime paraprake me anëtarët e grupit punues.

400 Stanivuković and Živković, “Serbia,” 2018, p. 293.

401 Morina and Nikci, *Komentar: Ligji Për Procedurën Kontestimore*, p. 524.

402 Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës Nr. C.N. Nr. 248/2015 i datës 25.05.2015. Vendimi nuk e përmend drejtpërdrejtë natyrën e gjinisë së njëjtë të partneritetit, por mund të nënkuptohet nga emrat e palëve dhe dokumentet e bashkangjitura të rastit.

403 Për një analizë të plotë mbi *lis pendens* brenda Ligjit të DNP të Jugosllavisë, shih Qerimi, “Jurisdiction in International Disputes in Commercial Matters: A Comparison between the Brussels Ibis and the Western Balkans,” pp. 228–34.

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

Fjalja e dytë e nenit 96 të Ligjit të DNP dikton që nëse paditësi kërkon ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të huaj në Kosovë— përveç dokumenteve të nevojshme për njohje — duhet të ofrojë vërtetim të ekzekutueshmërisë së atij vendimi gjyqësor bazuar në të drejtën e shtetit të origjinës. Pasi të njihet vendimi gjyqësor, pastaj realizohet procedura e ekzekutimit bazuar në Ligjin për Procedurën Përmbartimore, siç përcakton neni 11 dhe neni 22 para.1(5). Neni 12 parasheh kufizime për ekzekutim kundër pronës së një shteti apo organizate të huaj, për të cilat kërkohet miratimin paraprak të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Me përjashtim të çështjeve familjare dhe vendimeve për rikthimin e një punëtori në punë nga punëdhënësi, të gjitha çështjet tjera mund të zbatohen nga përmbartuesit privatë. Zakonisht, vendimi që lejon ekzekutimin e një vendimi të huaj jep një periudhë kohore brenda së cilës duhet të ekzekutohen vendimet në mënyrë vullnetare. Ky afat kohor mund të zgjatet nga përmbartuesi.⁴⁰⁴ Pastaj përmbartuesi privat jep urdhër bazuar në propozimet për realizimin e përmbartimit (të bërë nga pala) dhe realizon përmbartimin për ta përmbushur kërkesën e debitorit bazuar në një dokument përmbartimi.⁴⁰⁵

Duke pasur parasysh që një vendim i huaj gjyqësor është "dokument i përmbartueshëm" vetëm pasi të jetë njohur nga një gjykatë në Kosovë, nuk ka situata kur përmbartuesit ballafaqohen drejtpërdrejt me vendime të huaja gjyqësore.

Në kapitujt e tjerë të mësipërm janë dhënë më shumë hollësi specifike mbi procedurën përmbartimore dhe do të shmanget përsëritja e tyre këtu.

8. Referenca

- A. De Bloos, SPRL v. Société en commandite par actions Bouyer, , Case 14/76 (1976).
- Andrew Owusu v N.B. Jackson, trading as 'Villa Holidays Bal-Inn Villas', Mammee Bay Resorts Ltd, Mammee Bay Club Ltd, The Enchanted Garden Resorts & Spa Ltd, Consulting Services Ltd, Town & Country Resorts Ltd, Case C-281/02 (2005).
- Appleton, Susan Frelich. "Leaving Home? Domicile, Family, and Gender." *U.C. Davis Law Review*, 2014, 1954.
- Berliner Verkehrsbetriebe (BVG), v JPMorgan Chase Bank NA, Frankfurt Branch, Case C-144/10 (2011).
- Bilalli, Aslan, and Hajredin Kuçi. *E Drejta Ndërkombëtare Private*. Prishtina, Kosovo: University of Prishtina, 2012.
- Briggs, Adrian. *Civil Jurisdiction and Judgments*. Sixth. Informa Law, 2015.
- Deskoski, Toni. "The New Macedonian Private International Law Act of 2007." *Yearbook of Private International Law* 10 (2008): 441–58.
- Donikë Qerimi. "Western Balkans." In *Choice of Law in International Commercial Contracts*. Private International Law. Oxford: Oxford University Press, 2021.
- Francisco Garcimartín and Geneviève Saumier. "Explanatory Report on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters (HCCH 2019 Judgments Convention)." The Hague, 2020.
- Gugu Bushati, Aida, and Nada Dollani. "Albanian PIL Act and Its Implementation in Judicial Practice." *Anal of the Faculty of Law of University of Zenica* 18 (2016): 147.

- Handelskwekerij G. J. Bier BV v Mines de potasse d'Alsace SA., Case 21/76 (1976).
- Hartley, Trevor C. *International Commercial Litigation*. Second Edi. Cambridge University Press, 2015.
- Hay, Peter. "Notes on the European Union's Brussels-I 'Recast' Regulation." *The European Legal Forum Forum Iuris Communis Europae* 13, no. 1 (2013): 1–36.
- Hummel Holding A/S v Nike Inc., Nike Retail BV, Case C-617/15 (2017).
- Kostić, Maja, Maja Stanivuković, and Mirko Živković. "Montenegro." In *Kluwe Encyclopedia of Private International Law*, 2013.
- Kuçi, Hajredin. "E Drejta Ndërkombëtare Private Në Kosovë." In *Hyrje Në Sistemin Ligjor Në Kosovë*, 103–40. Prishtine, Kosove: Akademia e Drejtësisë, 2019.
- Magnus, Ulrich, Peter Mankowski, and Richard Fentiman. *Brussels I Regulation*. Sellier, 2007.
- Meškić, Zlatan. "Bosnia and Herzegovina." In *Elgar Encyclopedia of Private International Law*, 171–96. Elgar European Law, 2017.
- Michaels, Ralf. "Jurisdiction, Foundations." In *Elgar Encyclopedia of Private International Law*, n.d.
- Morina, Iset, and Selim Nikci. *Komentar: Ligji Për Procedurën Kontestimore*. 1st Editio. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2012.
- MSG v Gravières Rhénanes, Case C-106/95 (1997).
- Nicole Hassett v South Eastern Health Board and Cheryl Doherty v North Western Health Board, Case C-372/07 (2008).
- Orakhelashvili, Alexander. "The International Court's Advisory Opinion on the UDI in Respect of Kosovo: Washing Away the 'Foam on the Tide of Time.'" *Max Planck Yearbook of United Nations Law* 15 (2011).
- Petrović, Milena. "Posebna Međunarodna Nadležnost Za Sporove Iz Ugovornih Odnosa Prema Pravu EU i Pravu Republike Srbije." *Anal of the Faculty of Law of University of Belgrade*, no. 1 (2014): 41–61.
- Qerimi, Donikë. "Jurisdiction in International Disputes in Commercial Matters: A Comparison between the Brussels Ibis and the Western Balkans." Gent University, 2019.
- SAR Schotte GmbH v Parfums Rothschild SARL, Case 218/86 (1987).
- Slavko Đorđević. "Kratak Kritički Osvrt Na Priznanje i Izvršenje Stranih Javnobeležničkih Isprava Prema Zakonu o Javnim Beležnicima Srbije." *Nova Pravna Revija*, no. 1 (2014): 81–84.
- Somafer SA v Saar-Ferogas AG, Case 33/78 (1978).
- Stanivuković, Maja. "Tačke Vezivanja Za Komercijalna Prava Lica u Međunarodnom Privatnom Pravu (Points of Connection for Commercial Legal Persons in International Private Law)." *Zbornik Radova Pravnog Fakulteta u Novom Sadu* 36 (2002).
- Stanivuković, Maja, and Mirko Živković. *Međunarodno Privatno Pravo*. Belgrade, 2004.
- ———. "Serbia." In *Kluwe Encyclopedia of Private International Law*, 2009.
- ———. "Serbia." In *Kluwer Encyclopedia of Private International Law*, 55:1–343. Wolters Kluwer, 2018.

404 Neni 24 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

405 Neni 5 para. 3 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

- Varadi, Tibor, Bernadet Bordaš, and Gašo Knežević. *Međunarodno Privatno Pravo*. V. Novi Sad: Forum, 2001.
- Varadi, Tibor, Bernadet Bordaš, Gašo Knežević, and Vladimir Pavić. *Međunarodno Privatno Pravo*. XIII. Belgrade, 2010.

RAPORT KOMBËTAR: MALI I ZI

Autore

Maja Kostić-Mandić

Përmbledhje ekzekutive

Kuadri ligjor për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në Malin e Zi, në çështjet civile dhe tregtare, mbështetet kryesisht në ligjin “Për të drejtën ndërkombëtare private” të Malit të Zi dhe në disa traktate ndërkombëtare. Mali i Zi ka juridiksion vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga ligji (ose marrëveshja ndërkombëtare) në lidhje me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Mund të njihen vetëm vendimet mbi themelin e çështjes, pavarësisht emrit në shtetin e origjinës dhe llojit të autoritetit, brenda dhe jashtë gjykatës, që merr vendimin.

Në Malin e Zi, gjykatat (themelore dhe tregtare) kanë juridiksion ekskluziv në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, ndërsa procedura e ekzekutimit (përmbartimor) mbështetet në kompetencën e agjentëve zbatues dhe vetëm nëse nuk bie ndesh me kompetencën e gjyqësorit. Duke qenë se kompetencën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore e ka ekskluzivisht gjykata kompetente, një agjent zbatues nuk mund të vendosë për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore si çështje paraprake në procedurën e ekzekutimit.

Nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e vendimeve që lidhen me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve nga asnjë prej gjykatave në territorin e Malit të Zi. Megjithatë, mund të gjurmohen çështje specifike përmes faqes zyrtare të internetit të gjykatës përkatëse. Në përgjithësi, gjykatat kanë kapacitetet për të marrë vendime mbi çështje të tilla pasi Qendra për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në Malin e Zi organizon shpeshherë trajnime për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.

Ekonomia e Malit të Zi mbështetet kryesisht tek turizmi dhe investimet e huaja. Edhe pse vendi ka marrëdhënie të mira ekonomike me vende në mbarë botën, Mali i Zi realizon aktivitete tregtare kryesisht me vendet fqinje dhe tregun evropian. Aktualisht, është e vështirë të vlerësohet nëse Mali i Zi do të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 apo nëse do të bëjë deklarata në përputhje me nenin 19 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, pasi nevojitet një analizë e mëtejshme mbi interesat parësore kombëtare.

Në Malin e Zi, dispozitat për juridiksionin ndërkombëtar jepen kryesisht në ligjin “Për të drejtën ndërkombëtare private” (LDNP) të vitit 2014, dhe në shumicën e rasteve do të zbatohen pikërisht dispozitat e LDNP-së. Dispozitat e këtij ligji janë pjesërisht në përputhje me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” dhe lidhen kryesisht me caktimin e juridiksionit me marrëveshje. Dispozitat e tjera përkatëse mbështeten në bazën tradicionale për juridiksionin, në mbështetje të sistemeve kombëtare juridike, ose pasqyrojnë dispozitat e Konventës së Luganos (në të cilin Mali i Zi nuk është një shtet palë). Megjithatë, Mali i Zi është palë në Konventën e HCCH-së të vitit 2005 “Për zgjedhjen e gjykatës”.

Kufizimet e parashikuara në LDNP lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore janë përgjithësisht në përputhje me ato të përcaktuara në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Dallimet qëndrojnë në kufizimet më të rrepta të parashikuara në legjislacionin kombëtar të Malit të Zi lidhur me juridiksionin ndërkombëtar. LDNP parashikon shprehimisht një fushë veprimi më të gjerë të juridiksionit ekskluziv si dhe nocionin e juridiksionit të tepruar (të ashtuquajtur “imazhi pasqyrë i juridiksionit”) si bazë për refuzimin e njohjes.

1. Kuadri ligjor për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Burimi ligjor më i rëndësishëm për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore në Malin e Zi është ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”, i cili e rregullon këtë çështje në detaje. Dispozitat e Procedurës Ekstra-Gjyqësore aplikohen edhe për disa çështje të caktuara.

LDNP parashikon se në mungesë të dispozitave specifike në kapitullin ekzistues mbi procedurën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore dhe të vendimeve të arbitrazhit, do të zbatohen dispozitat e ligjit që rregullon procedurën jokontestimore (neni 158 - Zbatimi i përshtatshëm i legjislacioneve të tjera), si dhe do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive"⁴⁰⁶ për vetë procedurën e ekzekutimit.

Për sa i përket marrëveshjeve shumëpalëshe, Mali i Zi është shtet palë në Konventën "Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës" (Konventa e HCCH-së e vitit 2005 "Për zgjedhjen e gjykatës"), e cila zbatohet në Malin e Zi nga data 1 gusht 2018. Edhe pse konventa parashikon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të marra nga një gjykatë e zgjedhur, në shumë raste nuk ka një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës ndërmjet palëve në një mosmarrëveshje.⁴⁰⁷

Për më tepër, disa marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe të ratifikuara më parë përmbajnë dispozita të caktuara, të cilat janë të rëndësishme për këtë fushë. Konventa e Hagës "Për procedurën civile" dhe Konventa e Hagës "Për qasjen ndërkombëtare në drejtësi" përmbajnë dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që lidhen me kostot dhe shpenzimet.

Mali i Zi ka nënshkruar traktate dypalëshe për ndihmën juridike në procedurat civile me shtetet e mëposhtme: Austrinë, Belgjikën, Bosnjë-Hercegovinën, Qipron, Republikën Çeke, Francën, Greqinë, Hungarinë, Italinë, Maqedoninë, Poloninë, Rumaninë, Serbinë dhe Sllovakinë. Ministria e Drejtësisë e Malit të Zi zbaton aktualisht traktatet e ish-Jugosllavisë me Kroacinë⁴⁰⁸ dhe me Federatën Ruse.⁴⁰⁹

Për më tepër, janë nënshkruar katër traktate dypalëshe me shtetet në vijim, të cilat trajtojnë ekskluzivisht çështjet e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të huaja dhe vendimeve të arbitrazhit: Austrinë, Belgjikën, Francën dhe Greqinë: Marrëveshja me Austrinë "Për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit dhe marrëveshjeve të arritura përpara gjykatave të arbitrazhit për çështjet tregtare" (1960, në fuqi nga viti 1961); Konventa me Austrinë "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor" (1961, në fuqi nga viti 1962); Konventa me Belgjikën "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor" (1971, në fuqi nga viti 1976), Konventa me Francën "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare" (1971, në fuqi nga viti 1972); Marrëveshja me Greqinë "Për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore" (1959, në fuqi nga viti 1960).

1.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore

LDNP është ligji bazë që do të zbatohet më shpesh në praktikë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Pjesa e tretë e ligjit e rregullon këtë çështje në detaje. Kapitulli XII specifikon efektin e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore në Malin e Zi dhe se çfarë përfaqëson një vendim i huaj gjyqësor (neni 141), dhe përcakton në mënyrë shteruese kushtet/ pengesat për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor (nenet 142-147, neni 149).

Në mënyrë që një vendim i huaj gjyqësor të ketë efekt në Malin e Zi, është e nevojshme që t'i nënshtrohet procedurës së njohjes. Neni 141 i LDNP-së parashikon se një vendim i huaj gjyqësor i njohur në Malin e Zi është i barasvlershëm me vendimet e gjykatave vendase. Kjo do të thotë se një vendim i huaj gjyqësor në Malin e Zi mund të prodhojë vetëm ato efekte që parashikohen nga legjislacioni i brendshëm për vendimin në fjalë.

⁴⁰⁶ <https://wipolex-res.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/me/me031en.pdf>

⁴⁰⁷ Konventa „Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare“ (Konventa e HCCH-së e vitit 2019 „Për vendimet gjyqësore“) synon të plotësojë konventën e mësipërme.

⁴⁰⁸ Marrëveshja ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Kroacisë „Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale“ (në fuqi nga viti 1998).

⁴⁰⁹ *Shihni* Maja Kostić-Mandić. *Private International Law of Montenegro, International Encyclopaedia of Laws*. Kluwer Law International, 2020, f. 30-31. Marrëveshja me BRSS „Për ndihmën juridike në çështjet familjare, civile dhe penale“ (në fuqi nga data 26 maj 1963). Çështja e vazhimit të traktateve ndërkombëtare me Federatën Ruse nuk është përmbyllur ende, kështu që nuk kemi konfirmime zyrtare nga ana e Rusisë që marrëveshja është ende në fuqi.

Sipas LDNP, kushtet për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor janë: 1) vendimi i huaj gjyqësor ka marrë formë të prerë në përputhje me legjislacionin e shtetit të origjinës (dhe është i ekzekutueshëm nëse kjo gjë kërkohet), dhe nuk bie në kundërshtim me ligjin e Malit të Zi sa i përket; 2) juridiksionit ndërkombëtar; 3) të drejtës për t'u mbrojtur; 4) ekzistencës së një vendimi të formës së prerë për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë dhe efektit "lis pendens", dhe 5) shkëljes së rendit publik. Kushtet janë shteruese dhe reduktohen në kushte formale dhe procedurale, dhe i vetmi kusht që lidhet me themelin e çështjes është që të mos shkelë rendin publik të vendit ku kërkohet njohja. Në varësi të përmbushjes së kushteve të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, një vendim i huaj mund të njihet ose njohja e tij mund të refuzohet. Në çdo rast, vendimi nuk mund të ndryshohet, plotësohet ose modifikohet.

Kapitulli XIV rregullon në detaje procedurën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore (nenet 152-158).

Juridiksioni i gjykatave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore parashikohet në ligjin "Për gjykatat", dhe dispozitat e ligjit "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive" zbatohen për procedurat e ekzekutimit.

1.2. Vlerësimi i kuadrit ligjor

Ashtu si në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë, në Malin e Zi zbatohet sistemi i kontrollit të kufizuar të vendimeve gjyqësore, i cili përdoret më shpesh në të drejtën e krahësuar. Në njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore, Mali i Zi ka juridiksion vetëm mbi kushtet e përcaktuara nga ligji (ose marrëveshja ndërkombëtare). Mund të njihen vetëm vendimet mbi themelin e çështjes, pavarësisht emrit në shtetin e origjinës dhe llojit të autoritetit, brenda dhe jashtë gjykatës, që merr vendimin, për sa kohë që vendimi merret në formën, procedurën dhe nga autoriteti përgjegjës për marrjen e këtij vendimi, në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës (p.sh., një vendim i një organi të huaj administrativ mund të njihet nëse përmbush kushtet e njohjes). Karakteri i huaj i vendimit lidhet me momentin kur vendimi merr formë të prerë. Për shembull, vendimet e gjykatave në Slloveni ose Kroaci, të cilat kanë marrë formë të prerë gjatë ekzistencës së Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë nuk mund të konsiderohen si vendime të huaja tashmë.⁴¹⁰

Për herë të parë, procedura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore është rregulluar në detaje nga LDNP, dhe zgjidhjet e suksesshme nga legjislacioni i vendeve të rajonit kanë shërbyer si pikënisje.⁴¹¹

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.1. Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Në Malin e Zi, gjykatat luajnë rolin më të rëndësishëm në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, ndërsa roli i aktorëve të tjerë, përveç agentëve zbatues, nuk ka një rregullim të drejtpërdrejtë në lidhje me masat zbatuese. Roli i gjykatës në këtë procedurë është parashikuar në ligjin "Për gjykatat" dhe në LDNP. Ligji i mëparshëm parashikonte vetëm juridiksionin ndërsa LDNP, krahas juridiksionit, përmban dispozita të detajuara mbi procedurën "exequatur" dhe nuk përmban dispozita për agentët zbatues, juridiksioni i të cilëve parashikohet në ligjin "Për

⁴¹⁰ Kostić-Mandić, Maja. *Međunarodno privatno pravo* (Private International Law). Podgorica, Pravni fakultet UCG, Podgorica, 2017, f. 184.

⁴¹¹ Krahasoni nenet 152-158 të LDNP-së të Malit të Zi me nenet 108-111 të LDNP-së së Sllovenisë, dhe me nenet 111-116 të LDNP-së së Maqedonisë së Veriut.

ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive”.

2.2. Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.2.1. Gjykatat

Gjykatat themelore të Malit të Zi marrin vendime për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, me përjashtim të vendimeve për çështjet tregtare, për të cilat është kompetente Gjykata për Çështjet Tregtare e Malit të Zi.⁴¹² Gjykatat themelore dhe Gjykata për Çështjet Tregtare kanë juridiksion ekskluziv për të marrë vendime për ekzekutimin dhe njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore (LDNP, neni 152, paragrafi 3).

Gjykatat themelore dhe Gjykatat për Çështjet Tregtare kanë juridiksion ekskluziv mbi ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në procedurat e ekzekutimit, vetëm në çështjet në vijim: në dhënien ose heqjen e kujdestarisë së një fëmije; në rikthimin e një punonjësi në vendin e punës; kur vendimi gjyqësor detyron debitorin që të kryejë një akt të cilin nuk mund ta kryejë asnjë person tjetër përveç tij/saj, në përputhje me ligjin ose transaksionin ligjor; për një petition që krijon siguri; për një petition që kthen mbrapsht vendimin e ekzekutimit, dhe me kërkesë të kreditorit në vendimin gjyqësor, për shlyerjen e detyrimeve të palikuiduara ndaj tij (LESK, neni 4).

2.2.2. Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.)

Roli i institucioneve administrative lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore nuk përshkruhet shprehimisht nga e drejta pozitive. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë, e cila është gjithashtu Autoriteti Qendror për të gjitha konventat e HCCH-së të ratifikuara nga Mali i Zi, mund të caktohet nga gjykata që merr vendimin për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore për të marrë informacione mbi një ligj të huaj (në përputhje me Konventën evropiane të vitit 1968 për informacion mbi të drejtën e një vendi të huaj); nëse nevojitet një shërbim (në përputhje me Konventën e HCCH-së të vitit 1965 “Për shërbimet”⁴¹³), ose nëse nevojitet ndihmë në një mënyrë tjetër.

Për më tepër, Ministria e Drejtësisë përgatit një raport të përgjithshëm vjetor për zbatimin e LDNP-së, për të përmbushur një nga detyrimet e saj në kuadër të integritetit Evropian, dhe mbledh të dhëna mbi praktikën ligjore të gjykatave në Malin e Zi. Megjithatë, të dhënat janë vetëm të një natyre të përgjithshme dhe përfshijnë numrin e çështjeve sipas gjykatave dhe fushave, por nuk përmbajnë përshkrime zyrtare të çështjeve, duke përfshirë të çështjeve në fushën e njohjes dhe të ekzekutimit.

2.2.3. Juristët (avokatët, përfaqësuesit ligjorë etj.)

Palët duhet të angazhojnë gjithmonë avokatë gjatë proceseve në të cilat merren vendime për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në Mal të Zi. Zakonisht, ata janë avokatë nga një shtet i huaj që kanë të drejtë të përfaqësojnë klientët edhe në Malin e Zi. Në dijeninë tonë, këta avokatë nuk janë të specializuar posaçërisht në trajtimin e çështjeve të tilla.

2.2.4. Agjentët zbatues

Ligji “Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive”, i cili u zbatua fillimisht në vitin 2014, prezantoi një profesion të ri në sistemin juridik të Malit të Zi, përkatësisht agjentin zbatues, i cili është një nëpunës i pavarur që mban një funksion pranë një autoriteti publik. Dispozitat e LESK-së bëjnë dallime të qarta ndërmjet juridiksionit të gjykatës dhe nëpunësit publik të zbatimit, dhe specifikojnë kompetencat e tyre përkatëse (neni 4).⁴¹⁴ Kjo solli braktisjen e sistemit të ashtuquajtur të “ekzekutimeve të gjykatave” pasi agjentët zbatues janë kompetentë për të marrë vendime në procedurat e ekzekutimit (përmbartim), për të garantuar ekzekutimin si dhe për të garantuar sigurimin e kërkesëpadive, me përjashtim të rasteve kur kompetenca e gjykatave parashikohet me ligj (neni 3). Kompetenca për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore i takon ekskluzivisht gjykatës kompetente (LDNP, neni 152, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3) dhe rrjedhimisht, agjentët zbatues nuk mund të vendosin për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore si një çështje paraprake në procedurën e ekzekutimit.

Juridiksioni vendor i agjentëve zbatues përcaktohet qartësisht nga dispozitat e LESK-së. Rrjedhimisht, ata përcaktojnë dhe ekzekutojnë vendimet mbi bazën e dokumentit të ekzekutimit të gjykatës ose të autoritetit që ushtron kompetencën e tij në zonën ku është i vendosur agjenti zbatues, ndërsa kompetenca e agjentit zbatues lidhet me vendqëndrimet ose selinë e debitorit ekzekutiv, në rastet kur përcaktimi dhe ekzekutimi bëhet sipas dokumenteve autentike. Në këto raste duhet pasur parasysh dispozita e LDNP-së që përcakton se “ekzekutimi i vendimeve të gjykatës dhe vendimeve të arbitrazhit realizohet në juridiksionin territorial të gjykatës në territorin e së cilës do të kryhet ekzekutimi” (neni 152, paragrafi 4). Kjo mospërputhje ndërmjet dy ligjeve është qartësisht një gabim i cili nuk duhet të ekzistonte. Janë dashur disa vite për hartimin e LDNP-së dhe LESK-së, dhe më pas ka pasur një periudhë të gjatë “vacatio legis”, por të dy ligjet kanë hyrë në fuqi në vitin 2014.

Sipas agjentëve zbatues, kjo mospërputhje nuk përbën një problem në praktikë pasi ata thjesht e injorojnë këtë dispozitë por kjo mund të jetë çorientuese për publikun e gjerë. Për këtë arsye, kjo dispozitë e LDNP-së duhet të ndryshohet për të garantuar siguri ligjore.⁴¹⁵

2.2.5. Aktorë të tjerë të rëndësishëm

Shërbimi noterial në Malin e Zi funksionon si një shërbim publik në përputhje me ligjin “Për noterinë”.⁴¹⁶ Krahës hartimit dhe lëshimit të akteve noteriale dhe mbajtjes së certifikatave, letrave me vlerë, parave dhe pasurive të tjera të luajtshme, noterët janë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të caktuara përmes vendimeve të gjykatave.⁴¹⁷ Në objektin e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private, roli më i rëndësishëm i noterëve është në fushën e kontratave dhe trashëgimisë.⁴¹⁸ Ligji “Për noterinë” parashikon përdorimin e formatit noterial si një parakusht për vlefshmërinë e disa prej kontratave më të rëndësishme në fushën e ligjit për trashëgiminë, familjen dhe detyrimet.⁴¹⁹ Një akt noterial për një transaksion ligjor duhet të ketë statusin e një dokumenti publik dhe në kushte të caktuara mund të marrë gjithashtu statusin e një titulli ekzekutiv. Megjithatë, nëse një akt i huaj noterial do të zbatohet në Malin e Zi, nuk është e nevojshme që të kryhet një procedurë “exequatur”.

Një akt i huaj noterial, i cili është subjekt i reciprocitetit, ka të njëjtin efekt ligjor si akti noterial i hartuar në Malin e Zi.⁴²⁰

414 <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/me/me031en.pdf>.

415 Kostić-Mandić, Maja. *Private International Law of Montenegro, International Encyclopaedia of Laws*. Kluwer Law International, 2020, f. 207.

416 Neni 52, paragrafi 1 i ligjit „Për noterinë”, <https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-notarima.html>

417 Neni 4 i ligjit „Për noterinë”.

418 Noterëve që veprojnë si nëpunës të gjykatave u është besuar vendimarrja mbi procedurat e trashëgimisë, përmes vendimeve të gjykatave.

419 Shihni Korać, Velibor. “Notarial Form *Ad Solemnitatem* in Montenegrin Law.” *Annals FLB – Belgrade Law Review*, no. 3, year LXIV, 2016. https://www.researchgate.net/publication/312353465_Notarial_form_ad_solemnitatem_in_Montenegrin_law (aksesuar më 16 prill 2021).

420 Neni 8, paragrafi 1 i ligjit „Për noterinë”.

412 Gjykata për Çështjet Tregtare merr vendime për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore të dhëna nga gjykatat për çështjet tregtare, si dhe të vendimeve të huaja të arbitrazhit (neni 14, paragrafi 4 dhe neni 18, paragrafi 2, pika 4 e ligjit “Për gjykatat”).

413 Konventa për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe tregtare, (Konventa e HCCH-së e vitit 1965 „Për shërbimet”).

2.3. Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve

Deri më tani nuk ka pasur bashkëpunim specifik ndërmjet aktorëve. Kjo situatë mund të përmirësohet nëse aktorët kryesorë shkëmbejnë informacione dhe të dhëna, nëse marrin pjesë në trajnime tematike, dhe nëse Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat japin të dhëna lehtësisht të gjurmueshme për çështjet.

3. Roli i gjykatave dhe agentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

3.1. Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Rregullat e gjykatës së Malit të Zi⁴²¹ japin informacione të përgjithshme lidhur me kapacitetet e gjykatave në këtë shtet. Gjykatat kanë ngritur seksione të posaçme të cilat merren me fushat specifike të ligjit.

Një seksion mund të ketë një ose disa Këshilla.⁴²² Gjykata merr vendim rreth një kërkesë për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor në një procedurë ekstra-gjyqësore. Procedurat për njohjen e vendimeve të huaja janë klasifikuar me shkurtimin “Pso”⁴²³ ose “Rs” si çështje komplekse ekstra-gjyqësore. Një gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë merr vendim rreth kërkesës për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor. Për shembull, në vitin 2020 Gjykata Themelore në Podgoricë kishte katër gjyqtarë që merreshin me çështjet e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore. Një këshill i përbërë nga tre gjyqtarë të gjykatave të apelit merr vendim lidhur me ankimimet ndaj vendimeve.⁴²⁴ Kjo procedurë është klasifikuar me shkurtimin “Psp” ose “Rp.”

3.2. Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Ministria e Drejtësisë e Malit të Zi mbikëqyr zbatimin e LDNP në Malin e Zi. Një raport vjetor për zbatimin e LDNP-së jep të dhëna lidhur me numrin e vendimeve. Ministria e Drejtësisë mbledh të dhëna, në mënyrë zyrtare, lidhur me zbatimin e LDNP-së në praktikën gjyqësore: gjatë periudhës 2019/2020 ka pasur një total prej 443 çështjesh të lidhura me ligjin e së drejtës ndërkombëtare private (LDNP).

Nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e vendimeve që lidhen me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore nga asnjë prej gjykatave në territorin e Malit të Zi. Megjithatë, Gjykata e Lartë në Podgoricë ka një seksion që monitoron praktikën gjyqësore dhe gjurmon çështjet që lidhen me LDNP. Pavarësisht kësaj, në Malin e Zi është ende e vështirë që të merren informacione mbi praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e ligjeve ose të konventave në fushën e LDNP-së, si dhe të traktateve ndërkombëtare në përgjithësi, duke qenë se softueri i specializuar i përdorur nga gjykatat njihet vetëm zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Vendimet e gjykatave publikohen zakonisht në faqen zyrtare të internetit të gjykatës përkatëse pas garantimit të anonimitetit,⁴²⁵ por në praktikë ky rregull nuk aplikohet për të gjitha vendimet. Për më tepër, në disa raste kalojnë vite deri në publikimin e një vendimi në faqen e internetit. Studimi i realizuar në mënyrë private nga autori i kësaj analize mbi praktikën e gjykatave

themelore në Podgoricë dhe Cetinje për periudhën janar 2015 - nëntor 2018, tregon se çështjet kur është kërkuar njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore përbëjnë shumicën e çështjeve ku përfshihet një element ndërkombëtar në çështjet e së drejtës private. Në përgjithësi, gjyqtarët janë të kualifikuar për trajtimin e këtyre çështjeve dhe rastet më të vështira janë ato me origjinë nga vendet e të drejtës zakonore (SHBA ose MB), në të cilat janë hasur vështirësi për të përcaktuar nëse vendimi i huaj është i formës së prerë ose jo.

Gjatë periudhës janar 2015 - nëntor 2018, Gjykata për Çështjet Tregtare në Podgoricë ka marrë kryesisht vendime për njohjen e gjykimeve të huaja nga Serbia, në përputhje me marrëveshjen dypalëshe me këtë vend,⁴²⁶ dhe në një rast, për njohjen e një vendimi nga Kroacia në përputhje me LDNP-në.⁴²⁷

Megjithatë, gjykatat kanë raportet e tyre individuale. Për shembull, Raporti Vjetor Individual i Gjykatës Themelore në Podgoricë, tregon se kjo gjykatë, gjatë vitit 2020, ka marrë 24 kërkesa për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore dhe ka dhënë vendime mbi 29 kërkesa të tilla.⁴²⁸

Gjithashtu, në vitin 2020, Gjykata Themelore në Podgoricë ka marrë 5 ankesa për njohjen e vendimeve, të cilat janë klasifikuar si “Rp”, dhe ka zgjidhur 6 çështje. Megjithatë, nuk janë mbledhur të dhëna mbi cilësinë e vendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.

3.3. Kapacitetet e agentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Agentët zbatues në Malin e Zi nuk janë kompetentë për të marrë vendime për procedurat e njohjes (exequatur). Ata janë kompetentë vetëm për të marrë vendime për procedurat e ekzekutimit.

3.4. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor

Mali i Zi, si një vend kandidat për t'u anëtarësuar në BE, dhe bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ka ndërmarrë detyrimin për të harmonizuar ligjet e tij me “acquis communautaire” (tërësinë e ligjeve të BE-së). Në kuadër të trajnimeve të shumta, Qendra për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë⁴²⁹ ka trajtuar gjithashtu çështjet që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Kështu, në mars të vitit 2015, në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar/Fondacioni IRZ, u organizua një seminar dy ditor me titull “Juridiksioni, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare në të Drejtën e Bashkimit Evropian dhe në të Drejtën e Malit të Zi”, për të trajnuar gjyqtarët e gjykatave civile dhe tregtare të rajoneve veriore dhe qendrore. Me këtë rast, u diskutua tema e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore bazuar në Rregulloren I bis të Brukselit, në Konventën e Luganos dhe në ligjin “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Në të njëjtin vit, kjo Qendër, me mbështetjen teknike të një projekti ndërmjet Luksemburgut dhe Malit të Zi, në bashkëpunim me EIPA-n (Instituti Evropian i Administratës Publike) në Luksemburg, organizoi një seminar mbi “Qarkullimin e lirë të vendimeve gjyqësore - Njohja e ndërsjellë dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor në BE, në çështjet civile dhe tregtare - Rregullorja e re e BE-së, Bruksel I-bis, dhe procedurat gjyqësore përpara gjykatave evropiane”.

Në vitin 2016, në kuadër të një seminari dy ditor të mbajtur në Bar, u realizua një trajnim mbi temat në vijim: Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile dhe

421 Rregullat e gjykatës së Malit të Zi „Fletorja Zyrtare e Malit të Zi nr. 65/16, 19/19, 58/19,6/20 dhe 93/20.

422 Neni 25 i Rregullave të gjykatës.

423 Neni 252 i Rregullave të gjykatës.

424 Raporti vjetor i Gjykatës Themelore në Podgoricë për vitin 2020, <https://sudovi.me/osp/g/sadrzaj/d5wx>

425 <http://en.sudovi.me/vrhs/library/laws> (aksesuar më 16 prill 2021).

426 Gjykata për Çështjet Tregtare Rs. br. 16/15, Rs. br. 19/16, Rs. br. 2/17, Rs. br. 19/17, br. 20/17, Rs. br. 23/17, Rs. br. 13/18.

427 Gjykata për Çështjet Tregtare Rs. br. 20/16.

428 Raporti Vjetor i Gjykatës Themelore në Podgoricë për vitin 2020, <https://sudovi.me/osp/g/sadrzaj/d5wx>

429 <http://cosdt.me/>

tregtare bazuar në ligjin "Për të drejtën ndërkombëtare private" dhe Rregulloren I bis të Brukselit.

Në dhjetor të vitit 2016, në Podgoricë, Qendra për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Zhvillimin e Ligjit/IDLO në Romë, dhe me mbështetjen financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në kuadër të projektit "Mbështetje për formimin gjyqësor në fushën e së drejtës tregtare në Malin e Zi", organizoi një seminar me temë: "Ekzekutimi dhe siguria në Malin e Zi dhe në BE". Ky trajnim përfshinte temat në vijim: Ekzekutimi dhe sigurimi i kërkesëpadive në Malin e Zi, marrëdhënia ndërmjet agjentit zbatues dhe gjykatës; Apelimet dhe objekti i ekzekutimit (me theks tek ekzekutimi i vendimeve për pronat e paluajtshme, aksionet dhe kuotat, anijet); Masat e përkohshme; Njohja e vendimeve të huaja gjyqësore; Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në BE: Konventa e Luganos, Rregullorja I bis e Brukselit, Rregullorja Evropiane për Urdhrin e Ekzekutimit (Nr. 805/2004), Rregullorja Evropiane për Urdhërpagesat (Nr. 1896/2006), Rregullorja Evropiane për Procedurën për Kërkesëpaditë për Shuma të Vogla (Nr. 861/2007) dhe Rregullorja Evropiane që ndryshon Rregulloren Evropiane për Urdhërpagesat dhe Rregulloren Evropiane për Procedurën për Kërkesëpaditë për Shuma të Vogla (Nr. 2015/2421).

Në maj të vitit 2017, në Podgoricë, Qendra për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë organizoi modulën e pestë (V) të Programit të trajnimit për të Drejtën e BE-së, me titull "Njohja e ndërsjellë dhe ekzekutimi, instrumentet për njohjen dhe ekzekutimin në çështjet civile dhe tregtare, në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor në BE - Rregullorja e rishikuar e BE-së I-bis e Brukselit dhe Procedurat e rishikuara Evropiane." Seminari u organizua në bashkëpunim me Institutin Evropian të Administratës Publike me seli në Luksemburg (EIPA Luksemburg) në kuadër të programit për ofrimin e mbështetjes teknike për Malin e Zi, me titull "Fuqizimi i kapacitetit të organeve gjyqësore dhe i cilësisë së drejtësisë", me mbështetjen financiare të qeverisë së Luksemburgut.

Në të gjitha këto trajnime morën pjesë ekspertë të huaj dhe vendas.

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

Konventa mbështet fuqimisht ekzekutimin, dhe ofron mundësi për harmonizimin e ligjeve në këtë fushë. Ajo synon të reduktojë kostot e proceseve gjyqësore ndërkombëtare dhe të promovojë aksesin në drejtësi, tregti, investime dhe në ekonominë globale,⁴³⁰ me qëllim që shtetet palë të kenë detyrimin të njohin dhe ekzekutojnë vendimet e huaja gjyqësore, duke iu nënshtruar disa masave mbrojtëse që lidhen me rendin publik, mashtimin, njoftimin e pamjaftueshëm etj.⁴³¹ Konventa ofron disa zgjidhje me synim që të nxisë anëtarësimin e shteteve. Së pari, konventa parashikon bazat e juridiksionit "të tërthortë". Së dyti, konventa përjashton fushat ku ekzistojnë kontradikta ndërmjet sistemeve juridike. Së treti, ajo ka një fushë zbatimi të ngushtë. Suksesi i konventës varet nga vullneti politik i shteteve që e nënshkruajnë atë. Deri më tani, konventa është nënshkruar nga tre shtete.⁴³² Mbetet për t'u parë se cili do të jetë afati kohor dhe numri i shteteve që do e nënshkruajnë konventën. Nga ana tjetër, nëse konventa nuk është e suksesshme, palët do të jenë të detyruara të kryejnë analiza të fragmentuara të ligjeve të ndryshme kombëtare në juridiksione të ndryshme.

Mali i Zi ka marrëdhënie tregtare me vendet e përfshira aktivisht në Konferencën e Hagës. Pyetja që ngrihet është se cilat janë përfitimet e Malit të Zi nëse bëhet shtet palë (palë kontraktore)? A

sjell kjo konventë përfitime për tregtinë, investimet, konsumatorët dhe qeverinë?⁴³³ Nëse Mali i Zi bëhet shtet palë në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 «Për vendimet gjyqësore», kjo do të rrisë aftësinë e tij për të eksportuar vendime gjyqësore nga gjykatat malazeze te gjykatat e vendeve të tjera, dhe me shumë mundësi do të rritet lista e këtyre vendeve (krahasuar me shtetet palë të Konventës së HCCH-së të vitit 2005 «Për zgjedhjen e gjykatës»).⁴³⁴ Për më tepër, investitorët e huaj do të përfitonin nga siguria ligjore që lidhet me garancinë se vendimet gjyqësore të dhëna në vendin e tyre mund të njihen dhe ekzekutohen në Malin të Zi, në përputhje me të njëjtat kushte që ekzistojnë në vendin e tyre. Në një skenar të tillë mund të parashikohet rritja e stabilitetit politik dhe e funksionimit të sistemit juridik, krahas rritjes së ekonomisë së Malit të Zi.

4.1. Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

Ekonomia e Malit të Zi mbështetet kryesisht tek turizmi dhe investimet e huaja. Mali i Zi është një vend kandidat për t'u anëtarësuar në BE dhe ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në, si dhe një marrëveshje të përkohshme për tregtinë dhe çështjet që lidhen me tregtinë. Megjithatë, duke qenë se nuk është një vend anëtar i BE-së, Mali i Zi ka rregulloret e tij doganore. Ligji "Për doganat"⁴³⁵ dhe Rregullorja "Për tarifrat doganore"⁴³⁶ përfaqësojnë burimet kryesore për rregulloren e import/eksportit në Malin e Zi. Edhe pse vendi ka marrëdhënie të mira ekonomike me vende në mbarë botën, aktivitete tregtare të Malit të Zi realizohen kryesisht me vendet fqinje dhe tregun evropian.

Mali i Zi është anëtar i OBT-së, e cila promovon lëvizjen e mallrave në një treg më të gjerë.⁴³⁷ Integrimi rajonal është arritur përmes anëtarësimit në CEFTA, EFTA dhe në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë në BE. Për më tepër, Mali i Zi respekton standarde të ndryshme ndërkombëtare dhe ka lidhur disa marrëveshje me një sërë shtetesh.

Zyra e Statistikave e Malit të Zi (MONSTAT) mbledh, përpunon dhe shpërndan të dhëna zyrtare lidhur me partnerët kryesorë tregtarë të Malit të Zi. Sipas këtyre të dhënave, tregtia e jashtme ka qenë më e lartë me shtetet palë të CEFTA-s dhe me vendet anëtare të BE-së.

4.1.1. Importi

Partnerët kryesorë tregtarë në lidhje me importet janë Serbia me 500,4 milionë euro, Gjermania me 244,2 milionë euro dhe Kina me 221,9 milionë euro.⁴³⁸

Produktet e importuara më shpesh në Malin e Zi janë makineritë dhe pajisjet e transportit me vlerë rreth 578,1 milionë euro.

4.1.2. Eksporti

Mali i Zi i eksporton produktet e tij në Serbi - 107,9 milionë euro, Hungari - 45,0 milionë euro dhe Bosnjë-Hercegovinë - 29,8 milionë euro.⁴³⁹

Struktura e eksporteve mbështetet te burimet natyrore ku përfshihen alumini, mineralet, lëndët djegëse dhe nafta, hekuri dhe çeliku.

433 Teitz, Louise Ellen. "Another Hague Judgments Convention? Bucking the past to provide for the future." *Duke Journal of Comparative & International Law*, Vol. 29, f. 491-511.

434 Konventa e HCCH-së e vitit 2005 "Për zgjedhjen e gjykatës" është kritikuar shpeshherë se ka dështuar në arritjen e objektivit të dëshiruar pasi është në fuqi vetëm në BE, Meksikë, Mal të Zi dhe Singapor.

435 "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 21/08, 1/11, 39/11, 40/11, 28/12, 62/13 dhe 71/17.

436 „Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 4/20.

437 Mali i Zi është anëtar i OBT-së që nga 29 prilli i vitit 2012, https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/org6_e.htm

438 <https://www.monstat.org/eng/page.php?id=171&pageid=171>

439 *Po aty*.

430 Stewart, David P. "The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters." *American Journal of International Law*, Volume 113, Issue 4, October 2019, f. 772-783.

431 Garcimartin, Francisco dhe Genevieve Saumier. "Explanatory Report, on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters." *The Hague Conference on Private International Law – HCCH*, 2020 (Explanatory Report).

432 Izrael, Ukrainë dhe Uruguai.

<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=137>

4.2. Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Për momentin, është e vështirë të jepet një panoramë objektive e situatës lidhur me ratifikimin e mundshëm të konventës nga ana e Malit të Zi, dhe zbatimin e saj në të ardhmen. Zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 30 gusht 2020 sollën ndryshim të qeverisë në Malin e Zi, dhe Partia Demokratike e Socialistëve, e cila është pasuese e Partisë Komuniste, si dhe partnerët e saj në koalicion humbën pushtetin për herë të parë që nga futja e sistemit shumëpartiak (në dhjetor 1990). Gjatë periudhës përpara zgjedhjeve, qeveria e mëparshme nuk e mori në konsideratë anëtarësimin e Malit të Zi në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

Qeveria e re u krijua në dhjetor 2020 dhe nuk ka marrë ende masa konkrete për këtë çështje. Megjithatë, është parashikuar se ratifikimi i mundshëm i kësaj konvente nuk do të jetë prioritet për qeverinë e re, veçanërisht duke pasur parasysh që aktualisht fokusi është te çështjet që lidhen me ndryshimet e legjislacionit zgjedhor dhe të rregulloreve përkatëse, si dhe me miratimin e një sërë rregulloresh për arritjen e drejtësisë tranzicionale.

4.2.1. Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Deri më tani, Mali i Zi nuk i ka përdorur mekanizmat e “refuzimit” të përfshirë në instrumentet e tjera të HCCH-së. Në pamje të parë, mund të arrijmë në konkluzionin se Mali i Zi nuk ka shumë gjasa të marrë në konsideratë dhënien e njoftimeve në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Duke pasur parasysh funksionet kryesore të këtij njoftimi në Konventë (përcaktimi i kohës kur konventa hyn në fuqi mes dy shteteve palë dhe opsioni i kufizuar i refuzimit për të shmangur vendosjen e marrëdhënieve të traktatit me shtetet e tjera palë),⁴⁴⁰ ekziston një dispozitë specifike që ka tërhequr vëmendjen tonë. LDNP specifikon se një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet nëse gjykata e huaj e ka bazuar juridiksionin e saj në fakte që nuk njihen nga ligji i Malit të Zi si fakte që mund t’i japin një gjykatë malazeze juridiksion ndërkombëtar për të trajtuar të njëjtën mosmarrëveshje.⁴⁴¹ Mund të argumentohet se për të ruajtur të ashtuquajturin “imazh pasqyrë të juridiksionit” nga legjislacioni i brendshëm, Mali i Zi mund të marrë në konsideratë dhënien e njoftimit në këtë drejtim.

4.2.2. Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Në pikëpamjen tonë, nuk ka shumë gjasa që Mali i Zi të bëjë deklaratë në përputhje me nenin 17 të konventës, pasi LDNP nuk përmban një përkufizim për vendimet e huaja gjyqësore dhe i vetmi kriter që përdor është vendndodhja e gjykatës së origjinës që jep vendimin gjyqësor jashtë Malit të Zi. Për rrjedhojë, nuk përbën rëndësi vendqëndrimi i palëve ose çështje të tjera që nuk përfshihen në listën e kushteve/kufizimeve të njohjes sipas neneve 142–147 të LDNP-së. Për më tepër, Mali i Zi respekton të njëjtën dispozitë nga Konventa e HCCH-së e vitit 2005 “Për zgjedhjen e gjykatës” (neni 20).

Për sa i përket mundësisë së Malit të Zi për të bërë një deklaratë në përputhje me nenin 18, nuk ka një përgjigje të drejtpërdrejtë. Në përgjithësi, rezervat e shprehura në instrumente të tjera kanë pasur gjithmonë si synim të neutralizojnë disa koncepte të së drejtës zakonore.⁴⁴² Është e

vështirë të vlerësohet rezultati i mundshëm pasi Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” parashikon aktualisht disa masa mbrojtëse (p.sh., ndëshkime për dëmet). Një nga çështjet që mund të merret në konsideratë në këtë kontekst janë kontratat që prodhojnë efekte reale (*in rem*) mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Malin e Zi, pasi ato bëjnë pjesë në juridiksionin ekskluziv të gjykatave malazeze.⁴⁴³

Neni 19 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” ngre shumë pyetje dhe duhet të trajtohen shkurtimisht të paktën dy çështje: kapaciteti i palëve për të ushtruar kompetenca sovraane dhe imuniteti. Duke qenë se, në përputhje me nenin 19 të konventës, deklarata mund të bëhet vetëm në lidhje me një palë që ka kapacitetin për të ushtruar kompetenca sovraane, edhe pse kjo palë mund të angazhohet gjithashtu në aktivitete tregtare, shteti duhet të identifikojë se cilat agjenci qeveritare mbulohen nga deklarimi, si dhe rrethanat në të cilat këto agjenci do të përfshihen përpara dhënies së një vendimi për bërjen e kësaj deklarate.⁴⁴⁴ Një tjetër çështje lidhet me faktin nëse neni 2, paragrafi 5 ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e pronave shtetërore, edhe pse shteti ruan imunitetin e tij.⁴⁴⁵ Duke qenë se është një shtet i vogël, Mali i Zi mund të gjykojë se nuk është në interesin e tij më të mirë që të lejojë ekzekutimin sipas kushteve të parashikuara në konventë dhe mund të marrë në konsideratë zbatimin e kushteve më të rrepta për të mbrojtur pronat shtetërore.

Deklarata që lidhet me sistemet juridike të paunifikuara, sipas nenit 25 nuk është me rëndësi për Malin e Zi.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Në Malin e Zi, dispozitat për juridiksionin ndërkombëtar jepen kryesisht në ligjin “Për të drejtën ndërkombëtare private” të vitit 2014, dhe në shumicën e rasteve do të zbatohen pikërisht dispozitat e LDNP-së. Dispozitat e këtij ligji janë pjesërisht në përputhje me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” dhe lidhen kryesisht me caktimin e juridiksionit me marrëveshje. Dispozitat e tjera përkatëse mbështeten në bazën tradicionale për juridiksionin, në mbështetje të sistemeve kombëtare juridike, ose pasqyrojnë dispozitat e Konventës së Luganos (në të cilin Mali i Zi nuk është një shtet palë). Megjithatë, Mali i Zi është palë në Konventën e HCCH-së të vitit 2005 “Për zgjedhjen e gjykatës”, dhe në rastin e një hendeuku ligjor, ligji “Për procedurën civile” mundëson zbatimin e rregullave kombëtare për juridiksionin vendor, në funksion të rregullave të juridiksionit ndërkombëtar.⁴⁴⁶

Juridiksioni përcaktohet bazuar në faktet dhe rrethanat e pranishme në momentin e nisjes së procedurës. Ndryshimet e fakteve mbi bazën e të cilave është përcaktuar juridiksioni, të cilat mund të ndodhin në një fazë të ardhshme të procedurës, nuk do të ndikojnë te juridiksioni (LDNP, neni 112). Nëse juridiksioni ndërkombëtar mundësohet përmes një traktati ndërkombëtar të ratifikuar, atëherë ky traktat do të ketë përparësi ndaj LDNP-së ose ligjeve të tjera të posaçme që rregullojnë juridiksionin ndërkombëtar, dhe do të zbatohet drejtpërdrejt në rastet kur rregullon marrëdhëniet në një mënyrë të ndryshme nga legjislacioni i brendshëm.⁴⁴⁷ Në rast se një gjykatë e huaj ka juridiksion sipas dispozitave të një traktati ndërkombëtar, gjykata vendase duhet ta

443 *Shihni seksionin 5.4 më poshtë.*

444 “...qoftë drejtpërdrejt ose në një mënyrë të deleguar, në një fushë specifike ose të përgjithshme, dhe personat fizikë që veprojnë në emër të tyre, pavarësisht statusit të tyre të punësimit.” Raporti shpjegues, f. 154.

445 Çështjet e imunitetit që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore nuk trajtohen në legjislacionin e brendshëm të Malit të Zi. Imuniteti nga masat zbatuese në procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vendase ose të huaja, parashikohet nga neni 13 i ligjit «Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive (LESK)». Neni 29 i ligjit „Për procedurën civile” parashikon se gjykata e Malit të Zi do të ketë juridiksion ndërkombëtar nëse juridiksioni i saj në një mosmarrëveshje me element ndërkombëtar parashikohet shprehimisht nga një statut ose një traktat ndërkombëtar ose nëse juridiksioni i saj lind nga dispozitat për juridiksionin vendor të gjykatës vendase. Opsioni i dytë zbatohet nëse nuk ka dispozitë specifike mbi juridiksionin e gjykatës vendase në një statut ose në një traktat ndërkombëtar për llojin specifik të mosmarrëveshjes me element ndërkombëtar. LDNP parashikon vetëm se dispozitat e tij do të zbatohen edhe për marrëdhëniet e së drejtës private në të cilat përfshihet një element ndërkombëtar dhe në të cilat njëra nga palët është një shtet, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji (LDNP, neni 22). Për më tepër, ekzistojnë referenca specifike ku e drejta ndërkombëtare publike shërben si burim për ligjin në disa legjislacione të brendshme. *Për shembull, ligji «Për procedurën civile» (neni 28) parashikon se rregullat e së drejtës ndërkombëtare publike rregullojnë çështjen e juridiksionit të gjykatave malazeze për të gjykuar çështjet kundër qytetarëve të huaj të mbrojtur nga imuniteti dhe kundër shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare.*

446 Neni 29 i ligjit „Për procedurën civile”.

447 Në përputhje me nenin 9 të Kushtetutës së Malit të Zi.

deklarojë veten si jokompetente dhe nuk duhet t'ia dërgojë dosjet e çështjes gjykatës së huaj.

5.1. Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)

Juridiksioni i përgjithshëm i gjykatave të Malit të Zi, për të gjitha llojet e çështjeve kontestimore dhe jokontestimore me një element të huaj, bazohet në vendbanimin e të paditurit dhe, në mënyrë përjashtimore, në vendqëndrimin e të paditurit që është person fizik. Kështu, vendqëndrimi i zakonshëm nuk është një kusht për juridiksionin e përgjithshëm ndërkombëtar në LDNP.

Nëse i padituri është një person juridik, në përputhje me rregullin e juridiksionit të përgjithshëm, ai mund të paditet në vendin ku ka selinë. Nocioni i selisë (si dhe i vendbanimit) të të paditurit përcaktohet në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Në çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me persona juridikë, në rast dyshimi, vendi ku zhvillohet aktiviteti do të konsiderohet vendi ku ndodhet selia. Në mosmarrëveshjet kundër Malit të Zi ose njësive të qeverisjes vendore, seli do të konsiderohet vendndodhja e parlamentit.⁴⁴⁸

Në disa çështje, vendqëndrimi i të paditurit mund të shërbejë gjithashtu si bazë për këtë lloj juridiksioni, por vetëm në rastet kur i padituri është një person fizik. Nëse një i paditur nuk ka një vendbanim në Malin e Zi dhe as në një shtet tjetër, atëherë juridiksionin do ta ketë një gjykatë në Malin e Zi, në rast se i padituri e ka vendqëndrimin në këtë shtet.⁴⁴⁹

LDNP e zgjeron juridiksionin e përgjithshëm të gjykatave vendase në rastin e ekzistencës së bashkë të paditurve materialë, si dhe në rastin e çështjeve jokontestimore, nëse përmbushen kushte të caktuara. Në rastin e një kërkesëpadie ku përfshihen disa të paditur me statusin e bashkë të paditurve materialë, një gjykatë malazeze do të ketë gjithashtu juridiksion kur një nga të paditurit e ka vendbanimin ose selinë në Malin e Zi.⁴⁵⁰ Në rastet kur përcaktohet një marrëdhënie juridike në një procedurë jokontestimore ku përfshihen disa palë, një gjykatë malazeze ka juridiksion nëse pala kundër së cilës është ngritur padia e ka vendbanimin ose selinë në Malin e Zi, dhe në rastet kur procedura përfshin vetëm një person, nëse ky person e ka vendbanimin ose selinë në Malin e Zi.⁴⁵¹ Në procedurat jokontestimore nuk ka të paditur kështu që gjykata fillon duke përcaktuar vendbanimin e personit, roli i të cilit në procedurë është i ngjashëm me atë të të paditurit. Për më tepër, nuk ka një opsion alternativ për të përcaktuar vendqëndrimin e të paditurit, nëse ky i fundit është një person fizik pa vendbanim.

5.2. Caktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur/i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës)

Dispozitat për caktimin e juridiksionit me marrëveshje në LDNP janë frymëzuar nga rregullat e Konventës së Luganos, Rregullorja I bis e Brukselit (përpara riformulimit të vitit 2012) dhe Konventa e HCCH-së "Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës" (në fuqi në Malin e Zi nga data 8 janar 2018). Idetë bazë të këtyre dokumenteve ndërkombëtare u përshtatën në një legjislacion të vetëm kombëtar.

LDNP parashikon mundësinë e zgjedhjes së marrëveshjeve për caktimin e juridiksionit të gjykatave malazeze dhe të huaja. Sipas LDNP-së, palët mund të bien dakord mbi juridiksionin e një autoriteti të huaj gjyqësor (të një ose më tepër gjykatave ndërkombëtare) ose të gjykatave vendase (të një ose më tepër gjykatave vendase) në çështjet për të cilat mund të japin vendime lirisht, pavarësisht

shtetësisë, vendbanimit ose vendqëndrimit të tyre,⁴⁵² për sa kohë që në marrëdhënien e tyre ka një karakter ndërkombëtar. Ky formulim shkon përtej rregullit të mëparshëm të ligjit ish-Jugosllav «Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera (ZKLR)»⁴⁵³ dhe ka si synim liberalizimin e kësaj fushe.⁴⁵⁴ Kështu, LDNP është në përputhje me nenin 1, paragrafi 2 "Objekti", të Konventës së HCCH-së të vitit 2005 "Për zgjedhjen e gjykatës", ku përcaktohet përkufizimi i një çështjeje ndërkombëtare (rregullat juridiksionale të konventës do të zbatohen nëse palët nuk e kanë vendqëndrimin në të njëjtin shtet, ose nëse një element tjetër me rëndësi për mosmarrëveshjen [pavarësisht vendndodhjes së gjykatës së zgjedhur] ka lidhje me një shtet tjetër).

Sipas LDNP-së, caktimi i juridiksionit me marrëveshje nuk do të ketë efekt nëse gjykata e Malit të Zi ka juridiksion ekskluziv mbi një lloj të caktuar mosmarrëveshjeje, dhe nëse mosmarrëveshja është e llojit të tillë që palët nuk mund të bien dakord mbi juridiksionin sepse nuk mund të zbatojnë lirisht të drejtat e tyre.⁴⁵⁵ Për shembull, në rastin e një mosmarrëveshjeje për transferimin e të drejtave të pronësisë të një pasurie të paluajtshme që ndodhet në Malin e Zi, gjykatat vendase kanë juridiksion ekskluziv dhe çdo marrëveshje për juridiksionin e një gjykate të huaj lidhur me këtë mosmarrëveshje nuk do të prodhojë efekte ligjore në Malin e Zi. Por, nëse kemi të bëjmë me një marrëveshje për caktimin e juridiksionit në lidhje me një mosmarrëveshje për pagesën e dëmeve që vjen si pasojë e mosekzekutimit të një kontrate për shitjen e kësaj pasurie të paluajtshme, në rastin kur kjo mosmarrëveshje nuk bën pjesë në juridiksionin ekskluziv të gjykatave malazeze, atëherë një vendim gjyqësor i bazuar në këtë marrëveshje mund të njihet në Malin e Zi nëse përmbush kushte të tjera ligjore të parashikuara.⁴⁵⁶

Një marrëveshje për caktimin e juridiksionit të një gjykate mund të parashikohet përpara se të lindë një mosmarrëveshje, për shembull, si klauzolë në një kontratë shitjeje, ku të përcaktohet se të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë mund të zgjidhen nga gjykatat e një vendi të caktuar, ose pasi të ketë lindur një mosmarrëveshje, në formën e caktimit të juridiksionit me marrëveshje. Në të dy rastet, theksi është te caktimi i juridiksionit me marrëveshje për mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënie të caktuara. Nuk lejohet vendosja e një klauzole të përgjithshme për caktimin e juridiksionit me marrëveshje, mbi bazën e të cilit mund të supozohet një juridiksion i caktuar për të gjitha mosmarrëveshjet e ardhshme që lindin nga marrëdhëniet juridike të palëve, pavarësisht objektit të mosmarrëveshjes.⁴⁵⁷ Një gjykatë vendase ose e huaj ka juridiksion ekskluziv përveçse kur palët bien dakord ndryshe.

Një marrëveshje për caktimin e juridiksionit finalizohet ose konfirmohet: (1) me shkrim; (2) në një format në përputhje me praktikën e përcaktuar më parë nga palët; ose 3) në marrëdhëniet në fushën e tregtisë dhe shkëmbimit ndërkombëtar, në një format në përputhje me praktikën e njohur ose që duhet të njihet nga palët, dhe që njihet përgjithësisht në fushën e tregtisë dhe që zbatohet rregullisht nga palët në marrëveshje të të njëjtit lloj. Një marrëveshje për caktimin e juridiksionit konsiderohet se është finalizuar me shkrim nëse është finalizuar përmes mjeteve elektronike të komunikimit, me anë të të cilave mund të krijohet një kopje e përhershme e marrëveshjes.⁴⁵⁸

Krahas marrëveshjes së shprehur ndërmjet palëve, në çështjet kur lejohet një marrëveshje për caktimin e juridiksionit të një gjykate malazeze, juridiksioni i kësaj gjykate mund të përcaktohet

452 Sipas Konventës së HCCH-së të vitit 2005 „Për zgjedhjen e gjykatës” (Neni 1, paragrafi 2), një çështje konsiderohet me juridiksion ndërkombëtar përveçse kur palët e kanë vendqëndrimin në të njëjtin shtet palë dhe marrëdhënia e palëve dhe e të gjithë elementëve të tjerë me rëndësi në mosmarrëveshje, pavarësisht se ku ndodhet gjykata e zgjedhur, kanë lidhje vetëm me atë shtet.

453 Ligji „Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera”, Beograd, „Fletorja Zyrtare e RSFJ-së” nr. 43/82, 72/82 dhe „Fletorja Zyrtare e RSFJ-së” nr. 49/96.

454 Më parë, në përputhje me nenin 49 të ZKLR-së, në mënyrë që të arrihej një dakordësi mbi juridiksionin e një gjykate vendase, të paktën një nga palët duhet të ishte qytetar i Malit të Zi ose në rastin e një personi juridik, të kishte selinë në Malin e Zi. Për të caktuar me marrëveshje juridiksionin e një gjykate të huaj, është e nevojshme të ekzistojë elementi i shtetësisë së huaj ose selia të ndodhet në një shtet të huaj dhe gjykata malazeze të mos ketë juridiksion ekskluziv.

455 Neni 104 i LDNP-së.

456 Pak, Milan. *Međunarodno privatno pravo*, 4. izdanje (Private International Law, 4th edn.). Belgrade, Službeni list SRJ, 2000, f. 56.

457 Triva, Siniša and Mihajlo Dika. *Građansko parnično procesno pravo*, 6. izdanje (Civil Litigation Law, 6th edn.). Zagreb, Narodne novine, 2004, f. 286; Jakšić, Aleksandar. *Građansko procesno pravo* (Civil Procedural Law). Belgrade, Univerzitet u Beogradu, Pravni fakultet 2010; Vuković, Đuro. *Međunarodno građansko procesno pravo* (International Civil Procedural Law). Zagreb, Informator, 1987, f. 29.

458 Neni 105 i LDNP-së.

përmes dhënies së pëlqimit nga një i paditur. Një i paditur do të konsiderohet se ka dhënë pëlqimin e tij që një gjykatë malazeze të ketë juridiksion, nëse ka depozituar një përgjigje me shkrim ndaj një kërkesëpadie ose një ankesë kundrejt një urdhri pagese, ose nëse ka argumentuar themelin e çështjes pa kundërshtuar juridiksionin.⁴⁵⁹

5.3. Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Përpara se të krahasojmë kriteret kombëtare mbi juridiksionin me kriteret nga neni 5 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, do të japim një përmbledhje të shkurtër të bazës kryesore për juridiksionin e posaçëm në LDNP. Ky legjislacion i përmbahet një baze përgjithësisht të pranuar për juridiksionin e posaçëm ndërkombëtar,⁴⁶⁰ (shtetësia,⁴⁶¹ vendqëndrimi i zakonshëm, vendbanimi i paditësit, vendi ku ndodhet pasuria, vendi i përmbushjes së një kontrate, vendi i ngjarjes së dëmshme e kështu me radhë).

Përcaktimi i juridiksionit të posaçëm për të mbrojtur një kategori të caktuar personash, veçanërisht palën më të dobët, në rolin e paditësit, bazohet në vendbanimin e konsumatorit, vendin e zakonshëm të punës së punonjësit e kështu me radhë. Mbrojtja e posaçme për konsumatorët dhe punonjësit bazohet kryesisht në argumentet që:

1. pala më e dobët në rolin e paditësit e ndërmerr procedurën në Malin e Zi: në rastin e kontratave me konsumatorin, nëse konsumatori e ka vendbanimin në Malin e Zi, dhe në rastin e kontratës së punës, nëse punonjësi e kryen zakonisht punën e tij në Malin e Zi;⁴⁶²
2. pala tjetër në kontratë (shoqëria, punonjësi) mund ta nisë procedurën vetëm në Malin e Zi, si vendbanimi i palës më të dobët;
3. për të shmangur devijimet nga ky sistem, palët kanë mundësi të kufizuar për të përcaktuar juridiksionin.

LDNP prezanton konceptin e juridiksionit përjashtimor (Forum necessitatis) dhe parashikon mundësinë e përcaktimit të juridiksionit të gjykatave dhe organeve të Malit të Zi, kur ky juridiksion nuk është i parashikuar me ligj.⁴⁶³ Megjithatë, kjo mundësi ka karakter përjashtimor dhe kërkon përmbushjen e disa kushteve: procesi nuk mund të nisë jashtë shtetit, ose do të ishte e paarsyeshme të kërkohej që masa të ndërmerrej jashtë shtetit, dhe çështja ka një lidhje të mjaftueshme me Malin e Zi.⁴⁶⁴

Seksioni në vijim krahason kriteret juridiksionale të nenit 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, me kriteret e burimeve ligjore kombëtare (LDNP) dhe jep një konstatim të shkurtër mbi përputhshmërinë e tyre.

Rregulli i juridiksionit të përgjithshëm në LDNP parashikon se juridiksioni i përket gjykatës që ndodhet në vendbanimin e të paditurit. Për rrjedhojë, vendqëndrimi i zakonshëm nuk shërben si bazë për këtë lloj juridiksioni për çështjet që mbulohen nga Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, kështu që këto kriterë nuk përputhen me nenin 5, paragrafi 1, germa “a”.

Në përgjithësi, vendqëndrimi i zakonshëm nuk shërben si standard për juridiksionin në LDNP

459 Neni 106 i LDNP-së.

460 Kostić-Mandić, Maja. “The New Private International Law Act of Montenegro.” *Yearbook of Private International Law*, Vol. XVI, 2014/2015, f. 437–438.

461 Duke qenë se shtetësia nuk është me rëndësi për këtë fushë, ajo nuk do të trajtohet në studimin e mëposhtëm.

462 Edhe nëse punonjësi nuk punon ose nuk ka punuar rregullisht në një vend, nëse njësia e biznesit që ka punësuar punonjësin ndodhet ose ndodhej në Malin e Zi.

463 Caktimi i juridiksionit të gjykatave në Malin e Zi vjen si rrjedhojë e garantimit të aksesit në drejtësi, si një nga të drejtat themelore të njeriut, edhe pse LDNP nuk parashikon kompetencën e organeve malazeze për këtë lloj marrëdhënieje.

464 Neni 113 i LDNP-së.

për çështjet e trajtuara në këtë studim. Ligji nuk parashikon rregulla të veçanta mbi juridiksionin lidhur me personat fizikë që kryejnë veprimtari biznesi dhe nuk mund të aplikohen rregulla të tjera me analogji. Rrjedhimisht, kriteret kombëtare për juridiksionin nuk janë të përputhshme me nenin 5, paragrafi 1, germa “b”.

Për më tepër, nuk ka dispozita të veçanta në LDNP ku të përcaktohet se një vendim gjyqësor është i përshtatshëm për njohje, nëse personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi është personi që ka paraqitur kërkesëpadinë, e ndryshme nga një kundërpadi, mbi të cilën bazohet vendimi. Për rrjedhojë, kriteret kombëtare për juridiksionin nuk janë të përputhshme me nenin 5, paragrafi 1, germa “c”.

Neni 102 i LDNP-së, i titulluar “Juridiksioni sipas vendit të biznesit”, është në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, germa “d”. Ai përcakton se një gjykatë malazeze ka juridiksion mbi një mosmarrëveshje që lind nga veprimtaria e biznesit të një dege, njësie përfaqësuese ose strukture dytësore që ndodhet në Malin e Zi, edhe në rastin kur i padituri nuk e ka selinë juridike në Malin e Zi.

LDNP parashikon se në çështjet ku lejohet një marrëveshje për caktimin e juridiksionit të një gjykate malazeze, në përputhje me nenin 103, juridiksioni i gjykatës malazeze mund të përcaktohet përmes dhënies së pëlqimit nga i padituri (neni 106, paragrafi 1). Për më tepër, ligji “Për procedurën civile” trajton situatat kur juridiksioni i gjykatës vendase varet nga dhënia e pëlqimit të të paditurit.⁴⁶⁵ Për rrjedhojë, dispozitat e ligjit malazez janë në përputhje me situatat në të cilat i padituri e ka pranuar shprehimisht juridiksionin e gjykatës së origjinës gjatë procesit në të cilin është dhënë një vendim gjyqësor sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “e”, në mënyrën e shpjeguar në raportin shpjegues.⁴⁶⁶

Neni 106, paragrafi 2 i LDNP-së trajton një situatë të ngjashme me atë të nenit 5, paragrafi 1, germa “f” të konventës. Një i paditur konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për juridiksionin e një gjykate malazeze nëse ka depozituar një kundërpadi ose një ankesë kundrejt një urdhri pagese, nëse në seancën dëgjimore ose nëse nuk ka pasur një seancë të tillë, në seancën e parë për themelin e çështjes, ka hyrë në diskutime pa e kundërshtuar juridiksionin, ose nëse ka depozituar një kundërpadi.

Për sa i përket juridiksionit për të shqyrtuar mosmarrëveshjet kontraktore, LDNP (neni 123) pasqyron formulimin e nenit 5, paragrafi 1, germa “g” dhe nenit 5, paragrafi 1, germa “g”, pika I të konventës në një rregull të përgjithshëm, ku trajtohet madje edhe përkufizimi mbi vendin e përmbushjes së detyrimit, përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe (në rastin e furnizimit të mallrave, vendi ku, sipas kontratës, janë dërguar ose duhet të dërgohen mallrat; në rastin e furnizimit të shërbimeve, vendi ku, sipas kontratës, janë ofruar ose duhet të ofrohen shërbimet). Duke qenë se palët janë të lira të bien dakord për detyrimet kontraktore, ato mund të arrijnë një marrëveshje tjetër. Megjithatë, filtri i parashikuar nën pikën (ii) trajtimi i ligjit të zbatueshëm për kontratën, nuk zbatohet në Malin e Zi.

Juridiksioni ekskluziv i gjykatave malazeze ekziston vetëm për proceset që lidhen me qiramarrjen afatgjatë të pasurive të paluajtshme që ndodhen në Malin e Zi. Nëse arrihet një marrëveshje për marrjen me qira të një pasurie të paluajtshme, për përdorim privat të përkohshëm, për një periudhë prej jo më tepër se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, nëse qiramarrësi është një person fizik, dhe si qiradhënësi po ashtu dhe qiramarrësi e kanë vendbanimin në një vend tjetër, atëherë gjykatat malazeze nuk do të kenë juridiksion ekskluziv dhe në këtë rast ekziston përputhshmëri me nenin 119, paragrafi 2 të LDNP-së me nenin 5, paragrafi 1, germa “h” të konventës.

Në përputhje me nenin 101 të LDNP-së, një gjykatë malazeze që ka juridiksionin për të shqyrtuar

465 Neni 9, paragrafi 3 i ligjit „Për procedurën civile” përcakton se: „Nëse gjatë një procedure, gjykata arrin në konkluzionin se një gjykatë vendase nuk ka juridiksion mbi mosmarrëveshjen, ajo deklaron se nuk është kompetente, anulon masat e realizuara gjatë procedurës dhe refuzon ankesën, përveçse kur juridiksioni i gjykatës vendase varet nga dhënia e pëlqimit të të paditurit, dhe i padituri ka dhënë pëlqimin e tij.”

466 Raporti shpjegues, f. 95-96. <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

një ose disa masa, do të ketë gjithashtu juridiksionin për të shqyrtuar masa të tjera nëse lidhen me një masë mbi të cilën ka juridiksion gjykata malazeze (do të konsiderohet se masat kanë lidhje me njëra-tjetrën nëse janë aq të përlefërta saqë mund të shqyrtohen së bashku dhe mund të jepet një vendim i përbashkët për to, me qëllim që të shmanget rreziku i vendimeve gjyqësore kontradiktore nëse masat shqyrtohen veçmas). Në mënyrë të përgjithshme, kjo doktrinë pranon në mënyrë unanime se juridiksioni ekskluziv i gjykatave malazeze ekziston vetëm në lidhje me efektet ligjore pronësore të kontratave për pasuritë e paluajtshme. Në mënyrë analogjike, një vendim gjyqësor do të kualifikohet për njohje nëse vendimi jepet kundër të paditurit për një detyrim kontraktor që garantohet nga një e drejtë reale (*in rem*) mbi një pasuri të paluajtshme që ndodhet në Malin e Zi, nëse kërkesëpadija kontraktore është paraqitur së bashku me një kërkesëpadi kundër të njëjtit të paditur lidhur me të drejtën reale (*in rem*) dhe nëse ky kriter është plotësisht në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, germa “i” të konventës.

Kriteri i parashikuar në LDNP, përkatësisht në nenin 126, paragrafi 1, ku përcaktohet se “Një gjykatë malazeze ka juridiksion për të shqyrtuar mosmarrëveshjet që lidhen me marrëdhënie jokontraktore, edhe në rastet kur dëmtimi/shkelja ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhë në territorin e Malit të Zi”, është plotësisht në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, germa “j” të konventës.

Ligji malazez nuk e njeh konceptin e besimit pasi është një kategori ligjore e panjohur nga sistemi ligjor vendas. Rrjedhimisht, nuk ka dispozitë në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, germa “k” të konventës.

Për sa i përket juridiksionit për një vendim gjyqësor të dhënë për një kundërpadi, LDNP parashikon, në mënyrë të përgjithshme, se gjykata malazeze ka juridiksion për të shqyrtuar kundërpadinë që lind nga e njëjta marrëveshje ose të njëjtat fakte mbi të cilat është mbështetur masa bazë, por nuk parashikon filtra shtesë nga neni 5, paragrafi 1, germa “i”, pikat I dhe II.

Duke qenë se Mali i Zi është një shtet palë në Konventën e HCCH-së të vitit 2005 “Për zgjedhjen e gjykatës”, në përputhje me këtë konventë ai ka prezantuar dispozita mbi të njëjtën fushë në LDNP (nenet 103, 104) dhe ka harmonizuar plotësisht legjislacionin e tij me përkufizimin e marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatës, sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “m” të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

Dispozitat e LDNP-së lidhur me juridiksionin në çështjet e punësimit dhe të konsumatorëve (nenet 124-125) janë në linjë me Konventën e Luganos dhe në përputhje me kriteret e nenit 5, paragrafi 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

Dispozitat e LDNP-së për juridiksionin ekskluziv (nenet 119, 111) janë plotësisht në përputhje me nenin 5, paragrafi 3 të konventës.

5.4. Juridiksioni ekskluziv

LDNP e rregullon juridiksionin ekskluziv duke pasqyruar nenin 22, paragrafi 1 të Konventës së Luganos. LDNP specifikon se një gjykatë malazeze ka juridiksion ekskluziv në rastet kur diçka e tillë parashikohet shprehimisht nga ky ligj ose një ligj tjetër. Bazuar në LDNP, gjykatat e Malit të Zi kanë kompetenca ekskluzive për dy grupe marrëdhëniesh: ato që lidhen me pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Malin e Zi dhe procedurat ku ushtrimi i disa të drejtave private varet nga autoritetet e Malit të Zi, për çështjet përtej fushës së veprimit të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.⁴⁶⁷

Fusha e parë përfshin juridiksionin ekskluziv të gjykatave të Malit të Zi për proceset që lidhen me blerjen, transferimin, ndryshimin ose mbarimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme në Malin e Zi, si dhe për marrjen me qira të pasurive të paluajtshme që ndodhen në këtë vend. Në këtë

⁴⁶⁷ Në fushat e trajtuara përfshihen: regjistrimi në regjistrat publikë të Malit të Zi, vlefshmëria, pavlefshmëria ose shpërbërja e një shoqërie apo personi tjetër juridik, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre, nëse e kanë selinë në Malin e Zi, dhe procedurat që lidhen me regjistrimin ose vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë industriale në Malin e Zi (përkatësisht nenet 111, 118 dhe 122 të LDNP-së).

rast, duhet të bëhet dallimi ndërmjet efekteve ligjore pronësore dhe të detyrueshme të kontratës. Nëse të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme transferohen sipas një kontrate, juridiksioni ekskluziv zbatohet vetëm për efektet pronësore të kontratës.⁴⁶⁸ Për sa i përket marrjes me qira të pasurive të paluajtshme që ndodhen në Malin e Zi, juridiksioni ekskluziv i gjykatave vendase ekziston vetëm për proceset që lidhen me qiramarrjen afatgjatë. Nëse arrihet një marrëveshje për marrjen me qira të një pasurie të paluajtshme, për përdorim privat të përkohshëm, për një periudhë prej jo më tepër se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, nëse qiramarrësi është një person fizik, dhe si qiradhënësi po ashtu dhe qiramarrësi e kanë vendbanimin në një vend tjetër, atëherë gjykatat vendase nuk do të kenë juridiksion ekskluziv.⁴⁶⁹

LDNP nuk parashikon juridiksion ekskluziv për mosmarrëveshjet që lidhen me të drejtat reale mbi avionët dhe anijet, dhe as për mosmarrëveshjet që lidhen me qiranë e avionëve dhe anijeve, edhe në rastet kur regjistri i avionëve ose anijeve mbahet në Malin e Zi.⁴⁷⁰

LDNP parashikon gjithashtu rastet e juridiksionit ekskluziv relativ mbi bazën e një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet palëve për caktimin e juridiksionit. Ligji përcakton shprehimisht se juridiksioni ekskluziv bazohet në një marrëveshje për caktimin e juridiksionit të një gjykate vendase ose të huaj, përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe.⁴⁷¹ Mund të krijohet një situatë ku, pavarësisht ekzistencës së një marrëveshjeje për caktimin e juridiksionit, një palë nis procesin në një vend tjetër dhe jo në vendin të cilit i është caktuar juridiksioni me marrëveshje, dhe pala tjetër depoziton një përgjigje me shkrim ndaj një kërkesëpadie ose ankese kundrejt një urdhri pagese, ose argumenton themelin e çështjes pa kundërshtuar juridiksionin. Në këto raste, palët mund të shfrytëzojnë mundësinë që të ndryshojnë juridiksionin kompetent bazuar në autonominë e tyre (që mund të shprehet përmes masave të formës së prerë) për çështjen që nuk mund të trajtohet më sipas rregullave për juridiksionin ekskluziv.

Juridiksioni ekskluziv relativ përfshin gjithashtu rregullat për lloje të caktuara kontratash përmes të cilave ligjvënësi mbron palën më të dobët. Kështu, në rastin e një kontrate me konsumatorin, ligjvënësi mbron konsumatorin, ose në rastin e një kontrate individuale punësimi, mbron punonjësin, duke parashikuar se një palë më e fortë ekonomikisht (tregtuesi ose punëdhënësi) mund të padisë vetëm në Malin e Zi një palë më të dobët që ka vendbanim në Malin e Zi, përveçse kur palët caktojnë një gjykatë tjetër përmes një marrëveshjeje për caktimin e juridiksionit.⁴⁷²

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

6.1. Qëllimi material i zbatimit

6.1.1. Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Legjislacioni malazez është në përputhje me objektin përmbajtësor që lidhet me çështjet civile

⁴⁶⁸ Galič, Aleš. “Uredba Brisel I: temelj evropskog građanskog procesnog prava (The Brussels I Regulation – the base of European civil procedural law).” *Recent trends in European PIL – challenges for the national legislations of the South East European countries*. Edited by T. Deskoski. Skopje, Faculty of Law Skopje, 2011, f. 50.

⁴⁶⁹ Neni 119, paragrafi 2 i LDNP-së.

⁴⁷⁰ Neni 121 i LDNP-së.

⁴⁷¹ Nenet 103-104 të LDNP-së.

⁴⁷² Nenet 124-125 të LDNP-së.

dhe tregtare siç përcaktohet nga neni 1 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" i cili trajton objektin e Konventës, duke e përkufizuar në terma përmbajtësorë dhe gjeografikë.⁴⁷³

Për më tepër, njohja dhe ekzekutimi nuk shtrihen specifikisht për çështjet e të ardhurave dhe doganave në Malin e Zi. Megjithatë, vendimet mbi themelin e çështjes në çështjet administrative mund të jenë objekt njohjeje dhe ekzekutimi, në përputhje me kushtet e rrepta të shpjeguara në detaje në seksionin 6.2. të këtij studimi.

Legjislacioni malazez është gjithashtu në përputhje me nenin 2, paragrafi 1 dhe filtrat e tij (nënparagrafët "a" deri në "q") të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", të cilat përjashtojnë disa çështje të caktuara nga objekti i konventës. Në Malin e Zi, statusi i personave fizikë, detyrimi ushqimor, çështjet familjare, çështjet e trashëgimisë (nënparagrafët "a", "b", "c", "d") si çështje civile tradicionale mund të jenë objekt i njohjes dhe ekzekutimit në përputhje me LDNP-në. Disa çështje të renditura në nenin 2, paragrafi 1 të konventës përfshihen në juridiksionin ekskluziv të gjykatave malazeze (nënparagrafët "e", "i", "j", "m", me përjashtim të vendimeve gjyqësore për pronësinë intelektuale bazuar në të drejtën për kontratat e përgjithshme), dhe disa prej tyre janë objekt i traktateve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara (nënparagrafët "f", "g", "h"). Për sa i përket çështjeve të tjera të renditura, ato duhet të shqyrtohen për të përcaktuar nëse vendimet gjyqësore në raste konkrete përfshihen në nocionin e çështjeve civile dhe vendimeve gjyqësore të kualifikuara për njohje dhe ekzekutim (nënparagrafët "k", "l"). Çështjet e tjera të renditura, në përgjithësi nuk konsiderohen çështje civile ose tregtare në legjislacionin malazez nëse burojnë nga ushtrimi i autoritetit të shtetit (acta iure imperii).

Neni 2, paragrafi 2 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" i referohet rasteve "kur një çështje e përjashtuar nga objekti i konventës ishte objekt i procesit, dhe jo rasteve kur ka lindur si një çështje paraprake, veçanërisht gjatë procedurave të mbrojtjes."⁴⁷⁴ Një çështje paraprake, edhe pse jo në këtë kontekst, trajtohet në nenin 155 të LDNP-së ku përcaktohet se "Në rastet kur një gjykatë malazeze trajton njohjen ose deklaratën e ekzekutueshmërisë së një vendimi të huaj gjyqësor si çështje paraprake, atëherë gjykata malazeze ka juridiksion lidhur me njohjen e këtij vendimi ose të deklaratës si të ekzekutueshme, gjatë procedurës së marrjes së një vendimi lidhur me çështjen për të cilën është bërë kërkesa."

Procedurat e arbitrazhit dhe procedurat që lidhen me to, të trajtuara në nenin 2, paragrafi 3 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", si çështje të përjashtuara nga objekti i konventës, janë plotësisht në përputhje me legjislacionin e Malit të Zi pasi këto çështje përfshihen në Konventën e Nju-Jorkut të vitit 1958 "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit" dhe në ligjin "Për arbitrazhin".⁴⁷⁵

Legjislacioni i brendshëm i Malit të Zi është në përputhje me nenin 2, paragrafi 4 dhe 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore". LDNP parashikon gjithashtu se dispozitat e tij do të zbatohen edhe për marrëdhëniet e së drejtës private në të cilat përfshihet një element ndërkombëtar dhe në të cilat njëra nga palët është një shtet, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji. Duke qenë se privilegjet dhe imunitetet e trajtuara në nenin 2, paragrafi 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", në përgjithësi lidhen me ushtrimin e autoritetit të shtetit (acta iure imperii), situatat që lidhen me privilegjet dhe imunitetet nuk sjellin vendime gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare.⁴⁷⁶

6.2. Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh., vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme)

Në Malin e Zi mund të jetë objekt i njohjes një vendim i huaj gjyqësor, zgjidhjet gjyqësore ose një vendim i një autoriteti tjetër që është i barasvlershëm me një vendim gjyqësor në vendin e origjinës dhe që rregullon marrëdhëniet ligjore private me element ndërkombëtar.⁴⁷⁷ Mund të njihen vetëm vendimet mbi themelin e çështjes, pavarësisht vendit se ku janë marrë dhe pavarësisht llojit të autoritetit që ka dhënë vendimin, përfshirë në rastet e autoriteteve jo-gjyqësore, për sa kohë që vendimi është dhënë sipas formës dhe procedurës së parashikuar nga ligji dhe nga një autoritet kompetent për miratimin e këtij vendimi në përputhje me ligjin e vendit ku është marrë vendimi (p.sh. vendimi i një organi të huaj administrativ ose fetar për divorcin mund të njihet nëse përmbush kushtet përkatëse për njohjen e tij).⁴⁷⁸ Ligji "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive" përcakton se vendimet e huaja të ekzekutueshme duhet të plotësojnë kërkesat për njohje dhe ekzekutim, të parashikuara nga ligji ose traktati ndërkombëtar, në mënyrë që të jenë objekt i procedurës së ekzekutimit (neni 12). Ky ligj rendit vendimet gjyqësore dhe vendimet në procedurat administrative që mund të jenë objekt i procedurës së ekzekutimit (duke përfshirë gjithashtu edhe vendimet e huaja). Sipas këtij ligji, vendimet gjyqësore përfshijnë vendimet e gjykatës për sigurimin e kërkesëpadive, për pagesat dhe vendime të tjera të gjykatës, si vendimet e arbitrazhit dhe zgjidhjet gjyqësore (neni 10, paragrafi 1). Vendimet që lidhen me procedurën administrative sipas këtij ligji janë: një vendim gjyqësor dhe konkluzion i një organi shtetëror administrativ dhe i një organi tjetër shtetëror, si dhe i një organizate biznesi ose subjekti tjetër ligjor të miratuar në zbatim të autorizimeve publike dhe marrëveshjeve të arritura në përputhje me ligjin që rregullon procedurën e përgjithshme administrative (neni 19, paragrafi 2).

Për sa i përket zbatimit të rregullit të parashikuar në nenin 19, paragrafi 1 të LESK-së për vendimet e huaja gjyqësore, mund të përmendet lista në vijim: vendimet e huaja me karakter ndëshkimor në çështjet civile dhe vendimet e huaja me karakter ndëshkimor në çështjet civile, jokontestimore dhe ekzekutive, vendimet e huaja gjyqësore për sigurinë, pagesat e huaja dhe urdhra të tjerë të huaj të gjykatës, vendimet e huaja të arbitrazhit, zgjidhjet gjyqësore të arritura para një gjykate.⁴⁷⁹

Karakteri i huaj i vendimit lidhet me momentin kur vendimi merr formë të prerë. Për shembull, vendimet e gjykatave në Slloveni ose Kroaci që kanë marrë formë të prerë gjatë ekzistencës së Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë nuk mund të konsiderohen si vendime të huaja.⁴⁸⁰

6.3. Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)

Procedura për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor nis përmes dorëzimit një kërkesë. Njohja e vendimeve të huaja gjyqësore përfshihet në juridiksionin territorial të gjykatës që ka momentalisht juridiksionin.

Në rastet kur një gjykatë malazeze trajton njohjen ose deklaratën e ekzekutueshmërisë së një vendimi të huaj gjyqësor si çështje paraprake, atëherë gjykata malazeze ka juridiksion për njohjen e këtij vendimi ose të deklaratës si të ekzekutueshëm, gjatë procedurës së marrjes së vendimit lidhur me çështjen për të cilën është bërë kërkesa.⁴⁸¹

⁴⁷⁷ Neni 141 i LDNP-së.

⁴⁷⁸ Pak, Milan. *Međunarodno privatno pravo* (Private International Law). Belgrade, Nomos, 1991, f. 104.

⁴⁷⁹ Račić, Ranka. *Sprovođenje stranih izvršnih naslova u Crnoj Gori* (Enforcement of Foreign Executory Titles in Montenegro). Podgorica, Pravni zbornik, no. 3/2019, f. 73.

⁴⁸⁰ Për sa i përket praktikës ligjore në Serbi, *shihni*: Varadi, Bordaš, Knežević, Pavić. *Međunarodno privatno pravo*, 14. izdanje (Private International Law, 14th edn.). Belgrade, Univerzitet u Beogradu, Pravni fakultet, 2012, f. 583.

⁴⁸¹ Nenet 152 dhe 155 të LDNP-së.

⁴⁷³ Raporti shpjegues, f. 52.

⁴⁷⁴ Raporti shpjegues f. 56.

⁴⁷⁵ „Fletorja Zyrtare e Malit të Zi” nr. 47/2015, https://www.paragraf.me/propisi-crnogore/zakon_o_arbitrazi.html

⁴⁷⁶ Raporti shpjegues f. 71.

6.4. Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Dokumentet në vijim duhet të dorëzohen së bashku me kërkesën për njohjen ose deklaratën e ekzekutueshmërisë së një vendimi të huaj gjyqësor: vendimi gjyqësor origjinal ose transkripti i tij i certifikuar, së bashku me një përkthim nga një përkthyes i certifikuar i gjykatës; një vërtetim që konfirmon se vendimi gjyqësor është i formës së prerë sipas ligjit të shtetit ku është dhënë dhe një vërtetim që konfirmon se vendimi është i ekzekutueshëm sipas ligjit të shtetit ku është dhënë, në rastet kur kërkohet një deklaratë për ekzekutueshmërinë e vendimit gjyqësor (LDNP, neni 156).

6.5. Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Në Malin e Zi, parakushtet për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor janë formuluar si kufizime për njohjen, pra janë formuluar në formë mohore. I vetmi parakusht i formuluar në mënyrë pohore është se kërkuesi që kërkon njohjen e vendimit duhet të dorëzojë një vërtetim të gjykatës së huaj kompetente ose të një autoriteti tjetër kompetent që konfirmon se vendimi është i formës së prerë.

Për rrjedhojë, me përjashtim të rastit të mësipërm, barra e provës i takon palës tjetër dhe nëse kjo palë arrin të vërtetojë ekzistencën e një pengese, atëherë njohja e vendimit të huaj gjyqësor duhet të mohohet. Për pengesat e vërtetuara “ex officio” nga gjykata zbatohet një rregull tjetër. Nëse gjykata nuk arrin të përcaktojë ekzistencën ose mungesën e kushteve të nevojshme për *ex officio*, atëherë do të konsiderohet se nuk ka pengesa, dhe rrjedhimisht do të lëshohet një vendim për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor.

Sipas LDNP-së, kushtet për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor janë:

Vendimi duhet të ketë marrë formë të prerë në përputhje me legjislacionin e shtetit të origjinës

Një vendim i huaj gjyqësor do të njihet nëse personi që kërkon njohjen e tij, dorëzon, së bashku me vendimin e huaj gjyqësor (ose transkriptin e tij të certifikuar, një përkthim të certifikuar të vendimit të huaj gjyqësor), një vërtetim nga një gjykatë e huaj ose një autoritet tjetër kompetent që konfirmon se vendimi është i formës së prerë në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës.⁴⁸² Nëse kërkuesi që kërkon njohjen e vendimit nuk arrin të paraqesë një vërtetim as pas shtyrjes së afatit, atëherë kërkesa për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor do të refuzohet.

Pengesat ndaj njohjes së vendimit, të cilat lidhen me shkeljet e mundshme të sistemit juridik të Malit të Zi, si vendi ku kërkohet njohja, përfshijnë:

Juridiksionin ndërkombëtar

Juridiksioni ndërkombëtar përfshin dy raste: mungesën e juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Malit të Zi dhe mungesën e juridiksionit të tepërt të gjykatave të huaja. Ligji specifikon se një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet nëse objekti bën pjesë në juridiksionin ekskluziv të një gjykate ose autoriteti tjetër në Malin e Zi,⁴⁸³ dhe nëse gjykata e huaj e ka bazuar juridiksionin e saj në fakte që nuk njihen nga ligji i Malit të Zi si fakte që mund t'i japin një gjykate malazeze juridiksion ndërkombëtar për të trajtuar të njëjtën mosmarrëveshje.⁴⁸⁴

Të drejtën për t'u mbrojtur

Në ligjin e Malit të Zi, respektimi i të drejtës për t'u mbrojtur nënkupton se një gjykatë malazeze refuzon njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor nëse pas depozitimit të kërkesës së një pale

zbulon se i padituri nuk ka mundur të marrë pjesë në procesin e huaj si pasojë e parregullsive në procedurë. Pamundësia për të marrë pjesë në proces duhet të interpretohet me kujdes, pra që pala nuk ka qenë në gjendje të marrë pjesë në një fazë të caktuar të procedurës dhe se më pas nuk mund të ndryshonte rezultatin përmes procedurës së apelimit ose përdorimit të mjeteve juridike të jashtëzakonshme. Nëse një palë ka pasur në dispozicionin e saj, në fazat e mëvonshme të procesit, një mjet juridik efikas por nuk e ka përdorur, atëherë kjo palë nuk mund të ngrejë pretendime për shkelje të së drejtës për t'u mbrojtur gjatë procedurës për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor.⁴⁸⁵ LDNP specifikon se parregullsitë lidhen “në veçanti” me shërbimin e përshtatshëm dhe kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen,⁴⁸⁶ çka krijon mundësinë e një interpretimi më të gjerë të përmbajtjes së këtij ligji. Në rastin e parë, personi kundër të cilit është marrë vendimi duhet të vërtetojë se nuk mund të merrte pjesë në procedurë pasi nuk e ka marrë personalisht thirrjen për t'u paraqitur, padinë ose vendimin në themel të procesit, ose nuk është bërë asnjë përpjekje për t'i ofruar shërbimin përkatës. Nëse është tentuar informimi në mënyrë personale por diçka e tillë nuk është arritur, atëherë pala kundërshtare nuk mund të mbështetet mbi këtë argument. Ky kundërshtim është karakteristikë e vendimeve të marra në mungesë të të paditurit.⁴⁸⁷ Në rastin e dytë, palës kundërshtare të kërkuesit që ka paraqitur kërkesën për njohje në procedurën e huaj, nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen pasi, për shembull, afatet e trajtimit të pretendimeve të palës tjetër kanë qenë shumë të shkurtra.⁴⁸⁸ Pala kundërshtare e kërkuesit që ka paraqitur kërkesën për njohje nuk mund ta përdorë këtë bazë për të ngritur pretendime nëse ka marrë pjesë në çfarëdolloj mënyre në seancën dëgjimore për themelin e çështjes gjatë procedurave në shkallën e parë.

Ekzistencën e një vendimi të formës së prerë për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë dhe efektet “lis pendens”

Neni 146, paragrafi 1 i LDNP-së parashikon se, “Një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet nëse një gjykatë ose një autoritet tjetër i Malit të Zi ka dhënë një vendim të formës së prerë lidhur me të njëjtat fakte, ose nëse në Malin e Zi është njohur një tjetër vendim i huaj gjyqësor bazuar në të njëjtat fakte”. Për rrjedhojë, ligji malazez i jep prioritet vendimeve kombëtare të formës së prerë, pavarësisht kohës kur është dhënë vendimi, dhe në rast se ka pasur një vendim kombëtar të vlefshëm, ose nëse një vendim i huaj gjyqësor është njohur më parë për të njëjtën çështje ligjore dhe ndërmjet të njëjtave palë, atëherë ky do të jetë një fakt i pashmangshëm për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor.

LDNP parashikon se gjykata do të pezullojë procedurat për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor nëse procedurat e nisura më parë, që përfshijnë të njëjtat fakte dhe ndërmjet të njëjtave palë, janë ende në proces gjykimi nga një gjykatë malazeze. Procedurat do të mbeten të pezulluara derisa të kenë përfunduar procedurat e mëparshme.⁴⁸⁹ Njohja e vendimit do të varet nga rezultati i padisë kombëtare. Nëse çështja gjyqësore kombëtare përfundon me dhënien e një vendimi mbi themelin e saj, atëherë do të kishim të bënim me një çështje të gjykuar (res iudicata) dhe për rrjedhojë një vendim i huaj gjyqësor nuk do të mund të njëhej. Nëse procedura në Malin e Zi nuk përfundon me dhënien e një vendimi mbi themelin e saj, procedura e njohjes së vendimit të huaj do të vazhdojë.

Shkeljen e rendit publik

Një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet nëse efekti i njohjes së tij, dhe jo vetë gjykimi, do të ishte dukshëm në kundërshtim me rendin publik të Malit të Zi.⁴⁹⁰ Gjikata do të veprojë ex

482 Neni 142 dhe neni 149, paragrafi 2 i LDNP-së.

483 Neni 144 i LDNP-së.

484 Neni 145 i LDNP-së.

485 Dika, Mihajlo, Gaša Knežević dhe Srđan Stojanović. *Komentar Zakona o međunarodnom privatnom i procesnom pravu* (Commentary of the PILA). Belgrade, Nomos, 1991, f. 290.

486 Neni 143 i LDNP-së.

487 Stanivuković, Maja dhe Mirko Živković. *Međunarodno privatno pravo: opšti deo* (Private International Law: General Part). Belgrade, Službeni list SCG, 2004, f. 453.

488 *Po aty*.

489 Neni 146, paragrafi 2 i LDNP-së.

490 Neni 147 i LDNP-së.

officio. Në këtë rast, mund të shqyrtohet themeli i vendimit dhe ekzistenca e parregullsive ligjore procedurale me rëndësi gjatë dhënies së një vendimi të huaj gjyqësor. Në të dyja rastet, duhet pasur në konsideratë efekti i vendimit të huaj dhe marrëdhënia e tij me parimet bazë të sistemit ligjor vendas. Rendi publik përfshin një mbrojtje ndaj mashtrimit në lidhje me procedurat dhe përmbajtjen.⁴⁹¹

Pengesat e renditura më sipër ndaj njohjes dhe ekzekutimit, të parashikuara në LDNP, janë në përputhje me ato të përcaktuara në nenin 7 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore". Çështjet më të ndërlikuara lidhen me juridiksionin ndërkombëtar. Çështjet që lidhen me juridiksionin trajtohen në disa nene, paragrafë dhe nënparagrafë të Konventës por nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë në LDNP. Për rrjedhojë, dispozita për juridiksionin ekskluziv (neni 6 i Konventës) ka një objekt më të ngushtë se sa koncepti i juridiksionit ekskluziv të shpjeguar në detaje në kreun 5.4. të këtij studimi. Një tjetër aspekt që lidhet me mbrojtjen dhe që nuk është i njëjtë në të dyja burimet ligjore, është nocioni i juridiksionit të tepruar (i ashtuquajtur "imazhi pasqyrë i juridiksionit"), i cili është renditur shprehimisht si pengesë ndaj njohjes në nenin 145 të LDNP-së.

6.6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Në mënyrë që vendimet e huaja gjyqësore të prodhojnë efekt në Malin e Zi, ata duhet t'i nënshtrohen një procesi formal njohjeje të quajtur "exequatur". Neni 141 i LDNP-së parashikon se një vendim i huaj gjyqësor i njohur në Malin e Zi është i barasvlershëm me vendimet e gjykatave vendase. Kjo do të thotë se në Malin e Zi një vendim i huaj gjyqësor mund të prodhojë vetëm ato efekte që janë parashikuar nga sistemi juridik i këtij vendi dhe nuk mund të prodhojë asnjë efekt tjetër që do të kishte prodhuar në shtetin e origjinës. Gjatë procedurës për njohjen e një vendimi të huaj gjykata kufizohet me shqyrtimin nëse janë përmbushur nenet 142-147 të LDNP-së.

Procedura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore rregullohet përmes neneve 152-157 të LDNP-së. Procedura e njohjes nis pas dorëzimit të kërkesës nga një palë.⁴⁹² Gjykata merr vendim rreth kësaj kërkeje përmes një procedure ekstra-gjyqësore të posaçme. Gjatë procedurës së njohjes, gjykata shqyrton vetëm nëse janë përmbushur kushtet për ekzekutim.⁴⁹³ Procedura duhet të jetë e shpejtë dhe zakonisht bazohet në shqyrtimin e dokumenteve me shkrim dhe nuk përfshin seanca dëgjimore. Në vendimin e saj, gjykata mund të njohë një vendim gjyqësor, mund të njohë një vendim gjyqësor dhe ta përcaktojë si të ekzekutueshëm ose mund të refuzojë njohjen e tij. Një palë mund të dorëzojë një ankesë kundër vendimit për njohje pranë këshillit të Gjykatës Themelore ose Gjykatës për Çështjet Tregtare, të përbërë nga tre gjyqtarë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Pala e pakënaqur gëzon të drejtën të apelojë pranë Gjykatës së Lartë (ose pranë Gjykatës së Apelit nëse Gjykata për Çështjet Tregtare ka marrë vendim në cilësinë e një gjykate të shkallës së parë) kundër vendimit që refuzon njohjen. Për më tepër, nëse vendimi i një gjykate të huaj është anuluar nga një gjykatë e vendit të origjinës, atëherë pala përkatëse mund të dorëzojë një kërkesë për të rihapur procedurën si një mjet juridik i jashtëzakonshëm.⁴⁹⁴

Vendimet e huaja gjyqësore me karakter ndëshkimor të njohura nga një gjykatë e Malit të Zi janë tituj ekzekutivë.⁴⁹⁵

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

7.1. Lloji i procedurës përmbarimore

Procedura përmbarimore (e ekzekutimit) rregullohet nga ligji "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive".⁴⁹⁶ Procedura përmbarimore mund të nisë pas kërkesës së bërë nga një palë pranë një agjenti zbatues,⁴⁹⁷ përveçse kur gjykata është kompetente për ekzekutimin.⁴⁹⁸ Agjentët zbatues caktohen nga Ministri i Drejtësisë, i cili mbikëqyr punën e tyre.⁴⁹⁹ Pala përkatëse duhet t'i bashkëngjisë kërkesës për ekzekutim, vendimin për njohjen si dhe konfirmimin se vendimi gjyqësor është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.⁵⁰⁰

Pas marrjes së kërkesës për ekzekutim, agjenti zbatues merr një vendim për nisjen e procedurës së mbledhjes ose për refuzimin e ekzekutimit. Një palë e pakënaqur mund të depozitojë një ankesë kundër këtij vendimi pranë një gjykate kompetente, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit. Megjithatë, kjo ankesë nuk e pengon procedurën e mbledhjes sepse ajo bazohet në titullin ekzekutiv.⁵⁰¹

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se agjentët zbatues janë kompetentë vetëm për të marrë vendime mbi procedurën e ekzekutimit, për të garantuar ekzekutimin si dhe për të garantuar sigurimin e kërkesëpadive, me përjashtim të rasteve kur kompetenca e gjykatave parashikohet me ligj. Megjithatë, kompetenca për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore i takon ekskluzivisht gjykatës kompetente (LDNP, neni 152, paragrafi 1, 2, 3 dhe rrjedhimisht, nëpunësit zbatues publikë nuk mund të vendosin për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor si një çështje paraprake në procedurën e ekzekutimit.⁵⁰²

Mbi bazën e një vendimi që është bërë pjesërisht i ekzekutueshëm, ekzekutimi mund të urdhërohet deri në atë masë të pjesshme. Ekzekutimi urdhërohet gjithashtu bazuar në një vendim gjyqësor jo të formës së prerë dhe të paapelueshëm, si dhe bazuar në një vendim të miratuar përmes një procedure administrative, i cili nuk ka marrë ende formë të prerë, nëse ligji parashikon se apelimi nuk pengon ekzekutimin e një vendimi.

7.2. Procedura përmbarimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me një vendim të gjykatës së huaj

Në rastet kur kërkesës për ekzekutim i është bashkëngjitur një vendim i huaj gjyqësor, agjenti zbatues është i detyruar ta refuzojë këtë kërkesë me arsyetimin se është e papranueshme pasi nuk ka një vendim gjyqësor që të njohë vendimin e huaj gjyqësor. Agjenti është i detyruar të shpjegojë se pse e ka refuzuar kërkesën për ekzekutim dhe ta udhëzojë kreditorin ekzekutiv që të dorëzojë një kërkesë për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor.

8. Referenca

- Raporti Vjetor i Gjykatës Themelore në Podgoricë për vitin 2020, <https://sudovi.me/osp/sadrzaj/d5wx>

491 *Shihni* Kostić-Mandić, Maja. *Međunarodno privatno pravo* (Private International Law). Podgorica, Pravni fakultet UCG, Podgorica, 2017, f. 196-198.

492 Neni 152 i LDNP-së.

493 Neni 153 i LDNP-së.

494 Neni 154 i LDNP-së.

495 Ligji „Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive“, „Fletorja Zyrtare e Malit të Zi“ nr. 36/2011, 28/2014, 20/2015, 22/2017, 76/2017 dhe 25/2019.

496 Ligji "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive", "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 36/2011, 28/2014, 20/2015, 22/2017, 76/2017 dhe 25/2019.

497 Collier, J. G. *Conflict of Laws*. Cambridge University Press, 2004, f. 123.

498 Neni 4 i LESK-së.

499 Ligji „Për agjentët zbatues publikë“, „Fletorja Zyrtare e Malit të Zi“ nr. 61/2011, 22/2017 dhe 17/2019.

500 Rogerson, Pippa. *Collier's Conflict of Laws*. Cambridge University Press, 2013, f. 237.

501 Nenet 47 dhe 49 të ligjit "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive", "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 36/2011, 28/2014, 20/2015, 22/2017, 76/2017 dhe 25/2019.

502 Račić, Ranka. *Sprovođenje stranih izvršnih naslova u Crnoj Gori* (Enforcement of Foreign Executory Titles in Montenegro). Podgorica, Pravni zbornik, no. 3/2019, f. 63–88.

- Collier, J. G., *Conflict of Laws*. Cambridge University Press, 2004.
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 44/2001 e datës 22 dhjetor 2000 "Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare", [2001] FZ L 12/1.
- Dika, Mihajlo, Gaša Knežević, dhe Srđan Stojanović. *Komentar Zakona o međunarodnom privatnom i procesnom pravu (Commentary of the PIL Act)*. Belgrade, Nomos, 1991.
- Explanatory Report of the HCCH 2019 Judgments Convention, <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>
- Galić, Aleš. "Uredba Brisel I: temelj evropskog građanskog procesnog prava (The Brussels I Regulation – the base of European civil procedural law)." *Recent trends in European PIL – challenges for the national legislations of the South East European countries*, edited by T. Deskoski. Skopje, Faculty of Law Skopje, 2011.
- Garcimartin, Francisco dhe Genevieve Saumier. Explanatory Report, on the Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters, The Hague Conference on Private International Law – HCCH, 2020 (Explanatory Report).
- <http://cosdt.me/>
- <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=137>
- <https://www.monstat.org/eng/page.php?id=171&pageid=171>
- <https://www.paragraf.me/>
- https://www.researchgate.net/publication/312353465_Notarial_form_ad_solemnitatem_in_Montenegrin_law
- <http://en.sudovi.me/vrhs/library/laws>
- <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/me/me031en.pdf>
- https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/org6_e.htm
- Jakšić, Aleksandar. *Građansko procesno pravo (Civil Procedural Law)*. Belgrade, Univerzitet u Beogradu, Pravni fakultet, 2010.
- Korać, Velibor. "Notarial Form Ad Solemnitatem in Montenegrin Law." *Annals FLB – Belgrade Law Review*, no. 3. year LXIV, 2016.
- Kostić-Mandić, Maja. *Međunarodno privatno pravo (Private International Law)*. Podgorica, Pravni fakultet UCG, Podgorica, 2017.
- Kostić-Mandić, Maja. "Private International Law of Montenegro." *International Encyclopaedia of Laws*. Kluwer Law International, 2020.
- Kostić-Mandić, Maja. "The New Private International Law Act of Montenegro." *Yearbook of Private International Law*, Vol. XVI, 2014/2015.
- Ligji "Për arbitrazhin" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 47/2015).
- Ligji "Për procedurën civile" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 22/2004, 28/2005 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe 76/2006 dhe "Sl. list CG" nr. 47/2015 – ligj tjetër, 48/2015, 51/2017, 75/2017 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe 62/2018 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 34/2019 dhe 42/19).
- Ligji "Për doganat" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 21/2008, 1/2011, 39/2011, 40/2011,

28/2012, 62/2013 dhe 71/2017).

- Ligji "Për ekzekutimin dhe sigurimin e kërkesëpadive" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 36/2011, 28/2014, 20/2015, 22/2017, 76/2017 dhe 25/2019).
- Ligji "Për noterinë" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 68/2005 dhe "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 49/2008, 55/ 2016 dhe 84/2018).
- Ligji "Për agjentët zbatues publikë" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 61/2011, 22/2017 dhe 17/2019).
- Ligji "Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendimeve të tjera", Beograd ("Fletorja Zyrtare e RSFJ-së" nr. 43/1982, 72/1982 dhe "Fletorja Zyrtare e RSFJ-së" nr. 49/1996).
- Konventa e Luganos, datë 30 tetor 2007, "Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare", [2007] FZ L 339/3.
- Pak, Milan. *Međunarodno privatno pravo (Private International Law)*. Belgrade, Nomos, 1991.
- Pak, Milan. *Međunarodno privatno pravo, 4. izdanje (Private International Law, 4th edn.)*, Belgrade, Službeni list SRJ, 2000.
- Ligji "Për të drejtën ndërkombëtare private" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 1/2014, 6/2014–corr., 11/2014–corr., 14/2014 dhe 47/2015 – ligj tjetër). Ligji "Për gjykatat" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 11/2015).
- Račić, Ranka. *Sprovođenje stranih izvršnih naslova u Crnoj Gori (Enforcement of Foreign Executory Titles in Montenegro)*. Podgorica, Pravni zbornik, no. 3/2019.
- Rregullorja e BE-së nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012, "Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare" (riformulim).
- Rregullorja "Për tarifën doganore" ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 4/2020).
- Rogerson, Pippa. *Collier's Conflict of Laws*. Cambridge University Press, 2013.
- Rregullat e gjykatës së Malit të Zi ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 65/16, 19/19, 58/19, 6/20 dhe 93/20).
- Stanivuković, Maja dhe Mirko Živković. *Međunarodno privatno pravo: opšti deo (Private International Law: General Part)*. Belgrade, Službeni list SCG, 2004.
- Stewart, David P. "The Hague Conference Adopts a New Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters." *American Journal of International Law*, Volume 113, Issue 4, October 2019.
- Teitz, Louise Ellen. "Another Hague Judgments Convention? Bucking the past to provide for the future." *Duke Journal of Comparative & International Law*, Vol. 29.
- Triva, Siniša dhe Mihajlo Dika. *Građansko parnično procesno pravo, 6. izdanje (Civil Litigation Law, 6th edn.)*. Zagreb, Narodne novine, 2004.
- Varadi, Bordaš, Knežević, dhe Pavić. *Međunarodno privatno pravo, 14. izdanje (Private International Law, 14th edn.)*. Belgrade, Univerzitet u Beogradu, Pravni fakultet, 2012.
- Vuković, Đuro. *Međunarodno građansko procesno pravo (International Civil Procedural Law)*. Zagreb, Informator, 1987.

RAPORT KOMBËTAR: REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Autor

Ilija Rumenov

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një përmbledhje të legjislacionit kombëtar në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe të vlerësojë në mënyrë kritike sistemin juridik aktual, strukturën institucionale, praktikën ligjore dhe pengesat ekzistuese për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, ky raport është hartuar duke marrë parasysh zgjidhjet e dhëna në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” me qëllim që të intensifikohet bashkëpunimi ndërkombëtar me Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH) dhe të merret një vendim i bazuar në informacion mbi ratifikimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë punës intensive për përgatitjen e këtij raporti, qëllimi kryesor ishte të përfshiheshin pikëpamjet e aktorëve kryesorë për procedurat e njohjes dhe ekzekutimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, siç është Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (MD), Oda e Përmbartuesve e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe gjykata më e madhe civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Gjykata Themelore Civile e Shkupit.

Strategjia kryesore e Ligjit vendas të së Drejtës Ndërkombëtare Private është t'i përfshijë rregulloret përkatëse të BE-së brenda Ligjit të së Drejtës Ndërkombëtare Private (LDNP 2020) dhe të jetë në përputhje me zhvillimet e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH). Një strategji e tillë synon që gradualisht të bëjë përshtatjen e gjyqësorit me zgjidhjet dhe parimet e parashikuara në rregulloret e BE-së para se Republika e Maqedonisë së Veriut të bëhet shtet anëtar i BE-së, dhe në të njëjtën kohë, të sigurojë një uniformitet të bazuar në përvojat e nxjerra nga Konventat e HCCH-së. Si rezultat, LDNP 2020 synon ta funksionalizojë këtë strategji, prandaj edhe gjetjet përkatëse janë paraqitur në këtë raport. LDNP 2020 ka hyrë në fuqi që nga shkurti i vitit 2021, dhe në kohën kur ky raport ishte duke u hartuar, problemet e mundshme ende nuk ishin shfaqur në praktikë, megjithëse afati kohor i zbatimit të tij është mjaft i shkurtër (vetëm 2 muaj).

Në përgjithësi, në kontekstin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, ky raport tregon se procedura kombëtare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore do ta mbështesë qarkullimin e vendimeve gjyqësore në bazë të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Sidoqoftë, ekzistojnë disa aspekte që LDNP 2020 duhet t'i miratojë për të siguruar një koordinim më të mirë midis këtyre dy instrumenteve ligjore. Shumë nga filtrat e juridiksionit indirekt të parashikuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” gjenden edhe në LDNP 2020. Megjithatë, ka disa aspekte që mund ta cenojnë koordinimin midis LDNP 2020 dhe Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, siç janë problemet me vendbanimin e personave që nuk janë të regjistruar, ose që e kanë braktisur vendbanimin e tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kanë vendqëndrim të zakonshëm në një shtet tjetër.

Sa i përket aktorëve, ky raport tregon se ata janë të vetëdijshëm për burimet ligjore, kompleksitetin dhe ndërlikueshmërinë e burimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, por megjithatë, të gjithë aktorët kanë treguar se është bërë shumë pak në trajnimin praktik të tyre, veçanërisht me zbatimin e LDNP-së së re të vitit 2020 dhe të katër Konventave të HCCH-së të nënshkruara në vitin 2019, të cilat ende nuk janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile

1.1 Përmbledhje e dispozitave kushtetuese dhe ligjore

Dispozitat ligjore për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe veçanërisht ato për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut (M. e Veriut) mbulohen nga dy kategori të ndryshme të burimeve ligjore: burimet ligjore kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Koordinimi midis burimeve ligjore kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohet nga neni 118 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut,⁵⁰³ i cili përcakton epërsinë (mbizotërimin) e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi burimet ligjore kombëtare.⁵⁰⁴ Për më tepër, ligji «Për gjykatat»⁵⁰⁵ shprehimisht thotë se në situatat kur Gjykata konsideron se ligji i brendshëm është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën, atëherë kushtimisht, nëse dispozitat në marrëveshjen ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme, Gjykata do të zbatojë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare.⁵⁰⁶ Një qëndrim i tillë është parashikuar edhe në Ligjin e së Drejtës Ndërkombëtare Private (në vijim referuar si LDNP 2020)⁵⁰⁷ ku epërsia e marrëveshjeve ndërkombëtare përcakton se dispozitat e LDNP 2020 nuk janë të zbatueshme nëse ato rregullohen nga traktatet e ratifikuara ndërkombëtare.⁵⁰⁸

Prandaj, për ta kuptuar siç duhet sistemin e përfshirjes së vendimeve të huaja gjyqësore brenda sistemit të Maqedonisë së Veriut, duhet të përmenden burimet ligjore kombëtare, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare (bilaterale dhe multilaterale) që janë të zbatueshme në Maqedoninë e Veriut. Pjesa 1.1.1 do të trajtojë dispozitat ligjore për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore që janë pjesë e burimeve ligjore kombëtare, ndërsa pjesa 1.1.2. e këtij raporti do të ofrojë një përmbledhje të marrëveshjeve juridike ndërkombëtare që përmbajnë dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore.

1.1.1 Burimet ligjore kombëtare

1.1.1.1. Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i Republikës së Maqedonisë së Veriut

LDNP 2020 u miratua në janar të vitit 2020 (në fuqi që nga shkurti 2021) dhe përfaqëson sistemimin e dytë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private që nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut nga Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë (në vijim referuar si RSFJ) në vitin 1991. Megjithatë, për t'i kuptuar siç duhet rregullat e LDNP-së së re të vitit 2020, duhet të përmenden legjislacionet pararendëse: Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i vitit 2007 (në vijim referuar si LDNP 2007)⁵⁰⁹ dhe ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera për çështje të caktuara” (në vijim referuar si LDNP 1982).⁵¹⁰ Për më tepër, obligimet që rrjedhin nga neni 68 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

me Komunitetet Evropiane dhe Shtetet e tyre Anëtare (MSA)⁵¹¹ lidhur me përshtatjen e ligjeve të brendshme dhe përputhshmërinë e burimeve ligjore të Maqedonisë së Veriut me burimet ligjore të BE-së, kanë një ndikim të rëndësishëm në strukturën dhe përmbajtjen e LDNP-së së re të vitit 2020. Fushëveprimi i LDNP 2020 është ndryshuar pak dhe, në krahasim me LDNP 2007, tani përmban vetëm një paragraf që mbulon të gjitha çështjet e LDNP-së (ligjin e zbatueshëm, juridiksionin dhe procedurën ndërkombëtare dhe njohjen e ekzekutimin). Ky rregull gjithashtu nuk specifikon lëndën e marrëdhënieve të mbuluara nga LDNP 2020,⁵¹² por përmban përkufizimin e përgjithshëm që LDNP 2020 zbatohet për “... marrëdhëniet juridike private që përmbajnë një element ndërkombëtar...”.⁵¹³

1.1.1.2 Dispozitat e LDNP 2020 në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja

Pjesa IV e LDNP 2020 i referohet njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja. Dispozitat për njohjen dhe ekzekutimin ndahen në tre kapituj: Kapitulli I - përkufizimet; Kapitulli II - kushtet për njohjen dhe ekzekutimin; dhe Kapitulli III - procedura për njohjen dhe ekzekutimin. Këto aspekte do të mbulohen në pjesën 6 të këtij studimi.

1.1.2 Burimet ligjore ndërkombëtare

1.1.2.1 Marrëveshjet bilaterale

Republika e Maqedonisë së Veriut ka krijuar marrëdhënie miqësore me shtetet e tjera me qëllimin e përgjithshëm të rritjes së tregtisë dhe bashkëpunimit të saj. Për këtë qëllim, një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve bilaterale janë lidhur në fusha të ndryshme të LDNP-së. Këto marrëveshje bilaterale i referohen aspekteve të mëposhtme: Konventat “Për marrëdhëniet konsullore”,⁵¹⁴ marrëveshjet bilaterale për bashkëpunim tregtar dhe/ose ekonomik,⁵¹⁵

511 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Komunitetet Evropiane dhe Shtetet e tyre Anëtare, nga njëra anë, dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nga ana tjetër, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 28/2001.

512 Ky ishte rasti me LDNP 2007, që në nenin 1 përcaktonte „... marrëdhëniet personale (statusi), familja, puna, prona dhe marrëdhëniet e tjera civile që përmbajnë një element ndërkombëtar”. Një zgjidhje identike gjendet edhe në nenin 1 të LDNP 1982.

513 Neni 1 i LDNP 2020

514 Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.32/1999); Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.50/1997); Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Rumanisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.6/); Marrëveshja për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.6/2003); Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Federatës Ruse (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.31/2003); Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.55/2000, me korrigjim në 79/2000); Konventa për Marrëdhëniet Konsullore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.34/1997);

515 Marrëveshja për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.49/1993); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.37/1992); Ndryshimet e Marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë sipas rendit juridik të BE-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.131/2006); Marrëveshja për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik, lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.19/1995); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.60/1995); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë së Ukrainës për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.50/1997); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Federale Austriake për bashkëpunim ekonomik, bujqësor, industrial, teknik dhe teknologjik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.55/1997); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Shqiptare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.15/1998); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.17/1995); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për amendimet dhe ndryshimet e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.63/2015); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Bjellorusisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.31/2003); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Shtetit të Katarit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.110/2005); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.117/1996); Marrëveshja për bashkëpunim tregtar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Malajzisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.7/1999); Marrëveshja tregtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.7/2000); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.88/2015); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë

marrëveshjet bilaterale për ndihmë juridike ndërkombëtare,⁵¹⁶ dhe marrëveshjet bilaterale që janë të zbatueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazuar në trashëgiminë nga ish-Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë (RSFJ).⁵¹⁷

1.1.2.2 Marrëveshjet multilaterale

Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e një numri të madh të konventave multilaterale që mbulojnë aspekte të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare private. Disa nga këto marrëveshje multilaterale janë nënshkruar dhe ratifikuar nga Maqedonia e Veriut, ndërsa të tjerat janë trashëguar nga RSFJ. Lista e mëposhtme e marrëveshjeve multilaterale bazohet në organizatën ndërkombëtare që i miratoi këto konventa multilaterale: Konferenca e Hagës për të Drejtën

së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.143/2010); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për bashkëpunim ekonomik dhe industrial (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.77/2010); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.77/2010); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.117/2011); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.132/2011); Marrëveshja për bashkëpunim teknik, industrial dhe shkencor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Rumanisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.40/2012); Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.139/2012); Memorandumi për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Sllovakisë (Memorandumi është nënshkruar më 19.11.2012); Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Socialiste të Vietnamit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.6/2016).

516 Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Shqiptare për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.16/1998); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.10/2006); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.13 /2014); Marrëveshja për ndihmë juridike në çështjet civile ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.13/2002); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Rumanisë për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.41/2004); Marrëveshja për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.24/1996); Marrëveshja për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr. 23/1997); Marrëveshja për ndihmë juridike ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.15/1995); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës për ndihmë juridike në çështjet civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.48/2000); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.15/2013); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Malit të Zi për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.55/2016).

517 Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Bullgarisë për ndihmë juridike të ndërsjellë e 23 marsit 1956 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.1/1957); Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Austrisë për bashkëpunim të ndërsjellë juridik e 16 dhjetorit 1956 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.8/1955); Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Polonisë për bashkëpunim të ndërsjellë juridik e 6 shkurtit 1960 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.5/1963); Marrëveshja ndërmjet Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Socialiste të Çekosllovakisë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në çështjet civile, familjare dhe penale e 20 janarit 1964 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, nr.13/1964); Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikave të Bashkimit Sovjetik për ndihmë juridike në çështjet civile, familjare dhe penale e 24 shkurtit 1962 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.5/1963); Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Mbretërisë së Greqisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore e 18 qershorit 1959 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.6/1960); Marrëveshja ndërmjet Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Qipros për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale e 19 shtatorit 1984 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.2/1986); Konventa e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Mbretërisë së Greqisë për marrëdhëniet e ndërsjella juridike e 18 qershorit 1959 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.7/1960); Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë juridik ndërmjet Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Hungarisë e 7 marsit 1968 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.3/1968 me ndryshimet në Gazetën Zyrtare të Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë , nr.1/1987); Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Rumanisë për ndihmë juridike e 18 tetorit 1961 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.8/1961); Marrëveshja për lehtësimin e zbatimit të Konventës së Hagës për Procedurën Civile e 1 marsit 1954 ndërmjet Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe Republikës Franceze e 29 tetorit 1969 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.21/ 1971); Konventa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare ndërmjet Qeverisë së Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës të 18 majit 1971 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr. 7/1972).

Ndërkombëtare Private (HCCH);⁵¹⁸ Këshilli i Evropës;⁵¹⁹ Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera përkatëse ndërkombëtare.⁵²⁰

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor

Republika e Maqedonisë së Veriut synon të ndjekë tendencat e reja të LDNP-së dhe të jetë në përputhje me tendencat e reja të LDNP-së së BE-së dhe dispozitat e Konventave të Hagës. Kushtetuta nuk përmban rregulla të drejtpërdrejta mbi procedurat “exequatur” për vendimet e huaja. Neni 118 i Kushtetutës është një dispozitë shumë e rëndësishme e cila zgjidh çështjen e hierarkisë dhe koordinimit midis burimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

LDNP e vitit 2020, kodifikimi i dytë i rregullave të LDNP-së në Maqedoninë e Veriut, është burimi më i rëndësishëm ligjor në lidhje me LDNP-në dhe, kësisoj, edhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Ky ligj është relativisht i ri (i miratuar në vitin 2020 dhe në fuqi nga viti 2021) me zgjidhje që ndryshojnë nga zgjidhjet e LDNP-së së vitit 2007. Zgjidhjet e reja në LDNP 2020 janë ndërtuar rreth ideve të rritjes së transparencës së dispozitave, të miratimit të një qasjeje të hapur dhe ndërkombëtare në trajtimin e çështjeve të LDNP-së dhe që rregullat të jenë më lehtë të aksesueshme për juristët.⁵²¹ Për t'i arritur këto qëllime, LDNP 2020 ka caktuar tre objektiva kryesore.

Objekti i parë i LDNP 2020 është ta bëjë ligjin më “të përshtatshëm për përdoruesit”, duke e ndarë atë në kapituj dhe nënkaptuj sipas lëndës, dhe me tituj para çdo komponenti dhe tituj shtesë për ta identifikuar lëndën për çdo nen. Ky lloj strukturimi e bën LDNP 2020 më lehtësisht të aksesueshëm për juristët dhe, kësisoj, rrit transparencën e dispozitave.

Objekti i dytë është që përmes LDNP 2020 të zbatohen shumica e tendencave të reja të dispozitave të së drejtës ndërkombëtare private të BE-së (në vijim referuar si LDNP e BE-së), dhe ato të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (në vijim referuar si HCCH) në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, të kriterëve juridiksionale dhe të dispozitave në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Për ta arritur këtë qëllim - “evropianizimi i LDNP-së” - LDNP 2020 po transpozon dispozitat e së drejtës ndërkombëtare private të BE-së,

518 Konventa e HCCH-së për procedurën civile e 1 marsit 1954 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.6/1962); Konventa e HCCH-së për heqjen e kërkesës për legalizim për dokumentet publike të huaja e 5 tetorit 1961 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.10/1962); Konventa e HCCH-së për konfliktet e ligjeve në lidhje me formën e disponimit me testament e 5 tetorit 1961 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.10/1962); Konventa e HCCH-së për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare e 15 nëntorit 1965 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.29/2008); Konventa e HCCH-së për marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare e 18 marsit 1970 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.140/2008); Konventa e HCCH-së për ligjin e zbatueshëm për aksidentet në trafik e 4 majit 1971 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.26/1976); Konventa e HCCH-së për ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë e produkteve e 2 tetorit 1973 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.8/1977); Konventa e HCCH-së për aspektet civile të rëmbimit ndërkombëtar të fëmijës e 25 tetorit 1980 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.7/1991); Konventa e HCCH-së për qasjen ndërkombëtare në drejtësi e 25 tetorit 1980 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.4/1988); Konventa e HCCH-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me birësimin jashtë shtetit e 29 majit 1993 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.103/2008); Konventa e HCCH-së e 19 tetorit 1996 për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve; Konventa e HCCH-së për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës e 30 qershorit 2005; Konventa e HCCH-së për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes e 23 nëntorit 2007; Protokoll i HCCH-së „Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” i 23 nëntorit 2007 (Katër konventat e fundit të HCCH-së janë nënshkruar në vitin 2019, por ende nuk janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut).

519 Konventa evropiane për informimin mbi të drejtën ndërkombëtare e vitit 1968 me Protokollin shtesë nga viti 1978 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.13/2002); Marrëveshja evropiane për transferimin e kërkesave për ndihmë juridike nga viti 1977 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.47/2002); Konventa evropiane për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë së fëmijëve nga viti 1980 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr. 12/2002); Konventa evropiane për kombësinë nga viti 1997 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr. 12/2002).

520 Konventa për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor e 20 qershorit 1956 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.2/1960); Konventa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit (Konventa e Nju-Jorkut) e 10 qershorit 1958 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.11/1981); Konventa evropiane për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar e 21 prillit 1961 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr. 12/1963); Konventa për zgjidhjen e kontesteve mbi investimet midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera e 18 marsit 1965 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.7/1967); Protokoll i për klauzolat e arbitrazhit e 24 shtatorit 1923 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.4/1959); Konventa për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit e 26 shtatorit 1927 (Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, nr.4/1959); Konventa e Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave (CISG) e 11 prillit 1980 (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Marrëveshjet ndërkombëtare plotësuese, nr.10/1984).

521 Kramer X. et al. Study by the European Parliament’s Committee on Legal Affairs “A European framework for private international law: current gaps and future perspectives.” PE 462.487, 8.

veçanërisht ato që kanë “zbatim universal”.⁵²² Këto rregulla janë krijuar sipas parimeve të cilat janë të rrënjësura fort në instrumentet e së drejtës ndërkombëtare private të BE-së dhe HCCH-së, ku ligji i përcaktuar nga rregullorja do të zbatohet pavarësisht nëse është apo jo ligj i një shteti anëtar pjesëmarrës, dhe të gjitha situatat brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian do të trajtohen në mënyrë të barabartë.⁵²³ Për më tepër, ligjvënësi ka parasysh se LDNP e BE-së është ende në hartim e sipër,⁵²⁴ dhe se përbëhet jo vetëm nga instrumentet ligjore të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian, por edhe nga konventat ndërkombëtare (veçanërisht të rëndësishme janë ato të HCCH-së).⁵²⁵ Nga ana tjetër, ka disa mospërputhje për sa i përket zbatimit të LDNP-së së BE-së që mund të identifikohen në shumë nga shtetet anëtare të BE-së.⁵²⁶ Prandaj, për t'i zbatuar siç duhet rregullat e LDNP-së së BE-së dhe, në të njëjtën kohë, për të siguruar një qasje më koherente ndaj LDNP-së së BE-së, ligjvënësi kombëtar zgjodhi t'i përfshijë shumë nga këto tendenca të LDNP-së (rritja e përdorimit të autonomisë së palëve si një faktor lidhës, zvogëlimi i kombësisë si faktor lidhës, futja e vendqëndrimit të zakonshëm si alternativë ndaj vendbanimit si një faktor lidhës/kritere juridiksioni, kufizimi i bazave të juridiksionit ekskluziv, etj.) në LDNP 2020, në mënyrë që gjyqtarët dhe juristët të mund të njihen me rregullat e LDNP-së së BE-së edhe përpara se Maqedonia e Veriut të bëhet shtet anëtar i BE-së. Pra, për këtë qëllim, LDNP 2020 është harmonizuar me Rregulloret e mëposhtme të BE-së:

- Rregulloren e Këshillit (BE) 2016/1103, e datës 24 qershor 2016, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e juridiksionit, ligjit të zbatueshëm, dhe njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në çështjet e regjimeve të pasurive martesore;⁵²⁷
- Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 1259/2010, e datës 20 dhjetor 2010, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e ligjit të zbatueshëm për shkurorëzimet dhe ndarjen;⁵²⁸
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 4/2009, e datës 18 dhjetor 2008, “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe bashkëpunimin në çështjet që lidhen me detyrimet ushqimore”;⁵²⁹
- Rregulloren (KE) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 qershor 2008, “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore” (Roma I);⁵³⁰
- Rregulloren (KE) nr. 864/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 korrik 2007, “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore” (Roma II);⁵³¹
- Rregulloren (BE) nr. 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012, “Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”;⁵³²
- Rregulloren (BE) nr. 650/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 4 korrik 2012, “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, dhe pranimin dhe zbatimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe për krijimin e një Certifikate Evropiane të Trashëgimisë”;⁵³³

522 Ekzistojnë disa dispozita në Rregulloret e BE-së që tentojnë ta harmonizojnë konfliktin e legjislacionit brenda BE-së i cili parashikon „zbatimin universal” të këtyre dispozitave, siç është neni 2 i Rregullores (KE) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 qershor 2008 “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore” (Roma I) GZ L 177, 4.7.2008, 6–16; neni 3 i Rregullores (KE) nr. 864/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 korrik 2007 “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore” (Roma II), GZ L 199, 31.7.2007, 40–49.; neni 4 i Rregullores së Këshillit (BE) nr. 1259/2010, e datës 20 dhjetor 2010, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e ligjit të zbatueshëm për shkurorëzimet dhe ndarjen GZ L 343, 29.12.2010, 10–16; neni 20 i Rregullores (BE) nr. 650/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 4 korrik 2012 „Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, dhe pranimin dhe zbatimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe për krijimin e një Certifikate Evropiane të Trashëgimisë”, GZ L 201, 27.7.2012, 107–134; dhe neni 20 i Rregullores së Këshillit (BE) 2016/1103, e datës 24 qershor 2016, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e juridiksionit, ligjit të zbatueshëm, dhe njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në çështjet e regjimeve të pasurive martesore, GZ L 183, 8.7.2016, 1–29.

523 Boele Woelki K. “For better or for worse: The Europeanisation of International Divorce Law.” *Yearbook of Private International Law*, vol. 12. 2010, f. 29.

524 *Po aty.*, f. 20.

525 *Po aty.*

526 Hess, B., S. Law dhe P. Ortolani (eds.). “An evaluation study of national procedural laws and practices in terms of their impact on the free circulation of judgments and on the equivalence and effectiveness of the procedural protection of consumers under EU consumer law.” JUST/2014/RCON/PR/CIVI/0082, 2017, f. 45.

527 GZBE L183/1.

528 GZBE L 343/10.

529 GZ L 7, 10.1.2009.

530 GZBE L177/6.

531 GZBE L 199/40.

532 GZBE L351/1.

533 GZBE, L 201/107.

Objektivi i tretë i ligjvënësit është që ta “evropianizojë” LDNP-në kombëtare me nocionin specifik i cili përcakton se ligji kombëtar i së drejtës ndërkombëtare private nuk zbatohet vetëm midis shteteve anëtare të BE-së, por edhe midis vendeve të treta. Pra, ky nocion i universalitetit të dispozitave luajti një rol të rëndësishëm në hartimin e LDNP 2020, bazuar në përvojat e nxjerra nga Konventa e Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” e vitit 1996; Konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” e vitit 2007; Protokolli i Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” i vitit 2007 dhe Konventa e Hagës “Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës” e vitit 2005.

LDNP 2020 paraqet një hap të rëndësishëm për LDNP-në kombëtare, duke i ndërlidhur tendencat e reja në të drejtën ndërkombëtare private dhe duke e evropianizuar kuptimin thelbësor të institucioneve të veta. Sistematizimi që është bërë në këtë kod të ri të LDNP-së mundëson zbatim shumë më të lehtë nga juristët në Maqedoninë e Veriut. Sidoqoftë, për gjyqësorin do të jetë sfidë një ndryshim kaq i madh strukturor në lidhje me ligjin e së drejtës ndërkombëtare private, por megjithatë, për të arritur qëllimin kryesor të legjislacionit, domethënë për ta harmonizuar atë me rregullat e ligjit të së drejtës ndërkombëtare private të BE-së, ky ndryshim nuk duhet të jetë aspak pengesë. Kur gjyqësori të përshtatet me këto dispozita në LDNP 2020, atëherë kalimi i menjëhershëm te rregulloret e BE-së për të drejtën ndërkombëtare private nuk duhet të jetë një problem i jashtëzakonshëm. Në këtë mënyrë, LDNP 2020 zgjidh dy probleme me një ligj: modernizon ligjin kombëtar të së drejtës ndërkombëtare private në mënyrë evolucionare dhe mundëson përshtatje më të lehtë me rregulloret e BE-së.

Dispozita shumë të rëndësishme në LDNP 2020 janë rregullat për interpretimin e dispozitave të cilat janë rregullore plotësisht të transpozuar të BE-së. Këto rregulla i mundësojnë gjyqësorit që ta harmonizojë ligjin e vet kombëtar me standardet dhe interpretimet e instituteve të BE-së dhe në këtë mënyrë të jetë në përputhje me interpretimin e dhënë në BE, edhe pse Maqedonia e Veriut është ende vetëm shtet kandidat për anëtarësim në BE. Pa këto dispozita, do të vijonte keqkuptimi i institucioneve ligjore të BE-së dhe qëllimi i harmonizimit të ligjit të brendshëm me legjislacionin e BE-së nuk do të arrihej.

Sa i përket burimeve ligjore ndërkombëtare, Maqedonia e Veriut priret të jetë anëtare e konventave më të rëndësishme multilaterale të LDNP-së. Sidoqoftë, ka ende hapësirë për përmirësim. Megjithëse Maqedonia e Veriut nënshkroi katër Konventa të Hagës (Konventa e HCCH-së e vitit 1996; Konventa e HCCH-së e vitit 2005; Konventa e HCCH-së e vitit 2007 dhe Protokolli i HCCH-së i vitit 2007) në vitin 2019, edhe pas tri viteve, këto konventa nuk janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Një numër i caktuar i marrëveshjeve bilaterale u nënshkruan nga viti 1991 e tutje, dhe ka gjithashtu një numër marrëveshjesh bilaterale që janë të zbatueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazuar në trashëgiminë nga ish-Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë (RSFJ). Maqedonia e Veriut e ka zgjeruar edhe më tej politikën e vet për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile me vendet e tjera duke nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe konventa multilaterale për ndihmë juridike në çështjet civile. Përveç kësaj, si pjesëmarrëse aktive në HCCH, Maqedonia e Veriut i ndjek zhvillimet në këtë organizatë, dhe bazuar në interesat e veta, mund të bëhet anëtare e Konventave të tjera të HCCH-së (Konventa e HCCH-së “Për mbrojtjen ndërkombëtare të të rriturve” e vitit 2000 dhe Konventa e HCCH-së “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare” e vitit 2019).

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile

2.1 Pasqyrë e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin ndërmjet shteteve të vendimeve gjyqësore në fushën civile

Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore është e parashikuar si procedurë jokontestimore që realizohet para Gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktori kryesor në këtë procedurë është gjyqësori. LDNP specifikon edhe aktorët e tjerë përkatës që luajnë një rol të rëndësishëm në procedurën për integrimin e vendimeve të huaja gjyqësore në sistemin ligjor të Maqedonisë së Veriut. Aktori kryesor në procedurën “*exequatur*” janë Gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Organizimi dhe kompetencat e tyre janë përcaktuar me ligjin “Për gjykatat”.⁵³⁴ Procedura e njohjes dhe ekzekutimit është e parashikuar në Ligjin e së Drejtës Ndërkombëtare Private të vitit 2020⁵³⁵ dhe duke qenë se përbën një procedurë të veçantë jokontestimore, zbatohet edhe ligji “Për procedurën jokontestimore”.⁵³⁶

Aktorë të tjerë relevantë që janë veçanërisht të rëndësishëm në procesin e ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në Maqedoninë e Veriut janë përmbauesit. Procedura dhe detyrat e përmbauesve janë parashikuar në ligjin “Për përmbarim”.⁵³⁷

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Ministria e Drejtësisë), sidomos Sektori për Ndhmë Juridike Ndërkombëtare, ka rëndësi të madhe në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit. Ata janë shpesh Autoriteti Qendror në Konventat që referojnë ndihmën juridike ndërkombëtare dhe luajnë rol në procedurën për ndihmë juridike që parashikohet në ligjin “Për procedurën civile”.⁵³⁸

2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve civile ndërmjet shteteve

2.2.1 Gjykatat

Në Maqedoninë e Veriut, kompetencën për të vendosur në procedura të pavarura për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore e kanë gjykatat themelore me juridiksion të zgjeruar (**Основни судови со проширена надлежност**).⁵³⁹ Gjykatat themelore veprojnë për një a më shumë komuna. Në Maqedoninë e Veriut janë gjithsej 27 gjykata themelore. *Competentia ratione materiae* e gjykatave themelore përcaktohet me rregullat e delegimit të përgjithshëm ligjor. Gjykatat themelore janë themeluar si gjykata me juridiksion themelor dhe gjykata me juridiksion të zgjeruar. Gjykatat themelore me juridiksion të zgjeruar kanë divizione të specializuara gjyqësore që gjykojnë lloje të caktuara të çështjeve. Vlen të përmendet që edhe pse të gjitha gjykatat themelore janë themeluar si gjykata me juridiksion të përgjithshëm, ligji “Për gjykatat” përcakton juridiksion *ratione materiae* tjetër të gjykatave themelore për zonën e Shkupit si kryeqytet. Përkatësisht, dy gjykatat themelore që ndodhen në Shkup janë të organizuara si gjykata “të specializuara” me juridiksion plotësisht të veçantë në çështje penale dhe civile. Më herët të njohura si Gjykata Themelore e Shkupit 1 dhe Gjykata Themelore e Shkupit 2, gjykatat themelore

në Shkup janë riemëruar si Gjykata Themelore Penale e Shkupit dhe Gjykata Themelore Civile e Shkupit.

Juridiksioni territorial mbi njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor i takon çdo gjykate që ka juridiksion procedural.⁵⁴⁰ Megjithatë, një pozitë e tillë nuk e përjashton mundësinë që njohja e vendimit të huaj gjyqësor të ngrihet si çështje paraprake nga gjykata ekzekutuese. Nëse nuk është marrë vendim i veçantë për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor, çdo gjykatë mund të vendosë për të si çështje paraprake, megjithatë, me efekt që i referohet vetëm kësaj procedure.⁵⁴¹

2.2.2 Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.)

Institucioni më i rëndësishëm administrativ që ka kompetenca për ndihmën juridike në çështje civile është Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo ka një sektor të veçantë të dedikuar për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje civile që, përveç përgjegjësive të tjera, mbulon: përgjegjësitë në lidhje me kërkesat e gjykatave kombëtare dhe të huaja në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështje civile për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështje penale dhe civile; të dhënat statistikore për çështjet civile; përgjegjësitë për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për ndihmë juridike dhe zbatimin e këtyre marrëveshjeve; vëzhgimin e zbatimit të konventave të ratifikuara për zbatimin e tyre të mirëfilltë në çështjet që përfshijnë ndihmën juridike në çështje civile; vëzhgimin e zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare;⁵⁴² bashkëpunimin me përfaqësues diplomatikë dhe konsullorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në shtete të huaja në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare.

Autoritetet Qendrore që janë organizuar në bazë të këtyre konventave që mbulojnë ndihmën juridike ndërkombëtare, zakonisht⁵⁴³ bazohen në sektorin e njëjtë për ndihmë juridike ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.2.3 Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.)

Praktika ligjore është veçanërisht e rëndësishme për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar. Meqë procedura e njohjes dhe ekzekutimit është e parashikuar si procedurë gjyqësore jokontestimore, kreditori i huaj i padisë zakonisht angazhon një jurist (avokat) për ta paraqitur kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të huaj gjyqësor. Kjo procedurë, e parashikuar në LDNP 2020 (nenet 163-175), zbatohet si për vendime gjyqësore ashtu edhe për vendime të arbitrazhit.

2.2.4 Përmbauesit

Procedura përmbauese në Maqedoninë e Veriut është e përcaktuar në ligjin “Për përmbarim”.⁵⁴⁴ Ky ligj hyri në fuqi më 1 janar 2017. Historikisht, përpara përcaktimit të modelit të ri për përmbarimin në Maqedoninë e Veriut, përmbarimi civil ishte nën juridiksionin ekskluziv të gjykatave sipas ish-ligjit federal për procedurën përmbauese të vitit 1978. Sipas këtij ligji, gjykatat kishin juridiksion për të lejuar dhe për të bërë ekzekutimin e padive në vlerë monetare dhe jomonetare.

540 Neni 166, paragrafi 2 i LDNP 2020.

541 Neni 167 i LDNP 2020.

542 Konventa e HCCH-së për procedurën civile e 1 marsit 1954; Konventa e HCCH-së për heqjen e kërkesës për legalizim për dokumentet publike të huaja e 5 tetorit 1961; Konventa e HCCH-së për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare e 15 nëntorit 1965; Konventa e HCCH-së për marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare e 18 marsit 1970; Konventa e HCCH-së për qasjen ndërkombëtare në drejtësi e 25 tetorit 1980; Konventa për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor e 20 qershorit 1956; Konventa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit (Konventa e Nju-Jorkut) e 10 qershorit 1958; Konventa evropiane për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar e 21 prillit 1961; Konventa për zgjidhjen e kontesteve mbi investimet midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera e 18 marsit 1965; Protokolli për klauzolat e arbitrazhit e 24 shtatorit 1923; Konventa për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit e 26 shtatorit 1927.

543 Autoritetet Qendrore të përcaktuara në bazë të konventave që iu referohen çështjeve familjare janë të strukturuar në Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale.

544 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/2016, 142/2016, 233/2018 dhe 14/2020.

534 Ligji „Për gjykatat”, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 96/19.

535 Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private (Закон за меѓународно приватно право), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 32/2020.

536 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 9/2008.

537 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/2016, 142/2016, 233/2018 dhe 14/2020.

538 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/10 dhe 124/2015.

539 Neni 31, ligji “Për gjykatat”.

Përgjegjësia për ekzekutim i besohet gjyqtarëve (gjyqtarëve ekzekutivë), sepse konsiderohej që interpretimi i përmbajtjes së vendimit gjyqësor sa i përket ekzekutimit të detyrueshëm kërkon njohuri profesionale gjyqësore. Zyrtarët gjyqësorë (nëpunësit e gjykatës) ishin gjithashtu të përfshirë në procedurën përmbartuese duke kryer detyra të mëdha teknike (dhe nganjëherë edhe esenciale) brenda procedurave.⁵⁴⁵

Ligji i parë "Për procedurën përmbartuese" i vitit 1997 (me ndryshime në vitin 2000 dhe 2003) i ka mbartur të njëjtat zgjidhje si ish-ligji federal i vitit 1978. Ligji "Për përmbartim" i vitit 2005 (me ndryshime në vitin 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2013)⁵⁴⁶ prezantoi një sistem të ri të përmbartimit në Maqedoninë e Veriut. Përkatesisht, sistemi paraprak i orientuar drejt gjykatave u zëvendësua me një sistem të orientuar drejt përmbartuesve gjyqësorë. Procedura përmbartuese ka pushuar së qeni nën juridiksionin e gjykatave dhe përmbartimi iu është besuar përmbartuesve – persona me autorizime publike të përcaktuara me ligj, që bëjnë përmbartim.⁵⁴⁷

Në Maqedoninë e Veriut, sistemi juridik përfshin përmbartimin privat nga përmbartues të pavarur dhe tejet profesionale. Ata bëjnë përmbartim sipas titullit të përmbartimit (ekzekutiv) dhe sipas autorizimeve ligjore. Koncepti modern i përmbartimit konsiderohet efikas dhe efektiv sepse parasheh mbledhjen e shpejtë dhe të plotë të kërkesës së kreditorit.

2.3 Aktorët përgjegjës për zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019

Procedura për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut është e parashikuar në ligjin "Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare".⁵⁴⁸ Ai është një akt shumë i rëndësishëm ligjor që përcakton procedurën për zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, aderimin në marrëveshje multilaterale ndërkombëtare, nisjen e procedurës për ratifikimin dhe ekzekutimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut.⁵⁴⁹ Ligji "Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare" vlen si për marrëveshje bilaterale ashtu edhe për marrëveshje multilaterale. Ky ligj përcakton po ashtu aktorët kryesorë që janë përgjegjës për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështje civile dhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, aktorët e drejtpërdrejtë që janë me rëndësi në kontekstin e miratimit të marrëveshjeve ndërkombëtare janë: Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut; Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut; Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut; Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Sekretariati për Legjislacion i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktorët vijues indirekt luajnë një rol të rëndësishëm në nivelin e politikave sa i përket ofrimit të ekspertizës dhe analizave, përkthimeve zyrtare ligjore dhe si forum për diskutim dhe arsimim dhe për funksionalizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështje civile si dhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore: universitetet dhe Organizata Joqeveritare (OJQ).

2.3.1 Ministritë dhe institucionet e tjera

Aktorët kryesorë që janë me rëndësi për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështje civile, të cilët mbulojnë edhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore janë Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punëve

të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Sekretariati për Legjislacion i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktori kyç për marrëveshje ndërkombëtare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore është Qeveria, e cila është përgjegjëse për nënshkrimin dhe negociimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁵⁵⁰ Me nismën me shkrim të Ministrisë së Drejtësisë,⁵⁵¹ Qeveria vendos që duhet të fillojë negociatat ose të nënshkruajë një marrëveshje ndërkombëtare. Ministria e Drejtësisë paraqet një propozim për fillimin e negociatave ose përmbushjen e kushteve përkatëse për nënshkrimin e një marrëveshjeje bilaterale apo aderimin në një marrëveshje multilaterale ndërkombëtare.⁵⁵² Ky propozim duhet të përmbajë disa elemente siç janë: baza kushtetuese, opinionin mbi marrëdhëniet me organizatën përkatëse ndërkombëtare, arsyet për nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare, nevojat financiare dhe mjetet për prokurimin e tyre në lidhje me ekzekutimin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe delegacionin që do të zhvillojë negociatat.⁵⁵³ Propozimi duhet të përmbajë draftin e marrëveshjes ndërkombëtare që do të nënshkruhet apo miratohet.⁵⁵⁴ Më pas ky propozim i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme si dhe Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit për Legjislacion, të cilët duhet të japin opinionin e tyre rreth këtij propozimi.⁵⁵⁵ Nëse Qeveria e pranon propozimin, atëherë përcakton bazën për negociata dhe delegacionin që do të zhvillojë negociatat.⁵⁵⁶ Për më tepër, Qeveria mund të autorizojë Kryesuesin e delegacionit⁵⁵⁷ (zakonisht Ministria e Drejtësisë) për të nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare.⁵⁵⁸ Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërkombëtare, Delegacioni përgatit raportin me shkrim dhe ia dorëzon atë Qeverisë.⁵⁵⁹ Vendimi për aderimin e Maqedonisë e Veriut në një marrëveshje multilaterale ndërkombëtare që është në fuqi, zbatohet nga Ministria e Punëve të Jashtme.⁵⁶⁰

Faza tjetër e procedurës është ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare. Ministria e Drejtësisë ia dërgon tekstin origjinal të marrëveshjes ndërkombëtare Ministrisë së Punëve të Jashtme, së bashku me propozimin e saj për të nisur procesin e ratifikimit dhe një shpjegim.⁵⁶¹ Më pas, Ministria e Punëve të Jashtme nis procedurën për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në bazë të një propozimi për miratimin e një ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare që i është dorëzuar Qeverisë. Qeveria ia dorëzon ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare.⁵⁶²

Faza e fundit e ekzekutimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Qeveria ose Ministria e Drejtësisë.⁵⁶³

2.3.2 OJQ-të

Në Maqedoninë e Veriut nuk ka ndonjë OJQ, fokusi kryesor i së cilës është njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe ndihma juridike ndërkombëtare. Megjithatë, nga përvoja në fushat e tjera ligjore, bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe OJQ-ve është pozitiv.

550 Neni 3, paragrafi 2 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

551 Për Konventat e Hagës është përgjegjës Sektori për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë.

552 Neni 6, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

553 Neni 8, paragrafi 1 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

554 Neni 8, paragrafi 3 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

555 Neni 9 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

556 Neni 12, paragrafi 1 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

557 Nëse Qeveria nuk autorizon një person për ta nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare, pas pranimi të raportit me shkrim nga delegacioni, ajo mund të autorizojë një person përkatës për ta nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare. Neni 15, paragrafi 2 i ligjit «Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare».

558 Neni 12, paragrafi 2 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

559 Neni 14 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

560 Neni 17 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

561 Neni 19 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

562 Neni 20 i ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

563 Nenet 23-24 të ligjit „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

2.3.3 Akademia


Bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Universiteteve në Maqedoninë e Veriut është pozitiv. Një numër i madh i stafit akademik të universiteteve merr pjesë në grupet punuese të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e legjislacionit të ri. Po ashtu, stafi akademik është i përfshirë në arsimimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve publikë, i cili ofrohet nga Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë.

2.3.4 Aktorë të tjerë të rëndësishëm


Organizatata qeveritare të disa shteteve siç janë Gjermania (GIZ), SHBA (USAID), shtetet Skandinave, Holanda, Mbretëria e Bashkuar dhe Kombet e Bashkuara, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në formësimin e sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut. Këto shtete dhe organizata ndërkombëtare kanë organizuar një mori të larmishme aktiviteteve që i ndihmojnë autoriteteve vendore të ofrojnë zgjidhje më të mira ligjore dhe zbatim më të mirë të legjislacionit të ri. Këto aktivitete përfshijnë ofrimin e analizës për një fushë të caktuar ligjore, prokurimin e ekspertëve për aspekte të caktuara ligjore, organizimin e debateve, punëtorive (seminareve) dhe aktiviteteve të tjera arsimore.

2.4 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve

2.4.1 Aktorët me rëndësi për procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore



2.4.2 Aktorët me rëndësi për procedurën e miratimit të Konventës së Hagës të vitit 2019



3. Roli i gjykatave dhe i përmbaruesve në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile

3.1 Kapacitetet e gjykatave për njohjen ndërmjet shteteve të huaja gjyqësore

Gjykata më e madhe themelore civile ndodhet në Shkup dhe është Gjykata Themelore Civile e Shkupit (më herët e njohur si Gjykata Themelore e Shkupit 2). Procedura e njohjes dhe ekzekutimit është e parashikuar si procedurë jokontestimore, prandaj kompetenca për të vendosur për “exequatur” i takon seksionit jokontestimor dhe të trashëgimisë të Gjykatës Themelore Civile të Shkupit. Ky seksion i Gjykatës Themelore Civile të Shkupit përbëhet prej vetëm tre gjyqtarësh, të cilët mbulojnë aspekte të ndryshme ligjore që vendosen në procedurë jokontestimore. Numri i çështjeve për të cilat gjyqtarët vendosin çdo vit është i konsiderueshëm: për shembull, ata pranojnë dhe vendosin për rreth 200 kërkesa për njohje dhe ekzekutim. Megjithatë, shumica e këtyre çështjeve kanë të bëjnë me shkurorëzimin, prandaj vendosen nga një gjyqtar i vetëm.⁵⁶⁴ Të dhënat statistikore tregojnë që një numër i vogël i çështjeve vendosen në Fazën II të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit (nga një panel prej tre gjyqtarësh).⁵⁶⁵ Të dhënat statistikore janë dhënë në tabelën 1.

3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të huaja gjyqësore

Pas vlerësimit të të dhënave të ofruara nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Oda e Përmbaruesve e Republikës së Maqedonisë së Veriut, numri total është 21 çështje, të përpunuara përmes sistemit të Ministrisë së Drejtësisë dhe 32 çështje me një element të huaj që duhet të zbatoheshin nga Përmbaruesit në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2017-2020. Sistemi i të dhënave i Ministrisë së Drejtësisë nuk parasheh klasifikimin e çështjeve në bazë të kriterëve nëse vendimet e huaja duhet të ekzekutohen apo vetëm të njihen nga gjykata.

564 Tabela 1.1

565 Tabela 1.2

Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ruan informata për numrin e çështjeve të përpunuara përmes mekanizmave të parashikuar në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale si ndihmë juridike ndërkombëtare. Në këto raste, Ministria e Drejtësisë iu ofron palëve ndihmë juridike, duke i ndihmuar palët me përkthimin e dokumentacionit, duke i asistuar palët në dorëzimin e kërkesës pranë gjykatës përkatëse që ka juridiksion për një çështje të caktuar dhe ndihma të tjera. Një veçori e rëndësishme e këtyre çështjeve është që shumica e tyre janë përpunuar sipas LDNP 2007. Pasi që LDNP 2020 u bë e zbatueshme vetëm në janar 2021, Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Përmbauesve nuk kanë të dhëna të mjaftueshme për çështjet në vitin aktual.

Në përgjithësi, pozita e përmbauesve është që ata zbatojnë dispozitat e ligjit "Për përmbarim"⁵⁶⁶ dhe LDNP 2020, dhe në mënyrë që një vendim i huaj gjyqësor të ekzekutohet në Maqedoninë e Veriut, duhet fillimisht të njihet nga gjykata vendore. Nëse përmbauesi ballafaqohet drejtpërdrejt me një vendim të huaj gjyqësor, do ta refuzojë kërkesën për ekzekutim me shpjegimin që vendimi i huaj gjyqësor nuk është njohur nga gjykata vendase, prandaj vendimit të huaj i mungon një vendim për njohje. Sipas Odës së Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ata kanë hasur në disa aspekte problematike lidhur me problemet teknike gjatë procedurës së ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në rastet e shlyerjes së borxhit nga llogari bankare jorezidenciale. Në situata të tilla, procedura bankare ka kërkuar bazën për transaksionin dhe dosjen e plotë të çështjes dhe është nevojitur prokurimi i tërë dokumentacionit. Kjo gjë nuk përbënte problem për çështjet kur pagesa ishte bërë e njëhershme (një këst). Megjithatë, në situatat me pagesa të vazhdueshme (detyrimet ushqimore), kjo ka shkaktuar disa probleme dhe i ka rritur kostot e administrimit të procedurës përmbauese pasi që banka ka kërkuar dosjen e plotë të çështjes dhe tërë dokumentacionin për çdo pagesë pasuese. Në këndvështrimin e Odës së Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një procedurë e tillë vetëm rrit koston e ekzekutimit dhe është e panevojshme sepse baza për një transferim të tillë është prokuruar kur është transferuar kësti i parë.

Numri i çështjeve të njohjes ndërmjet shteteve dhe i vendimeve të marra nga Gjykata Themelore Civile e Shkupit (2017-2020)

Viti	2017	2018	2019	2020
1. Numri total i çështjeve	190	200	195	210
2. Çështjet e vendosura nga një panel prej tre gjyqtarësh (Faza II e procedurës së njohjes dhe ekzekutimit)	5	3	3	5

Tabela 1: Numri i çështjeve çdo vit

Numri i çështjeve ndërmjet shteteve të përpunuara nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2017-2020)⁵⁶⁷

Viti	2017	2018	2019	2020
Numri i çështjeve	1	11	7	2

Tabela 2: Numri i çështjeve çdo vit

⁵⁶⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/2016, 142/2016, 233/2018 dhe 14/2020.

⁵⁶⁷ Në disa prej çështjeve, palët e kanë adresuar drejtpërdrejt kërkesën e tyre përmes disa mekanizmave të parashikuar në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut si ndihmë juridike në çështje civile.

3.3 Kapacitetet e përmbauesve lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në territorin e Maqedonisë së Veriut bëhet sipas ligjit "Për përmbarim". Procedura përmbauese vlen për vendimet gjyqësore vendase të ekzekutueshme si dhe për vendimet e huaja gjyqësore nëse i përmbushin kushtet për njohje të parashikuara në legjislacionin kombëtar ose në marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar sipas Kushtetutës.⁵⁶⁸ Një pozitë e tillë parasheh që të gjithë përmbauesit që janë të autorizuar në Maqedoninë e Veriut mund të ekzekutojnë vendime të huaja gjyqësore.

Numri i çështjeve ndërmjet shteteve të zbatuara nga përmbauesit (2017-2020)

Viti	2017	2018	2019	2020
Numri i çështjeve	16	13	1	2

Tabela 3: Numri i çështjeve çdo vit

3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor

Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë "Pavel Shatev" (Akademia) shihet si bartësi kryesor i aktiviteteve për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor përmes trajnimit profesional të gjyqtarëve, prokurorëve publikë, shërbimit gjyqësor dhe prokurorial. Struktura dhe organizimi i saj janë të rregulluara me ligjin "Për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë",⁵⁶⁹ Statut⁵⁷⁰ dhe ligje të tjera përkatëse. Ekzistojnë dy lloje të aktiviteteve arsimore: arsimi themelor dhe arsimi i vazhdueshëm. Arsimi themelor ka të bëjë me kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, ndërsa arsimi i vazhdueshëm është i përcaktuar për aftësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të gjyqësorit. Programi arsimor për arsimin themelor të kandidatëve në lëndën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore mbulohet me 2 orë mësim teorik (këto 2 orë kanë të bëjnë me tërësinë e LDNP-së kombëtare) dhe 2 orë mësim teorik në bashkëpunimin me BE-së në çështje civile dhe tregtare. Mësimi praktik është i parashikuar në programin arsimor si 5 orë mësim (2 orë LDNP dhe 3 orë LDNP e BE-së).

Arsimi i vazhdueshëm përbëhet nga kurse të përhershme rreth risive dhe akteve të reja ligjore në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke mbuluar kështu fushën e të drejtës ndërkombëtare private dhe procedurën "exequatur" për vendimet e huaja gjyqësore. Në vitin 2019, Akademia zhvilloi dy trajnime mbi "Rregulloren I bis të Brukselit" dhe "Rregulloren II bis të Brukselit"; në vitin 2020, Akademia nuk mbajti asnjë trajnim mbi njohjen dhe ekzekutimin; ndërsa për vitin 2021, është parashikuar një trajnim me temën "Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore".

4. Aspektet ekonomike dhe politike në lidhje me zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

Në periudhën 2016-2019, shtetet partnere kryesore tregtare të Maqedonisë së Veriut për eksporte ishin Gjermania, Serbia, Bullgaria, Belgjika dhe Greqia dhe për importe ishin Gjermania,

⁵⁶⁸ Neni 8 i ligjit „Për përmbarim“.

⁵⁶⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 20/2015, 192/2015, 231/2015 dhe 163/2018.

⁵⁷⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 56/2015.

Mbretëria e Bashkuar, Greqia, Serbia dhe Kina. Nga tabela 4 dhe tabela 5, shihet qartë që partnerët tregtarë më të rëndësishëm të Maqedonisë së Veriut janë nga Evropa, megjithatë, partnerët e tjerë tregtarë ndërkombëtarë siç janë Turqia, SHBA, Federata Ruse, Afrika e Jugut, Brazili dhe të tjerë, janë po ashtu të rëndësishëm.

4.1.1 Importi

Shteti	2019 ⁵⁷¹	2018	2017	2016
1. Gjermania	1 075 000 000 USD	1 050 359 000 USD	910 251 000 USD	829 895 000 USD
2. Mbretëria e Bashkuar	1 084 000 000 USD (1-rë)	863 262 000 USD	780 175 000 USD	726 830 000 USD
3. Greqia	765 000 000 USD	766 755 000 USD	617 952 000 USD	497 191 000 USD (4-rt)
4. Serbia	678 000 000 USD	646 640 000 USD	590 390 000 USD	541 002 000 USD (3-të)
5. Kina	544 000 000 USD	523 244 000 USD	444 003 000 USD	421 227 000 USD
6. Italia	527 000 000 USD	508 038 000 USD	427 153 000 USD	384 877 000 USD
7. Turqia	452 000 000 USD	425 512 000 USD	367 197 000 USD	349 265 000 USD
Afrika e Jugut	/	295 604 000 USD (10-të)	250 095 000 USD (9-të)	172 985 000 USD (10-të)
SHBA	309 000 000 USD (9-të)	244 757 000 USD (11-të)	176 565 000 USD (13-të)	150 211 000 USD (11-të)
Federata Ruse	142 000 000 USD (20-të)	131 372 000 USD (20-të)	148 494 000 USD (15-të)	142 962 000 USD (12-të)
Brazili	42 000 000 USD (27-të)	46 722 000 USD (31-të)	44 432 000 USD (29-të)	43 045 000 USD (28-të)

Tabela 4: Partnerët tregtarë për import

Burimi: WITS – Banka Botërore [https://wits.worldbank.org/CountryProfile/en/Country/MKD/Year/2018/TradeFlow/EXPIMP/Partner/by-country]

4.1.2 Eksporti

Shteti	2019 ⁵⁷²	2018	2017	2016
1. Gjermania	3 501 000 000 USD	3 248 099 000 USD	2 662 466 000 USD	2 246 626 000 USD
2. Serbia	277 000 000 USD (4-rt)	542 956 000 USD	474 634 000 USD	423 706 000 USD
3. Bullgaria	351 000 000 USD (2-të)	360 718 000 USD	332 914 000 USD	246 501 000 USD

571 Burimi: NBRSM [https://www.nbrm.mk/nadvoresno_trgovska_razmena.nspix]

572 Burimi: NBRSM [https://www.nbrm.mk/nadvoresno_trgovska_razmena.nspix]

4. Belgjika	238 000 000 USD (5-të)	259 265 000 USD	133 448 000 USD (5-të)	189 266 000 USD
5. Greqia	193 000 000 USD (7-të)	225 133 000 USD	203 511 000 USD (4-rt)	163 326 000 USD (6-të)
Kina	166 000 000 USD (10-të)	65 259 000 USD (22-të)	62 256 000 USD (18-të)	47 810 000 USD (19-të)
Turqia	87 000 000 USD (15-të)	96 166 000 USD (14-të)	88 595 000 USD (9-të)	70 721 000 USD (11-të)
Afrika e Jugut	/	39 511 000 USD (25-të)	563 000 USD (63-të)	6 718 000 USD (30-të)
SHBA	50 000 000 USD (24-rt)	67 377 000 USD (19-të)	55 547 000 USD (22-të)	50 768 000 USD (16-të)
Federata Ruse	52 000 000 USD (23-të)	131 372 000 USD (26-të)	54 127 000 USD (23-të)	48 953 000 USD (18-të)
Brazili	6 200 000 USD (31-të)	3 444 000 USD (41-të)	2 956 000 USD (47-të)	2 717 000 USD (40-të)

Tabela 5: Partnerët tregtarë për eksport

Burimi: WITS – Banka Botërore

[https://wits.worldbank.org/CountryProfile/en/Country/MKD/Year/2018/TradeFlow/EXPIMP/Partner/by-country]

4.2 Aspektet politike në lidhje me zbatimin e Konventës së Hagës të vitit 2019

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së Hagës të vitit 2019

Neni 29 i Konventës së Hagës të vitit 2019 përmbush dy funksione: përcakton kur bëhet konventa efektive mes dy shteteve palë dhe lejon një opsion të kufizuar të refuzimit për të shmangur vendosjen e marrëdhënieve të traktatit me shtetet e tjera palë. Rezultati kryesor i nenit 29 është që konventa ka efekt mes dy shteteve palë vetëm nëse asnjëra nuk ka bërë njoftim në lidhje me tjetrën sipas nenit 2 ose 3. Paragrafi 1 specifikon që në mungesë të njoftimit të tillë, konventa ka efekt mes dy shteteve nga dita e parë e muajit pas skadimit të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet.⁵⁷³ Sa i përket Maqedonisë së Veriut, nuk ka çështje politike apo ligjore me shtetet e tjera që do të mund të rezultojnë në përdorimin e opsionit të kufizuar të refuzimit dhe pritet që Konventa e Hagës e vitit 2019 do të jetë e zbatueshme për të gjitha shtetet anëtare të konventës.

4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së Hagës së vitit 2019

Duke pasur parasysh politikën e përgjithshme të Maqedonisë së Veriut në lidhje me avancimin e tregtisë dhe parashikueshmërinë e zbatimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve, pritet që Maqedonia e Veriut nuk do ta shfrytëzojë mundësinë për të bërë deklaratë sipas neneve

573 Garcimartín Alférez, F., Saumier, G. "Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters: Explanatory Report," as approved by the HCCH on 22 September 2020, <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf> (Aksesuar më 28 prill 2021), f. 176-177, paragrafët 407-408.

17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së Hagës të vitit 2019.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e Hagës të vitit 2019

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)

Thjeshtësia dhe koherenca e LDNP 2020 është e qartë në seksionin e parë të Kapitullit I, që parashtron dispozitat e përgjithshme për juridiksionin ndërkombëtar. Risia kryesore sa i përket dispozitave të juridiksionit të përgjithshëm si në procedurën kontestimore ashtu edhe në atë jokontestimore, është prezantimi i vendqëndrimit të zakonshëm i të paditurit si kriter juridik.⁵⁷⁴ Vendbanimi i të paditurit është ende i pranishëm si kriter juridiksional, por tani jepet si alternativë me vendqëndrimin e zakonshëm të të paditurit. Prandaj, juridiksioni i përgjithshëm i Gjykatave të Maqedonisë së Veriut vendoset nëse i padituri (që është person fizik) ka vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në Maqedoninë e Veriut. Ka një dispozitë të veçantë lidhur me kriterin e juridiksionit të përgjithshëm për personat juridikë në të dyja procedurat që e përcakton juridiksionin e Gjykatave të Maqedonisë së Veriut sipas selisë së personit juridik.⁵⁷⁵ Një risi tjetër është dispozita në LDNP 2020 që e përjashton trashëgiminë nga juridiksioni i përgjithshëm.⁵⁷⁶

Neni 5, paragrafi 1, germa "a" e Konventës së Hagës së vitit 2019 parasheh që një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim nëse personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi e ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur ai person është bërë palë e procedurave. LDNP e re 2020 po ashtu i parasheh vendbanimin dhe vendqëndrimin e zakonshëm si kriter juridiksionale për përcaktimin e juridiksionit themelor.⁵⁷⁷ Në shikim të parë, një dispozitë e tillë përkon me filtrin juridiksional të parashikuar në nenin 5, paragrafi 1, germa «a» të Konventës së Hagës të vitit 2019 dhe zakonisht vendbanimi do të përkojë me vendqëndrimin e zakonshëm të të paditurit. Megjithatë, migrimet e fundit në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon mund të nxisin një problem të mundshëm në zbatimin e këtij filtri juridiksional në rastin e personave fizikë. Kryesisht, gjykatat do ta përcaktojnë në mënyrë tradicionale juridiksionin themelor bazuar në vendbanimin e të paditurit në Maqedoninë e Veriut, përkundër kriterit të ri juridiksional të vendqëndrimit të zakonshëm. Vendbanimi përcaktohet sipas ligjit «Për raportimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të përkohshëm»⁵⁷⁸ dhe është kryesisht i natyrës administrative, megjithatë, me një element subjektiv të shtuar në nocion.⁵⁷⁹ Në praktikë, gjykatat e përcaktojnë vendbanimin me dokumentet personale ose të udhëtimit të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme,⁵⁸⁰ të cilat nganjëherë nuk përkojnë me situatën faktike,⁵⁸¹ sepse shumë njerëz qëllimisht ose nga neglizhenca nuk e respektojnë obligimin për t'u regjistruar nëse largohen nga vendi për më shumë se tre muaj.⁵⁸² Si rrjedhojë, mund të jetë një situatë hipotetike ku

574 Neni 110, paragrafi 1 i LDNP 2020 dhe neni 114, paragrafi 1 i LDNP 2020

575 Neni 110, paragrafi 1 i LDNP 2020 dhe neni 114, paragrafi 1 i LDNP 2020

576 Neni 110, paragrafi 2 i LDNP 2020 dhe neni 114, paragrafi 3 i LDNP 2020

577 Neni 110, paragrafi 1 i LDNP 2020

578 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/92, 12/93, 43/00, 66/07, 51/11, 152/15 dhe 55/16

579 Neni 2 i ligjit „Për raportimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të përkohshëm” e definon termin vendbanim si “Vendbanimi është vendi ku qytetari është vendosur me qëllimin për të jetuar aty përherë dhe ka marrë apartament për të jetuar”.

580 Neni 98 i ligjit „Për procedurën civile”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015

581 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mban evidenca koherente për të dyja kategoritë e adresave – vendbanimi i përkohshëm dhe vendbanimi i përhershëm. Bazuar në një deklaratë të thjeshtë, qytetarët mund të regjistrohen në një adresë të përkohshme në vend dhe lejohen të votojnë aty, edhe pse nuk janë duke jetuar në adresën e deklaruar ose mund të mos kenë vendbanim në këtë vend. Edhe pse dispozitat ligjore e obligojnë MPB-në t'i regjistrojë qytetarët që janë larguar nga shteti për më shumë se tre muaj dhe nuk e kanë deklaruar këtë gjë, si dhe për të bërë verifikime të deklaramëve të adresave të përkohshme, veprimet proaktive të MPB-së kanë qenë të kufizuara për përditësimin e regjistrit të adresave. Ky raport ka gjetur në lidhje me listën elektorale se “Procesi i rishikimit, që është vrojtuar nga katër partitë kryesore politike, ka çuar në një numër të kufizuar të fshirjeve, kryesisht të personave të vdekur. Përveç kësaj, 39 502 votues janë identifikuar si persona me të dhëna „të dyshimta të regjistrimit” dhe janë obliguar të regjistrohen përsëri dhe 171 500 votues janë konsideruar si me vendqëndrim të përkohshëm jashtë vendit dhe janë zhvendosur në një regjistër të veçantë të votuesve jashtë vendit”. Raporti Final i Misionit të OSBE/ODIHR mbi Vëzhgimin e Zgjedhjeve, ZGJEDHJET E PARAKOHSHE PARLAMENTARE 11 dhjetor 2016, i disponueshëm online <https://www.osce.org/files//documents/8/b/302136.pdf>. I aksesuar më 28 prill 2021.

582 Neni 8 i ligjit „Për raportimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të përkohshëm”.

gjykatat në Maqedoninë e Veriut me të drejtë kanë supozuar juridiksion në bazë të nenit 110 të LDNP-së (vendbanimi i të paditurit), por vendimi nuk mundi ta kalonte filtrin juridiksional të parashikuar në nenin 5, paragrafi 1, germa “a” të Konventës së Hagës të vitit 2019, për shkak se vendqëndrimi i zakonshëm i të paditurit është në një vend tjetër. Një zgjidhje e mundshme është aplikimi i vendqëndrimit të zakonshëm i të paditurit si kriter juridiksional bazuar në nenin 110 të LDNP-së në vend të vendbanimit. Neni 110 i LDNP-së i parasheh të dyja kriteret juridiksionale dhe përmbushja e njërit prej tyre mjafton. Në këto raste, nëse gjykata e Maqedonisë së Veriut përcakton juridiksion bazuar në vendqëndrimin e zakonshëm të të paditurit, kjo do ta zvogëlonte mospërputhjen mes vendbanimit dhe vendqëndrimit të zakonshëm, dhe sërish do të parashihte mbrojtje të mjaftueshme të të paditurit.

5.2 Prorogimi i juridiksionit (drejtpërdrejtë/tërthorazi, para ose pas fillimit të procedurës)

Seksioni 2 i LDNP 2020 tashmë i dedikohet prorogimit të juridiksionit. Ky seksion është modifikuar dhe është përpiluar në përputhje me Rregulloren I bis të Brukselit.⁵⁸³ Nenet 122 deri 125 pasqyrojnë dispozitat në seksionin 7 të Rregullores I bis të Brukselit dhe formulimi i këtyre dispozitave përpiqet të ndjekë formulimin e dispozitave në Rregulloren I bis të Brukselit. Në krahasim me LDNP 2007, një prej risive më domethënëse është parashikuar në nenin 122 të LDNP 2020 që i referohet prorogimit të juridiksionit të gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Sipas kësaj dispozite, statusi i juridiksionit ekskluziv i atribuohet prorogimit të juridiksionit të gjykatave të Maqedonisë së Veriut.⁵⁸⁴ Me një pozitë të tillë, prorogimi i juridiksionit të gjykatave të Maqedonisë së Veriut mbështetet nga të gjitha modalitetet për mbrojtjen e juridiksionit ekskluziv në LDNP 2020 siç është rregulli *lis pendes*⁵⁸⁵ dhe mosnjohja e vendimeve të huaja që janë në kundërshtim me prorogimin e gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁵⁸⁶ Efekti i aspektit të juridiksionit ekskluziv të marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës nuk është absolut, pasi që iu mbetet palëve të vendosin për një efekt të tillë.⁵⁸⁷ Një dallim tjetër i rëndësishëm në LDNP 2020 nga LDNP 2007 është që për t'i zgjedhur gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk kërkohet që njëra nga palët të jetë shtetas maqedonas, apo nëse është person juridik ta ketë *situsin (selinë)* në Maqedoninë e Veriut.⁵⁸⁸ Për më tepër, LDNP 2020 parashtron se në mënyrë që të zgjidhet një gjykatë e huaj, nuk kërkohet që njëra nga palët të jetë shtetas i huaj apo nëse është person juridik ta ketë *situsin (selinë)* në një shtet të huaj.⁵⁸⁹

Neni 5, paragrafi 1 i Konventës së Hagës të vitit 2019 parasheh filtra juridiksionalë që kanë të bëjnë me tri forma të pëlqimit: shprehja e pëlqimit gjatë procesit gjyqësor (neni 5, paragrafi 1, germa “e” e Konventës së Hagës të vitit 2019), pëlqimi i nënkuptuar (neni 5, paragrafi 1, germa “f” e Konventës së Hagës të vitit 2019) dhe marrëveshja mes palëve për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës (neni 5, paragrafi 1, germa “m” e Konventës së Hagës të vitit 2019).⁵⁹⁰ Gjerësisht e ndikuar nga Rregullorja I bis e Brukselit, LDNP 2020 parasheh rregulla juridiksioni të drejtpërdrejtë lidhur me pëlqimin e shprehur dhe të nënkuptuar.⁵⁹¹ Palët mund të pajtohen për juridiksionin para ose pasi të ketë lindur kontesti në lidhje me një marrëdhënie të caktuar juridike.⁵⁹² Po ashtu, Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar Konventën e Hagës të vitit 2005 dhe

583 Rregullorja (BE) nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012, „Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, GZBE L351/1. Për më shumë informata mbi marrëveshjet juridiksionale në Rregulloren I bis të Brukselit

584 Neni 122, paragrafi 2 i LDNP 2020

585 Neni 119 i LDNP 2020

586 Neni 160 i LDNP 2020

587 Neni 122, paragrafi 2 i LDNP 2020

588 Neni 56, paragrafi 3 i LDNP 2020

589 Neni 123, paragrafi 1 i LDNP 2020. Për vlefshmërinë formale të marrëveshjeve për zgjedhjen e gjykatës, kushtet replikojnë dispozitat e nenit 25, paragrafët „a” deri në „c” të Rregullores I bis të Brukselit. Po ashtu ekziston edhe mundësia e zgjedhjes së tërthortë të gjykatës në situatat kur i padituri ka hyrë në një paraqitje qoftë duke dorëzuar një përgjigje ndaj padisë, ka hyrë në një paraqitje për çështjen kryesore pa e kontestuar juridiksionin ose ka ngritur kundërpadi (neni 125, paragrafi 1 i LDNP 2020).

590 Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 160.

591 Seksioni 2, nenet 122-125 të LDNP-së.

592 Nenet 122 dhe 123 të LDNP-së.

pritet ta ratifikojë atë. Nëse Maqedonia e Veriut bëhet vend anëtar i Konventës së Hagës të vitit 2019, atëherë shpërndarja e vendimeve gjyqësore të njohura dhe/ose të ekzekutuara sipas këtyre instrumenteve do të bëhet në parimin “qoftë...ose”.

LDNP 2020 jep disa alternativa për paraqitje siç janë: i padituri ka paraqitur një përgjigje ndaj padisë pa e kontestuar juridiksionin; ka dhënë argumente mbi themelin dhe nuk e ka kontestuar juridiksionin apo nuk ka ngritur kundërpadi.⁵⁹³ Pika e fundit për kontestimin e juridiksionit është seanca preliminare në gjykatë, apo në rastet kur nuk ka seancë preliminare në gjykatë, në seancën e parë gjyqësore.⁵⁹⁴ Siç është rasti me nenin 26, paragrafi 2 i Rregullores I bis të Brukselit, në rastet kur një mbajtës i policës, i siguruar, përfitues i një kontrate sigurimi, palë e lënduar, konsumator apo punëtor është i padituri, pa pretenduar ende juridiksionin, gjykata do të sigurojë që i padituri është informuar për të drejtën e tij për ta kontestuar juridiksionin e gjykatës, dhe për pasojat e ardhjes apo mos ardhjes në proces.⁵⁹⁵ Prandaj për rastet e paraqitjes, vendimet gjyqësore të marra nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut mund të qarkullojnë nën Konventën e Hagës të vitit 2019.

5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

5.3.1 Vendi kryesor i biznesit (person fizik)

Neni 5, paragrafi 1, germa “b” parasheh një filtër juridiksional për situatat shumë të kufizuara, shumë të ngushta ku një person fizik kundër të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi e ka pasur vendin kryesor të biznesit në shtetin e origjinës në kohën kur personi është bërë pjesë e procesit gjyqësor në gjykatën e origjinës dhe padia në të cilën bazohet vendimi ka lindur nga ato veprimtari. LDNP 2020 ndikohet nga Rregullorja Roma I dhe Roma II dhe përmban një përkufizim të ngjashëm për vendin kryesor të biznesit për një person fizik.⁵⁹⁶

5.3.2 Paraqitja e një padie në procesin kryesor - paditësi

Një prej filtrave më të dukshëm juridiksionalë është neni 5, paragrafi 1, germa “c” që i referohet vendimeve gjyqësore kundër paditësit të procesit kryesor. Arsyetimi i këtij filtri juridiksional është i qartë: nëse paditësi nga procesi kryesor (që në shumicën e rrethanave zgjedh forumin) e humb çështjen,⁵⁹⁷ atëherë vendimi duhet të njihet në shtetet e tjera pa mundësinë e kontestimit të juridiksionit.⁵⁹⁸ Janë disa aspekte që duhet të merren parasysh sa i përket zbatimit të këtij filtri juridiksional. Së pari, ky rregull iu referohet padive, duke i përjashtuar kështu kundërpaditë të cilat trajtohen në mënyrë të veçantë në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi I i Konventës së Hagës të vitit 2019.⁵⁹⁹ Së dyti, neni 5, paragrafi 1, germa «c» është i rëndësishëm së veçantë kur paditësi nuk ka vendqëndrim të zakonshëm në shtetin e origjinës sepse në një skenar të tillë, filtri juridiksional që bazohet në pëlqimin e nënkuptuar të paditësit bëhet relevant, për dallim prej lidhjes së palëve me shtetin e origjinës në nenin 5, paragrafi 1, germa «a» e Konventës së Hagës të vitit 2019.

5.3.3 Dega, agjencia ose institucionet e tjera

Ndikimi i nenit 7, paragrafi 5 i Rregullores I bis të Brukselit lidhur me “juridiksionin e degës” mund të shihet në nenin 5, paragrafi 1, germa “d” e Konventës së Hagës të vitit 2019, edhe pse kjo e fundit parasheh një qasje më kufizuese sa i përket filialeve.⁶⁰⁰ Zbatimi i këtij rregulli nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut duhet të bëhet pa asnjë problem, pasi që LDNP 2020 përmban një dispozitë lidhur me përcaktimin e juridiksionit të gjykatave për çështjet që lindin nga veprimtaritë e një dege, agjencie apo institucioni tjetër, për sa kohë që ato ndodhen në Maqedoninë e Veriut dhe i padituri nuk ka seli statutore në Maqedoninë e Veriut.⁶⁰¹ Nëse i padituri ka seli statutore në Maqedoninë e Veriut, atëherë juridiksioni themelor i gjykatave të Maqedonisë së Veriut do të përcaktohet sipas selisë statutore të të paditurit të parashikuar në nenin 110 të LDNP-së (që është në përputhje me filtrin juridiksional të parashikuar në nenin 5, paragrafi 1, germa «a» e Konventës së Hagës të vitit 2019).

5.3.4 Detyrimet kontraktore

Neni 5, paragrafi 1, germa “g” e Konventës së Hagës të vitit 2019 përcakton filtrin juridiksional për marrëdhëniet juridike që janë marrëdhënie kontraktore. Në mënyrë që një vendim i huaj ta kalojë këtë filtër, ai duhet të plotësojë disa kushte: së pari, duhet të ketë lidhje me detyrimet kontraktore; së dyti, gjykata e origjinës duhet të jetë gjykata ku është kryer ose është dashur të kryhet ai detyrim; së treti, vendi i kryerjes së detyrimit kontraktor është përcaktuar në kontratë ose diku tjetër nëse kontrata nuk e ka përcaktuar këtë çështje sipas ligjit të zbatueshëm për këtë kontratë; dhe së fundmi, që vendi i realizimit të kontratës nuk është arbitrar, nuk ka lidhje rastësore ose të pamjaftueshme me transaksionin mes palëve dhe që ekziston një lidhje e qëllimshme dhe domethënëse me shtetin e origjinës. Nëse kjo dispozitë krahasohet me rregullat për juridiksionin e drejtpërdrejtë lidhur me kontratat në BE, të parashikuara përkatësisht në Rregulloren I bis të Brukselit⁶⁰² dhe në juridiksione të tjera jashtë BE-së,⁶⁰³ shihet qartë që kjo dispozitë paraqet një kompromis mes dy qasjeve⁶⁰⁴ dhe përpiket të ndërtojë “ura konceptuale”⁶⁰⁵ mes kulturës ligjore më “juridike” dhe kulturës ligjore më “faktike”.⁶⁰⁶

Neni 145 i LDNP 2020 ndjek kriteret juridiksionale nga neni 7, paragrafi 1 i Rregullores I bis të Brukselit dhe parasheh këtë sistem të dyfishtë juridiksioni të drejtpërdrejtë, mbi të cilin gjykatat e Maqedonisë së Veriut do të supozonin juridiksionin (vendi i realizimit të kontratave dhe nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, detyrimi “karakteristik” lidhur me shitjen e mallrave dhe shërbimeve). Në këtë mënyrë, rezultati i mundshëm sa i përket ndërlidhjes mes Konventës së Hagës dhe regjimit të Rregullores I bis të Brukselit vlen për Maqedoninë e Veriut dhe juridiksioni i supozuar në përputhje me nenin 145 të LDNP nuk do të përputhej me kushtet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, germa “g” e Konventës së Hagës e vitit 2019. Kështu, vendimet e marra nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut në atë bazë juridiksionale nuk mund ta kalojnë filtrin juridiksional. Megjithatë, këto vendime mund të njihen dhe të ekzekutohen në shtete të tjera sipas filtrave të tjerë juridiksionalë të përcaktuar në nenin 5 ose sipas rregullave kombëtare në përputhje me nenin 15 të Konventës së Hagës të vitit 2019.

600 Shihni Garcimartin dhe Saumier, paragrafi 157. Megjithatë, ekzistojnë disa interpretime të tjera lidhur me atë se a i mbulon ky rregull filialet përmes “doktrinës së paraqitjes” siç parashikohet në vendimin nga çështja e *GJDBESAR Schotte GmbH v Parfums Rothschild SARL* (ECLI:EU:C:1987:536), 9. Weller M. “The Jurisdictional Filters of the HCCH 2019 Judgments Convention.” *Yearbook of Private International Law* XXI, 2019/2020, f.289. Skenari i parashikuar në nenin 5, paragrafi 1, germa „d“ i referohet një situatë specifike me disa kushte: së pari, që i padituri në procesin kryesor e ka deklaruar një degë, agjenci apo institucion tjetër; së dyti, që dega, agjencia apo institucioni tjetër nuk ka pasur karakter ligjor; së treti, që dega, agjencia ose institucioni tjetër ndodhet në shtetin e origjinës në kohën kur i padituri bëhet palë në proces në gjykatën e origjinës dhe së fundmi, që padia në të cilën bazohet vendimi është ngritur si rrjedhojë e veprimtarive të degës, agjencisë ose një institucioni tjetër.

601 Neni 149 i LDNP-së.

602 Neni 7, paragrafi 1 i Rregullores I bis të Brukselit.

603 SHBA dhe Kanada. Për doktrinën ligjore në këto vende shihni Bonomi dhe Mariottini, f. 556.

604 Garcimartin dhe Saumier, paragrafi 180.

605 Weller, f.294.

606 Garcimartin dhe Saumier, paragrafi 180.

593 Neni 125 i LDNP-së

594 Po aty.

595 Neni 125, paragrafi 2 i LDNP-së.

596 Neni 6, paragrafi 2 i LDNP 2020.

597 Dëmet i barten atij/asaj, të cilat njihen sipas nenit 3, paragrafi 1, germa «b» e Konventës së Hagës të vitit 2019.

598 Garcimartin dhe Saumier, paragrafët 147-151.

599 Po ashtu, kundërpaditësi nuk e “zgjedh” forumin. Bonomi, A., Mariottini, Cristina M., “(Breaking) News From The Hague: A Game Changer in International Litigation? – Roadmap to the 2019 Hague Judgments Convention”, *Yearbook of Private International Law* 20 (2018/2019), f. 553

5.3.5 Detyrimet jokontraktore

Filtri juridiksional për vendimet gjyqësore lidhur me detyrimet jokontraktore është përcaktuar në nenin 5, paragrafi 1, germa “j” e Konventës së Hagës të vitit 2019. Kriteri juridiksional i parashikuar në këtë nen është vendi ku ka ndodhur veprimi apo mosveprimi që drejtpërdrejtë e ka shkaktuar një dëm të tillë, pavarësisht se ku ka ndodhur dëmi, që nënkupton se shteti i origjinës është vendi ku ka ndodhur veprimi apo mosveprimi që e ka shkaktuar dëmin. Kjo pozitë, e parë së bashku me kufizimet e llojeve të dëmit, është në përputhje me praktikën ligjore në SHBA dhe paraqet një distancim nga qasja e gjerë juridiksionale e Rregullores I bis të Brukselit.⁶⁰⁷ Kjo mund të krijojë disa paqartësi lidhur me zbatimin e nenit 5, paragrafi 1, germa “j” e Konventës së Hagës të vitit 2019 për vendimet gjyqësore nga Gjykatat e Maqedonisë së Veriut pasi që neni 148, paragrafi 1 i LDNP 2020 është transpozim i nenit 7, paragrafi 2 i Rregullores I bis të Brukselit që mbulon një fushë më të gjerë materiale të marrëdhënieve që nuk do të njiheshin apo ekzekutoheshin sipas Konventës së Hagës të vitit 2019. Megjithatë, nëse vendimet gjyqësore nuk mund të njihen apo të ekzekutohen sipas këtij filtri juridiksional, atëherë mund të aplikohen filtra të tjerë juridiksionalë në nenin 5, paragrafi 1 i Konventës së Hagës të vitit 2019 apo eventualisht neni 15 i Konventës së Hagës të vitit 2019 do të parashikojë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore sipas rregullave kombëtare.

5.3.6 Trustet

Dispozitat në nenin 5, paragrafi 1, germa “k” e Konventës së Hagës të vitit 2019 zbatohen për vendimet gjyqësore që iu referohen trusteve. Nuk ka rregulla të veçanta për trustet në LDNP 2020.

5.3.7 Kundërpaditë

Neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi I i Konventës së Hagës të vitit 2019 parasheh një filtër juridiksional lidhur me kundërpaditë. Kjo dispozitë dallon dy skenarë bazuar në faktin nëse kundërpadia ka qenë: (i) në favor të kundërpaditësit; ose (ii) kundër kundërpaditësit.

LDNP 2020 përmban një dispozitë të veçantë lidhur me kundërpaditë, duke përcaktuar juridiksion të drejtpërdrejtë të gjykatave të Maqedonisë së Veriut për kundërpaditë nëse kërkesa për kundërpadi është në përputhje me padinë.⁶⁰⁸ Një qëndrim i tillë është në përputhje me Konventën e Hagës të vitit 2019.

5.3.8 Kontratat e konsumatorëve dhe kontratat e punës

Konsumatorët dhe punëtorët janë në përgjithësi të mbrojtur në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.⁶⁰⁹ Dispozita të tilla mund të gjenden në Rregulloren I bis të Brukselit,⁶¹⁰ instrumente të tjera ndërkombëtare⁶¹¹ si dhe në LDNP 2020.⁶¹² Kontratat e konsumatorëve dhe punëtorëve përjashtohen nga fushëveprimi i zbatimit të Konventës së Hagës të vitit 2005,⁶¹³ dhe njohja apo ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në këto marrëdhënie mbulohet me Konventën e Hagës të vitit 2019. Megjithatë, jo të gjitha vendimet gjyqësore lidhur me kontratat e konsumatorëve dhe punëtorëve mbulohen nga Konventa e Hagës e vitit 2019.

LDNP 2020 përmban dispozita të veçanta lidhur me përcaktimin e juridiksionit të drejtpërdrejtë

⁶⁰⁷ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 197; Bonomi dhe Mariottini, f.558.

⁶⁰⁸ Neni 113 i LDNP-së.

⁶⁰⁹ Nielsen, P. A. “The Hague 2019 Judgments Convention – from failure to success.” *Journal of Private International Law* 16. 2020, f.222.

⁶¹⁰ Nenet 17 deri 23 të Rregullores I bis të Brukselit. Rregullorja I bis e Brukselit po ashtu siguron një mbrojtje të caktuar ndaj personave të siguruar, shihni edhe nenet 10 deri 16 të Rregullores I bis të Brukselit.

⁶¹¹ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 222.

⁶¹² Nenet 146 dhe 147 të LDNP-së.

⁶¹³ Neni 2 paragrafi 1, germa „b” e Konventës së Hagës të vitit 2005.

mbi kontratat e konsumatorëve dhe kontratat individuale të punës.⁶¹⁴ Sa i përket kontratave të konsumatorëve, është i zbatueshëm neni 146 i LDNP-së. Dispozitat në nenin 146 të LDNP-së janë mbështetur në rregullat për përcaktimin e juridiksionit të drejtpërdrejtë në Rregulloren I bis të Brukselit⁶¹⁵ dhe iu referohen dy skenarëve të veçantë: kur paditësi është konsumatori dhe kur është shitësi. Nëse paditësi është konsumatori, atëherë gjykatat e Maqedonisë së Veriut do të kishin juridiksion nëse shitësi ka vendbanim në Maqedoninë e Veriut.⁶¹⁶ Nëse është e kundërta, nëse shitësi është paditësi dhe i padituri është konsumatori, atëherë juridiksioni ekskluziv i gjykatave të Maqedonisë së Veriut vlen nëse konsumatori ka vendbanim në Maqedoninë e Veriut.⁶¹⁷ Kjo situatë është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me Konventën e Hagës të vitit 2019 sepse në shumicën e rasteve, juridiksioni mbi vendimet gjyqësore për konsumatorin, kur konsumatori është personi ndaj të cilit kërkohet njohja, do të përcaktohej sipas vendbanimit të konsumatorit. Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara që mbeten pas zbatimit të pengesave dhe kufizimeve të parashikuara në nenin 5, paragrafi 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019, i vetmi rezultat i parashikueshëm do të ishte filtri juridiksional në nenin 5, paragrafi 1, germa “a” e Konventës së Hagës të vitit 2019, që është vendqëndrimi i zakonshëm i konsumatorit. Një qëndrim i tillë nuk është pa probleme, siç janë çështjet që u përmendën më herët lidhur me problemin e përcaktimit të vendbanimit nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut dhe të vendqëndrimit të zakonshëm. Në disa situata kjo eventualisht do të çonte në mosnjohje të vendimeve gjyqësore për kontratat e konsumatorëve sipas Konventës së Hagës të vitit 2019, ku gjykata e Maqedonisë së Veriut me të drejtë vendosi juridiksionin e saj në bazë të vendbanimit të të paditurit, por i padituri ka vendqëndrim të zakonshëm diku tjetër, duke e bërë kështu Konventën e Hagës të vitit 2019 të pazbatueshme për kontratat e konsumatorëve. Një qëndrim i tillë mund të zbutet me dy rregulla: e para nga mundësia në nenin 146, paragrafi 3 i LDNP-së që lejon përjashtim nga juridiksioni ekskluziv duke u lejuar palëve të pajtohen me juridiksionin e gjykatave të Maqedonisë së Veriut me kushtin që pëlqimi duhet të jepet pasi të ketë lindur kontesti. Megjithatë, pëlqimi duhet të jepet në mënyrë të qartë gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor para gjykatës, në mënyrë që të kalohet kufizimi i filtrit juridiksional në nenin 5, paragrafi 2 që i referohet nenit 5, paragrafi 1, germa “e” e Konventës së Hagës të vitit 2019. Ky skenar do të ishte i dobishëm për një numër shumë të vogël vendimesh gjyqësore pasi që kërkon akte shumë specifike nga palët. Mundësia e dytë e parashikuar në nenin 15 të Konventës së Hagës duket më realiste dhe në një situatë kur shpallet një vendim kundër një konsumatori me vendqëndrim të zakonshëm jashtë Maqedonisë së Veriut, këto vendimeve gjyqësore do të njihen sipas rregullave kombëtare të gjykatës që bën njohjen. I njëjti arsyetim vlen për kontratat individuale të konsumatorëve pasi që neni 147 i LDNP-së parasheh të njëjtin juridiksion ekskluziv bazuar në vendbanimin e punëtorit si kriter juridiksional.

5.4 Juridiksioni ekskluziv

Dispozitat specifike për juridiksionin ndjekin sistematizimin e dispozitave që përcaktojnë ligjin e zbatueshëm. Paragrafi 3 i kapitullit I në pjesën III ndahet në nënparagrafë që përmbajnë dispozita specifike mbi juridiksionin për statusin e personave,⁶¹⁸ marrëdhëniet familjare,⁶¹⁹ trashëgiminë,⁶²⁰ të drejtat reale (in rem),⁶²¹ të drejtat mbi pronësinë intelektuale,⁶²² marrëdhëniet kontraktore dhe jokontraktore.⁶²³

⁶¹⁴ Nenet 146 dhe 147 të LDNP-së.

⁶¹⁵ Rumenov I. Europeanisation of the Macedonian Private International Law – Legal Evolution of a National Private International Law Act, EU and comparative law issues and challenges (ECILC), Vol.4, 2020, Osijek, Croatia, f. 319.

⁶¹⁶ Neni 146, paragrafi 1 i LDNP-së.

⁶¹⁷ Neni 146, paragrafi 2 i LDNP-së.

⁶¹⁸ Nenet 126 deri 130 të LDNP 2020.

⁶¹⁹ Nenet 131 deri 136 të LDNP 2020.

⁶²⁰ Nenet 137 deri 140 të LDNP 2020.

⁶²¹ Nenet 141 deri 143 të LDNP 2020;

⁶²² Neni 144 i LDNP 2020.

⁶²³ Nenet 145 deri 150 të LDNP 2020.

LDNP 2020 ka sjellë ndryshime të rëndësishme sa i përket juridiksionit ekskluziv. Së pari, është zvogëluar numri i situatave ku gjykatave të Maqedonisë së Veriut u është dhënë juridiksion ekskluziv. Në LDNP 2007 ishin 13 situata të juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Maqedonisë së Veriut.⁶²⁴ Në LDNP 2020, vetëm 7 situata janë karakterizuar me juridiksion ekskluziv të gjykatave të Maqedonisë së Veriut:

1. Marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës që përcaktojnë juridiksionin e gjykatës në Maqedoninë e Veriut (përveç nëse palët kanë vendosur ndryshe),⁶²⁵
2. Kontestet lidhur me themelimin, shpërbërjen dhe ndryshimet në statusin ligjor të personit juridik, nëse shoqëria apo ndonjë person tjetër ligjor apo shoqata e ka vendin kryesor të biznesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,⁶²⁶
3. Kontestet (mosmarrëveshjet) lidhur me regjistrimet në regjistrat publikë, nëse regjistrat publikë mbahen në Republikën e Maqedonisë së Veriut,⁶²⁷
4. Kontestet lidhur me birësimin, nëse i birësuari është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka vendqëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut në kohën e fillimit të procedurës për birësim,⁶²⁸
5. Kontestet lidhur me të drejtat e pronës për pronën e paluajtshme dhe kontestet lidhur me qiranë e pronës së paluajtshme (përveç qirasë për afat të shkurtër për një periudhë prej më pak se gjashtë muajsh rresht) nëse prona e paluajtshme ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;⁶²⁹
6. Kontestet lidhur me të drejtat e pronësisë industriale, nëse aplikimi për dorëzim apo regjistrim është paraqitur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dorëzimi apo regjistrimi i asaj të drejte është bërë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, apo bazuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, rast në të cilin do të konsiderohet që dorëzimi apo regjistrimi i asaj të drejte është bërë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;⁶³⁰
7. Kontestet lidhur me marrëveshjet individuale të punës, nëse punëdhënësi është paditësi dhe punëtori është i padituri, dhe nëse ai/ajo ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁶³¹

5.4.1 Kriteri juridiksional për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar lidhur me të drejtat reale (in rem) në pronën e paluajtshme

Konventa e Hagës e vitit 2019 përmban disa dispozita lidhur me pronën e paluajtshme. Neni 6 i Konventës së Hagës të vitit 2019 është shumë specifik dhe është një dispozitë shumë e rëndësishme në mekanizmin e Konventës, duke e ngritur mbrojtjen e forumit në të cilin ndodhet prona e paluajtshme deri në rëndësinë më të lartë dhe duke ofruar juridiksion të tërthortë ekskluziv për këto çështje.⁶³² Pasoja e dispozitave të nenit 6 të Konventës së Hagës të vitit 2019, është që vendimet gjyqësore lidhur me të drejtat *reale* do të njihen vetëm nëse janë dhënë nga gjykata ku ndodhet prona. Kjo do të thotë që rruga e vetme drejt "exequatur" për këto vendime gjyqësore është nëse merren në një forum *rei sitae* dhe, e kundërta, nëse merren nga një gjykatë tjetër nga ajo ku ndodhet prona, këto vendime gjyqësore nuk duhet të njihen apo të ekzekutohen as sipas Konventës as sipas ligjit kombëtar, duke e bërë nenin 15 të Konventës së Hagës të vitit 2019 të

pazbatueshëm në këto situata.⁶³³ Një qëndrim i tillë nuk është risi në të drejtën ndërkombëtare private pasi që, në përgjithësi, pjesë të ngjashme mund të gjinden në burime të tjera ligjore si për shembull në nenin 24 të Rregullores I bis të Brukselit.

LDNP 2020 parasheh një grup rregullash juridiksionale lidhur me të drejtat in rem dhe qiramarrjet. Neni 141 i LDNP-së, i ndikuar gjerësisht nga neni 24 i Rregullores I bis të Brukselit, fillimisht parasheh juridiksion ekskluziv për gjykatën e Maqedonisë së Veriut mbi të drejtat *in rem* në pronën e paluajtshme apo qiramarrjen e pronës së paluajtshme. Megjithatë, neni 141, paragrafi 2 i LDNP-së parasheh përjashtim nga juridiksioni ekskluziv i gjykatës së Maqedonisë së Veriut lidhur me qiramarrjet afatshkurta (i përpiluar në bazë të nenit 24, paragrafi 1 i Rregullores I bis të Brukselit) me kusht që qiramarrjet e pronës së paluajtshme të bëhen për shfrytëzim të përkohshëm privat për një periudhë maksimale prej gjashtë muaj rresht, dhe nëse qiramarrësi është person fizik dhe nëse qiradhënësi dhe qiramarrësi kanë vendbanim në të njëjtin shtet anëtar. Me një qëndrim të tillë, pritet që vendimet gjyqësore nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut në shumicën e rasteve do ta bazojnë juridiksionin e tyre mbi çështjet lidhur me pronën e paluajtshme dhe qiramarrjen në faktin që prona e paluajtshme ndodhet në Maqedoninë e Veriut, duke parashikuar juridiksion ekskluziv, përveç qiramarrjeve afatshkurta të cilave vetëm në situata të kufizuara mund t'u jepet juridiksion i njëkohshëm.

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e Hagës të vitit 2019

6.1 Fushëveprimi material i aplikimit

Ratione materiae i LDNP 2020 është dhënë në nenin 1. Ai parasheh që LDNP 2020 përmban dispozita për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për marrëdhëniet juridike private që përmbajnë një element të huaj, dispozita për juridiksionin dhe dispozita për procedurën e gjykatave dhe autoriteteve të tjera, si dhe dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të autoriteteve të tjera.

Në krahasim me nenin 1 të LDNP 2007, ai në përgjithësi dallon në dy aspekte. Së pari, sa i përket marrëdhënieve juridike që mbulon, LDNP 2020 përmban vetëm një përshkrim të përgjithshëm të marrëdhënieve juridike "marrëdhëniet juridike private që përmbajnë një element të huaj" ndërsa LDNP 2007 rendit marrëdhëniet juridike lidhur me "... (statusin) personal, familjen, punën, pronën dhe marrëdhënie të tjera civile që kanë një element ndërkombëtar". Zgjidhja identike gjendej në nenin 1 të LDNP 1982. Së dyti, ekziston një dallim formal mes nenit 1 të LDNP 2020 dhe nenit 1 të LDNP 2007, ku neni 1 i LDNP 2020 përmban vetëm një paragraf dhe neni 1 i LDNP 2007 përmban dy paragrafë. Megjithatë, përmbajtja lëndore e ligjit ka mbetur e njëjtë, duke përmbajtur dispozita për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave dhe autoriteteve të tjera të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në Maqedoninë e Veriut.

6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e fushëveprimit material të kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Konventa e Hagës e vitit 2019 lidhur me *ratione materiae* përdor një qasje të njohur që gjendet në Konventën e Hagës të vitit 2005 si dhe në Rregulloren I bis të Brukselit⁶³⁴ me disa specifika të

624 Neni 65, 66, 67, 68, 63, 84, 85, 86, 73 paragrafi 2, 76 paragrafi 2, 78 paragrafi 2, 83 paragrafi 2, 87, 88 dhe 91 të LDNP 2007.

625 Neni 122, paragrafi 2 i LDNP 2020.

626 Neni 129 i LDNP 2020.

627 Neni 130 i LDNP 2020.

628 Neni 136, paragrafi 2 i LDNP 2020.

629 Neni 141 i LDNP 2020.

630 Neni 144 i LDNP 2020.

631 Neni 147, paragrafi 2 i LDNP 2020.

632 Nielsen, f.223.

633 Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 231.

634 Rregullorja (BE) nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012, „Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve

caktuara që janë të veçanta për Konventën e Hagës të vitit 2019.

Neni 1 së bashku me nenin 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019 parasheh fushëveprimin e aplikimit të kësaj Konvente dhe e përcakton zbatimin e saj në kushte përmbajtësore.⁶³⁵ Në kushte përmbajtësore, fushëveprimi i aplikimit siç është parashikuar në nenin 1 të Konventës së Hagës të vitit 2019 thekson që zbatohet për çështje civile ose tregtare,⁶³⁶ dhe më tutje përjashton fusha më specifike siç janë të ardhurat, dogana dhe vendimet administrative nga fushëveprimi i aplikimit.⁶³⁷ Njësoj si në rastin e Rregullores I bis të Brukselit, fushëveprimi i aplikimit nuk kufizohet vetëm me këto aspekte të së drejtës publike, por mbulon edhe *acta iure imperii* kur shtetet ushtrojnë pushtetin e tyre qeveritar dhe sovran që nuk gëzohet nga personat e thjeshtë.⁶³⁸ Gjithashtu, neni 2, paragrafi 4 i Konventës së Hagës të vitit 2019 parasheh që një vendim nuk përjashtohet nga fushëveprimi i Konventës nëse një shtet, duke përfshirë qeverinë, agjencinë qeveritare apo ndonjë person që vepron për një shtet, ka qenë palë e procedurave. Si ekuilibër i këtij parimi, neni 19 parasheh mundësinë që një shtet të bëjë një deklaratë me të cilën e nxjerr veten jashtë këtyre vendimeve me efektin që pasi një palë kontraktore të ketë bërë këtë deklaratë, ajo nuk do të mund ta shfrytëzojë konventën për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të favorshëm.⁶³⁹ Neni 2 vazhdon me specifikat e tjera, duke renditur fushat e tjera që përjashtohen nga fushëveprimi i aplikimit.⁶⁴⁰ Një aspekt tjetër i rëndësishëm i nenit 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019 është që i përjashton vendimet e arbitrazhit dhe vendimet e tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve nga fushëveprimi i aplikimit. Për më tepër, Konventa e Hagës e vitit 2019 është e zbatueshme për vendimet gjyqësore civile ose tregtare në të cilat njëra prej palëve është një shtet, qeveri, institucion qeveritar ose një person që vepron në emër të shtetit, por duke përjashtuar aspektet e imunitetit dhe privilegjet e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare.

Kur ballafaqohet me një vendim të huaj, gjykata e njohjes duhet të ketë parasysh nenin 20 të Konventës së Hagës të vitit 2019 kur përcakton nëse një vendim është marrë në “çështje civile apo tregtare”, që është kusht për interpretimin dhe zbatimin uniform të konventës.⁶⁴¹ Rrjedhimisht, ky distancohet nga kuptimi i termit “çështje civile apo tregtare” në nocionin kombëtar⁶⁴² dhe nga kuptimi i dhënë në Rregulloren I bis të Brukselit, që është shumë më i gjerë se ai në Konventën e Hagës të vitit 2019.⁶⁴³ Për më tepër, gjykata e njohjes duhet të garantojë koherencë në interpretimin e termit “çështje civile apo tregtare” me instrumentet e tjera të HCCH-së, në veçanti me Konventën e Hagës të vitit 2005 «Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës».⁶⁴⁴

Ratione materiae e LDNP 2020 është në përputhje me Konventën e Hagës të vitit 2019 edhe pse ka ndryshuar paksa dhe është thjeshtuar në krahasim me përmbajtjen e LDNP 2007. Në krahasim me LDNP 2007, LDNP 2020 tashmë përmban vetëm një paragraf që përcakton se LDNP 2020 zbatohet për të gjitha çështjet e LDNP-së (ligji i zbatueshëm, juridiksioni dhe procedura ndërkombëtare, si dhe njohja e ekzekutimi). Ky rregull nuk hyn në përmbajtjen specifike

gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, GZBE L351, 20.12.2012, f. 1–32.

635 Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 27.

636 Karakterizimi i një vendimi nëse i përket çështjeve civile apo tregtare varet nga natyra e padisë ose veprimit që është lënda e vendimit gjyqësor dhe jo nga natyra e gjykatës, natyra e palëve apo nga vetë fakti se padia i është transferuar një personi tjetër. Shihni Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 28-31, f.8.

637 Garcimartín dhe Saumier, paragrafët 34-35.

638 Hartley T., Dogauchi M. “Convention of 30 June 2005 Choice of Court Agreements Convention: Explanatory Report”, <https://assets.ccch.net/docs/0de60e2f-e002-408e-98a7-5638e1ebac65.pdf>. Aksesuar më 28 prill 2021, paragrafi 85.

639 Bonomi dhe Mariottini, f.542.

640 Çështjet e përjashtuara nga Konventa e Hagës e vitit 2019 janë: (a) statusi dhe aftësia ligjore e personave fizikë; (b) detyrimet ushqimore; (c) çështje të tjera të së drejtës familjare, duke përfshirë regjimet e pasurisë martesore dhe të drejtat apo detyrimet e tjera që lindin nga martesat apo nga marrëdhënie të ngjashme; (d) testamentet dhe trashëgimia; (e) faliment, përbërja, zgjidhja e institucioneve financiare dhe çështjet analoge; (f) transporti i mallrave dhe udhëtarëve; (g) ndotja detare, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare, parimi i barazisë së dëmeve dhe rimorkimi dhe shpëtimi në raste emergjencash (h) përgjegjësia për dëmin bërthamor; (i) vlefshmëria, pavlefshmëria ose shpërbërja e personave juridikë ose shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre; (j) vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë; (k) shpifja; (l) privatësia; (m) pronësia intelektuale; (n) veprimtaritë e forcave të armatosura, duke përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare; (o) veprimtaritë ligjzbatuese, duke përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare; (p) çështjet anti-trust (të konkurrencës); (q) ristrukturimi i borxhit sovran përmes masave të njëanshme të shtetit.

641 Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 32.

642 Hartley dhe Dogauchi, paragrafi 49.

643 Wilderspin, M., Vysoka, L., “The 2019 Hague Judgments Convention through European lenses”, *Nederlands Internationaal Privaatrecht (NIPR)* 2020, f. 37.

644 Nielsen, f.211.

të marrëdhënieve të mbuluara në LDNP 2020,⁶⁴⁵ por përmban një përkufizim të përgjithshëm që LDNP 2020 e zbaton për “... marrëdhëniet juridike private që përmbajnë një element ndërkombëtar...”⁶⁴⁶ Po ashtu, neni 174 i LDNP 2020 parasheh që procedura e parashikuar në nenet 165-171 për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore zbatohet edhe për procedurën e njohjes së vendimeve të huaja të arbitrazhit.⁶⁴⁷

6.2 Llojet e vendimeve gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme)

LDNP 2020 drejtpërdrejtë i referohet shpjegimit të llojeve të vendimeve që njihen dhe ekzekutohen në Maqedoninë e Veriut. Neni 157 i LDNP 2020 lidhur me llojet e vendimeve që mund të njihen dhe ekzekutohen në Maqedoninë e Veriut i jep një kuptim më të gjerë termit “vendime të huaja”. Nuk kufizohet vetëm me vendimet e gjykatës⁶⁴⁸ por e zgjeron këtë aspekt me marrëveshje gjyqësore⁶⁴⁹ dhe vendime të tjera të nxjerra nga një autoritet relevant në shtetin e origjinës, që kanë të njëjtin efekt si vendimet gjyqësore, me kusht që t’i referohen *rationae materiae* së LDNP 2020 të dhënë në nenin 1 të të njëjtë ligj.⁶⁵⁰ Qëllimi i nenit 157 të LDNP 2020 është të mbulojë një fushë më të gjerë të vendimeve të huaja që do të ishin të kualifikueshme për njohje në Maqedoninë e Veriut. Neni 157 i LDNP 2020, duke i dhënë një kuptim më të gjerë termit “vendime të huaja” e kufizon Maqedoninë e Veriut nga skualifikimi i vendimeve të huaja sepse ato bartin një emër tjetër ose sepse shteti i origjinës ka procedurë tjetër për nxjerrjen e këtyre vendimeve. Prandaj, neni 157 i LDNP 2020 përqendrohet në përmbajtjen e vendimit e jo në autoritetet që e kanë nxjerrë atë apo në emrin e vendimit. Në këtë mënyrë, LDNP 2020 respekton sovranitetin e shteteve të huaja dhe karakterin kombëtar të sistemeve të tyre ligjore. Rrjedhimisht, të gjitha llojet e vendimeve (deklarative, konstituive dhe ndëshkuese), pavarësisht titullit të tyre, mund të njihen dhe të kenë efekt ligjor në Maqedoninë e Veriut, por vetëm vendimet ndëshkuese mund të ekzekutohen, për shkak të natyrës së tyre.

6.3 Fillimi i procedurës (si çështje kryesore ose paraprake) – juridiksioni i gjykatave të Maqedonisë së Veriut lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Juridiksioni i gjykatave të Maqedonisë së Veriut lidhur me njohjen e vendimeve të huaja varet nga fakti nëse njohja kërkohet si çështje kryesore apo si çështje paraprake.

Në Maqedoninë e Veriut, kompetenca për të vendosur për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore në procedura të pavarura i jepet gjykatave themelore me juridiksion të zgjeruar (**Основни судови со проширена надлежност**).⁶⁵¹ Juridiksioni territorial mbi njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor i takon çdo gjykate që ka juridiksion procedural.⁶⁵² Megjithatë, një pozitë e tillë nuk e përjashton mundësinë që njohja e vendimit të huaj gjyqësor të ngrihet si çështje paraprake nga gjykata ekzekutuese. Nëse nuk është marrë vendim i veçantë për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor, çdo gjykatë mund të vendosë për të si çështje paraprake, megjithatë, me efekt që i referohet vetëm kësaj procedure.⁶⁵³

645 I tillë ishte rasti me LDNP 2007, i cili në nenin 1 parashihte “...(statusin) personal, familjen, punën, pronën dhe marrëdhënie të tjera civile që kanë një element ndërkombëtar”. Zgjidhja identike gjendej në nenin 1 të LDNP 1982

646 Neni 1 i LDNP 2020

647 Ndërsa njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit bëhet sipas dispozitave të Konventës së nënshkruar në Nju-Jork më 10 qershor 1958 „Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”. Neni 37 i ligjit „Për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar” i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.39/2006.

648 Neni 157, paragrafi 1 i LDNP 2020.

649 Neni 157, paragrafi 2 i LDNP 2020.

650 Neni 157, paragrafi 3 i LDNP 2020.

651 Neni 31, ligji „Për gjykatat”

652 Neni 166, paragrafi 2 i LDNP 2020.

653 Neni 167 i LDNP 2020.

6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat formale) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Kushtet pozitive që përcaktojnë kërkesat formale për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore janë dhënë në nenin 159 të LDNP 2020. Njohja dhe ekzekutimi pranohet vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara. Dëshmitë e këtyre kërkesave duhet të shoqërojnë kërkesën për njohje dhe në atë fazë të procedurës së njohjes ato duhet të jenë të plotësuara që të mund të njihet dhe/ose ekzekutohet vendimi i huaj. Nëse gjykata nuk arrin ta njohë (pozitivisht) ekzistencën e këtyre kërkesave, do ta refuzojë njohjen.

Neni 159 i LDNP 2020 përcakton që personi kërkues për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor duhet t'i bashkëngjisë kërkesës së tij dokumentet e mëposhtme:

- vendimin e huaj gjyqësor ose një kopje të noterizuar të tij, dhe
- vërtetimin e një gjykate të huaj kompetente apo të një autoriteti tjetër për formën e prerë të vendimit sipas ligjit të shtetit në të cilin është marrë vendimi.

Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm: për shkak të diversitetit të gjuhëve që ekziston në botë, pala që kërkon njohje duhet të paraqesë një përkthim të vërtetuar të vendimit të huaj gjyqësor në gjuhën zyrtare të përdorur nga gjykata.⁶⁵⁴

Sa i përket ekzekutimit të vendimeve të huaja, neni 159, paragrafi 2 fillon me kërkesat e njëjta formale për ekzekutimin e vendimeve të huaja si ato të përcaktuara në nenin 159, paragrafi 1. Megjithatë, për shkak të natyrës së vendimeve gjyqësore të ekzekutueshme, LDNP 2020 kërkon kërkesa formale shtesë, ku kërkuesi për ekzekutimin e një vendimi të huaj gjyqësor duhet të paraqesë edhe certifikatën e ekzekutueshmërisë sipas ligjit të shtetit të origjinës. Ky akt do të shërbejë si dëshmi që vendimi i huaj është i ekzekutueshëm sipas ligjit të shtetit të origjinës.

6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Dispozitat e LDNP 2020 lidhur me kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore kanë kaluar nëpër modifikime strukturore dhe përmbajtësore në krahasim me dispozitat në LDNP 2007. Së pari, kapitulli II i pjesës IV është i ndarë në dy seksione: Seksioni 1 që parasheh kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore që konsiderohen “ex officio” nga gjykata; dhe Seksioni 2 që parasheh kushtet që konsiderohen pas kundërshtimit nga palët. Së dyti, sipas tendencave të LDNP 2020, janë ndryshuar dhe reduktuar kushtet.

6.5.1 Kushtet e përcaktuara ex officio

Një prej risive më të mëdha sa i përket njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në Maqedoninë e Veriut është që gjykata e njohjes inspekton shumicën e kushteve “ex officio” dhe kështu parasheh njohje të lehtë bazuar në rrethana objektive. Shumica e kushteve për njohje në LDNP 2020 kanë qenë të pranishme në pararendësin e tij LDNP 2007.

6.5.1.1 Certifikata e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë

Certifikata e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë e parashikuar në nenin 159 të LDNP 2020 është kombinim i neneve 101 dhe 102 të LDNP 2007. Formulimi i këtyre dispozitave ka mbetur i pandryshuar. Për më shumë informata rreth këtij kushti shihni pjesën 6.4.

6.5.1.2 Juridiksioni ekskluziv

Sa i përket juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Maqedonisë së Veriut, dispozita nga homologu i tij në LDNP 2007⁶⁵⁵ është thjeshtësuar, duke parashikuar që vendimet e huaja gjyqësore nuk do të njiheshin në Maqedoninë e Veriut nëse juridiksioni ekskluziv mbi çështjen i takon gjykatës apo një autoriteti tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç nëse dispozitat e LDNP 2020 u lejojnë palëve të pajtohen ndryshe.⁶⁵⁶ Situatat për juridiksion ekskluziv janë parashikuar në LDNP 2020 dhe janë përcaktuar në pjesën 5.4 të këtij raporti.

6.5.1.3 Juridiksioni i tepruar i gjykatës së huaj

Një prej risive lidhur me kushtet për njohje dhe ekzekutim është që, për të parandaluar juridiksionin e tepruar, ligjvënësi ka zgjedhur të përfshijë “parimin e pasqyrës” që nënkupton se një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëse juridiksioni do të ishte përcaktuar sipas rrethanave që nuk janë parashikuar për përcaktimin e juridiksioneve për çështje plotësuese ndërkufitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁶⁵⁷

6.5.1.4 Vendimi i formës së prerë për të njëjtën çështje mes palëve të njëjta

Dispozitat në LDNP 2020 mbi procedurat paralele e zgjidhin këtë problem me rregullat e *lis pendens*⁶⁵⁸ dhe dispozitat e parashikuara në nenin 162 që përcaktojnë se vendimet e huaja gjyqësore nuk njihen nëse gjykata apo një autoritet tjetër në Maqedoninë e Veriut e ka marrë një vendim të formës së prerë për të njëjtën çështje apo nëse është njohur një vendim tjetër i huaj gjyqësor për të njëjtën çështje dhe mes palëve të njëjta në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁶⁵⁹ Kjo dispozitë paraqiti një ndryshim të vogël, por shumë të rëndësishëm lidhur me identitetin e palëve pasi që neni 106 i LDNP 2007 parashihte që vetëm lënda e të dy vendimeve duhet të përputhet për vendimin e huaj gjyqësor që është njohur paraprakisht, ndërsa dispozita në nenin 164 të LDNP 2020 kërkon që të dy vendimet gjyqësore të jenë “...për të njëjtën çështje dhe mes palëve të njëjta...”. Paragrafi 2 i nenit 164 të LDNP 2020 mbetet i njëjtë si neni 106, paragrafi 2 i LDNP 2007.

6.5.1.5 Rendi publik

Një risi tjetër e rëndësishme në LDNP 2020 që është në përputhje me tendencat e reja në të drejtën ndërkombëtare private⁶⁶⁰ është pragu më i lartë që kërkohet për të zbatuar përjashtimin e “rendit publik”. Neni 107 i LDNP 2007 parashihte që një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në bazë të rendit publik. Në mënyrë që kjo klauzolë të bëhet efektive, dispozita e “rendit publik” vetëm parashihte që nëse efektet e njohjes së tij do të ishin në kundërshtim me rendin publik të Maqedonisë së Veriut atëherë ky përjashtim do të mund të zbatohet. Neni 163 i LDNP 2020 e ngre pragin më lartë deri në standardin që specifikon “dukshëm në kundërshtim me rendin publik”. Ky formulim nuk është vetëm semantikisht i rëndësishëm, por ofron edhe një qasje shumë më kufizuese për përdorimin e përjashtimit të “rendit publik”.⁶⁶¹

655 Neni 104 i LDNP 2007

656 Neni 160 i LDNP 2020

657 Neni 161 i LDNP 2020

658 Neni 119 i LDNP 2020

659 Neni 162 i LDNP 2020

660 Kramberger Škerl J., European Public Policy (With an Emphasis on Exequatur Proceedings), Journal of Private International Law vol. 7, 2011, f. 466-477; Kramberger Škerl J., Evropeizacija javnega reda v mednarodnem zasebnem pravu, Pravni letopis, Inštitut za primerjalno pravo pri Pravni fakulteti v Ljubljani, Ljubljani (2009), f. 349-370; Hess B.; Pfeifer T., Study on the Interpretation of the Public Policy Exception as referred to in EU Instruments of Private International and Procedural Law, prepared for the European Parliament's Committee on Legal Affairs [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=IPOL-JURI_ET%282011%29453189], aksesuar më 28 prill 2021, f. 1-181; Siehr K., General problems of private international law in modern codifications—de lege lata and—de lege europea ferenda, Yearbook of Private International Law, 2005, f. 54

661 Hess dhe Pfeifer, Study on the Interpretation of the Public Policy Exception, f. 13.

654 Neni 159, paragrafi 3 i LDNP 2020.

6.5.2 Kushtet e përcaktuara pas kundërshtimit të palëve

Mundësia për ta refuzuar njohjen e një vendimi të huaj pas kundërshtimit të palëve është kufizuar deri në minimum në LDNP 2020, vetëm në rastet kundër shkeljeve të rënda nga autoritetet gjyqësore të shtetit të origjinës.⁶⁶² Në LDNP 2020, neni 164 parasheh tre skenarë kur gjykatat duhet ta refuzojnë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore pas kundërshtimit të palëve lidhur me shkeljen e së drejtës për mbrojtje:

- për shkak të parregullsive në procedura, palës (në procesin kryesor) nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në të; ose⁶⁶³
- thirrja, dokumenti ose aktvendimi për fillimin e procedurës nuk i janë dërguar atij personalisht, ose nëse një shërbim i tillë personal as që është tentuar, përveç kur ajo palë është shprehur për themelin e padisë së paditësit në procedurën e shkallës së parë: ose⁶⁶⁴
- palës nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen nga momenti i shërbimit të dokumentit për fillimin e procedurës deri në momentin kur është caktuar seanca.⁶⁶⁵

6.5.3 Bazuar në nenin 7, paragrafi 1 dhe 2 të Konventës së Hagës të vitit 2019, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kushteve për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare (kushtet kombëtare për njohje dhe ekzekutim janë më të favorshme ose më kufizuese në krahasim me kushtet e parashikuara në nenin 7 të Konventës së Hagës të vitit 2019)

Pragu i dytë i Konventës së Hagës të vitit 2019 është që njohja dhe ekzekutimi mund të refuzohen nëse vendimi i huaj nuk i plotëson kushtet e përshkruara në nenin 7, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i Konventës së Hagës të vitit 2019. Këto gjashtë kushte mund të çojnë në refuzim të njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi në një shtet të kërkuar. Qëllimi i përpiluesve ishte të krijonin një standard minimal për refuzim, megjithatë, shtetet mund të shkojnë përtej këtyre kushteve.⁶⁶⁶ Shumica e këtyre kushteve nuk janë risi dhe mund të gjenden në sistemet kombëtare ligjore.

Kushti i parë i referohet cenimit të së drejtës për mbrojtje në shtetin e origjinës.⁶⁶⁷ Ky kusht i referohet në mënyrë të veçantë mungesës së njoftimit të duhur të të paditurit, që përbën bazë për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit.⁶⁶⁸ Formulimi i këtyre dy rregullave në Konventën e Hagës të vitit 2019 dhe në LDNP 2020 është i ndryshëm, megjithatë mund të shihen disa çështje të ngjashme. Së pari, të dyja këto rregulla i referohen çështjes së shërbimit të dokumenteve. Rregulli i Maqedonisë së Veriut fillon nga një pozitë më e përgjithshme në më të hollësishme, nga parregullsitë ekzistuese në procedura që si pasojë e kanë parandaluar palën nga pjesëmarrja, drejt aspektit më të hollësishëm të shërbimit të dokumenteve. Konventa e Hagës e vitit 2019 i referohet vetëm çështjes së shërbimit të dokumenteve. Megjithatë, ky rregull duhet të lexohet në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, germa "c" i cili i referohet mbrojtjes së rendit publik, por duke iu referuar konkretisht "...parimeve themelore të drejtësisë procedurale..." që, në nivel të përgjithshëm, mbulon çështje si e drejta e palës për t'u dëgjuar, mundësitë e barabarta, etj.⁶⁶⁹ Së dyti, standardi mbi të cilin bazohet shërbimi i dokumenteve në LDNP-në e Maqedonisë së Veriut dhe në LDNP 2020 nuk është i specifikuar. Në Konventën e Hagës së vitit 2019 nuk ka

asnjë referencë specifike për standardin në skenarin e parë. Çështja nëse dokumenti që fillon procedurat i është shërbyer siç duhet të paditurit, duhet të përcaktohet në frymën e dispozitave të Konventës së Hagës së vitit 2019 dhe për shërbimin e duhur mund të ofrohen disa modalitete, të tilla si shërbimi ndaj punëtorit ose të paditurit, ose njoftimi publik.⁶⁷⁰ Megjithatë, e drejta për t'u dëgjuar nuk cenohet nëse gjykata e kërkuar beson se të gjitha hetimet e nevojshme sipas parimit të kujdesit dhe mirëbesimit janë kryer për ta gjurmuar të paditurin pa sukses.⁶⁷¹ Në skenarin e dytë, që synon të mbrojë shtetin e kërkuar, çështja është nëse i padituri është njoftuar në një mënyrë që është në përputhje me parimet themelore të shtetit të kërkuar sa i përket shërbimit të dokumenteve.⁶⁷² Së treti, në të dyja rregullat, sjellja e të paditurit në shtetin e origjinës e dikton rezultatin e tij; përkatësisht, nëse i padituri ka ardhur në një paraqitje dhe e ka paraqitur çështjen e tij në gjykatën e origjinës pa e kontestuar njoftimin, në shtetin e kërkuar nuk do të përdoret mbrojtja e bazuar në njoftimin e papërshtatshëm.⁶⁷³

Kushti i dytë në Konventën e Hagës së vitit 2019 i referohet mashtimit si bazë për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit.⁶⁷⁴ Ky kusht mund të shihet së bashku me kushtin e tretë të Konventës së Hagës të vitit 2019 që i referohet mbrojtjes së rendit publik.⁶⁷⁵ Dispozita e rendit publik në LDNP 2020 përputhet me dispozitat plotësuese në nenin 7, paragrafi 1 germa "b" dhe "c" të Konventës së Hagës të vitit 2019. Rendi publik ka një kuptim shumë të gjerë dhe interpretimi i tij dallon sipas sistemeve kombëtare ligjore. Fushëveprimi dhe përmbajtja e tij varen nga mënyra në të cilën një shtet individual i vlerëson interesat e tij. Kjo nënkupton që rendi publik ose *ordre public* në të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të kuptohet si shuma e vlerave në të cilat varet rendi ligjor, social dhe kulturor i një shteti të caktuar dhe i cili duhet të respektohet brenda marrëdhënieve të ashtuquajtura me një element ndërkombëtar.⁶⁷⁶ Megjithatë, në kontekstin e Konventës së Hagës të vitit 2019, fushëveprimi i tij duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e tjera në tekst.⁶⁷⁷

Kushti i katërt i referohet vendimit gjyqësor të marrë nga një gjykatë me juridiksion të supozuar edhe pse ka pasur një marrëveshje për zgjedhjen e gjykatës që ka caktuar një gjykatë tjetër nga gjykata e origjinës.⁶⁷⁸ Ky kusht priret të mbështesë *prorogation iurisdictionis* dhe të respektojë autonominë e palëve. Neni 7, paragrafi 1, germa "d" e Konventës së Hagës të vitit 2019 duhet të shihet së bashku me bazat e juridiksionit indirekt të dhëna në nenin 5 dhe paraqet një mbrojtje të fundit kundër një vendimi që është marrë nga një gjykatë e cila e ka vendosur juridiksionin mbi baza të tjera, ndërkohë që ka ekzistuar një marrëveshje për zgjedhjen e gjykatës në atë çështje.⁶⁷⁹ LDNP 2020 nuk ka parashikuar një rregull specifik lidhur me shkeljen e marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatës si kusht për njohje dhe ekzekutim. Në vend të kësaj, LDNP 2020 ka marrë një qasje indirekte duke parashikuar që marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës kanë karakter të juridiksionit ekskluziv (nëse palët nuk kanë vendosur ndryshe)⁶⁸⁰ dhe që vendimet e huaja gjyqësore nuk do të njihen nëse gjykata e njohjes ka juridiksion ekskluziv.⁶⁸¹ Efekti i kësaj qasjeje është që vendimet e huaja gjyqësore nuk njihen nëse shkelin marrëveshjen e lejuar dhe drejtëplotë të palëve për zgjedhjen e gjykatës.

Kushti i pestë dhe i gjashtë i referohen dy situatave të ngjashme që zgjidhin problemin e procedurave paralele.⁶⁸² Së pari, kur vendimi konkurrent është dhënë nga një gjykatë në shtetin e kërkuar, së dyti kur vendimi konkurrent është dhënë në një shtet tjetër (të ndryshëm nga gjykata

⁶⁷⁰ Garcimartín and Saumier, paragrafi 251.

⁶⁷¹ Po aty.

⁶⁷² Neni 7, paragrafi 1, germa „a“, nënparagrafi (ii) i Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁷³ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 250.

⁶⁷⁴ Neni 7, paragrafi 1, germa „b“ e Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁷⁵ Neni 7, paragrafi 1, germa „c“ e Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁷⁶ Kramberger Škerl, f.349.

⁶⁷⁷ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 262.

⁶⁷⁸ Neni 7, paragrafi 1, germa „d“ e Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁷⁹ Garcimartín dhe Saumier, paragrafët 267-268.

⁶⁸⁰ Shihni nenin 122, paragrafi 2 i LDNP 2020.

⁶⁸¹ Shihni nenin 160 të LDNP 2020.

⁶⁸² Neni 7, paragrafi 1, germa „e“ dhe „f“ e Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁶² Neni 164 i LDNP 2020.

⁶⁶³ Neni 164, paragrafi 1 i LDNP 2020.

⁶⁶⁴ Neni 164, paragrafi 2 i LDNP 2020.

⁶⁶⁵ Neni 164, paragrafi 3 i LDNP 2020.

⁶⁶⁶ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 326.

⁶⁶⁷ Neni 7, paragrafi 1, germa „a“ e Konventës së Hagës të vitit 2019.

⁶⁶⁸ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 24.

⁶⁶⁹ Garcimartín dhe Saumier, paragrafi 250.

e origjinës).⁶⁸³ Në rastin e parë, vendimi nga shteti i origjinës nuk është në përputhje me një vendim të dhënë në shtetin e kërkuar në një kontest mes palëve të njëjta.⁶⁸⁴ Rregulli i parashikuar në këtë nen është i njëjtë me atë në Konventën e Hagës të vitit 2005 "Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës"⁶⁸⁵ dhe ka dy kushte: mospërputhja mes vendimeve gjyqësore dhe kontesti mes palëve të njëjta. Ai nuk kërkon hierarki të përkohshme dhe të njëjtin shkak veprimi.⁶⁸⁶ Rasti i dytë aplikohet kur vendimi nuk është në përputhje me një vendim të mëhershëm të dhënë në një shtet tjetër mes palëve të njëjta për të njëjtën çështje, me kusht që vendimi i mëhershëm i përmbush kushtet e nevojshme për njohjen e tij në shtetin e kërkuar.⁶⁸⁷ Ky rregull është më specifik se i fundit dhe përmban më shumë kërkesa që duhet të zbatohen. Së pari, vendimi nga shteti i tretë duhet të jetë dhënë para vendimit gjyqësor nga shteti i origjinës, pavarësisht se cila gjykatë është kontaktuar e para.⁶⁸⁸ Së dyti, të dyja vendimet gjyqësore duhet të jenë për të njëjtën çështje. Së treti, vendimi i mëhershëm duhet të jetë i kualifikueshëm për njohje dhe ekzekutim në shtetin e kërkuar, pavarësisht nëse është kërkuar apo jo ajo njohje apo ekzekutim.⁶⁸⁹

Neni 162 i LDNP 2020 i referohet çështjes së vendimeve gjyqësore të papajtueshme. Këto rregulla krijohen për ta mbrojtur sistemin kombëtar ligjor nga vendimet e papajtueshme gjyqësore të marra në sisteme të tjera ligjore për të njëjtën çështje (mes palëve të njëjta). Siç ka qenë rasti me pengesat e tjera ligjore për njohje dhe ekzekutim në LDNP 2020, neni 162 merr edhe konotacion negativ, që do të thotë se një vendim i huaj gjyqësor nuk do të njihet nëse gjykata apo një autoritet tjetër në Maqedoninë e Veriut e ka marrë një vendim të formës së prerë për të njëjtën çështje ose nëse një vendi i huaj gjyqësor i marrë për të njëjtën çështje është njohur në Maqedoninë e Veriut.⁶⁹⁰ Gjykata do t'i pezullojë procedurat për njohjen e një vendimi të huaj në rastet kur një procedurë e ngritur më herët është në pritje para gjykatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të njëjtën çështje dhe midis palëve të njëjta, derisa vendimi në këto procedura të marrë formë të prerë.⁶⁹¹ Përcaktimi i ekzistencës së kësaj pengese ligjore është *ex officio*. Prandaj, ky nen iu referohet dy situatave të ndryshme procedurale. Paragrafi i parë përmend rastet kur gjykatat në Maqedoninë e Veriut tashmë e kanë marrë një vendim të formës së prerë lidhur me të njëjtën çështje ose një vendim i huaj gjyqësor është njohur tashmë në Maqedoninë e Veriut në momentin kur bëhet kërkesa për njohje. Paragrafi i dytë i të njëjtit nen përmend rastet kur gjykatat e Maqedonisë së Veriut kanë marrë juridiksion dhe procedurat janë duke vazhduar në momentin kur bëhet kërkesa për njohje. Situata e dytë mbulohet edhe në Konventën e Hagës të vitit 2019 në nenin 7, paragrafi 2. Ky rregull i lejon gjykatës së shtetit të kërkuar ta shtyjë ose refuzojë njohjen dhe ekzekutimin nëse procedurat midis të njëjtave palë për të njëjtën çështje janë në pritje para gjykatës së shtetit të kërkuar dhe plotësohen dy kriteret shtesë: së pari gjykata e kërkuar është kontaktuar e para, dhe së dyti, ekziston një lidhje e ngushtë midis kontestit dhe shtetit të kërkuar.⁶⁹²

6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Thelbi i procedurës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në përgjithësi ka mbetur i njëjtë me procedurën në LDNP 2007. Risitë në procedurën për njohjen dhe ekzekutimin kanë të bëjnë me dy aspekte: së pari, kufizimet kohore janë zgjatur,⁶⁹³ dhe së dyti, seanca

ballafaquese (paraqitja e fakteve dhe argumenteve) në fazën e dytë të procedurës për njohje është e detyrueshme.⁶⁹⁴

Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në Maqedoninë e Veriut mund të ndahet në tri faza që janë të ngjashme me sistematizimin e parashikuar në Rregulloren I bis të Brukselit. Faza e parë është procedura *ex parte*, që realizohet pa pjesëmarrjen e personit kundër të cilit kërkohet njohja/ekzekutimi.⁶⁹⁵ Së pari, procedura për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor fillon me momentin e kërkesës.⁶⁹⁶ Në çështjet që kanë të bëjnë me statusin personal, njohja mund të kërkohet nga kushdo që ka interes ligjor.⁶⁹⁷ Kjo fazë e parë e njohjes gjykohet nga një gjyqtar i vetëm i një gjykate të komunës.⁶⁹⁸ Kjo gjykatë, pas vlerësimit të kërkesave formale dhe atyre që i përcakton *ex officio*,⁶⁹⁹ miraton një vendim për njohjen e vendimit të huaj nëse konstaton se nuk ka pengesa për njohjen.⁷⁰⁰

Siç u tha më herët, njëra prej karakteristikave të fazës së parë të procedurës është që ajo realizohet *ex parte*. Kjo shërben për të pasur elementin e befasisë, i cili është i nevojshëm në një procedurë të mëvonshme përmbaruese nëse i padituri nuk do të ketë mundësi t'i tërheqë asetet e tij nga çdo masë ekzekutimi.⁷⁰¹ Ky element i "befasisë" është më pak i rëndësishëm në çështje familjare, me disa përjashtime në rastet e rrëmbimit të fëmijëve.⁷⁰²

Pas kësaj faze, vendimi për njohjen i dërgohet nga gjykata palës së kundërt dhe/ose palëve të tjera në procedurat në të cilat është marrë vendimi gjyqësor i huaj me udhëzimin se mund të paraqitet ankesë brenda 30 ditëve⁷⁰³ nga shërbimi i vendimit mbi njohjen e vendimit të huaj gjyqësor.⁷⁰⁴ Ekziston një përjashtim nga kjo fazë e dytë e procedurës që është veçanërisht i rëndësishëm për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështje familjare. Në situatat që kanë të bëjnë me shkurorëzimin, gjykata nuk e shërben vendimin mbi njohjen e vendimit të huaj gjyqësor lidhur me shkurorëzimin për palën e kundërt nëse personi që ka aplikuar për njohje është shtetas i Maqedonisë së Veriut dhe pala e kundërt nuk ka as vendbanim dhe as vendqëndrim të zakonshëm në Maqedoninë e Veriut.⁷⁰⁵

Me apelin kundër këtij vendimi të fazës së parë merret e njëjta gjykatë e komunës (Gjykata që e ka miratuar vendimin mbi njohjen), por tashmë nga një panel prej tre gjyqtarësh.⁷⁰⁶ Në këtë fazë, gjykata mund të vendosë për vendimin e apelit pas një seance gjyqësore.⁷⁰⁷ Duhet theksuar që kjo seancë ballafaquese është e detyrueshme.⁷⁰⁸ Në seancën ballafaquese, gjykata vendos vetëm sipas parashtrësive të të dyja palëve. Me këtë, ofrohet parimi i "mundësive të barabarta" në LDNP 2020 dhe pala kundërshtuese mund ta apelojë vendimin mbi njohjen në një mënyrë që është e kufizuar vetëm nga kushtet e parashikuara në LDNP 2020.

Faza e tretë e kësaj procedure realizohet para Gjykatës së Apelit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kundër gjykatës që e ka refuzuar aplikimin për njohje dhe kundër vendimit të gjykatës lidhur me apelin, ankimi në Gjykatën e Apelit lejohet brenda 15 ditësh⁷⁰⁹ pas shërbimit të vendimit.⁷¹⁰ Sa i përket ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore, një vendim i huaj gjyqësor

⁶⁹⁴ Neni 169 i LDNP 2020.

⁶⁹⁵ Neni 168, i LDNP 2020.

⁶⁹⁶ Neni 165, paragrafi 1 i LDNP 2020.

⁶⁹⁷ Neni 165, paragrafi 3 i LDNP 2020.

⁶⁹⁸ Neni 166, paragrafi 1 i LDNP 2020

⁶⁹⁹ Neni 165, paragrafi 2 i LDNP 2020

⁷⁰⁰ Neni 168, paragrafi 1 i LDNP 2020.

⁷⁰¹ Raporti mbi konventën "Për juridiksionin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare" (Nënshkruar në Bruksel, 27 shtator 1968) nga z. P. Jenard, Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane Nr. C 59/1, f. 50.

⁷⁰² Magnus U., Mankowski P.(eds) *European Commentaries on Private International Law: Brussels IIbis Regulation*, Sellier, European Law Publishers, 2012, f. 302.

⁷⁰³ Në LDNP 2007, afati kohor ishte 15 ditë.

⁷⁰⁴ Neni 168, paragrafi 2 i LDNP 2020.

⁷⁰⁵ Neni 168, paragrafi 3 i LDNP 2020.

⁷⁰⁶ Neni 169 i LDNP 2020.

⁷⁰⁷ Neni 169 i LDNP 2020.

⁷⁰⁸ Në LDNP 2007, seanca ballafaquese nuk ka qenë e detyrueshme

⁷⁰⁹ Në LDNP 2007, ky afat kohor ishte 8 ditë.

⁷¹⁰ Neni 170 i LDNP 2020.

6.7 Kostot e procedurave

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

7.1 Lloji i procedurës përmbaruese

Kohëzgjatja e procedurës së përmbarimit nuk dallon nga zbatimi i vendimeve të brendshme dhe varet nga mjetet e ekzekutimit të parashikuara në rastin konkret dhe mirëqenia ekonomike e debitorit ndaj të cilit kryhet ekzekutimi.

7.2 Procedura përmbaruese në situatat kur përmbaruesit përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj

Në situata të tilla, përmbaruesi nuk ka juridiksion për të vendosur nëse janë plotësuar kushtet për njohje sipas legjislacionit kombëtar apo marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në mënyrë

711 Neni 173 i LDNP 2020.

712 Neni 12 i ligjit „Për përmbarim“.

713 Neni 173 i LDNP 2020.

714 Neni 8 i liqijt „Për përmbartim“.

8. Referenca

MONOGRAFI DHE ARTIKUJ

- Boele Woelki, K. "For better or for worse: The Europeanisation of International Divorce Law." *Yearbook of Private International Law*, vol. 12, 2010, f. 29.
- Bonomi, A. and Cristina M. Mariottini. "(Breaking) News from The Hague: A Game Changer in International Litigation? – Roadmap to the 2019 Hague Judgments Convention." *Yearbook of Private International Law* 20, 2018/2019.
- Kramberger Škerl, J. "European Public Policy (With an Emphasis on Exequatur Proceedings)." *Journal of Private International Law*, vol. 7, 2011.
- Kramberger Škerl, J. "Evropeizacija javnega reda v mednarodnem zasebnem pravu." *Pravni letopis*, Inštitut za primerjalno pravo pri Pravni fakulteti v Ljubljani, Ljubljani, 2009.
- Magnus, U. and P. Mankowski (eds). *European Commentaries on Private International Law: Brussels IIbis Regulation*. Sellier, European Law Publishers, 2012.
- Nielsen, P. A. "The Hague 2019 Judgments Convention – from failure to success." *Journal of Private International Law* 16, 2020.
- Rumenov, I. "Europeanisation of the Macedonian Private International Law – Legal Evolution of a National Private International Law Act." *EU and comparative law issues and challenges (ECILC)*, Vol.4. Osijek, 2020, f.319.
- Siehr, K. "General problems of private international law in modern codifications—de lege lata and—de lege europea ferenda." *Yearbook of Private International Law*. 2005.
- Weller, M. "The Jurisdictional Filters of the HCCH 2019 Judgments Convention." *Yearbook of Private International Law* XXI. 2019/2020.
- Wilderspin, M. and L. Vysoka. "The 2019 Hague Judgments Convention through European lenses," *Nederlands Internationaal Privaatrecht (NIPR)*. 2020, f. 37.
- Zoroska-Kamilovska, T. and M. Rakocevic. "A General Overview of Enforcement in Civil and Commercial Matters in Macedonia." *LeXonomica*. Vol. 8. Nr. 1. June 2016. f. 29-49.

LIGJET DHE AKTET KOMBËTARE

- Ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera për çështje të caktuara” (Закон за решавање на судирот на законите со прописите на другите држави во одредени односи), Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 43/1982;
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/91, 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 03/09, 49/11 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 06/19 me Aktin Kushtetues për zbatimin e Amendamenteve XXXIII – XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 06/19.
- Ligji „Për përmbarim“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 35/2005, me ndryshime në vitin 2006 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë , nr. 50/2006, 129/2006), 2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 8/2008), 2009 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 83/2009). 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 10/2010).

- së Maqedonisë , nr. 50/2010, 83/2010, 88/2010, 171/2010) dhe 2011 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë , nr. 148/2011).
- Ligji „Për përmbartim“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/2016, 142/2016, 233/2018 dhe 14/2020.
- Ligji „Për procedurën civile“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë , nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015.
- Ligji „Për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/1998.
- Ligji „Për gjykatat“, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 96/19.
- Ligji „Për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar“ i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 39/2006.
- Ligji „Për raportimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të përkohshëm“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/92, 12/93, 43/00, 66/07, 51/11, 152/15 dhe 55/16.
- Ligji „Për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 20/2015, 192/2015, 231/2015 dhe 163/2018.
- Ligji „Për procedurën jokontestimore“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 9/2008.
- Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private (Закон за меѓународно приватно право), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 32/2020.
- Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private (Закон за меѓународно приватно право), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 87/2007 dhe 156/2010.
- Statuti i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 56/2015.

RREGULLORET DHE PRAKTIKA LIGJORE E BE-SË

- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 4/2009, e datës 18 dhjetor 2008, „Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe bashkëpunimin në çështjet që lidhen me detyrimet ushqimore“, GZ L 7, 10.1.2009.
- Rregullorja e Këshillit (BE) 2016/1103, e datës 24 qershor 2016, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e juridiksionit, ligjit të zbatueshëm, dhe njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në çështjet e regjimeve të pasurive martesore, GZBE L183/1.
- Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1259/2010, e datës 20 dhjetor 2010, ku mundësohet bashkëpunim më i gjerë në fushën e ligjit të zbatueshëm për shkurorëzimet dhe ndarjen, GZBE L 343/10.
- Rregullorja (KE) nr. 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 qershor 2008, „Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore“ (Roma I), GZBE L177/6.
- Rregullorja (KE) nr. 864/2007 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 korrik 2007 „Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore“ (Roma II), GZBE L 199/40.
- Rregullorja (BE) nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012, „Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare“, GZBE L351/1.

- Rregullorja (BE) nr. 650/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 4 korrik 2012 „Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, dhe pranimin dhe zbatimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe për krijimin e një Certificate Evropiane të Trashëgimisë“, GZBE, L 201/107.
- Çështja e GJDBE SAR Schotte GmbH v Parfums Rothschild SARL (ECLI:EU:C:1987:536),

RAPORTE DHE STUDIME

- Hartley T., and M. Dogauchi. "Convention of 30 June 2005 Choice of Court Agreements Convention: Explanatory Report." [https://assets.hcch.net/docs/0de60e2f-e002-408e-98a7-5638e1ebac65.pdf]. Aksesuar më 28 prill 2021.
- Hess B. and T. Pfeifer. Study on the Interpretation of the Public Policy Exception as referred to in EU Instruments of Private International and Procedural Law, prepared for the European Parliament's Committee on Legal Affairs
- [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=IPOL-JURI_ET%282011%29453189]. Aksesuar më 28 prill 2021.
- Hess, B., S. Law and P. Ortolani (eds.). An evaluation study of national procedural laws and practices in terms of their impact on the free circulation of judgments and on the equivalence and effectiveness of the procedural protection of consumers under EU consumer law, JUST/2014/RCON/PR/CIVI/0082, 2017.
- Kramer X. et al. Study by the European Parliament's Committee on Legal Affairs "A European framework for private international law: current gaps and future perspectives", PE 462.487, 8/
- OSCE/ODIHR Election Observation Mission Final Report, EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS 11 December 2016, i disponueshëm online [https://www.osce.org/files/f/documents/8/b/302136.pdf]. Aksesuar më 28 prill 2021.
- Report on the Convention on jurisdiction and the enforcement of judgments in civil and commercial matters (Signed at Brussels, 27 September 1968) by Mr P. Jenard Official Journal of the European Communities No. C 59/1.
- Garcimartín Alférez, F. and G. Saumier. "Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters: Explanatory Report", as approved by the HCCH on 22 September 2020, [https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf] Aksesuar më 28 prill 2021.

Shtojca 1 – Fjalorth

LP – Ligji “Për përmbardim”

LDNP e BE-së - Ligji i BE-së i së Drejtës Ndërkombëtare Private

GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

HCCH - Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private

MN – Marrëveshjet Ndërkombëtare

ON – Organizatë Ndërkombëtare

MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

MD - Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

NBRSM – Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut

OJQ - Organizatë Joqeveritare

ODIHR - Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut pranë OSBE-së

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

LDNP – Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private

LDNP 1982 - Ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera për çështje të caktuara”

LDNP 2007 - Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i vitit 2007

LDNP 2020 - Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private i vitit 2020

MSA - Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Komunitetet Evropiane dhe shtetet e tyre anëtare

RSFJ - Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë

SL – Sekretariati për Legjislacion i Republikës së Maqedonisë së Veriut

USAID – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Shtojca 2 – Model për shembuj të praktikave të mira

Shembulli 1

• Fusha:	Ligji i së Drejtës Ndërkombëtare Private, Bashkëpunimi gjyqësor i BE-së në çështje civile
• Titulli (gjuha origjinale)	Утврдување на степенот на усогласеност на националното законодавство на Република Македонија со законодавството на Европската Унија за правосудната соработка во граѓанско правната материја
• Titulli (ANG)	Vlerësimi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar të Republikës së Maqedonisë me tërësinë e legjislacionit të BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile
• Organizata (gjuha origjinale) • Përgj. për zbatimin • Përgj. për financimin	Министерство за Правда на Република Северна Македонија
• Organizata (ANG) • Përgj. për zbatimin • Përgj. për financimin	Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
• Qeveria/Shoqëria civile • Përgj. për zbatimin • Përgj. për financimin	Qeveria
• Linku në internet	
• Lloji i nismës	Studim
• Grupi kryesor i synuar	Politikëbërësit

Përshkrim i shkurtër (maks. 1000 karaktere)	Raporti në dy gjuhë i përgatitur nga Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare Private i Fakultetit Juridik "Iustinianus Primus" – Shkup, paraqiti një vlerësim gjithëpërfshirës të legjislacionit kombëtar dhe pajtueshmërisë së tij me tërësinë e legjislacionit të BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile. Ky vlerësim rezultoi në një raport që mbuloi të gjitha Rregulloret dhe Direktivat e BE-së si dhe dokumentet e barabarta të tyre në të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe të Drejtën e Procedurës Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky raport ishte pjesë e një vlerësimi të legjislacionit kombëtar në procesin e aderimit të Maqedonisë së Veriut në BE.
Vlerësim apo kontroll cilësie	☐ jo ☐ po si?
Përfshirja e aktorëve	☐ jo ☐ po kush? dhe si?
Pse është praktikë e mirë?	- x mbi standardet ndërkombëtare/të BE-së x efektiviteti dhe ndikimi ☐ transferimi ☐ risia ☐ qëndrueshmëria

Shembulli 2

Fusha:	Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore
Titulli (Gjuha origjinale)	Балканска иницијатива за извршување
Titulli (ANG)	Nisma Ballkanike e Ekzekutimit
Organizata (gjuha origjinale) - Përgj. për zbatimin - Përgj. për financimin	Комора на извршители на Република Северна Македонија Албанската комора на извршители Комората на јавни извршители на Црна Гора Комора на јавни извршители на Република Србија
Organizata (ANG) - Përgj. për zbatimin - Përgj. për financimin	Oda e Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë në Shqipëri Dhoma e Oficerëve Gjyqësorë të Malit të Zi Dhoma e Oficerëve Gjyqësorë të Serbisë

Qeveria/Shoqëria civile - Përgj. për zbatimin - Përgj. për financimin	
Linku në internet	https://www.balkaninitiative.net/
Lloji i nismës	Trajnimi, përmirësimi i legjislacionit, ngritja e bashkëpunimit mes Dhomave të rajonit
Grupi kryesor i synuar	publiku i përgjithshëm, politikëbërësit
Përshkrim i shkurtër (maks. 1000 karaktere)	Nisma Ballkanike e Ekzekutimit është një strukturë e përbashkët që përfshin dhomat zyrtare kombëtare të oficerëve gjyqësorë të licencuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nisma është projektuar në mënyrë që të rrisë mbledhjen e balancave (detyrimeve) të prapambetura ndërmjet shteteve në Ballkanin Perëndimor, për të ndërtuar kanale komunikimi midis sferave publike dhe private të dedikuara për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe për të shprehur rekomandimet e qarta të profesionit për çështje që ndikojnë në ekzekutimin efikas dhe të drejtë.
Vlerësim apo kontroll cilësie	☐ jo ☐ po si?
Përfshirja e aktorëve	☐ jo - x po kush? dhe si? Oda e Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut është anëtare themeluese e kësaj nisme dhe merr pjesë aktivisht në zhvillimin e instrumenteve për përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndërmjet shteteve
Pse është praktikë e mirë?	☐ mbi standardet ndërkombëtare/të BE-së x efektiviteti dhe ndikimi x transferimi ☐ risia x qëndrueshmëria

RAPORT KOMBËTAR: REPUBLIKA E SERBISË

Autor

Slavko Đorđević

1. Kuadri ligjor i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

1.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në sistemin juridik të Serbisë rregullohet përmes ligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”⁷¹⁵ (në vijim referuar me shkurtimin LDNP e Serbisë), ligjit “Për procedurën jokontestimore”⁷¹⁶ (në vijim referuar me shkurtimin LPJK) dhe ligjit “Për ekzekutimin dhe barrën siguruese”⁷¹⁷ (në vijim referuar me shkurtimin LEBS). LDNP-ja e Serbisë është burimi kryesor ligjor, dispozitat e të cilit rregullojnë kualifikueshmërinë e vendimeve të huaja gjyqësore për njohje dhe ekzekutim (neni 86), bazat për mosnjohje dhe mosekzekutim (neni 87-96), si dhe procedurat e njohjes (neni 101). Duke qenë se për nga natyra, procedurat e njohjes janë jokontestimore, zbatohen edhe dispozitat e LPJK-së, d.m.th. ato plotësojnë dispozitat e LDNP-së së Serbisë për procedurat e njohjes. Ekzekutimi i vendimeve të huaja me karakter ndëshkimor rregullohet nga dispozitat e LEBS-së.

Për sa i përket burimeve ligjore ndërkombëtare, Serbia nuk është palë kontraktore në asnjë konventë shumëpalëshe që i dedikohet posaçërisht njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve. Megjithatë, Serbia ka ratifikuar disa konventa shumëpalëshe që trajtojnë çështje të tjera ligjore, por përmbajnë disa dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të tilla si Konventa e HCCH-së e vitit 1954 “Për procedurën civile”,⁷¹⁸ Konventa e HCCH-së e vitit 1980 “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”,⁷¹⁹ Konventa e Gjenevës e vitit 1956 “Për kontratën për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave (CMR)”⁷²⁰, Konventa e Vjenës e vitit 1963 “Për përgjegjësinë civile për dëmin bërthamor”⁷²¹, Konventa Evropiane, “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve lidhur me kujdestarinë e fëmijëve dhe për rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët”,⁷²² Konventa e Nju-Jorkut e vitit 1956 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor”.⁷²³ Po ashtu, Serbia është palë në shumë konventa dypalëshe, të cilat përmbajnë dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare (p.sh. ka nënshkruar traktate dypalëshe me Bullgarinë,⁷²⁴ Bosnjë-Hercegovinën,⁷²⁵ Malin e Zi,⁷²⁶ Maqedoninë e Veriut,⁷²⁷ Republikën Çeke,⁷²⁸ Sllovakinë,⁷²⁹

715 Ligji “Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera” (ligji i Serbisë “Për të drejtën ndërkombëtare private”, në vijim referuar me shkurtimin LDNP i Serbisë), Fletorja Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 43/82 dhe 72/82 – Ndryshimi në Fletoren Zyrtare të RFJ-së, Nr. 46/96 dhe Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 46/2006 – ligje të tjera.

716 Ligji “Për procedurën jokontestimore” – referuar me shkurtimin LPJK, Fletorja Zyrtare e RSS-së, Nr. 25/82 dhe 48/88 dhe Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 46/95 - ligje të tjera, 18/2005 - ligje të tjera, 85/2012, 45/2013 - ligje të tjera, 55/2014, 6/2015 dhe 106/2015 - ligje të tjera.

717 Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 106/2015, 106/2016, 113/2017 dhe 54/2019.

718 Fletorja Zyrtare e RPFJ-së – Supplement, Nr. 6/62.

719 Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 7/91.

720 Fletorja Zyrtare RPFJ-së – Supplement, Nr. 11/1958.

721 Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Supplement, Nr. 5/1977.

722 Fletorja Zyrtare e RFJ-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 1/2001.

723 Fletorja Zyrtare RPFJ-së – Supplement, Nr. 2/60.

724 Traktati midis Republikës Popullore të Bullgarisë dhe Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë “Për ndihmë të ndërsjellë juridike”, datë 23 mars 1956, Fletorja Zyrtare e RPFJ-së – Supplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 1/57.

725 Traktati midis Serbisë dhe Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”, Fletorja Zyrtare e Serbisë dhe Malit të Zi – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 6/2005-6 dhe Traktati midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Bosnjë-Hercegovinës “Për ndryshimet në Traktatin midis Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Bosnjë-Hercegovinës për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”, Fletorja Zyrtare e RS-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 13/2010-35.

726 Traktati midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”, Fletorja Zyrtare e RS-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 1/2010-57.

727 Traktati midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë “Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale”, Fletorja Zyrtare e RS-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 5/2012-1.

728 Traktati midis Republikës Socialiste të Çekosllovakisë dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë “Për marrëdhëniet juridike në çështjet civile, familjare dhe penale”, datë 20 janar 1964, Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Supplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 13/1964.

729 Traktati midis Republikës Socialiste të Çekosllovakisë dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë “Për marrëdhëniet juridike në çështjet civile, familjare dhe penale”, datë 20 janar 1964, Fletorja Zyrtare e RSFJ – Supplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 13/1964.

Hungarinë,⁷³⁰ Poloninë,⁷³¹ Rumaninë,⁷³² Rusinë,⁷³³ Qipron⁷³⁴). Serbia ka lidhur traktate dypalëshe me Francën⁷³⁵ dhe Greqinë,⁷³⁶ të cilat i dedikohen posaçërisht njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare.

1.2 Vlerësimi i kuadrit ligjor

Duhet të theksohet se sipas dispozitave të LDNP-së së Serbisë, gjykatat serbe kanë kompetencat ekskluzive për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore,⁷³⁷ të cilat duhet të jenë të formës së prerë⁷³⁸ dhe të ekzekutueshme⁷³⁹ sipas legjislacionit të shtetit të origjinës. Gjatë procedurave të njohjes, gjykata kushtëzohet në shqyrtimin e kërkesave dhe të bazave për mosnjohje dhe mosekzekutim, të parashikuara nga nenet 87-96 të LDNP-së së Serbisë, të cilat kanë karakter formal. Ato përfshijnë shkeljen e rendit publik, "res judicata", shkeljen e juridiksionit ekskluziv ndërkombëtar të gjykatave serbe, mungesën e reciprocitetit dhe shkeljen e të drejtës së të paditurit për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin.⁷⁴⁰ Për sa i përket reciprocitetit, mjafton që ekzistenca e tij të prezumohet dhe të jetë faktik derisa të vërtetohet e kundërta. Për më tepër, është shumë e rëndësishme të përmendet se nuk ekzistojnë dispozita për juridiksionin e tërthortë dhe se gjykata nuk ka kompetencën për të rishikuar vendimin e huaj gjyqësor për sa i përket fakteve të pakundërshtueshme dhe legjislacionit të zbatuar në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin⁷⁴¹.

Prandaj, regjimi serb për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve i përket regjimeve të ashtuquajtura me kontroll të kufizuar për vendimet e huaja gjyqësore dhe mund të konsiderohet si regjim liberal.⁷⁴² Sidoqoftë, duhet të mbahet parasysh se një ndër bazat për mosnjohje është mungesa e reciprocitetit, e cila duhet të rregullohet përmes lidhjes së traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe. Për më tepër, lidhja e këtyre traktateve është mënyra e vetme për të arritur reciprocitetin me shtetet e huaja që kërkojnë reciprocitet diplomatik, si për shembull Austria, Holanda dhe Suedia. Edhe pse Serbia është palë në shumë traktate dypalëshe që përmbajnë dispozita për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare, këto traktate nuk janë lidhur me shtetet e lartpërmendura dhe as me disa shtete të tjera, të cilat, për sa i përket marrëdhënieve ekonomike dhe politike, janë shumë të rëndësishme për Serbinë (si për shembull Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Duke qenë se lidhja e traktateve dypalëshe varet nga disa faktorë dhe në disa raste mund të arrihet me vështirësi (p.sh. me shtetet anëtare të BE-së), Konventa e HCCH-së e vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" luan një rol shumë të rëndësishëm për vendosjen e regjimit për njohjen

730 Traktati midis Republikës Popullore të Hungarisë dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë "Për marrëdhëniet e ndërsjella juridike", datë 7 mars 1968, Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 3/1968.

731 Traktati midis Republikës Popullore të Polonisë dhe Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë "Për marrëdhëniet e ndërsjella juridike në çështjet civile dhe penale", datë 6 shkurt 1960, Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 5/1963.

732 Traktati midis Republikës Popullore të Rumanisë dhe Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë "Për ndihmë juridike", datë 18 tetor 1960, Fletorja Zyrtare e RPFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 8/1961, me protokollin shtesë, Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Suplement, Nr. 4/1973.

733 Traktati midis Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe Republikave të Bashkimit Sovjetik "Për ndihmën juridike në çështjet civile, familjare dhe penale", datë 24 shkurt 1962, Fletorja Zyrtare e RPFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 5/63.

734 Traktati midis Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë dhe Republikës së Qipros "Për ndihmën juridike në çështjet civile dhe penale", Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Traktatet ndërkombëtare, Nr. 2/86.

735 Konventa midis Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë dhe qeverisë së Republikës së Francës "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore", datë 18 maj 1971, Fletorja Zyrtare e RSFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 7/1972.

736 Marrëveshja midis Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë dhe Mbretërisë së Greqisë "Për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore", datë 18 qershor 1959, Fletorja Zyrtare e RPFJ-së – Suplement: Traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera, Nr. 6/60.

737 Neni 86, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë.

738 Neni 87 i LDNP-së së Serbisë.

739 Neni 96 i LDNP-së së Serbisë.

740 Nenet 93–95 të LDNP-së së Serbisë përmbajnë dispozita të veçanta për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore lidhur me gjendjen civile të shtetasve serbë dhe shtetasve të huaj, të cilat duke qenë se nuk përfshihen në objektin e këtij studimi, nuk do të trajtohen.

741 Shihni M. Stanivuković, M. Živković, Serbia, në: Verschraegen, B. (ed.), International Encyclopedia of Laws, vol. 2, Private International Law, supp. 21, Kluwer Law International 2009, 238.

742 Për informacione rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore sipas rregullave të LDNP-së së Serbisë, shihni me detaje: M. Dika, G. Knežević, S. Stojanović, Komentar Zakona o međunarodnom privatnom i procesnom pravu, Beograd 1991, 275 etc.; T. Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, Međunarodno privatno pravo, Beograd 2012, 531 etc.; M. Stanivuković, M. Živković, Međunarodno privatno pravo, Beograd 2008, 433 etc.; T. Varadi, 'Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Entscheidungen in Jugoslawien', RabelsZ 51 (1987), 632 etc; M. Stanivuković, M. Živković, op. cit. (Kluwer), 237 etc.

dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndërmjet shteteve në çështjet civile dhe tregtare (e cila është një ndër arsyet përse Serbia duhet ta nënshkruajë dhe ratifikojë këtë konventë).

2. Kuadri institucional për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.1 Përmbledhje e dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë aktorët në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Në Serbi, aktorët kryesorë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve janë gjykatat, Ministria e Drejtësisë, juristët (juristët profesionistë) dhe agjentët zbatues.

Organizimi i sistemit gjyqësor në Serbi, duke përfshirë juridiksionin "ratione materiae" të gjykatave serbe, rregullohet nga ligji "Për organizimin e gjykatave"⁷⁴³ (në vijim referuar me shkurtimin LOGJ). Juridiksioni ndërkombëtar i gjykatave serbe rregullohet nga LDNP-ja e Serbisë (nenet 46-78), ndërsa juridiksioni vendor i gjykatave rregullohet nga ligji "Për procedurën kontestimore"⁷⁴⁴ (në vijim referuar me shkurtimin LPK). Është e rëndësishme të përmendet se dispozitat për juridiksionin vendor të LPK-së mund të përdoren edhe si dispozita për juridiksionin ndërkombëtar, por vetëm nëse nuk ekzistojnë dispozita për juridiksionin ndërkombëtar për lloje specifike mosmarrëveshjesh në LDNP-në e Serbisë, në një ligj tjetër ekzistues apo traktat ndërkombëtar (neni 26, paragrafi 2 i LPK-së).

Organizimi, veprimtaria dhe kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë rregullohen kryesisht nga ligji "Për ministrinë"⁷⁴⁵ dhe nga rregullorja⁷⁴⁶ "Për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë". Megjithatë, roli i Ministrisë së Drejtësisë lidhur me çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore rregullohet nga LDNP-ja e Serbisë.⁷⁴⁷ Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë është caktuar ose vepron si autoriteti qendror për zbatimin e shumë konventave shumëpalëshe ose dypalëshe, të cilat mbulojnë gjithashtu çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore.⁷⁴⁸

Veprimtaria dhe kompetencat e agjentëve zbatues në procedurat përmbartimore rregullohen nga LEBS.

Ndërsa organizimi dhe veprimtaria e juristëve profesionistë, d.m.th. e avokatëve, rregullohet kryesisht nga ligji "Për avokatinë"⁷⁴⁹ por edhe nga LPK dhe LPJK. Kompetencat e përfaqësuesve ligjorë përcaktohen nga ligji i zbatueshëm për marrëdhënien juridike ndërmjet tyre dhe palës së përfaqësuar.⁷⁵⁰ Nëse kjo e fundit është një person juridik, përfaqësuesi ligjor është drejtuesi i personit juridik dhe kompetencat e tij/saj përcaktohen nga ligji i zbatueshëm për statusin e personit juridik⁷⁵¹.

743 Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 116/2008, 104/2009, 101/2010, 31/2011 - ligje të tjera, 78/2011 - ligje të tjera, 101/2011, 101/2013, 106/2015, 40/2015 - ligje të tjera, 13/2016, 108/2016, 113/2017, 65/2018 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 87/2018 dhe 88/2018 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

744 Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 72/2011, 49/2013 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese 74/2013 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 55/2014, 87/2018 dhe 18/2020.

745 Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 128/2020.

746 Shihni: <https://mpravde.gov.rs/files/Pravilnik%20MP%20mart%202019.pdf>

747 Neni 92 i LDNP-së së Serbisë.

748 Shihni informacionet në: <https://www.mpravde.gov.rs/sekcija/5/medjunarodna-saradnja.php>

749 Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 31/2011 dhe 24/2012 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

750 Dika, G. Knežević, S. Stojanović, op. cit., 253.

751 Shihni nenin 17 të LDNP-së së Serbisë.

2.2 Aktorët përgjegjës për vënien në praktikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

2.2.1 Gjykatat

Duke qenë se një vendim i huaj gjyqësor mund të zbatohet në territorin e Republikës së Serbisë nëse një gjykatë serbe e ka njohur më parë atë, është i padiskutueshëm fakti se gjykatat janë aktorët kryesorë në procesin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve. Sipas nenit 11 të LOGJ-së, autoriteti gjyqësor i përket gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave me juridiksion të posaçëm. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm përfshijnë gjykatat themelore, gjykatat e larta, gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë të Kasacionit, ndërsa gjykatat me juridiksion të posaçëm përfshijnë gjykatat për çështjet me karakter tregtar, Gjykatën e Apelit për Çështjet me Karakter Tregtar, gjykatat për kundërvajtjet, Gjykatën e Apelit për Kundërvajtjet dhe Gjykatën Administrative. Gjykatat e larta, si gjykata me juridiksion të përgjithshëm, kanë kompetencat për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile,⁷⁵² ndërsa gjykatat për çështjet me karakter tregtar kanë tagrin për të vendosur për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet tregtare.⁷⁵³ Ankimimet ndaj vendimeve për njohjen do të depozitohen pranë gjykatave të apelit ose pranë Gjykatës së Apelit për Çështjet me Karakter Tregtar.⁷⁵⁴

Në rastet kur një vendim i huaj gjyqësor është njohur ligjërisht nga gjykata Serbe, dhe pala debitoare vazhdon të shmangë përmbushjen e detyrimit të tij/saj të përcaktuar përmes këtij vendimi, ky i fundit do të hyjë në fuqi sipas rregullave të LEBS-së, me kërkesë të palës kreditore. Gjykata themelore ose gjykata e çështjeve me karakter tregtar ka tagrin për të kryer procedurat përmbarimore,⁷⁵⁵ me përjashtim të rasteve që kanë të bëjnë me rikuperimin e borxheve që lindin nga veprimtaritë komunale, ku procedurat përmbarimore kryhen nga agjentët zbatues.⁷⁵⁶ Sapo të shpallet vendimi i ekzekutimit, ekzekutimi ndaj pasurive të debitorit do të kryhet nga agjentët zbatues, me përjashtim të rasteve kur parashikohet në mënyrë specifike se ekzekutimi duhet të kryhet nga gjykata.⁷⁵⁷

2.2.2 Institucionet administrative (Ministria e Drejtësisë, Autoritetet Qendrore etj.)

Roli i Ministrisë së Drejtësisë në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve pasqyrohet në sqarimin e vënë në dispozicion për ekzistencën e reciprocitetit. Pra, reciprociteti lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore prezumohet derisa të vërtetohet e kundërta. Megjithatë, nëse ekzistenca e reciprocitetit lë vend për dyshime, gjykata që kryen procedurat e njohjes i kërkon Ministrisë së Drejtësisë që të qartësojë nëse ekziston reciprociteti në fjalë.⁷⁵⁸

Ministria e Drejtësisë shërben gjithashtu si një autoritet për zbatimin e shumë konventave dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke iu ofruar palëve dhe gjykatës ndihmë lidhur me nisjen e procedurave të njohjes në Serbi (p.sh. ndihmë lidhur me dorëzimin e dokumenteve të nevojshme për nisjen e procedurave të njohjes)⁷⁵⁹.

⁷⁵² Neni 23 i LOGJ-së.

⁷⁵³ Neni 25 i LOGJ-së.

⁷⁵⁴ Nenet 24 dhe 26 të LOGJ-së.

⁷⁵⁵ Neni 6, paragrafi 1 i LEBS-së.

⁷⁵⁶ Neni 3, paragrafi 3 i LEBS-së.

⁷⁵⁷ Neni 4 i LEBS-së.

⁷⁵⁸ Neni 92 i LDNP-së së Serbisë.

⁷⁵⁹ Shihni: <https://www.mpravde.gov.rs/sekcija/5/medjunarodna-saradnja.php>

2.2.3 Juristët (Avokatët, përfaqësuesit ligjorë, etj.)

Në pjesën më të madhe të çështjeve që kanë të bëjnë me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore, palët përfaqësohen nga juristë (pra, avokatë). Megjithatë, pjesëmarrja e tyre nuk është e detyrueshme, që do të thotë se palët mund të marrin pjesë në proces pa një avokat.⁷⁶⁰


Nëse një nga palët nuk është në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur gjatë procesit (p.sh. pala është një person i mitur), ai/ajo duhet të përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor, ose në disa raste, nga një përfaqësues i përkohshëm i përcaktuar nga gjykata,⁷⁶¹ e cila mund të kontraktojë një jurist profesionist.

Personat juridikë përfaqësohen nga përfaqësuesi i tyre ligjor/statutor (p.sh. drejtuesit), të cilët mund të kontraktjnë gjithashtu një jurist profesionist.

2.2.4 Agjentët zbatues

Gjykata kryen procedurat përmbarimore për sa i përket vendimit të huaj gjyqësor me karakter ndëshkimor dhe sapo shpall vendimin për ekzekutimin, agjentët zbatues kryejnë ekzekutimin ndaj pasurive të debitorit. Prandaj, agjentët zbatues nuk kryejnë procedura përmbarimore (faza e parë e procedurave), por kryejnë procesin e ekzekutimit duke përdorur mjete të tjera (faza e dytë e procedurave) në përputhje me vendimin për ekzekutim të shpallur nga gjykata për procedurat përmbarimore.⁷⁶² Rasti i vetëm përjashtimor kur agjentët zbatues kanë tagrin për t'i kryer të dyja proceset janë rastet e rikuperimit të borxheve që lindin nga veprimtaritë komunale.⁷⁶³ Megjithatë, këto raste zakonisht janë me karakter të brendshëm dhe rrallëherë janë objekt i vendimeve të huaja gjyqësore.

2.3 Hartëzimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve



⁷⁶⁰ Neni 85 i LPK-së.

⁷⁶¹ Nenet 76-84 të LPK-së, nenet 4-6 të LPJK-së.

⁷⁶² Shihni nenet 3 dhe 4 të LEBS-së.

⁷⁶³ Neni 3, paragrafi 3 i LEBS-së.

3. Roli i gjykatave dhe i agjentëve zbatues në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

3.1 Kapacitetet e gjykatave lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Gjykata që vendos për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore mund vetëm të shqyrtojë kushtet e njohjes, të përcaktuara në nenet 86-96 të LDNP-së së Serbisë. Siç shihet më lart, këto kushte kanë natyrë formale (procedurale); vetëm vlerësimi që ka të bëjë me faktin nëse vendimi i huaj gjyqësor bie ndesh me rendin publik të Serbisë bën të mundur shqyrtimin mbi themelin e vendimit. Gjykata nuk ka kompetencën për të rishikuar vendimin e huaj gjyqësor për sa i përket fakteve të pakundërshtueshme dhe legjislacionit të zbatuar, apo për ta ndryshuar vendimin në çdo aspekt.⁷⁶⁴

3.2 Sasia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore lidhur me njohjen ndërmjet shteteve të vendimeve të huaja gjyqësore

Aktualisht, nuk ka statistika të sakta lidhur me vendimet e huaja gjyqësore të njohura nga gjykata serbe. Sipas informacioneve të marra përmes kërtimeve me iniciativën tonë,⁷⁶⁵ të paktën tridhjetë vendime të huaja gjyqësore janë njohur nga gjykatat serbe ndërmjet viteve 2010-2019. Cilësia e vendimeve të gjykatës serbe lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore mund të konsiderohet "e lartë", pasi zbatimi i dispozitave ligjore për rrethanat konkrete të çështjeve në fjalë është shpjeguar siç duhet në çdo rast. Duhet të theksohet se, shpeshherë, gjykatat serbe i referohen literaturës përkatëse të së drejtës ndërkombëtare private, e cila trajton njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve.

3.3 Kapacitetet e agjentëve zbatues lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore ndërmjet shteteve

Agjentët zbatues nuk kanë kapacitete lidhur me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore, pasi këto të fundit mund të njihen dhe të deklarohen të ekzekutueshme vetëm nga gjykata. Siç u përmend më lart, gjykatat kryejnë procedurat e njohjes dhe të ekzekutimit lidhur me vendimet e huaja gjyqësore të njohura, ndërsa agjentët zbatues kryejnë ekzekutimin ndaj pasurive të debitorit në përputhje me vendimin për ekzekutim që është dhënë nga gjykata.

3.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore brenda kurrikulave arsimore të Akademive të Formimit Gjyqësor

Në kurrikulat arsimore të Akademisë së Formimit Gjyqësor në Serbi nuk ka një lëndë të veçantë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Sidoqoftë, disa aspekte të tyre shtjellohen në lëndët mësimore që trajtojnë çështjet civile dhe tregtare me një element ndërkombëtar.

4. Aspektet ekonomike dhe politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

4.1 Partnerët kryesorë tregtarë për import-eksport

4.1.1 Importi

Sipas raportit të Institutit Serb të Statistikave,⁷⁶⁶ gjatë vitit 2020, partnerët kryesorë tregtarë të importit të mallrave në Serbi janë nga Gjermania, Kina, Italia, Federata Ruse dhe Hungaria.

Aktualisht, janë vendosur regjime për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare me Gjermaninë (sipas rregullave të brendshme), Hungarinë (sipas traktatit dypalësh), Italinë (sipas rregullave të brendshme) dhe me Federatën Ruse (sipas traktatit dypalësh), ndërkohë që për momentin nuk ekziston një regjim i tillë me Kinën.

4.1.2 Eksporti

Sipas të njëjtit raport, gjatë vitit 2020, partnerët kryesorë tregtarë të eksportit të mallrave janë nga Gjermania, Italia, Bosnjë-Hercegovina, Rumania dhe Hungaria.

Aktualisht, janë vendosur regjime për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare me të gjitha shtetet e përmendura (me Gjermaninë – sipas rregullave të brendshme, me Bosnjë-Hercegovinën – sipas traktatit dypalësh, me Rumaninë – sipas traktatit dypalësh, me Hungarinë – sipas traktatit dypalësh).

4.2 Aspektet politike lidhur me zbatimin e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

4.2.1 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë njoftime në përputhje me nenin 29 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore"

Neni 29 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore" parashikon mundësinë që shteti kontraktual (palë) të njoftojë depozituesin brenda periudhës 12-mujore, që ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i një shtetit tjetër nuk do të ketë efektin e vendosjes së marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy shteteve sipas kësaj konvente (paragrafi 2), si dhe mundësinë që një shtet, i cili dëshiron të bëhet shtet kontraktual, të njoftojë depozituesin që ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i tij nuk do të ketë efektin e vendosjes së marrëdhënieve me një shtet kontraktual, sipas kësaj konvente (paragrafi 3). Në këtë drejtim, Serbia mund të bëjë një njoftim të tillë lidhur me Kosovën, pasi Serbia e konsideron Kosovën, d.m.th. Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë (sipas Kushtetutës së Serbisë), si pjesë të territorit të saj. E njëjta gjë ka ndodhur tashmë sa i përket aderimit të Kosovës në Konventën e HCCH-së të vitit 1961 "Për vulën apostile", ku Serbia kundërshtoi aderimin e saj dhe njoftoi se Kosova, d.m.th. Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë është, sipas Kushtetutës së Republikës së Serbisë, një pjesë përbërëse e territorit serb, duke iu referuar edhe Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë.⁷⁶⁷

⁷⁶⁴ M. Stanivuković, M. Živković, op. cit. (Kluwer), 238.

⁷⁶⁵ Përmes përdorimit të bazës së të dhënave <https://www.paragraf.rs>

⁷⁶⁶ Shihni: <https://www.stat.gov.rs/oblasti/spoljna-trgovina/>

⁷⁶⁷ Shihni:

<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/notifications/?csid=342&disp=resdn>

4.2.2 Rrethanat të cilat i japin mundësi vendit tuaj që të bëjë deklaratë në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 25 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Nga pikëpamja e Serbisë, konstatohet se nuk ka nevojë për deklaratën për kufizimin e njohjes dhe të ekzekutimit, gjë që mund të shprehet në përputhje me nenin 17 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Pra, edhe pse mund të jetë rasti kur një çështje për të cilën është marrë vendimi nga një gjykatë e një shteti tjetër kontraktual, ka lidhje të forta me Serbinë, si shteti kontraktual i kërkuar, nuk duhet të ketë asnjë pengesë për njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi në Serbi, në përputhje me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, nëse ai ka kaluar një nga “filtrat e juridiksionit” të nenit 5 dhe nëse nuk ka baza për refuzim, siç parashikohet nga neni 7 i konventës.

Kësisoj, konstatohet se Serbia nuk ka arsye që ta bëjë deklaratën për çështje specifike (neni 18), gjë e cila do të përjashtonte çdo çështje specifike të mbuluar nga Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Dispozitat ligjore të brendshme të Serbisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore kanë një fushë më të gjerë zbatimi dhe janë më liberale se ato të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, e cila është edhe arsyeja se përse nuk duhet bërë një deklaratë e tillë.

I njëjti përfundim pritet të nxirret për sa i përket deklaratave për vendimet gjyqësore që i përkasin një shteti (neni 19) – nuk është e nevojshme që Serbia të bëjë një deklaratë të tillë. Konkretisht, për çështjet civile dhe tregtare, ku Serbia (duke vepruar në cilësinë e shtetit) ose një person fizik apo juridik që vepron për llogari të Serbisë (në cilësinë e shtetit) është palë, Serbia ose personi tjetër që vepron për llogari të Serbisë zakonisht dëshiron që të shmangë gjykatat kombëtare dhe, rrjedhimisht, vendos të lidhë një marrëveshje arbitrazhi me palën tjetër, duke e çuar çështjen përpara gjykatës ndërkombëtare të arbitrazhit për çështjet tregtare (qoftë arbitrazh i posaçëm ose institucional), çka nënkupton se zbatimi i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” do të ishte shumë i rrallë në raste të tilla.

5. Juridiksioni ndërkombëtar dhe pajtueshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

5.1 Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar (vendbanimi, vendqëndrimi i zakonshëm)

Juridiksioni i përgjithshëm ndërkombëtar i gjykatave serbe rregullohet nga neni 46 i LDNP-së së Serbisë. Ai vendoset bazuar në vendbanimin e të paditurit në Serbi, nëse i padituri është një person fizik, ose bazuar në selinë e të paditurit në Serbi, nëse i padituri është një person juridik (neni 46, paragrafët 1 dhe 5).⁷⁶⁸ Në raste përjashtimore, mund të vendoset juridiksioni i përgjithshëm i gjykatave serbe nëse i padituri, i cili është një person fizik e ka vendqëndrimin në Serbi dhe nëse ai/ajo nuk e ka vendbanimin as në Serbi dhe as në ndonjë shtet tjetër (neni 46, paragrafi 2) ose nëse të dyja palët janë shtetase të Serbisë (neni 46, paragrafi 3). Në rast se në kërkesëpadi janë të përfshirë disa të paditur, të cilët konsiderohen pjesë e një komuniteti ligjor lidhur me objektin e mosmarrëveshjes, ose nëse të drejtat dhe detyrimet e tyre lindin nga e njëjta bazë ligjore dhe faktike, gjykatat serbe kanë gjithashtu juridiksion ndërkombëtar nëse një nga të paditurit e ka vendbanimin ose selinë në Serbi (neni 46, paragrafi 4).⁷⁶⁹

Andaj, juridiksioni i përgjithshëm i gjykatave serbe përcaktohet nga vendbanimi dhe vendqëndrimi

⁷⁶⁸ Për informacione rreth nenit 46 të LDNP-së së Serbisë, shihni M. Dika, G. Knežević, S. Stojanović, op. cit., 165-172; M. Stanivuković, M. Živković, op. cit., 184; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 498-499.

⁷⁶⁹ Po aty.

i një personi fizik dhe nga selia e një personi juridik, si kriteret e juridiksionit që duhet të interpretohen në përputhje me legjislacionin serb. Vendbanimi duhet të interpretohet si vendi ku një person fizik është vendosur me synimin për të jetuar aty përgjithmonë, d.m.th. vendi ku një person fizik ka qendrën e ushtrimit të aktiviteteve të tij/saj të përditshme dhe kur marrëdhëniet e tij/saj profesionale, ekonomike, sociale dhe të tjera e konfirmojnë lidhjen e përhershme të personit me atë vend.⁷⁷⁰ Vendqëndrimi i personit fizik është vendi ku një person fizik po qëndron përkohësisht, jashtë vendbanimit të tij/saj. Selia e një personi juridik duhet të interpretohet si vendi ku ndodhet administrata e tij/saj qendrore.⁷⁷¹

LDNP-ja e Serbisë nuk e njeh vendqëndrimin e zakonshëm si kriter për juridiksionin.

5.2 Caktimi i juridiksionit me marrëveshje (i shprehur/i heshtur, përpara ose pas fillimit të procedurës)

Caktimi i juridiksionit me marrëveshje në çështjet civile dhe tregtare rregullohet nga neni 49 i LDNP-së së Serbisë, i cili përmban rregulla të ndryshme për caktimin e juridiksionit me marrëveshje të një gjykate serbe dhe për caktimin e juridiksionit me marrëveshje të një gjykate të huaj.⁷⁷² Nëse palët kanë për qëllim që të bien dakord se një gjykatë serbe do të ketë juridiksion për çështjen në fjalë, të paktën njëra nga palët duhet të jetë shtetas i Serbisë ose të ketë selinë në Serbi (neni 49, paragrafi 2). Nga ana tjetër, nëse palët kanë për qëllim ta caktojnë juridiksionin me marrëveshje të një gjykate të huaj, të paktën njëra nga palët duhet të ketë shtetësi të huaj ose të ketë selinë në një shtet të huaj dhe mosmarrëveshja në fjalë nuk duhet të jetë nën juridiksionin ekskluziv të gjykatave serbe (neni 49, paragrafi 1). Duhet të theksohet se caktimi i juridiksionit me marrëveshje të një gjykate të huaj do të jetë i vlefshëm vetëm nëse, krahas përmbushjes së kërkesave të parashikuara nga neni 49, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë, janë përmbushur edhe kërkesat për «lex fori prorogati» të huaj.⁷⁷³

Marrëveshja për zgjedhjen e gjykatës mund të bëhet në mënyrë të shprehur (expressis verbis) ose të heshtur (prorogation tacita). Marrëveshja “expressis verbis” do të thotë se është lidhur paraprakisht me shkrim, qoftë si marrëveshje e veçantë ose si klauzolë për caktimin e juridiksionit që përfshihet në kontratë, ose pas nisjes së procedurave kur i padituri bën një deklaratë verbale, në të cilën pranon juridiksionin përpara gjykatës.⁷⁷⁴ Literatura dhe praktika gjyqësore e Serbisë e barazon “prorogatio tacita” me juridiksionin e caktuar pas paraqitjes së argumenteve, i cili deri në një masë të caktuar, rregullohet nga neni 50 i LDNP-së së Serbisë.⁷⁷⁵ Pra, do të thotë se marrëveshja për caktimin e juridiksionit quhet e arritur në heshtje nëse i padituri dorëzon një përgjigje me shkrim ndaj një kërkesëpadie pa e kundërshtuar juridiksionin, ose nëse ai/ajo paraqitet në seancën e parë gjyqësore dhe diskuton themelin e çështjes pa kundërshtuar juridiksionin e gjykatës.⁷⁷⁶

5.3 Bazuar në nenin 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e kriterëve të tjera juridiksionale në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Neni 5 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” parashikon bazat për

⁷⁷⁰ Neni 3, pika 2 e ligjit “Për vendbanimin dhe vendqëndrimin e shtetasve” Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 87/2011.

⁷⁷¹ Shihni nenin 19 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 36/2011, 99/2011, 83/2014 - ligje të tjera, 5/2015, 44/2018, 95/2018 dhe 91/2019

⁷⁷² Shihni M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 178-191; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 501-503; . Stanivuković, M. Živković, op. cit., 188-193.

⁷⁷³ Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 503.

⁷⁷⁴ M. Stanivuković, M. Živković, op. cit. (Kluwer), 232.

⁷⁷⁵ Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 502; M. Stanivuković, M. Živković, op. cit., 192.

⁷⁷⁶ Po aty.

juridiksionin e tërthortë, që njihen dhe si “filtrat e juridiksionit”, të cilët duhet të kalohen me sukses nga vendimi i huaj, në mënyrë që ai të kualifikohet për njohje dhe ekzekutim në shtetin e kërkuar.⁷⁷⁷ Këta “filtra” tregojnë cilësinë e kontakteve që ka çështja me shtetin, gjykata e të cilit ka dhënë vendimin (shteti i origjinës) dhe përfaqësojnë standardet minimale përmes të cilave gjykata e shtetit të kërkuar kontrollon juridiksionin ndërkombëtar të shtetit të gjykatës që ka dhënë vendimin.⁷⁷⁸ Kjo do të thotë se gjykata e shtetit të kërkuar shqyrton nëse janë kaluar “filtrat” e parashikuar, dhe nëse përgjigja është pozitive, do ta konsiderojë vendimin e huaj gjyqësor si të kualifikueshëm për njohje dhe ekzekutim.

Lista e filtrave të juridiksionit, të parashikuara nga neni 5 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” është si në vijim: vendqëndrimi i zakonshëm, vendi kryesor i biznesit, dega, agjencia ose çdo institucion tjetër, miratimi i shprehur ose i nënkuptuar i të paditurit për juridiksionin e gjykatës që ka dhënë vendimin, vendi i përmbushjes së detyrimit kontraktor, vendndodhja e pasurisë së paluajtshme, e cila është objekt i kontratës së qirasë, vendndodhja e pasurisë së paluajtshme në çështjet që trajtojnë detyrimin kontraktor të siguruar me një të drejtë reale (in rem) në atë pasuri, vendi i veprimit ose mosveprimit në çështjet që lidhen me detyrimet jokontraktore, trustet, kundërpadia, marrëveshjet për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës, kontratat konsumatore dhe të punës dhe qiraja e pasurisë së paluajtshme për qëllime banimi. Ndërmjet këtyre filtrave nuk ka hierarki dhe në mënyrë që të njihet vendimi i huaj gjyqësor, mjafton që të kalohet vetëm njëri nga këta filtra.⁷⁷⁹

Duke qenë se pjesa më e madhe e bazave të renditura më lart ngjason me kriteret për juridiksionin e drejtpërdrejtë të gjykatave serbe që rregullohen nga LDNP-ja e Serbisë, ne do t'i krahasojmë ato në mënyrë që të përcaktojmë pajtueshmërinë e tyre, e cila mund të ndikojë në vendimin nëse Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” duhet të nënshkruhet ose ratifikohet nga Serbia. Megjithatë, duhet pasur parasysh fakti se neni 15 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” nuk pengon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas legjislacionit të brendshëm, i cili mund të jetë më liberal ndaj njohjes dhe ekzekutimit ndërmjet shteteve, se sa vetë konventa.

5.3.1 Vendqëndrimi i zakonshëm

Sipas nenit 5, paragrafi 1 germa “a”, një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim nëse “personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi e ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur ai person është bërë palë e procedurave në gjykatën që ka dhënë vendimin”.

Për zbatimin e duhur të kësaj dispozite, duhet t'i kushtohet vëmendje faktit që Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” bën dallimin midis vendqëndrimit të zakonshëm të personit fizik nga vendqëndrimi i zakonshëm i personit juridik. Vendqëndrimi i zakonshëm i personit fizik nuk përcaktohet nga Konventa, por literatura krahasuese ofron disa këndvështrime, të cilat si vendqëndrim të zakonshëm nënkuptojnë shtetin në territorin e të cilit një person fizik qëndron për një periudhë të caktuar kohore me qëllimin për të qëndruar zakonisht (vazhdimisht) në atë territor, dhe kur ky qëllim tregohet përmes lidhjeve të tij/saj personale, sociale, ekonomike, profesionale etj., me atë vend.⁷⁸⁰ Nga ana tjetër, vendqëndrimi i zakonshëm i një personi juridik përkufizohet nga neni 3, paragrafi 2 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, i cili parashikon se vendqëndrimi i zakonshëm konsiderohet vendi ku personi ka selinë juridike, administratën qendrore ose vendin kryesor të biznesit, ose shteti në bazë të

ligjeve të së cilit biznesi është themeluar ose krijuar. Gjithashtu, neni 5, paragrafi 1 germa “a” përmend “personin ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi,” që nënkupton se personi mund të jetë i padituri ose paditësi apo çdo person tjetër i cili ka marrë pjesë në procedurat përpara gjykatës së shtetit të origjinës, nëse ai/ajo merr përsipër rolin e të paditurit në procedurat e njohjes përpara gjykatës së shtetit të kërkuar.⁷⁸¹

LDNP-ja e Serbisë nuk e përdor, në asnjë rrethanë, vendqëndrimin e zakonshëm si kriter për juridiksionin. Siç u përmend më lart, kriteri kryesor është vendbanimi nëse i padituri është një person fizik, ose selia, nëse i padituri është një person juridik. Duke marrë parasysh përkufizimin e cituar më lart për vendbanimin në legjislacionin serb, mund të mendohet se vendbanimi do të përkojë me vendqëndrimin e zakonshëm të të paditurit në pothuajse të gjitha situatat, gjë që do të thotë se vendimet e gjykatave serbe mund ta kalojnë filtrin e juridiksionit të nenit 5, paragrafi 1, germa “a”. Megjithatë, duhet të mbahet parasysh se gjykata e merr informacionin për vendbanimin e të paditurit kryesisht nga dokumentet e tij/saj personale dhe zakonisht bazohet mbi to për përcaktimin e juridiksionit, edhe pse ky informacion ndonjëherë nuk përkon me situatën faktike (p.sh. mund të ndodhë që një person, i cili e ka vendbanimin të regjistruar në Serbi, të ketë qenë duke jetuar në një vend të huaj prej vitesh).⁷⁸² Për të shmangur këto mospërputhje, vetë gjykata duhet të përcaktojë dhe të marrë në konsideratë të gjitha faktet e nevojshme për përcaktimin e saktë të vendbanimit të të paditurit, dhe nëse nuk arrin ta bëjë këtë gjë, një nga palët mund të sjellë prova se vendbanimi aktual i të paditurit është në një vend të huaj, pavarësisht faktit se është zyrtarisht i regjistruar në Serbi. Për më tepër, duhet përmendur fakti që shumë autorë serbë mendojnë se informacioni për vendbanimin e regjistruar, që gjendet në dokumentet zyrtare, përbën një prezumim të kundërshtueshëm nëse personi të cilit i përket dokumenti zyrtar banon realisht në atë shtet.⁷⁸³

Selia e një personi juridik si kriter për juridiksionin në legjislacionin serb përkon me vendqëndrimin e zakonshëm të personit juridik sipas Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Pra, personi juridik e ka selinë në Serbi nëse e ka administratën qendrore në atë shtet.⁷⁸⁴ Duhet të përmendet edhe fakti që një person juridik, i cili është themeluar apo krijuar në përputhje me legjislacionin serb, duhet ta ketë selinë e tij/saj juridike në Serbi dhe pothuajse gjithmonë e ka administratën e tij/saj qendrore në Serbi. Vështirë të mendohet që një person juridik i themeluar apo i krijuar sipas një legjislacioni të huaj, ta ketë selinë juridike apo administratën qendrore në Serbi.

5.3.2 Vendi kryesor i biznesit

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “b” një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim nëse “personi fizik ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi e ka pasur vendin kryesor të biznesit në shtetin e origjinës në kohën kur personi është bërë palë e procedurave në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe kërkesëpadia ku bazohet vendimi ka lindur nga veprimtaritë e atij biznesi.”

Shihet qartas që kjo dispozitë ka të bëjë me personat fizikë që ushtrojnë veprimtari biznesi, ku filtri i juridiksionit është vendi i tij/saj kryesor i biznesit në shtetin e origjinës. LDNP-ja e Serbisë nuk e njeh vendin kryesor të biznesit të një personi fizik si kriter për juridiksionin. Megjithatë, ligji “Për shoqëritë tregtare” në Serbi rregullon statusin ligjor të sipërmarrësit,⁷⁸⁵ i cili është një person fizik me kapacitet ligjor për të ushtruar veprimtari biznesi. Ky person ka një seli të regjistruar, e cila përkufizohet si vendi ku ai/ajo ushtron veprimtarinë e biznesit⁷⁸⁶ dhe është një kriter për

⁷⁷⁷ Për informacione rreth filtrave në Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, shihni I. Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – is the “heart” of the Convention in the right place?, Shihni - Law Journal, issue 1, No. 8, 2021, 10 etc. Gjithashtu shihni - R. Brandt, The Hague Judgments Convention in the United States: A “Game Changer” or a New Path to the Old Game?, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3747078, 8 etc., 17 etc.

⁷⁷⁸ Po aty., 16-17.

⁷⁷⁹ Po aty., 18.

⁷⁸⁰ Shihni po aty., 19-20; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 275; M. Stanivuković, M. Živković, op. cit., 113-114

⁷⁸¹ I. Rumenov, op. cit., 20.

⁷⁸² Shihni S. Đorđević, Primena međunarodnog privatnog prava u javnobeležničkoj praksi, http://www.beleznik.org/images/pdf/obavestjenje/uputstvo_zaprimenampp_u_jb_praksi.pdf, 9; I. Rumenov, op. cit., 21.

⁷⁸³ A. Jakšić, Međunarodno privatno pravo, opšta teorija, Beograd 2017, 326; shihni gjithashtu M. Stanivuković, M. Živković, op. cit., 97.

⁷⁸⁴ Shihni nenin 19 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” në Serbi.

⁷⁸⁵ Shihni nenet 83-92 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” në Serbi.

⁷⁸⁶ Shihni nenin 87 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” në Serbi.

juridiksionin sipas LDNP-së së Serbisë. Prandaj, për sa i përket sipërmarrësve, gjykatat serbe mund të përcaktojnë juridiksionin për të vendosur mbi kërkesëpaditë që ngrihen për shkak të veprimtarive të biznesit të sipërmarrësit, nëse ai/ajo ka një seli në territorin e Serbisë.

5.3.3 Paraqitja e një kërkesëpadie në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “c”, një vendim gjyqësor kualifikohet “nëse personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi është personi që ka paraqitur kërkesëpadinë, e ndryshme nga një kundërpadi, mbi të cilën bazohet vendimi.”

Filtri i juridiksionit përqendrohet në personin paditës në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin, dhe nëse ai person e ka humbur çështjen, duket mjaft e arsyeshme që vendimi gjyqësor të kualifikohet për njohje ose ekzekutim në shtete të tjera, pavarësisht kriterit mbi të cilin është bazuar juridiksioni i gjykatës që ka dhënë vendimin.⁷⁸⁷

5.3.4 Dega, agjencia ose institucionet e tjera

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “c”, një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim nëse “i padituri ka pasur një degë, agjenci apo institucion tjetër pa një personalitet juridik të mëvetësishëm në shtetin që ka dhënë vendimin në kohën kur ky person është bërë palë në procedurat e gjykatës që ka dhënë vendimin dhe kërkesëpadia mbi të cilën është bazuar vendimi ka lindur nga veprimtaritë e asaj dege, agjencie apo institucioni.”

Filtri i juridiksionit i referohet një situatë ku i padituri në procedurat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin ka pasur një degë, agjenci apo institucion tjetër pa personalitet juridik dhe objekti i vendimit të dhënë ka qenë një kërkesëpadi në lidhje me veprimtarinë e degës, agjencisë ose institucionit. Neni 55 i LDNP-së së Serbisë përmban një dispozitë për juridiksionin e drejtpërdrejtë të gjykatave serbe, të cilat në disa raste përkojnë me filtrin e juridiksionit të nenit 5, paragrafi 1, germa “d”, të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Sipas kësaj dispozite, në mosmarrëveshjet kundër një personi fizik ose juridik që e ka selinë jashtë shtetit, të cilat trajtojnë detyrimet që kanë lindur në Serbi ose që duhet të përmbushen në Serbi, gjykata serbe ka juridiksionin nëse personi e ka zyrën përfaqësuese ose agjencinë në Serbi ose nëse selia e personit juridik, të cilit i ka besuar ushtrimin e biznesit të tij/saj, është në Serbi.⁷⁸⁸ Edhe pse nuk deklarohet shprehimisht, ky rregull për juridiksionin merr qartazi parasysh detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e biznesit të përfaqësuesit zyrtar të të paditurit apo agjencisë me vendndodhje në Serbi.

5.3.5 Miratimi i juridiksionit të gjykatës që ka dhënë vendimin dhe marrëveshja për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës

Sipas nenit 5, paragrafi 1, pikat “e” dhe “f”, një vendim i shpallur nga gjykata që ka dhënë vendimin do të kualifikohet për njohje ose ekzekutim në shtetin e kërkuar, nëse i padituri e ka pranuar shprehimisht juridiksionin e gjykatës që ka dhënë vendimin gjatë procedurave në të cilat është dhënë vendimi, ose nëse i padituri ka dhënë argumente mbi themelin përpara gjykatës që ka dhënë vendimin, pa e kundërshtuar juridiksionin brenda afatit kohor të parashikuar në legjislacionin e shtetit që ka dhënë vendimin, përveç nëse është e qartë se një kundërshtim ndaj juridiksionit ose ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte pasur sukses sipas atij ligji. Filtri i parë ka të bëjë me miratimin e shprehur, ndërsa i dyti me miratimin e nënkuptuar të juridiksionit. Krahës kësaj, neni 5, paragrafi 1 germa “m”, parashikon një filtër juridiksioni që i referohet marrëveshjes për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës. Nëse vendimi është dhënë nga një gjykatë e caktuar në

përputhje me marrëveshjen për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës, e cila përmbush disa kërkesa formale të caktuara, do të konsiderohet i kualifikueshëm për njohje dhe ekzekutim në shtetin e kërkuar.

Siç është përmendur më lart, LDNP-ja e Serbisë rregullon caktimin e juridiksionit me marrëveshje, i cili mbulon miratimin e shprehur dhe atë të nënkuptuar të juridiksionit, si dhe marrëveshjet për zgjedhjen joekskluzive të gjykatës, në mënyrë që vendimet e shpallura nga gjykatat serbe, juridiksioni i të cilave është vendosur në njërën prej këtyre mënyrave, të mund të kualifikohet për njohje dhe ekzekutim sipas Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

5.3.6 Vendi i përmbushjes së detyrimit kontraktor

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “g”, një vendim gjyqësor kualifikohet nëse trajton një detyrim kontraktor dhe është dhënë nga gjykata e shtetit ku ka ndodhur përmbushja e atij detyrimi, ose në të cilën duhet të kishte ndodhur, në përputhje me (i) marrëveshjen midis palëve, ose (ii) legjislacionin e zbatueshëm për kontratën, në mungesë të një vendi të dakordësuar për përmbushjen e detyrimit, me përjashtim të rasteve kur veprimtaritë e të paditurit në lidhje me transaksionin nuk përbënin një lidhje kuptimplotë dhe thelbësore me atë shtet. Prandaj, shteti i origjinës duhet të jetë shteti ku është përmbushur detyrimi ose ku supozohej të përmbushej sipas dispozitave të kontratës ose përmes “lex contractus”. Megjithatë, edhe nëse përmbushen këto kritere, vendimi gjyqësor nuk mund ta kalojë këtë filtër nëse veprimtaritë e të paditurit në lidhje me detyrimet kontraktore nuk kanë lidhje të mjaftueshme me shtetin e origjinës.

Sipas nenit 53, paragrafi 3 i LPK-së, gjykata serbe ka juridiksionin për të vendosur për çështjet lidhur me detyrimet që duheshin përmbushur në Serbi. Ekziston edhe një dispozitë e veçantë për juridiksionin në nenin 481, paragrafi 1 i LPK-së për çështjet që trajtojnë kontratat tregtare, sipas të cilës gjykata serbe ka juridiksionin për të vendosur mbi vlefshmërinë, shkeljen ose realizimin e kontratës nëse i padituri, sipas marrëveshjes midis palëve, duhet t'i kishte përmbushur detyrimet kontraktore në Serbi.⁷⁸⁹ Duke qenë se filtri i juridiksionit, i nenit 5, paragrafi 1, germa “g”, kërkon më shumë kritere për vendosjen e një lidhjeje mjaftueshme të fortë me shtetin e origjinës, mund të thuhet se vendimet e gjykatave serbe, në raste të tilla rrallëherë do ta kalojnë këtë filtër juridiksioni.

5.3.7 Vendndodhja e pasurisë së paluajtshme me qira

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “h”, një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim nëse është shpallur për qiranë e një pasurie të paluajtshme (qiramarrja) nga një gjykatë e shtetit në të cilën ndodhet prona.

LDNP-ja e Serbisë parashikon juridiksionin ekskluziv të gjykatave serbe lidhur me të drejtat reale ose me qiramarrjen e pasurisë së paluajtshme me vendndodhje në Serbi (neni 56), ndërsa për kontratat afatshkurtra të qirasë nuk ekzistojnë rregulla lidhur me juridiksionin e posaçëm.

5.3.8 Detyrimi kontraktor i siguruar me një të drejtë reale (in rem)

Neni 5, paragrafi 1, germa “i” parashikon një filtër juridiksioni për vendimet gjyqësore lidhur me detyrimet kontraktore të siguruara me një të drejtë reale (in rem) në pasurinë e paluajtshme, i cili kërkon që ky vendim të jetë dhënë në shtetin ku ndodhet pasuria e paluajtshme dhe që kërkesëpadia kontraktore të jetë ngritur së bashku me një kërkesëpadi kundër të njëjtit të paditur në lidhje me atë të drejtë reale. Ky filtër është tejet specifik, pasi mbulon lloje të ndryshme situatash që përfshijnë të drejtat reale, të cilat shërbejnë për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

⁷⁸⁷ Shihni dhe krahasoni I. Rumenov, op. cit., 22.

⁷⁸⁸ Për informacione rreth interpretimit dhe zbatimit të nenit 55 të LDNP-së së Serbisë, shihni M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit, 201-202.

⁷⁸⁹ Shihni dhe krahasoni po aty., 200-201.

LDNP-ja e Serbisë nuk e njeh këtë filtër si bazë për juridiksion të drejtpërdrejtë, por parashikon juridiksionin ekskluziv të gjykatave serbe për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat reale në pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Serbi. Prandaj, vetëm nëse një kërkesëpadi në lidhje me të drejtat reale në pasurinë e paluajtshme në Serbi, të cilat kanë shërbyer si garanci, është ngritur së bashku me një kërkesëpadi kontraktore kundër të njëjtit të paditur përpara një gjykate serbe, vendimi i shpallur në këtë rast do ta kalonte këtë filtër juridiksioni.

5.3.9 Vendi i veprimit ose mosveprimit në çështjet që lidhen me detyrimet jokontraktore

Sipas nenit 5, paragrafi 1, germa “j”, një vendim gjyqësor kualifikohet për njohje ose ekzekutim, nëse është shpallur për një detyrim jokontraktor si pasojë e vdekjes, lëndimit fizik, dëmtimit ndaj pasurisë fizike ose humbjes së saj, dhe veprimi ose mosveprimi që ka shkaktuar drejtpërsëdrejti këtë dëmtim ka ndodhur në shtetin e origjinës, pavarësisht se ku ka ndodhur dëmtimi. Prandaj, ky filtër juridiksioni kërkon që shteti i origjinës të jetë vendi ku ka ndodhur veprimi ose mosveprimi që ka shkaktuar drejtpërsëdrejti dëmtimin, duke nënkuptuar që vendi i dëmtimit nuk përbën peshë.

Nga ana tjetër, neni 53 i LDNP-së së Serbisë parashikon se gjykata serbe ka juridiksion për çështjet në lidhje me përgjegjësitë jokontraktore, nëse dëmi ka ndodhur në Serbi. Ky rregull mbulon një pjesë të madhe të qëllimit material të detyrimeve jokontraktore, por kriteri i tij për përcaktimin e juridiksionit (vendi i dëmit) ndryshon nga kriteri (vendi i veprimit ose mosveprimit) i kërkuar nga filtri i juridiksionit, i nenit 5, paragrafi 1, germa “h”, i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Megjithatë, disa autorë serbë konstatojnë se kriteri i nenit 53 i LDNP-së së Serbisë duhet të interpretohet më gjerësisht për të mbuluar edhe vendin e veprimit ose të mosveprimit.⁷⁹⁰

5.3.10 Trustet

Neni 5, paragrafi 1, germa “k” parashikon një filtër juridiksioni në lidhje me trustet.⁷⁹¹ Duke qenë se sistemi juridik i Serbisë nuk i njeh trustet si institucion ligjor në asnjë rrethanë, ky filtër juridiksioni ka vlerë të vogël praktike për sa i përket legjislacionit serb.

5.3.11 Kundërpaditë

Neni 5, paragrafi 1, germa “l” rregullon filtrin e juridiksionit për vendimet gjyqësore të dhëna për kundërpaditë. Këto vendime kualifikohen për njohje ose ekzekutim (i) deri në masën që kanë qenë në favor të kundërpaditësit, me kusht që kundërpadia të ketë ardhur si pasojë e së njëjtit transaksion ose ngjarje ashtu si kërkesëpadia ose (ii) deri në masën që ato kanë qenë kundër kundërpaditësit, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i shtetit të origjinës ka kërkuar që të depozitohej kundërpadia për të shmangur pamundësimin.

LDNP-ja e Serbisë nuk përmban rregulla të veçanta për juridiksionin ndërkombëtar lidhur me kundërpaditë. Megjithatë, duket se gjykata serbe e cila ka juridiksion ndërkombëtar për të vendosur mbi kërkesëpadinë, në përputhje me dispozitat për juridiksionin vendor të nenit 198 të LPK-së, që mund të zbatohet në mënyrë analoge për juridiksionin ndërkombëtar, mund të vendosë mbi kundërpadinë që ndërlidhet me kërkesëpadinë.⁷⁹² Kjo qasje është në përputhje me filtrin e juridiksionit të nenit 5, paragrafi 1, germa “l”, të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

5.3.12 Kontratat konsumatore dhe të punës

Neni 5, paragrafi 2, rregullon filtrin e juridiksionit për vendimet gjyqësore të shpallura për çështjet në lidhje me kontratat konsumatore dhe të punës, me kusht që vendimet gjyqësore të shpallura në favor të konsumatorëve ose punëmarrësve të kualifikohen për njohje dhe ekzekutim nëse kalojnë ndonjë prej filtrave të juridiksionit, që përfshihen në nenin 5, paragrafi 1, ndërsa vendimet e shpallura kundër konsumatorëve ose punëmarrësve kualifikohen nëse juridiksioni i gjykatës që ka dhënë vendimin është bazuar në miratimin verbal ose me shkrim pranë asaj gjykate ose është bazuar në vendqëndrimin e zakonshëm të konsumatorit ose punëmarrësit.⁷⁹³

LDNP-ja e Serbisë nuk ka rregulla të veçanta për juridiksionin e drejtpërdrejtë të gjykatave serbe në çështjet lidhur me kontratat konsumatore ose të punës.

5.3.13 Kritere të tjera për juridiksionin e drejtpërdrejtë të gjykatave serbe në kuadër të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

Në zbatim të LDNP-së së Serbisë, gjykatat serbe mund të vendosin juridiksionin për kritere që nuk përkojnë aspak me filtrat e juridiksionit të nenit 5 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”. Për shembull, për kërkesëpaditë për vlera monetare, gjykata serbe ka juridiksion nëse pasuria e të paditurit ose objekti i pretenduar ndodhet në Serbi (neni 54, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë) ose nëse detyrimet kanë lindur në kohën kur i padituri ka qenë i pranishëm në Serbi (neni 54, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë).⁷⁹⁴ Vendimet e shpallura për këto çështje nuk kualifikohen për njohje ose ekzekutim sipas Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

5.4 Juridiksioni ekskluziv

Në kuadrin e fushës së zbatimit të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, rregulli i vetëm i vlefshëm për juridiksionin e drejtpërdrejtë ekskluziv është ai i nenit 56 të LDNP-së së Serbisë, i cili parashikon juridiksionin ekskluziv të gjykatave serbe në çështjet që lidhen me pronësinë dhe të drejtat e tjera reale në pasuritë e paluajtshme, si dhe në lidhje me qiranë e pasurive të paluajtshme, nëse pasuria e paluajtshme në fjalë ndodhet në Serbi. Termi “të drejta të tjera reale” mbulon të gjitha të drejtat reale, krahas së drejtës së pronësisë, të cilat mund të fitohen përmes ligjit “Për pasuritë e paluajtshme” sipas legjislacionit serb.⁷⁹⁵ Duhet të përmendet edhe fakti se LDNP e Serbisë nuk bën diferencim midis kontratave afatgjata dhe kontratave afatshkurta të qirasë për pasuritë e paluajtshme, për sa i përket juridiksionit.

Neni 6 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” rregullon juridiksionin e tërthortë ekskluziv për çështjet lidhur me të drejtat reale në pasuritë e paluajtshme, duke deklaruar se vendimet e shpallura për këto raste njihen dhe ekzekutohen nëse dhe vetëm nëse pasuria e paluajtshme ndodhet në shtetin e origjinës. Prandaj, Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” garanton që gjykata e shtetit ku ndodhet pasuria e paluajtshme vendos ekskluzivisht për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat reale për pasurinë në fjalë.⁷⁹⁶

⁷⁹³ Për më shumë shihni I. Rumenov, op. cit., 35-37.

⁷⁹⁴ Për më shumë shihni M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 198-200; M. Stanivuković, P. Đundić, Međunarodno privatno pravo, posebni deo, Novi Sad 2008, 69-70.

⁷⁹⁵ Për më shumë shihni M. Dika, G. Knežević and S. Stojanović, op. cit., 202-203; M. Stanivuković, P. Đundić, op. cit., 49-51.

⁷⁹⁶ Shihni dhe krahasoni I. Rumenov, op. cit., 30.

⁷⁹⁰ Shihni po aty., 196-197

⁷⁹¹ Për më shumë shihni I. Rumenov, op. cit., 34.

⁷⁹² M. Stanivuković, Živković, op. cit., 198.

6. Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe përputhshmëria me Konventën e HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”

6.1 Qëllimi material i zbatimit

6.1.1 Bazuar në nenin 1 dhe 2 të Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”, duhet të parashikohet pajtueshmëria e qëllimit material të kërkesës për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në konventë dhe në burimet ligjore kombëtare

Qëllimi material i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të saj. Dispozita e nenit 1, paragrafi 1, fjalia 1, përshkruan gjerësisht qëllimin material, duke deklaruar se kjo konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në “çështjet civile ose tregtare,” ku termi “çështje civile ose tregtare” duhet të interpretohet në mënyrë të njëtrajtshme, duke pasur parasysh karakterin ndërkombëtar të konventës.⁷⁹⁷ Pas këtij përcaktimi të gjerë, dispozitat e nenit 1, paragrafi 1, fjalia 2 dhe neni 2 specifikojnë çështjet ligjore që përjashtohen shprehimisht nga qëllimi material i konventës. Konkretisht, konventa nuk zbatohet për çështjet e të ardhurave, doganore dhe administrative, të cilat kanë karakter të së drejtës publike, dhe as për çështjet e mëposhtme që kanë karakter të së drejtës civile ose të së drejtës tregtare: (a) statusi dhe aftësia ligjore e personave fizikë; (b) detyrimet ushqimore; (c) çështje të tjera të së drejtës familjare, duke përfshirë regjimet e pasurisë martesore dhe të drejtat apo detyrimet e tjera që lindin nga martesë apo nga marrëdhënie të ngjashme; (d) testamentet dhe trashëgimia; (e) falimenti, përbërja, zgjidhja e institucioneve financiare dhe çështjet analoge; (f) transporti i mallrave dhe udhëtarëve; (g) ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare e shkaktuar nga anijet, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare dhe parimi i barazisë së dëmeve (h) përgjegjësia për dëmin bërthamor; (i) vlefshmëria, pavlefshmëria ose shpërbërja e personave juridikë ose shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre; (j) vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë; (k) shpifja; (l) privatësia; (m) pronësia intelektuale; (n) veprimtaritë e forcave të armatosura, duke përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare; (o) veprimtaritë ligjzbatuese, duke përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare; (p) çështjet anti-trust (të konkurrencës), me përjashtim të rasteve kur vendimi gjyqësor është bazuar në sjellje që përbëjnë një marrëveshje antikonkurruese ose praktikë të përbashkët midis konkurrentëve realë ose të mundshëm për të vendosur çmimet, për të zgjedhur paraprakisht fituesit e tenderëve, për të vendosur kufizime në prodhim ose kuota, ose për të ndarë tregjet duke alokuar klientët, furnitorët, territoret apo linjat e tregtisë, dhe rastet kur kjo sjellje dhe pasojat e saj kanë ndodhur në shtetin e origjinës; (q) ristrukturimi i borxhit sovran përmes masave të njëanshme të shtetit. Krahas kësaj, vendimet e gjykatave të arbitrazhit dhe vendimet e tjera të shpallura në procedura alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përjashtohen shprehimisht nga fushëzbatimi i kësaj Konvente (neni 2, paragrafi 3). Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore për çështjet civile ose tregtare të shpallura gjatë procedurave, në të cilat njëra nga palët ka qenë një shtet, duke përfshirë qeverinë, agjencinë qeveritare ose çdo person që vepron për llogari të shtetit, nuk përjashtohen nga fushëzbatimi i konventës. Megjithatë, përjashtimi i këtyre vendimeve është i mundur sipas nenit 19, i cili bën të mundur që një shtet palë të deklarojë se nuk do ta zbatojë konventën për këto vendime.⁷⁹⁸

⁷⁹⁷ Neni 20 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”.

⁷⁹⁸ Për më shumë informacione për qëllimin e zbatimit shihni I. Rumenov, op. cit., 14-16; M. Wilderspin, L. Vysoka, The 2019 Hague Judgments Convention through European lenses, <https://www.nipr-online.eu/pdf/2020-138.pdf>, 2020, 36-37.

Sipas, LDNP-së së Serbisë, një vendim i huaj mund të njihet dhe ekzekutohet nëse është nxjerrë për çështje civile dhe tregtare (neni 86 dhe neni 1). Termi “çështje civile dhe tregtare” duhet të interpretohet dhe cilësohet në përputhje me legjislacionin serb.⁷⁹⁹ Ai mbulon çështjet e statusit të personave fizikë dhe juridikë, çështjet familjare, të trashëgimisë, të pasurisë, kontraktore dhe jokontraktore, si dhe çështje të tjera me karakter të së drejtës civile dhe të së drejtës tregtare⁸⁰⁰ (që do të thotë se mbulon pjesën më të madhe të çështjeve që përjashtohen nga neni 2, paragrafi 1 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”). Vendimet e huaja në lidhje me çështjet e të ardhurave, doganore ose administrative nuk mund të njihen dhe ekzekutohen në Serbi.⁸⁰¹

6.2 Llojet e vendimeve të huaja gjyqësore që njihen dhe ekzekutohen (p.sh. vendimet pozitive-negative, masat e përkohshme)

Sipas nenit 86, paragrafët 1 dhe 2 të LDNP-së së Serbisë, një vendim i gjykatës së një vendi të huaj, i shpallur për çështje civile ose tregtare mund të njihet dhe ekzekutohet në Serbi, me anë të të cilit zgjidhja që është arritur në një gjykatë të huaj (zgjidhje në rrugë gjyqësore) konsiderohet gjithashtu si vendim i huaj gjyqësor. Krahas kësaj, neni 86, paragrafi 3 i LDNP-së së Serbisë parashikon se një vendim i një autoriteti tjetër të huaj (p.sh. noter), i cili është i barasvlershëm me një vendim gjyqësor në vendin e origjinës do të konsiderohet gjithashtu si vendim i huaj gjyqësor.⁸⁰²

Çdo vendim i huaj gjyqësor, i cili është i formës së prerë sipas legjislacionit të vendit të origjinës, kualifikohet *në vetvetë* për njohje. Nëse kërkohet njohja e vendimit të huaj gjyqësor me karakter ndëshkimor, që ka marrë formë të prerë, ky vendim duhet të jetë i ekzekutueshëm sipas legjislacionit të vendit të origjinës. Personi që nis procedurat e njohjes duhet të ketë një interes ligjor për të kërkuar që vendimi i huaj gjyqësor në fjalë të njihet dhe të deklarohet i zbatueshëm në Serbi.⁸⁰³

Vendimet gjyqësore për masat e përkohshme ose kalimtare nuk mund të njihen dhe ekzekutohen, pasi nuk janë të formës së prerë.⁸⁰⁴

6.3 Nisja e procedurës (si çështje kryesore ose paraprake)

Në Serbi, njohja e vendimeve të huaja gjyqësore mund të jetë çështja kryesore e procedurave ose mund të zgjidhet si çështje paraprake në procedurat që përfshijnë një çështje tjetër (njohja rastësore/paraprake).⁸⁰⁵

Vendimi për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor si çështje kryesore bëhet në procedurat jokontestimore përpara gjykatës së lartë ose gjykatës për çështje tregtare, në varësi të faktit nëse vendimi i huaj është dhënë për një çështje civile apo tregtare.⁸⁰⁶ Palët, si dhe çdo person që mund të pretendojë një interes në njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor, mund të bëjnë kërkesë për njohje.⁸⁰⁷ Vendimi për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor të dhënë në këto procedura mbart efekte “erga omnes”.

Megjithatë, përpara se të jepet një vendim me efekt “erga omnes” për njohjen e një vendimi të

⁷⁹⁹ M. Stanivuković, Živković, op. cit., 439.

⁸⁰⁰ Shihni nenin 1 të LDNP-së së Serbisë.

⁸⁰¹ M. Stanivuković, Živković, op. cit., 439.

⁸⁰² Shihni Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 537-539; M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 279-285; M. Stanivuković, Živković, op. cit., 437-438.

⁸⁰³ M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 340; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 558.

⁸⁰⁴ Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 539.

⁸⁰⁵ Shihni nenin 101 të LDNP-së së Serbisë; M. Stanivuković, Živković, op. cit., 440; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 557.

⁸⁰⁶ Neni 23 dhe 25 të LOGJ-së.

⁸⁰⁷ M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 340; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 558.

huaj gjyqësor, çdo gjykatë në Serbi mund të nxjerrë një vendim paraprak për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor në procedurat që përfshijnë një çështje tjetër (pavarësisht nëse janë procedura kontestimore, jokontestimore ose përmbartimore), rast në të cilin kjo njohje zbatohet vetëm për ato procedura (neni 101, paragrafi 5 i LDNP-së së Serbisë). Në praktikë, njohja e një vendimi të huaj ndodh më shpesh si çështje paraprake në procedurat përmbartimore⁸⁰⁸ (shihni më poshtë në seksionin 7.1.1.).

6.4 Dokumentet që duhet të prodhohen (kërkesat zyrtare) për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore

Krahas kërkesës me shkrim për nisjen e procedurave të njohjes përpara një gjykate serbe, kërkuuesi duhet të dorëzojë:⁸⁰⁹

- vendimin e huaj gjyqësor origjinal ose kopjen zyrtare të noterizuar të tij (të dyja duhet të jenë të noterizuara siç duhet);
- përkthimin e noterizuar në gjuhën serbe të vendimit të huaj gjyqësor;
- vërtetimin e lëshuar nga autoriteti kompetent i huaj, i cili provon se vendimi i huaj gjyqësor ka marrë formë të prerë (me përjashtim të rastit kur ky vërtetim gjendet brenda vendimit), si dhe përkthimin e noterizuar në gjuhën serbe të atij vërtetimi;
- për vendimet e huaja gjyqësore me karakter ndëshkimor, vërtetimin e lëshuar nga autoriteti kompetent i huaj, i cili provon se vendimi i huaj gjyqësor është bërë i ekzekutueshëm (me përjashtim të rastit kur ky vërtetim gjendet brenda vendimit), si dhe përkthimin e noterizuar në gjuhën serbe të vërtetimit.

6.5 Kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Kushtet për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore janë të njëjta me kushtet për ekzekutimin e tyre (d.m.th. deklarimin e tyre të ekzekutueshëm) dhe rregullohen nga nenet 87-96 të LDNP-së së Serbisë. Para së gjithash, vendimi i gjykatës së huaj mund të njihet dhe ekzekutohet në Serbi vetëm nëse ka marrë formë të prerë (ka fuqi ligjore) dhe është i ekzekutueshëm sipas legjislacionit të shtetit të origjinës (nenet 87 dhe 96 të LDNP-së së Serbisë). Njohja dhe ekzekutimi do të refuzohen nëse:

- palës i është ndaluar që të marrë pjesë në procedura përpara gjykatës së huaj (neni 88 i LDNP-së së Serbisë). Përkatësisht, gjykata serbe nuk e njeh dhe ekzekuton një vendim të huaj gjyqësor nëse ai përcakton, pas kundërshtimit të personit ndaj të cilit është shpallur vendimi, se ai person nuk ka arritur të marrë pjesë në procedura përpara një gjykate të huaj për shkak të parregullsive procedurale (neni 88, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë). Konsiderohet se këto parregullsi ekzistojnë veçanërisht nëse ndonjë letërthirrje, fletë-thirrje ose vendim përmes së cilit janë nisur procedurat nuk i është përcjellë personit ndaj të cilit është shpallur vendimi ose nuk është tentuar shërbimi personal, me përjashtim të rastit kur ky person ka marrë pjesë në procedura në njëfarë mënyre (neni 88, paragrafi 2 i LDNP-së së Serbisë);⁸¹⁰
- nëse gjykatat serbe kanë juridiksionin ekskluziv për çështjen (neni 89 i LDNP-së së Serbisë). Duhet të theksohet në veçanti se vetëm ekzistenca e juridiksionit ekskluziv të gjykatave serbe në çështjen për të cilën është dhënë vendimi i huaj gjyqësor, përbën baza për mosnjohjen dhe mosekzekutimin e atij vendimi. Nuk ka rregulla të veçanta për

juridiksionin e tërthortë;

- një gjykatë serbe apo autoritet tjetër kompetent e ka shpallur ndërkohë vendimin e formës së prerë për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë apo nëse një vendim i huaj gjyqësor për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë është njohur ndërkohë në Serbi (neni 90, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë - "res iudicata"). Duhet të theksohet se: nëse vendimi i formës së prerë për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë është shpallur nga një gjykatë serbe, vendimi i huaj gjyqësor nuk mund të njihet dhe ekzekutohet pavarësisht faktit nëse procedurat përpara gjykatës së huaj kanë nisur më parë se procedurat përpara gjykatës serbe ose nëse vendimi i huaj është shpallur më parë se vendimi i gjykatës serbe.⁸¹¹ Megjithatë, gjykata do të pezullojë njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor nëse procedurat e nisura më herët përpara gjykatës serbe për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë janë pezulluar, derisa të merret vendimi i formës së prerë dhe detyrues (neni 90, paragrafi 2 i LDNP-së së Serbisë);
- nëse vendimi i huaj gjyqësor shkel rendin publik/*ordre public* (neni 91 i LDNP-së Serbisë) - kjo arsye për mosnjohje dhe mosekzekutim duhet të interpretohet në një lente më të ngushtë. Vetëm shkeljet që kanë si objekt parimet thelbësore procedurale dhe materiale të sistemit juridik të Serbisë duhet të merren në konsideratë;⁸¹²
- nëse nuk ka reciprocitet midis Serbisë dhe vendit të origjinës për sa i përket njohjes së ndërsjellë dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore (neni 92, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë). Është me rëndësi të theksohet se reciprociteti, për sa i përket njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore, prezumohet derisa të vërtetohet e kundërta. Nëse ka dyshime lidhur me ekzistencën e reciprocitetit, Ministria e Drejtësisë së Serbisë jep një shpjegim (neni 92, paragrafi 3 i LDNP-së së Serbisë). Megjithatë, mungesa e reciprocitetit nuk përbën baza për mosnjohjen e vendimit të huaj gjyqësor në mosmarrëveshjet martesore ose në mosmarrëveshjet amtare dhe atërore, dhe nëse një shtetas serb kërkon njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj gjyqësor (neni 92, paragrafi 2 i LDNP-së së Serbisë).

Gjykata do të shqyrtojë *ex officio* bazat e specifikuar në pikat "b", "c" dhe "d", ndërsa bazat e specifikuar në pikat "a" dhe "e" do të shqyrtohen vetëm me kërkesë të njërës prej palëve.

Gjatë krahasimit të bazave për mosnjohje dhe mosekzekutim të rregulluara nga LDNP e Serbisë me ato të parashikuara nga neni 7 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", mund të thuhet se ekzistojnë ngjashmëri, por edhe ndryshime. Për sa i përket ngjashmërive, të dyja parashikojnë shkeljet e të drejtave të të paditurit për organizimin e mbrojtjes së tij/saj në procedura, shkeljet e rendit publik dhe "res iudicata" si baza për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Sidoqoftë, këto baza nuk janë të rregulluara në mënyrë identike. Së pari, baza që ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për mbrojtje rregullohet më me rigorozitet nga neni 7, paragrafi 1, germa "a" e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", i cili parashikon që dokumenti i nisjes së procedurave në shtetin e origjinës (duke përfshirë deklaratën e elementeve thelbësore të kërkesëpadisë) nuk i është njoftuar të paditurit në kohën e duhur dhe në mënyrë të atillë që ai/ajo të organizonte mbrojtjen, ose i është njoftuar të paditurit në shtetin e kërkuar në një mënyrë të papajtueshme me parimet e shtetit të kërkuar, për sa i përket njoftimit të dokumenteve. Së dyti, shkelja e rendit publik si bazë për mosnjohjen rregullohet më me saktësi në nenin 7, paragrafi 1, germa "c" e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 "Për vendimet gjyqësore", i cili parashikon me detaje që njohja dhe ekzekutimi do të jenë shprehimisht të papajtueshme me rendin publik të shtetit të kërkuar, duke marrë parasysh parimet e tij thelbësore të drejtësisë procedurale dhe situatat lidhur me shkeljen e sigurisë dhe sovranitetit të tij, ndërkohë që neni 91 i LDNP-së së Serbisë thjesht parashikon se vendimi i huaj

808 Shihni Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 559-560.

809 M. Stanivuković, Živković, op. cit., 442-443.

810 Për më shumë shihni M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 287-291; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 546-548; M. Stanivuković, Živković, op. cit., 454-456.

811 M. Stanivuković, Živković, op. cit., 458.

812 Shihni M. Dika, G. Knežević dhe S. Stojanović, op. cit., 300-304; Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 553-555; M. Stanivuković, Živković, op. cit., 456-458.

gjyqësor duhet të jetë i papajtueshëm me rendin publik. Së treti, për sa i përket rregullimit “res iudicata” si bazë për refuzim të njohjes dhe ekzekutimit, ekzistojnë dallime për sa i përket vendimit të huaj gjyqësor, që është dhënë më herët nga gjykata e një shteti tjetër. Ndërkohë që neni 90, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë parashikon që një vendim i huaj gjyqësor në mosmarrëveshje ndërmjet palëve duhet të njihet në Serbi në mënyrë që të përfaqësojë bazën “res iudicata” për mosnjohje dhe mosekzekutim, neni 7, paragrafi 1, germa “f” e Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” kërkon që një vendim i mëparshëm gjyqësor i dhënë nga gjykata e një shteti tjetër ndërmjet të njëjtave palë, për të njëjtën çështje, të përmbushë kushtet për njohje në shtetin e kërkuar. Kjo do të thotë se ky vendim nuk ka nevojë që të jetë njohur më parë në procedura njohjeje të veçanta, për t’u bërë bazë “res iudicata”. Vlen të përmendet edhe se neni 7, paragrafi 2 i Konventës së HCCH-së të vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” bën të mundur shtyrjen ose refuzimin e njohjes dhe të ekzekutimit, nëse procedurat e nisura më herët ndërmjet të njëjtave palë për të njëjtin objekt janë pezulluar përpara gjykatës së shtetit të kërkuar dhe nëse çështja lidhet ngushtë me shtetin e kërkuar. Kjo dispozitë përkon, deri në njëfarë mase, me dispozitën e nenit 90, paragrafi 2 të LDNP-së së Serbisë, me dallimin se kjo e fundit e detyron gjykatën serbe të shtyjë njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor nëse procedurat e nisura më herët përpara një gjykate serbe për të njëjtën çështje dhe ndërmjet të njëjtave palë janë pezulluar dhe nuk kërkon që mosmarrëveshja të ketë lidhje të ngushtë me Serbinë në cilësinë e shtetit të kërkuar.

Krahas bazave të lartpërmendura për mosnjohje dhe moszbatim, Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore” parashikon edhe dy baza të tjera që nuk mund të gjenden në LDNP-në e Serbisë. Së pari, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, germa “b”, njohja dhe ekzekutimi mund të refuzohen nëse vendimi është marrë përmes mashtrimit. Edhe pse kjo bazë nuk ekziston në LDNP-në e Serbisë, mund të nënkuptohet në bazat lidhur me shkeljen e rendit publik, të cilat rregullohen nga neni 91 i LDNP-së së Serbisë. Së dyti, neni 7, paragrafi 1, germa “d” parashikon se njohja dhe ekzekutimi mund të refuzohen nëse procedurat në gjykatën që ka dhënë vendimin kanë rënë ndesh me një marrëveshje, ose me një përcaktim në instrumentin e trustit, sipas të cilave mosmarrëveshja në fjalë duhej të zgjidhej në një gjykatë të një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës. Këto baza nuk ekzistojnë në LDNP-në e Serbisë dhe nuk mund të nënkuptohen në asnjë bazë tjetër që rregullohet nga ky ligj.

6.6 Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore

Siç u përmend më lart, gjykatat e larta kanë kompetencën për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore të dhëna për çështjet civile, ndërsa gjykatat e çështjeve me karakter tregtar kanë kompetencat për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore të dhëna për çështjet me karakter tregtar. Gjykatat e larta ose gjykatat e çështjeve me karakter tregtar, që kanë kompetenca vendore, do të jenë ato në territorin e të cilave duhet të kryhen procedurat e njohjes (neni 101, paragrafi 1 i LDNP-së së Serbisë). Ky rregull duhet të interpretohet si vijon: mjafton për përcaktimin e juridiksionit vendor nëse kërkuesi deklaron se ai/ajo mund ta përdorë vendimin e huaj gjyqësor në territorin e asaj gjykate.⁸¹³

Në rrjedhën e procedurave të njohjes, gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kërkesat për njohje dhe nëse është e nevojshme, mund të kërkojnë sqarime (informacione) nga gjykata e vendit të origjinës ose/dhe nga palët (neni 101, paragrafi 2 i LDNP-së së Serbisë). Një seancë dëgjimore do të zhvillohet nëse gjykata e konsideron të nevojshme për sqarim të mëtejshëm të fakteve (neni 11 i LPJK-së). Procedurat e njohjes mbyllen me vendimin për njohje të vendimit të huaj gjyqësor, i cili sjell efekte “erga omnes”. Palët mund ta ankimojnë këtë vendim në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Apelit për Çështjet me Karakter Tregtar, brenda një periudhe 15-ditore

që nga dita e shpalljes së vendimit (neni 101, paragrafi 3 i LDNP-së së Serbisë).

Kur vendimi për njohjen e një vendimi gjyqësor me karakter ndëshkimor merr formë të prerë, vendimi i njohur duhet të ekzekutohet si të gjitha vendimet e tjera me karakter ndëshkimor, në përputhje me rregullat e LEBS-së.⁸¹⁴

7. Ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore

7.1 Lloji i procedurës përmbarimore

Në Serbi, ekziston një lloj i procedurave përmbarimore, të cilat mund të quhen si procedura përmbarimore të përgjithshme. Ajo përbëhet nga dy faza.⁸¹⁵

7.1.1. Faza e parë

Faza e parë e procedurave përmbarimore kryhet nga gjykata. Kjo fazë nis me dorëzimin e kërkesës së kreditorit për ekzekutim, së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme, në veçanti një vendim gjyqësor i ekzekutueshëm ose instrument tjetër i ekzekutueshëm (p.sh. një vendim i ekzekutueshëm i gjykatës së arbitrazhit)⁸¹⁶ ose një dokument i verifikuar i ekzekutueshëm (p.sh. një faturë e lëshuar nga një kreditor për një debitor),⁸¹⁷ pranë gjykatës themelore ose gjykatës për çështjet me karakter tregtar,⁸¹⁸ në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë.⁸¹⁹ Brenda një periudhe tetë ditore, që nga marrja e kërkesës së kreditorit, gjykata shqyrton kërkesat për ekzekutim dhe jep vendimin për ekzekutueshmërinë, nëse janë përmbushur kërkesat ose vendimin për refuzimin e ekzekutimit, nëse kërkesat nuk janë përmbushur.⁸²⁰ Palët mund ta ankimojnë këtë vendim në të njëjtën gjykatë (d.m.th. në gjykatën themelore ose gjykatën për çështjet me karakter tregtar) brenda tetë ditëve,⁸²¹ ku procesi i ankimit normalisht nuk e vonon ekzekutimin.⁸²² Gjykata do të refuzojë ankimimet e dorëzuara me vonesë dhe/ose joshteruese.⁸²³ Në rastet kur një ankimim shterues është dorëzuar në kohë, gjykata ia përcjell atë, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme, gjykatës së shkallës së dytë, d.m.th. gjykatës së lartë ose Gjykatës së Apelit për Çështjet me Karakter Tregtar,⁸²⁴ e cila do të vendosë lidhur me ankimin.⁸²⁵

Për sa i përket kësaj faze të procedurave, neni 46 i LEBS-së përmban dispozita të veçanta për ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore me karakter ndëshkimor, ku njohja e këtyre vendimeve lind si çështje paraprake në procedurat përmbarimore.⁸²⁶ Në raste të tilla, krahas kërkesave të tjera të parashikuara nga LEBS, gjykata shqyrton nëse kushtet për njohjen, të parashikuara nga nenet 86-96 të LDNP-së së Serbisë janë përmbushur⁸²⁷ dhe më pas jep vendimin për ekzekutimin e vendimit të huaj gjyqësor ose vendimin për refuzimin e ekzekutimit të tij. Në ankimin e këtij vendimi, palët mund të arsyetojnë përmbushjen ose mospërmbushjen e kushteve për njohje, si arsye të ankimit.⁸²⁸

814 Neni 46, paragrafi 1 i LEBS-së.

815 B. Poznić, V. Rakić-Vodinelić, Građansko procesno pravo, Beograd 2015, 574.

816 Të gjitha llojet e dokumenteve/titujve ekzekutues renditen në nenin 41 të LEBS-së.

817 Dokumentet të cilat merren në konsideratë për t’u verifikuar rregullohen nga neni 52 i LEBS-së.

818 Neni 6, paragrafi 1 i LEBS-së.

819 Neni 7 i LEBS-së.

820 Neni 64 i LEBS-së.

821 Neni 25, paragrafi 1 i LEBS-së.

822 Neni 25, paragrafi 2 i LEBS-së.

823 Neni 76, paragrafi 2 i LEBS-së.

824 Neni 6, paragrafi 2 i LEBS-së.

825 Neni 6, paragrafët 2 dhe 77 etj., të LEBS-së.

826 Neni 46, paragrafi 2 i LEBS-së.

827 Neni 46, paragrafi 3 i LEBS-së.

828 Neni 46, paragrafi 4 i LEBS-së.

813 Varadi, B. Bordaš, G. Knežević, V. Pavić, op. cit., 558.

Si përfundim, duhet të theksohet se kjo fazë e procedurave përmbartimore mund të kryhet vetëm nga agjenti zbatues, nëse objekti i instrumentit të ekzekutueshëm ose i dokumentit të verifikuar të ekzekutueshëm është rikuperimi i borxheve që kanë lindur nga veprimtaritë komunale.⁸²⁹

7.1.2. Faza e dytë

Sapo gjykata të japë vendimin për ekzekutim, ajo e përcjell atë pranë agjentit zbatues, së bashku me kopjet e të gjitha dokumenteve të nevojshme për kryerjen e ekzekutimit⁸³⁰ (gjenden në kërkesën e kreditorit për ekzekutim), gjë e cila shënjon dhe nisjen e fazës së dytë të procedurave përmbartimore. Në këtë fazë, agjenti zbatues kryen aktet konkrete të ekzekutimit duke përdorur mjetet dhe metodat e ndryshme, të propozuara nga kreditori në kërkesën e tij/saj për ekzekutim. Këto mjete/metoda ekzekutimi ndahen në dy kategori: mjetet për shlyerjen e detyruar të kërkesëpadive në vlerë monetare (si p.sh. shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, transferimi i fondeve nga llogaria e debitorit etj.) dhe mjetet për përmbushjen e detyruar të kërkesëpadive të tjera (jomonetare) (p.sh. dorëzimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit).⁸³¹ Megjithatë, duhet të përmendet se gjykata ka kompetencat ekskluzive për kryerjen e fazës së dytë të procedurave përmbartimore në disa raste specifike në lidhje me veprimet që duhet të kryhen nga një debitor ose me mosveprimet e një debitori, si dhe në rastet lidhur me kthimin e punëmarrësve në punë dhe me zbatimin e vendimeve për marrëdhëniet familjare (me përjashtim të detyrimeve ushqimore).⁸³²

7.2 Procedura përmbartimore në situatat kur nëpunësit zbatues përballen direkt me vendimin e gjykatës së huaj

Siç është përmendur tashmë në këtë studim, gjykata ka kompetencat ekskluzive për të njohur një vendim të huaj me karakter ndëshkimor dhe zakonisht kryen fazën e parë të procedurave përmbartimore lidhur me vendimet e huaja gjyqësore me karakter ndëshkimor, të cilat janë njohur më parë. Kjo do të thotë se agjenti zbatues mund të njihet me vendimin në fjalë në fazën e dytë të procedurave përmbartimore, kur tashmë vendimi është njohur dhe kur vendimi i gjykatës për ekzekutimin e tij është shpallur ndërkohë. Në të tilla situata, detyra e agjentit zbatues është që të kryejë veprimet konkrete përmbartimore duke përdorur mjetet dhe metodat e propozuara.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë faktin që agjenti zbatues ka tagrin që të kryejë fazën e parë të procedurave përmbartimore në lidhje me një vendim gjyqësor të ekzekutueshëm, i cili ka të bëjë me rikuperimin e borxheve që lindin nga veprimtaritë komunale, mund të shfaqen probleme nëse ky vendim i huaj gjyqësor ka karakter ndëshkimor (në raste të rralla), zbatimi i të cilit kërkohet nga kreditori përpara se të njihet nga gjykata. Sipas dispozitave të LEBS-së, një nga përfundimet e mundshme mund të jetë që agjenti zbatues të vendosë për njohjen e një vendimi të huaj gjyqësor me karakter ndëshkimor si çështje paraprake. Sidoqoftë, ky përfundim është i gabuar pasi neni 86 i LDNP-së së Serbisë parashikon shprehimisht se vetëm gjykata mund të vendosë për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Krahas kësaj, neni 46, paragrafi 3 i LEBS-së deklaron se gjykata kompetente për procedurat përmbartimore vendos paraprakisht për njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore dhe kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë rigorozë. Duke pasur parasysh këtë gjë, nëse agjenti zbatues në fazën e parë të procedurave përmbartimore has në vendime të huaja gjyqësore, të cilat nuk janë njohur, ai/ajo nuk mund të vendosë paraprakisht për njohjen e tyre, pra ai/ajo duhet t'i ndërpresë procedurat përmbartimore dhe ta drejtojë kreditorin për nisjen e procedurave të njohjes përpara gjykatës.

8. Referenca

- Brandt, The Hague Judgments Convention in the United States: A "Game Changer" or a New Path to the Old Game?, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3747078, 2020.
- Dika, Knežević, Stojanović, Komentar Zakona o međunarodnom privatnom i procesnom pravu, Beograd 1991
- Đorđević, Primena međunarodnog privatnog prava u javnobeležničkoj praksi, http://www.beleznik.org/images/pdf/obavestenje/uputstvo_za_primenu_mpp_u_jb_praksi.pdf
- Ligji "Për ekzekutimin dhe barrën siguruuese" – referuar me shkurtimin LEBS, Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 106/2015, 106/2016, 113/2017 dhe 54/2019.
- <https://www.mpravde.gov.rs/sekcija/5/medjunarodna-saradnja.php>
- <https://www.paragraf.rs>
- <https://www.stat.gov.rs/oblasti/spoljna-trgovina/>
- Jakšić, Međunarodno privatno pravo, opšta teorija, Beograd 2017
- Ligji „Për procedurën kontestimore“ – referuar me shkurtimin LPK, Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 72/2011, 49/2013 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese 74/2013 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 55/2014, 87/2018 dhe 18/2020.
- Ligji "Për procedurën jokontestimore" – referuar me shkurtimin LPJK, Fletorja Zyrtare e RSS-së, Nr. 25/82 dhe 48/88 dhe Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 46/95 - ligje të tjera, 18/2005 - ligje të tjera, 85/2012, 45/2013 - ligje të tjera, 55/2014, 6/2015 dhe 106/2015 - ligje të tjera.
- Poznić, V. Rakić-Vodinelić, Građansko procesno pravo, Beograd 2015, 574.
- Rumenov, The indirect jurisdiction of the 2019 Hague Convention on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters – is the "heart" of the Convention in the right place?, SHIHNI - Journal, issue 1, No. 8, 2021,
- Stanivuković, P. Đundić, Međunarodno privatno pravo, posebni deo, Novi Sad 2008, 69-70.
- Stanivuković, Živković, Međunarodno privatno pravo, Beograd 2008
- Stanivuković, Živković, Serbia, në: Verschraegen, B. (ed.), International Encyclopedia of Laws, vol. 2, Private International Law, supp. 21, Kluwer Law International 2009
- Ligji "Për zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me rregulloret e vendeve të tjera" (ligji i Serbisë "Për të drejtën ndërkombëtare private", referuar me shkurtimin LDNP i Serbisë), Fletorja Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 43/82 dhe 72/82 – Ndryshimi në Fletoren Zyrtare të RFJ-së, Nr. 46/96 dhe Fletorja Zyrtare e RS-së, Nr. 46/2006 – ligje të tjera.
- Varadi, 'Anerkennung und Vollstreckung ausländischer Entscheidungen in Jugoslawien', RabelsZ 51 (1987)
- Varadi, Bordaš, Knežević, Pavić, Međunarodno privatno pravo, Beograd 2012
- Wilderspin, L. Vysoka, The 2019 Hague Judgments Convention through European Lenses, <https://www.nipr-online.eu/pdf/2020-138.pdf>, 2020.

829 Neni 3, paragrafi 3 i LEBS-së.

830 Neni 70 i LEBS-së.

831 Neni 54 i LEBS-së.

832 Neni 4, paragrafët 1, 363, 364 dhe 366 të LEBS-së.

